# RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI (TEMATIK)
# NË
# "NJËSITË ADMINISTRATIVE KASHAR, VAQARR DHE ZALL-BASTAR"

**Tiranë 2023**

## PERMBAJTJA

**Faqe**

**I. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE**
**1. Përshkrim i shkurtër i Projektit të Auditimit.......................................................... 2-6**
**2. Përshkrim i gjetjeve kryesore dhe rekomandimeve................................................ 6-16**
**3. Konkluzioni i përgjithshëm dhe Opinioni i auditimit............................................ 16-20**

**II. Hyrje …...………………....................................................................................... 20-23**

**a. Titulli**
**b. Marrësi**
**c. Objektivat dhe qëllimi**
**d. Identifikimi i çështjes**
**e. Përgjegjësitë e strukturave drejtuese**
**ë. Përgjegjësitë e audituesve**
**f. Kriteret e vlerësimit**
**g. Standardet e Auditimit**
**h. Metodat e auditimit**
**i. Dokumentimi i auditimit**

**III. PËRSHKRIMI I AUDITIMIT**.

**III.1. Informacion i përgjithshëm mbi subjektin nën auditim…………………………23-24**

**III.2. Rezultatet e auditimit sipas drejtimeve të auditimit…………………………... 24-100**
**Auditimi i procedurave të ndjekura nga Njësia Administrative/Bashkia për saktësinë e lëshimit të AMTP-ve, në referencë të dispozitave të ligjeve nr. 9948, datë 7.7.2008, të ndryshuar, nr. 57/2012 dhe nr. 171/2014.**
Auditimi i dokumentacionit për vendimet që konfirmojnë vlefshmërinë e AMTP-ve për regjistrim në ASHK.
Auditimi i dokumentacionit për vendimet që shfuqizojnë pjesërisht AMTP-të, për shkak të tejkalimit të normës për frymë;
Auditim i dokumentacionit për vendimet që shfuqizojnë AMTP-të, për shkaqe që lidhen me legjitimimin ose me llojin e pasurisë.
**Auditimi i procedurave të ndjekura nga Njësia Administrative/Bashkia për konfirmimin e saktësisë të AMTP-ve dhe pozicionimit të planvendosjeve të tyre, në referencë të dispozitave të ligjit 33/2012 dhe 20/2020.**
Auditimi i dokumentacionit dërguar për regjistrim në ASHK.
Konfirmimi i akteve dhe planeve të rilevimit, sipas kërkesave të ASHK, për praktikat që janë kërkuar konfirmime.
Praktikat e dërguara për regjistrim në ASHK, konfirmuar më parë në Bashki.
Praktikat e dërguara për regjistrim në ASHK, konfirmuar më parë nga Kadastra e Këshillit të Qarkut Tiranë.

**IV. GJETJET DHE REKOMANDIMET........................................................ 101-113**

# I. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

## *I.1. Përshkrim i shkurtër i Projektit të Auditimit*

***I.1.A*** *Të dhënat e paraqitur nga* ***Njësia Administrative Kashar*** për konfirmimin e AMTP për regjistrim dhe procedurën e ndjekur për plotësimin e dokumentacionit tekniko ligjorë dhe dërgimin e dosjeve në Drejtorinë e Përgjithshme të Objekteve në Bashkëpronësi, Administrimit të NJA-ve dhe Emergjencave Civile (DANJA-ve/AMTP-ve), Bashkia Tiranë, ku kjo e fundit pas verifikimit të mëtejshëm për dërgimin e tyre në ASHK Tiranë për regjistrim, në zbatim të urdhrit të Kryetarit të Bashkisë Tiranë nr. 26474/1 datë 02.09.2016 "Për delegimin e kompetencave nga Bashkia Tiranë tek Njësitë Administrative nën administrim territorial dhe administrativ të Bashkisë Tiranë për kryerjen e procedurave që lidhen me krijimin e titujve të rinj të pronësisë mbi tokën bujqësore dhe të procedurave që lidhen me shqyrtimin e vlefshmërisë tekniko-ligjore të titujve të pronësisë të krijuara, mbi tokën bujqësore të ish ndërmarrjeve bujqësore dhe ish kooperativave bujqësore", i ndryshuar, në mbështetje në VKM-në nr. 994, datë 09.12.2015 "Për mënyrën e procedimit për pasuritë e paluajtshme, të fituara me Aktin e Marrjes të Tokës në Pronësi (AMTP), të nenit 9 të Ligjit nr. 9948, datë 7.7.2008, "Për shqyrtimin e vlefshmërisë ligjore të krijimit të titujve të pronësisë mbi tokën bujqësore", të ndryshuar, të Ligjit nr. 171/2014, "Për përfundimin e procedurave ligjore të kalimit të tokës bujqësore të ish-ndërmarrjeve bujqësore në pronësi të përfituesve", i ndryshuar, si dhe të neneve 25 dhe 45 të ligjit 33/2012 datë 21.03.2012 "Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme" dhe ligji nr. 111/2018 "Për Kadastrën".

- Në 21 raste, ne listat e trojeve 0001 të ZK 2105 Kashar janë pasqyruar 2 - 3 troje për çdo kryefamiljar, ne vend te 1 trualli deri 300 m2, madje listat pasqyrojne sipërfaqe mbi normën 300 m$^2$, në kundërshtim me dekretin e Presidentit nr. 5747 datë 29.06.1978 dhe ligjin nr. 33/2012 "*Për regjistrimin e pasurive të Paluajtshme" ndryshuar* si dhe Rregulloren 184 datë 08.04.1999, ndryshuar nr. 7 datë 07.01.2000 "*Për punën e ZVRPP".* Pranimi i kësaj liste te parregullt është në kundërshtim me VKM nr. 556 datë 23.10.2000 "*Për dorëzimin dokumentacionit në ZVRPP".*
- Ne 20 raste, ne Kashar disponohen 2 - 3 AMTP për te njëjtin kryefamiljar, ne vend te 1 AMTP, madje AMTP paraqesin korrigjime dhe mungese te dhënash, ne kundershtim me ligjin 7501 datë 19.7.1991 "*Për tokën*", me ligjin 9948 datë 7.07.2008 "*Për Shqyrtimin vlefshmërisë ligjore krijimit titujve pronësisë mbi tokën bujqësore"* ndryshuar, me nenin 119 "*Pavlefshmëria akteve*"
- Ne 1 rast, ish-komuna Kashar nuk ka dokumentacion sqarues shkresor në lidhje me kompensimin e sipërfaqes 1000 m$^2$, që rezulton ne zërin kadastral "kanal", pasuri e patjetërsueshme sipas kontratës së shitjes 05.09.2013 midis AKKP Tirane shitës dhe blerës "K$M-OIL" shpk, ne kundërshtim me nenin 7/1 dhe nenin 11/1/a te ligjit nr. 9235 date 29.07.2004 i ndryshuar "*Për kthimin dhe kompensimin e pronës".*
- Ne 3 raste, është ndryshuar zëri kadastral nga "pyll" ne "ullishte" dhe "are", pjesë e pasurisë "pyll" nr. 94 shtet, ZK 2105, vol 14, faqe 13, duke lëshuar AMTP, copëzuar, shitur dhe janë kryer ndërtime me leje dhe pa leje mbi këto pasuri, veprime në kundërshtim me nenin 2 dhe 21 te ligjit nr. 7501 date 19.07.1991 "*Per token",* me nenin 10 dhe 14 te ligjit nr. 9244 date 17.06.2004 "*Per mbrojtjen e tokes bujqesore",* me nenin 17 të ligjit 9385 datë 4.5.2005 "*Për pyjet dhe kullotat*".
- Ne 1 rast, sipas vendimit nr. 47 date 31.01.2017 KVVTP, ka shpallur me pavlefshmëri te plote për AMTP-në nr. 331/1996 rrjedhimisht edhe për pasurinë nr. 154 për 3200 m$^2$ "arë", e cila rezulton e shitur në të tretë. Nga Njësia Administrative Kashar nuk disponohet dokument

për arkëtimin e vlerës 1,433,600 leke nga familjaret e HV, (*pasuria e regjistruar nr. 1154/38, vol 17, faqe 111, ZK 2105),* ne kundershtim me ligjin 9948 datë 7.07.2008 "*Për Shqyrtimin vlefshmërisë ligjore krijimit titujve pronësisë mbi tokën bujqësore"* ndryshuar, me ligjin 7501 datë 19.7.1991 "*Për tokën*".
- Ne 1 rast, mungon dokumenti qe vërteton se sipërfaqja 5150 m2 B.F.S. ka kaluar ne pronësi "shtet" nen administrimin e njësisë vendore Kashar, pasi është toke pa frutë (PF), pra nuk është objekt i AMTP nr. 711/69, date 20.05.1996, shfuqizuar sipas vendimit gjykatës administrative shkalles pare Tirane nr. 2568 date 09.06.2017 dhe vendimit nr. 11 date 31.01.2017 te KVVTP Tirane.
- Ne 1 rast, nuk sqarohet diferenca 1700 m2 truall *(2000-300)* ne relacionin shpjegues nr. 1242 date 17.06.2020 te njësisë Kashar, pasi ne mënyre te paligjshme sipërfaqja 2000 m2 truall përfituar nga ES pasqyrohet ne AMTP 151 date 01.10.1992 dhe formularin 6, ne vend te 300 m2 truall qe pasqyrohet ne listën e trojeve 001.
- Ne 3 raste, paraqiten vonesa te pajustifikuara ne korrespondencat midis institucioneve njësi-bashki-subjekt-ASHK, pasi procedura e sqarimit te problemeve te AMTP-ve ka zgjatur nga viti 2017 deri 2022 dhe vazhdon ne proces, konkretisht:
- lidhur me AMTP .date 17.05.1996; AMTP 150/1992; AMTP nr. 65.
-Në 3 raste, nuk sqarojnë pasuritë e shpërndara me AMTP, te cilat ndodhen midis 2 fshatrave Kashar dhe Katund i ri, ne vend te 1 fshati ku banon përfituesi i AMTP.
- Në 7 raste, relacionet, nuk sqarojnë diferencat e sipërfaqeve dhe sistemimin e tyre, midis AMTP - formularit 6 - planrilevimeve.
- Ne 1 rast, Njësia Kashar nuk sqaron llojin e pasurisë 299/ për 800 m2 te AMTP 108/1995,
- Ne 1 rast, Njësia Kashar nuk sqaron ne relacion menaxhimin e pasurisë "shtet" 562/8 për 1037 m2, vol 25, faqe 74, ZK 2105, pasi është e okupuar nga E.E., sipas shkresës ZRPP nr. 30010 date 03.09.2018 dhe date 12.02.2020.
- Në 14 raste praktika e akivuar pranë Njësisë Administrative ka mangësi dhe mos plotësim të dokumentacionit të kërkuar ligjor për regjistrimin e pasurisë "Tokë bujqësore" sipas AMTP të lëshuara në zbatim të ligjit "Për tokën" si dhe relacioni shpjegues nuk ka referime e përcaktime për pozicionimin e pasurisë,
- Në 6 raste në relacionin shpjegues nuk ka referime e përcaktime për pozicionimin e pasurisë e cila bie në status "PF", si dhe nuk ka dokumentacion shterues mbi vlefshmërinë e lëshimit të AMTP-ve.

***I.1.B*** *Të dhënat e paraqitur nga* ***Njësia Administrative Vaqarr***, për konfirmimin e AMTP për regjistrim dhe procedurën e ndjekur për plotësimin e dokumentacionit tekniko ligjorë dhe dërgimin e dosjeve në Drejtorinë e Përgjithshme të Objekteve në Bashkëpronësi, Administrimit të NJA-ve dhe Emergjencave Civile (DANJA-ve/AMTP-ve), Bashkia Tiranë, ku kjo e fundit pas verifikimit të mëtejshëm për dërgimin e tyre në ASHK Tiranë për regjistrim, në zbatim të urdhrit të Kryetarit të Bashkisë Tiranë nr. 26474/1 datë 02.09.2016 "Për delegimin e kompetencave nga Bashkia Tiranë tek Njësitë Administrative nën administrim territorial dhe administrativ të Bashkisë Tiranë për kryerjen e procedurave që lidhen me krijimin e titujve të rinj të pronësisë mbi tokën bujqësore dhe të procedurave që lidhen me shqyrtimin e vlefshmërisë tekniko-ligjore të titujve të pronësisë të krijuara, mbi tokën bujqësore të ish ndërmarrjeve bujqësore dhe ish kooperativave bujqësore", i ndryshuar, në mbështetje në VKM-në nr. 994, datë 09.12.2015 "Për mënyrën e procedimit për pasuritë e paluajtshme, të fituara me Aktin e Marrjes të Tokës në Pronësi (AMTP), të nenit 9 të Ligjit nr. 9948, datë 7.7.2008, "Për shqyrtimin e vlefshmërisë ligjore të krijimit të titujve të pronësisë mbi tokën bujqësore", të ndryshuar, të Ligjit nr. 171/2014, "Për përfundimin e procedurave ligjore të kalimit të tokës bujqësore të ish-ndërmarrjeve bujqësore në pronësi të përfituesve", i ndryshuar, si dhe të neneve 25 dhe 45 të ligjit 33/2012 datë 21.03.2012 "Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme" dhe ligji nr. 111/2018 "Për Kadastrën".

*Rezultatet e auditimit sipas drejtimeve të auditimit:*

- Në 5 raste, rezulton se janë regjistruar në ASHK gjithsej 214 $m^2$ "truall" mbi normën mesatare prej 300 $m^2$ troje kjo e rezultuar nga rakordimi i listës të troje nr. 001 ZK 3321 administruar në ASHK me listën të troje nr. 001 ZK 3321 fshati " Sharrë" administruar në Njësinë Administrative Vaqarr.
- Në 1 rast, rezulton se pasuria nr. 301/4, ZK 3321, vol 1, faqe 26, me sipërfaqe 3200 $m^2$ aktualish pasuria mbi të cilën është lanfildi, rezulton e pa regjistruar megjithëse ka një korrespondencë të përsëritur midis NJA dhe ASHK dhe referuar AMTP nr. 41; LN dhe formularit nr. 6 është e llojit " arrë" ; "Vresht" dhe "Grope silazhi".
- Në 2 raste, rezulton se Komisioni i Ndarjes Tokës ka dhënë tokë të fshatit Vishaj dhe Damjan jashtë kufirit të fshatit Arbanë dhe ky veprim nuk është pasqyruar në relacionin shpjegues nr. 807, datë 25.03.2021, për regjistrimin e pasurive konkretisht sipas AMTP 71, pasuria 60/1 për 17000 $m^2$ dhe AMTP nr. 31 date 15.03.1993 për 11924 $m^2$, ZK 1315.
- Në 1 rast, rezulton se Njësia Administrative Vaqarr nuk ka zgjidhur kërkesën për saktësim nga DV ASHK Tirana Rurale 2 për azhurnimi hartës për gjendjen faktike në terren dhe pozicionin pasurive, tërheqjen e deklaratave noteriale të kufitarëve në ZK 2119 dhe ne ZK 2105.
- Në 2 raste, rezulton se ka vonesë mbi 10 vjet në korrespondencë Njësia administrative me ASHK për regjistrimin e pasurive sipas AMTP 45 date 19.05.1992, ZK 1017, Allgjate, Vaqarr dhe veprim të gabuar në kthimin e përgjigjes për pasurinë nr. 73/, ne vend te pasurisë nr. 83/14, ZK 1867, sipërfaqe 1000 $m^2$, vol 3, faqe 63, fshati Gropaj.
- Në 1 rast nuk ka sqarime për plan rilevimin e datës 23.10.2020 mbi përfshirjen e kanalit si pasuri publike në pasurinë e regjistruar me nr. 76/48, vol 3, faqe 83, sipërfaqe 3900 $m^2$ (1100 $m^2$ ndërtesa), ZK 1867, fshati Gropaj megjithëse nuk është përfshirë në AMTP që është bazë e regjistrimit të kësaj pasurie.
- Ne 7 raste, paraqitet moszbatim te afateve ligjore deri 1 vit, lidhur me korrespondencën për kthimin e përgjigjeve ndaj kërkesave dhe ri-kërkesave te ASHK dhe anasjelltas për Njësinë Vaqarr, nuk ka shpjegime ligjore për vonesën e përgjigjes. Si dhe nuk është plotësuar dokumentacioni ligjor i kërkuar nga DV ASHK Tirana Rurale.
- Ne 14 raste, dosjet e subjekteve kane mangësi dhe parregullsi ne dokumentacionin tekniko-ligjor, konkretisht: Në 2 raste, mungon HTR dhe formulari nr. 6; në 4 raste, mungon plan rilevimi ose janë te parregullta; në 3 raste, mungon dokumentacioni për argumentimin e diferencës sipërfaqes midis AMTP dhe vërtetimit pagesës taksave vendore, pasi pasqyrojnë sipërfaqe te ndryshme, çka tregon mos-rakordim me ASHK (për shitjet dhe transaksionet e pronës); në 1 rast, nuk përputhet AMTP date 10.08.1993 me formularin nr. 6; në 3 raste, deklaratat e kufitareve janë pranuar të parregullta, pasi janë pa date, pa numër, me korrigjime, mungojnë firmat e kufitareve, identiteti i kufitarit nuk është i sakte; në 1 rast, nuk përputhen kufitaret, midis deklaratës kufitareve dhe AMTP, për 1 pasuri, pasi sipas deklaratës ne perëndim ajo kufizohet me "shtet", në fakt sipas AMTP kjo pasuri ne perëndim kufizohet nga kufitar privat dhe jo shtet; në të gjitha rastet nuk disponohet vendimi ne njësinë vendore Vaqarr për normën për fryme, për rrjedhoje nuk argumentohet norma për fryme.
- Në 7 raste, relacionet shpjeguese nuk janë analitikë duke u trajtuar ne hollësi çdo mangësi dhe problematike përkatëse, paraqiten te pjesshëm në saktësimin e pasurive tokës bujqësore përfituar me AMTP, sipas kërkesës se ASHK, Bashkisë dhe subjektit, përkatësisht: Në 1 rast, relacioni sqaron një pasuri te AMTP, ndërsa nuk flet për pasuritë tjera te AMTP; në 2 raste, relacionin nuk sqaron mospërputhjen e AMTP-se me formularin nr. 6, pasi këta 2 dokumente pasqyrojnë numër dhe sipërfaqe te ndryshme te pasurive tokës bujqësore (AMTP përmban 1 pasuri, ndërsa formulari 6 përmban 3 pasuri); në 3 raste, relacioni nuk shpjegon pajisjen me 3 AMTP të familjes pandara nga trungu 1991, ne vend te 1 AMTP, nuk sqarohet sipërfaqja totale e marre sipas normës për frymë, nëse ka efekte; në 1 rast, relacioni shpjegues nuk sqaron dhënien e tokës me 2 standarde, pasi 2 familje me numër te njëjtë frymësh disponojnë sipërfaqe te ndryshme për te njëjtën ZK; në 2 raste, paraqitet mos-rakordim midis KPP dhe AMTP, madje KPP pasqyron emër tjetër.

-Në 3 raste në relacionin shpjegues nuk ka referime e përcaktime për pozicionimin e pasurisë konkretisht: - Pasuria me nr. 135, vol 1, faqe 150 ZK 3712 adresë Vaqarr lloji "kullotë" sipërfaqe 9140 $m^2$ pronësi "Shtet"; - Pasuria me nr. 52/36/1, vol 2, faqe 3 ZK 1867 adresë Gropaj lloji "truall" sipërfaqe 400 $m^2$ sipas akti dhe 600 $m^2$ ndërtesë 140 $m^2$; - Pasuria nr. 76/1, vol __, faqe __ ZK 3784 adresë Vishaj lloji "arrë" sipërfaqe 3220 $m^2$ që sipas akti rezulton e pa afishuar.

- Në 2 raste Nuk ka sqarime për ndryshimet e sipërfaqeve të pasurive dhe ndarjen e parcelave sipas regjistrimit fillestar konkretisht: - Pasuria nr. 294/6, vol. 2, faqe 53 në pronësi të Xh. L. me sip. 4500 $m^2$ e llojit "arrë" dhe Pasuria nr. 339/3, vol. 2, faqe 54 në pronësi të Xh. L. me sip. 2000 $m^2$ e llojit "arrë"; -për pasurinë nr. 46/12, Vol 9, faqe 121 ZK 3321 me sipërfaqe 2094 $m^2$. Veprime në kundërshtim me VKM nr. 994, datë 9.12.2015 "Për procedurën e regjistrimit të akteve të marrjes së tokës në pronësi"; me Ligjin nr. 20/2020, datë 03.05.2020 "Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë"; si dhe VKM nr. 1174, datë 24.12.2020 "Për procedurat e regjistrimit të AMTP-ve, saktësimin e kufijve e sipërfaqeve, si dhe normat për sipërfaqet shtetërore shtesë e pronat shërbyese".

***I.1.C.*** *Të dhënat e paraqitur nga* ***Njësia Administrative Zall-Bastar,*** për konfirmimin e AMTP për regjistrim dhe procedurën e ndjekur për plotësimin e dokumentacionit tekniko ligjorë dhe dërgimin e dosjeve në Drejtorinë e Përgjithshme të Objekteve në Bashkëpronësi, Administrimit të NJA-ve dhe Emergjencave Civile (DANJA-ve/AMTP-ve), Bashkia Tiranë, ku kjo e fundit pas verifikimit të mëtejshëm për dërgimin e tyre në ASHK Tiranë për regjistrim, në zbatim të urdhrit të Kryetarit të Bashkisë Tiranë nr. 26474/1 datë 02.09.2016 "Për delegimin e kompetencave nga Bashkia Tiranë tek Njësitë Administrative nën administrim territorial dhe administrativ të Bashkisë Tiranë për kryerjen e procedurave që lidhen me krijimin e titujve të rinj të pronësisë mbi tokën bujqësore dhe të procedurave që lidhen me shqyrtimin e vlefshmërisë tekniko-ligjore të titujve të pronësisë të krijuara, mbi tokën bujqësore të ish ndërmarrjeve bujqësore dhe ish kooperativave bujqësore", i ndryshuar, në mbështetje në VKM-në nr. 994, datë 09.12.2015 "Për mënyrën e procedimit për pasuritë e paluajtshme, të fituara me Aktin e Marrjes të Tokës në Pronësi (AMTP), të nenit 9 të Ligjit nr. 9948, datë 7.7.2008, "Për shqyrtimin e vlefshmërisë ligjore të krijimit të titujve të pronësisë mbi tokën bujqësore", të ndryshuar, të Ligjit nr. 171/2014, "Për përfundimin e procedurave ligjore të kalimit të tokës bujqësore të ish-ndërmarrjeve bujqësore në pronësi të përfituesve", i ndryshuar, si dhe të neneve 25 dhe 45 të ligjit 33/2012 datë 21.03.2012 "Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme" dhe ligji nr. 111/2018 "Për Kadastrën".

Në subjektin e audituar gjatë procesit të auditimit në terren, mbas ballafaqimit me personat përgjegjës në subjekt, nga grupi i auditimit janë mbajtur 2 Aktkonstatime të cilat janë dorëzuar në protokollin e subjektit. Në përfundim të punës në terren është kryer takimi ballafaques me përfaqësuesit e Njësisë Administrative Zall-Bastar.

*Rezultatet e auditimit sipas drejtimeve të auditimit:*

- Ne 1 rast, 2 pasuritë me sipërfaqe 3531 m2 *(1325+2206)* dhënë me AMTP date 22.06.1992 për familjen bujqësore ML, rezultojnë me certifikate pronësie ne emër te personave tjerë, qe ne vitin 2001 përkatësisht:

- Ne 1 rast, mungon korrespondenca pas vitit 2020 midis Njësisë Zall-Bastar dhe ASHK, për sqarimin dhe sistemimin e sipërfaqeve tepër 3893 m2 nëse kane kaluar *"shtet",* pasi 5 pasuritë regjistruar ne vitin 2001 (KPP) ne emër A Ç, fshati Bastar-Murriz, ZK 1125, janë me te mëdha se AMTP 70, formulari 6 dhe plan rilevimet, sipas relacionit shpjegues 07.09.2020.

- Ne 1 rast, relacioni shpjegues 15.11.2020 i njësisë Zall-Bastar nuk sqaron diferencën 11085 m2 *(21800-10715)* midis AMTP 22/1992 dhe vërtetimit taksave vendore ne emër S M, fshati Besh.

- Ne 1 rast, përfituar 2 AMTP nga familja D, ne 1992 pretendohet se ka qene e ndare ne 2 familje, ku disponohet 1 certifikate familjare ne vend te 2 certifikatave familjare, përkatësisht:

- Në 3 raste, dosjet e kthyera për mangësi dhe mungesë të dokumentacionit të konstatuara nga Drejtoria e Përgjithshme Juridike e Aseteve dhe Liçensimit, Drejtoria e Pasurive të Paluajtshme Bashkia Tiranë nuk janë plotësuar, por janë nisur përsëri më mangësi nga Njësia Administrative Zall-Bastar.
- Në 3 rast janë lëshuar AMTP-të me nr. 34, datë 18.08.2000; nr. 276, datë 18.08.2000; nr. 63, datë 18.08.2000 në kundërshtim me ligjin nr. 7501, datë 19.07.1991 "Për Tokën", me VKM nr. 994, datë 9.12.2015 "Për procedurën e regjistrimit të akteve të marrjes së tokës në pronësi"
- Në 1 rast nga Njësia Administrative Zall-Bastar në relacionin shpjegues nuk ka sqaruar pajisjen me AMTP familje bujqësore me gjendje pas datës 01.08.1991, nuk ka sqaruar normën për frymë të tokës bujqësore dhe të argumentonte zbatimin e saj.
- Në 2 rast ka mangësi dokumentare dhe nuk ka sqarime të dokumentuar:
- Në 1 rast nuk ka azhornim faktik të pasurive të regjistruara në ASHK me nr. 93, vol 1, faqe 93 ZK 3775 me sipërfaqe 6000 $m^2$ fshati Vilëz dhe nr. 711 vol. 3, faqe 211. 6600 $m^2$ "arrë" për saktësimin e gjendjen e pasurisë së poseduar faktikisht në terren veprime në kundërshtim me nenin 38 të ligjit nr. 111/2018.

### *I.2. Përshkrim i gjetjeve kryesore dhe rekomandimeve*

### *I.2.A. Njësia Administrative Kashar*

| Nr. | Përmbledhje e gjetjes | Referenca në Raport | Rëndësia | Rekomandimi |
|---|---|---|---|---|
| 1 | Nga auditimi u konstatua se Njësia Administrative Kashar:<br>a. nuk disponon listën e sipërfaqeve tokës tepër kaluar "shtet" nga ASHK, sipas subjekteve private objekt i legalizimeve, për diferencat midis pjesës te zaptuar me pjesën e legalizuar.<br>b. nuk disponon listën e sipërfaqeve tokës tepër kaluar "shtet" nga ASHK, sipas subjekteve private objekt i AMTP, për diferencat midis AMTP dhe matjeve ne terren ku sipërfaqja rezulton me e madhe se AMTP. Kështu parcelëzat "shtet" kane mbetur në posedim dhe shfrytëzim në mënyrë të paligjshme nga subjektet private, pa asnjë detyrim, taksë apo qira për buxhetin. | 24-55 | i mesëm | Njësia Administrative Kashar ne bashkëpunim me ASHK te marre masa për administrimin e sipërfaqeve tepër toke "shtet", diferenca midis pjesës zaptuar me atë legalizuar dhe midis AMTP dhe sipërfaqes ne terren, te cilat kane kaluar shtet nga ASHK. |
| 2 | Nga auditimi u konstatua se *Ne 4 raste (para periudhes auditimit)*, toka bujqesore e shperndare me AMTP ne Kashar nuk i ka sherbyer qellimit te ligjit nr. 7501 date 19.07.1991 *"Per token"* dhe ligjit nr. 9244 date 17.06.2004 *"Per mbrojtjen tokes bujqesore"*,per ruajtjen, mbrojtjen, permiresimin pjellorise tokes, per funksionet natyrore te saj si krijuese bazes jetes per jetesen e njerzve, per prodhimin e drithrave dhe perimeve bujqesore, per rritjen e sigurise dhe rezervave tyre ne mireqenien e komunitetit, pasi ka sherbyer si biznes shitje-blerje, ku mbi te jane ngritur ndertime pa leje dhe me leje, ne dem mbrojtjes tokes dhe planifikimit, zhvillimit territorit e infrastruktures, per periudhen 30-vjeçare (1992-2022), konkretisht:<br>*- sipërfaqe bashkuar 50478 m2 "are", pasuria 181/17, ZK 2105, vol 1, faqe 40, referencë 17 date 17.12.1998,*<br>*- sipërfaqe bashkuar 16000 m2 are, reference 4923 date 13.01.2020,*<br>*- sipërfaqe 2000 m2 "are", pasuria 974/2, ZK 2105, vol 9, faqe 226, AMTP 150/1992,*<br>*- sipërfaqe 4470 m2 "are", pasuria 1182/11, ZK 2105, vol 15, faqe 136, AMTP 371 date 01.07.1992, referencë 95 date 23.05.2002.*<br>- Shitblerja e tokes bujqesore e shperndare me AMTP, bie ndesh me nenin 2 te ligjit nr. 7501 date 19.07.1991 "*Per token*", | 24-55 | i mesëm | Njësia Administrative Kashar në bashkëpunim me Bashkinë Tiranë të marrë masa për mbrojtjen e tokës bujqësore nga ndërtimet e pa ligjshme. |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | -Zenia dhe demtimi i tokes bujqesore nga ndertimet e paligjshme, bie ndesh me nenin 10 dhe 14 te ligjit 9244 date 17.06.2004 "*Per mbrojtjen tokes bujqesore"* dhe me nenin 21 ligjit nr. 7501 date 19.07.1991 "*Per token*". | | | |
| **3** | Nga auditimi u konstatua se në 1 rast, nuk disponohet dokument për arkëtimin e vlerës 1,433,600 leke nga familjaret HL, ne zbatim te vendimit nr. 47 date 31.01.2017 te KVVTP, pasi pasuria nr. 154 për 3200 $m^2$ "are" e AMTP 331/1996 është shpallur me pavlefshmëri plote, ndërsa ajo është shitur treteve, pasuria nr. 1154/38, vol 17, faqe 111, ZK 2105, ne kundershtim me ligjin 9948 datë 7.07.2008 "*Për Shqyrtimin vlefshmërisë ligjore krijimit titujve pronësisë mbi tokën bujqësore"* ndryshuar, me ligjin 7501 datë 19.7.1991 "*Për tokën*". | 24-55 | i mesëm | Njësia Administrative Kashar në bashkëpunim me Bashkinë Tiranë te marre masa për sigurimin e dokumentit të arkëtimit vlerës 1,433,600 leke nga familjaret e H V, ne zbatim te vendimit nr. 47 date 31.01.2017 te KVVTP, pasi pasuria nr. 154 për 3200 m2 "are" e AMTP 331/1996 është shpallur me pavlefshmëri te plote. |
| **4** | Nga auditimi u konstatua se në 1 rast se mungon dokumenti qe vërteton se sipërfaqja 5150 m2 e BS ka kaluar pronësi "shtet", pasi është toke pa frutë (PF) sipas AMTP nr. 711/69, date 20.05.1996, shfuqizuar me vendimin e gjykatës administrative shkalles pare Tirane nr. 2568 date 09.06.2017 dhe vendimit nr. 11 date 31.01.2017 te KVVTP Tirane. | 24-55 | I Lartë | Njësia Administrative Kashar në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme e Objekteve në Bashkëpronësi, Administrimit të NJA-ve dhe Emergjencave Civile (DANJ-ve/AMTP-ve), Bashkia Tiranë, dhe me ASHK te siguroje dokumentin (KPP), për sipërfaqen 5150 m2 nëse ka kaluar pronësi "shtet", ne zbatim vendimit gjykatës administrative shkalles pare Tirane nr. 2568 date 09.06.2017 dhe vendimit nr. 11 date 31.01.2017 KVVTP Tirane, lidhur me AMTP 711/69 date 20.05.1996. Të marrë masa për menaxhimin dhe administrimin e sipërfaqes 5150 $m^2$ "shtet". |
| **5** | Nga auditimi u konstatua se ne relacionin shpjegues nr. 1242 date 17.06.2020 te njësisë Kashar nuk sqarohet diferenca 1700 m2 truall *(2000-300)*, pasi subjekti ES ne mënyre te paligjshme ka përfituar 2000 m2 truall sipas AMTP 151 date 01.10.1992 dhe formularit 6, ne vend te 300 m2 truall e pasqyruar ne listën e trojeve 001. | 24-55 | i mesëm | Njësia Administrative Kashar në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme e Objekteve në Bashkëpronësi, Administrimit të NJA-ve dhe Emergjencave Civile (DANJ-ve/AMTP-ve), Bashkia Tiranë te marre masa për verifikimin dhe sistemimin e diferencës 1700 m2 truall, pasi ne listën e trojeve pasqyrohet 300 m2 truall dhe jo 2000 m2 sipas AMTP dhe formularit 6, ku trualli nuk është objekt i tyre. |
| **6** | Nga auditimi u konstatua se n*e 3 raste* paraqiten vonesa te pajustifikuara ne korrespondencat midis institucioneve njësi-bashki-subjekt-ASHK, pasi procedura e sqarimit te problemeve te AMTP-ve ka zgjatur nga viti 2017 deri 2022 dhe vazhdon ne proces, konkretisht:<br>** lidhur me AMTP date 17.05.1996, ne emër TG, fshati Katund Ri, për sqarimin e 2 pasurive te AMTP, rezulton se 3-4 here janë kthyer dhe rikthyer dokumentet nga bashkia dhe ASHK ne adrese te njësisë Kashar. Po kështu është ripërsëritur korrespondencave me ASHK, me Dhomën Avokatisë dhe subjektin, çka ka detyruar këta te fundit te ankimohet ne bashkinë Tirane dhe Kryeministri, sipas shkresës nr. 55/10 date 21.01.2021.*<br>** lidhur me AMTP 150/1992 ne emër Xh.S sqarimi ka zgjatur nga viti 2017 deri 2020 dhe vazhdon, sipas shkresave bashkisë ne adrese njësisë Kashar nr. 1160/1 date 16.01.2018, nr. 1160/3 date 21.02.2018, nr. 42503/1 date 13.11.2019 dhe nr. 6319/3 date 30.10. 2020 etj.* | 24-55 | i mesëm | Njësia Administrative Kashar të marrë masa , të përcjell AMTP-të për regjistrim, në Drejtorinë Vendore të ASHK Rurale 2, në afat dhe pasi të ketë shqyrtuar vlefshmërinë tekniko-ligjore të titullit të pronësisë të krijuar mbi tokën bujqësore (AMTP-së), pa verifikuar dhe shqyrtuar dokumentacionin kadastral që disponon Njësia Administrative Kashar. |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | ** lidhur me AMTP nr. 65 ne emër ML, procedura e sqarimit problemeve pasurive paraqet zgjatje pa mbarim, pasi subjekti disponon 2 AMTP te parregullta ne formë, përmbajtje dhe mangësi e korrigjime, nuk pasqyrojnë kufitaret, mungon nënshkrimi i k/komisionit tokës dhe marrësit tokës.* | | | |
| **7** | Nga auditimi u konstatua se në 19 raste Njësia Administrative Kashar paraqet relacione shpjeguese te pjesshme, pa sqaruar gjitha problematikat, pa dokumentacion te plote tekniko-ligjor shoqërues, çka janë bere objekt kthimi dhe rikthimi nga Bashkia Tiranë dhe ASHK, duke ndikuar ne dem zgjidhjes kërkesave subjekteve ne regjistrimin e pronave përfituara me AMTP, konkretisht:<br>- *ne 3 raste, relacionet nuk sqarojnë pasuritë e shpërndara me AMTP, te cilat ndodhen midis 2 fshatrave* Kashar dhe Katund Ri, *ne vend te 1 fshati ku banon përfituesi AMTP*, përkatësisht:<br>** AMTP 151 date 01.10.1992, ES ku pasuria nr. 156 për 1400 m2 sipas planrilevimit 21.05.2020 ndodhet ne Katund i ri, ne vend te fshatit Kashar ku është banor personi. Mungon dokumenti qe sqaron sipërfaqet ne secilin fshat. Subjekti disponon edhe AMTP tjetër për te cilën nuk flitet asgjë ne relacionin shpjegues 1242 date 17.06.2020, kërkese kjo e Bashkisë Tirane sipas shkresës saj nr. 19799/1 date 26.06.2020.*<br>** AMTP 150/1992 për XhS, pasuria 156 prej 1200 m2 ndodhet midis 2 fshatrave Kashar dhe Katund i ri, ne vend te fshatit Kashar.*<br>** AMTP dublikate 331/1996, pasuria 154 për 3200 m2 are, shpallur me pavlefshmëri te plote, sipas vendimit nr. 47 date 31.01.2017 te KVVTP, pasi toka me 01.08.1991 dhe 01.10.1992 ndodhet ne fshat tjeter Katundi Ri, pra jashte fshatit Kashar ku ben pjese banori HV.*<br>*- ne 7 raste, relacionet nuk sqarojnë diferencat e sipërfaqeve dhe sistemimin e tyre, midis AMTP - formularit 6 - planrilevimeve*, përkatësisht:<br>** AMTP 127 date 01.10.1992 për 8550 m2 për H S, rezulton me e madhe 11550 m2 dhe nuk përputhet me formularin 6. Parcela 7 e AMTP 127 prej 3000 m2 prek pasurinë 1436 "kanal" dhe nuk sqarohet.*<br>** AMTP nr. 50/1992 për 34700 m2, R S rezulton se nuk rakordon sipërfaqja AMTP me formularin 6, madje pasuria 125 AMTP për 8500 m2 ka shume pronar dhe ka qene objekt konfliktesh.*<br>** AMTP 18 për 37300 m2 dhe AMTP 581 /1994 për 2750 m2 e R L, paraqet korrigjime, formulari 6 ka korrigjime tek sipërfaqet e pasurive. Paraqitet tejkalim i normës për fryme nga 3500 m2/fryme ne 5328 m2/fryme, dhe njësia në relacionin shpjegues 3800/1 date 04.11.2020 i ka pasqyruar këto parregullsi, por nuk ka sqaruar sistemimin "shtet" te diferencës se sipërfaqes mbi normën për fryme dhe nuk komenton AMTP 581/1994 me sipërfaqe 2750 m2.*<br>** AMTP 539 date 23.06.1992, R H, Dublikate rezulton se nuk përputhet me origjinalin, pasi pasqyron me shume sipërfaqe prej 18547 m2 nga 16150 m2 qe duhej si dhe 8 numër pasurish nga 5 qe ishin.*<br>** nuk flitet ne relacionin nr. 4944/43 date 19.02.2020 dhe nr. 4944/5 date 16.04.2020 për pasurinë me 1000 m2 are E E te AMTP date 25.07.1994, pasi disponon 2 AMTP.*<br>** ne relacioni shpjegues nuk flitet për sipërfaqen 3000 m2. Kështu vërtetimi nr. 4331/1 date 05.11.2021 i njësisë Kashar flet për pajisjen me toke te S D t, por nuk përcakton 2 aktet AMTP dhe sipërfaqen qe i takon dhe sa ka marre sipas numrit frymëve.*<br>** Nuk rakordon AMTP 184/1996 me 3200 m2 ne emër P K, fshati Katund i Ri me formularin nr. 6 qe pasqyron 4000 m2 (diferenca "ullishte" nga 1200 m2 ne AMTP ne 2000 m2 tek formulari), madje nuk ka shpjegim për regjistrimin e saj.* | 24-55 | i mesëm | Njësia Administrative Kashar te marre masa për plotësimin e dosjeve me dokumentacionin e munguar dhe te beje sqarime te plota për gjitha problemet e AMTP ne relacionet e saj, sipas rasteve te cituara me larte. |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | *- Ne 4 raste, dokumentacionin tekniko-ligjor shoqërues i relacioneve shpjeguese paraqitet me mangësi dhe parregullsi,* përkatësisht:<br>**  nuk disponohet AMTP e 2-te ne emër ES  dhe nuk flitet asgjë për këtë AMTP ne relacionin shpjegues te njësisë Kashar nr. 1232/1 date 17.06.2020, megjithëse është kërkese e Bashkisë Tirane, sipas shkresës nr. 19799/1 date 26.06.2020. Për rrjedhoje nuk sqarohet plotësimi me toke sipas normës/fryme. Nuk disponohet deklarata noteriale e subjektit,*<br>** nuk disponohet AMTP për  AH. Mungon vendimi i KVVTP për vlefshmërinë e 2 AMTP, pasi ka nisur procedura e shqyrtimit, sipas shkresës Njësisë  1201 date 13.04.2010, shkresës Prefekturës 1731/1 date 08.07.2010 dhe 1731/20 date 19.05 2014.*<br>** mungon Formulari nr. 6 lidhur me AMTP 108/1995.*<br>** mungon Formulari nr. 6, kërkese kjo edhe bashkisë Tirane, sipas shkresës nr. 15791/1 date 26.05.2020 dhe nr. nr. 15791/3 date 09.07.2020 lidhur me 2 AMTP, AB, Yzberish,*<br>*- Ne 1 rast, Njësia Kashar nuk sqaron llojin e pasurisë 299/ për 800 m2 te AMTP 108/1995, emër të XhF, pasi ne relacionin 4146/1 date 21.12.2020 përcaktohet "are", ndërsa planrilevimi 30.10.2020 nuk përcakton llojin e pasurisë, pra bie relacioni. Fakt për ketë është shkresa e mëvonshme 4164/3 date 18.01.2021 ne adrese KQ Tirane, ku njësia kërkon zërin kadastral te kësaj parcele, bazuar ne regjistrin e kadastrës datës 01.08.1991 (ne proces).*<br>*- Ne 1 rast, Njësia Kashar nuk sqaron  ne relacion menaxhimin e pasurisë "shtet"  562/8 për 1037 m2, vol 25, faqe 74, ZK 2105,  pasi  është e okupuar nga EE, sipas shkresës ZRPP nr. 30010 date 03.09.2018 dhe date 12.02.2020.*<br>*- Ne 3 raste, dokumentacioni tekniko ligjore paraqitet i parregullt dhe me 2 standarde*, përkatësisht:<br>** Plarilevimet pranohen pa nënshkrimin e njësisë vendore Kashar te Administratorit dhe pronarit te pasurisë 156/4/2, sipërfaqe 1000 m2, ZK 2119. Katund i Ri, ndryshe nga rastet tjera.*<br>** Deklarata e kufitareve janë lejuar pa firmën e kufitareve, madje pa numrin e identitetit tyre, por është mjaftuar vetëm me firmën e kryeplakut fshatit.*<br>** Ne 1 rast është kryer verifikimi ne terren për pasuritë e subjektit, sipas procesverbal konstatimit ne terren date 28.12.2020, nënshkruar nga 1 person i ZMT, ne vend te komisionit njësisë, ndërsa nuk është aplikuar matjet ne terren për rastet tjera.* | | | |
| **8** | Ne Njësinë Administrative Kashar te gjitha dosjet e AMTP nuk janë inventarizuar, në kundërshtim me kërkesat  e nenit 3 e 29 të ligjit nr. 9154, datë 06.11.2003 "*Për Arkivat*". | 24-55 | i mesëm | Njësia Administrative Kashar te marre masa për inventarizimin e dosjeve te AMTP, ne zbatim te kërkesave ligjore. |
| **9** | Nga auditimi u konstatua se në 7 raste  praktika e akivuar pranë Njësisë Administrative ka mangësi dhe mos plotësim të dokumentacionit të kërkuar ligjor për regjistrimin e pasurisë "Tokë bujqësore" sipas AMTP të lëshuara në zbatim të ligjit "Për tokën" si dhe relacioni shpjegues nuk ka referime e përcaktime për pozicionimin e pasurisë konkretisht:<br>- Praktika për pasuritë e regjistruar të familjes bujqësore ZA, sipas 2 AMTP me nr. akti 258 e cila ndodhet në origjinal dhe nr. akti 262 e cila ndodhet fotokopje.<br>- Praktika për pasuritë e regjistruar të familjes me përfaqësuesit PP me nr. kadastral 211/1/ Plan Rilevimi i pa nënshkruar nga Administratori i Njësisë Administrative si dhe Deklarata e kufitarëve pa nënshkrime.<br>- Në arkivën e Njësisë Administrative nuk gjendet asnjë dokumentacion që të na informon në lidhje me mënyrën e pajisjes me AMTP Në emër të subjektit IH, cili është anëtar i familjes bujqësore, pasi në 01.08.1991 është 16 vjeç e jo në | 24-55 | i mesëm | Njësia Administrative Kashar Bashkia Tiranë në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme e Objekteve në Bashkëpronësi, Administrimit të NJA-ve dhe Emergjencave Civile (DANJ-ve/AMTP-ve), Bashkia Tiranë, të mos përcjell AMTP-të për regjistrim, në Drejtorinë Vendore të ASHK Rurale 2, pa shqyrtuar vlefshmërinë tekniko-ligjore të titullit të pronësisë të krijuar mbi tokën bujqësore (AMTP-së), pa verifikuar dhe shqyrtuar dokumentacionin kadastral që |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | moshë madhore në cilësinë për të vepruar si përfaqësues i familjes bujqësore.<br>- Në dosje konstatohet problematika e ekzistencës së dy AMTP-ve në një familje bujqësore, të ndryshme me njëra tjetrën, AMTP me nr. 61, pa datë, e vitit 1992 në emër të përfaqësuesit QGj të familjes bujqësore, fshati Kus: për Pasuritë 535/3, 535/4, 598/3, 598/2, 597/8,138/7,133/2-2,138/4. Gjithashtu, në dosje gjendet edhe një tjetër AMTP, me nr. 61, pa datë, e vitit 1992 në emër të përfaqësuesit QGj të familjes bujqësore, fshati Kus: për pasurinë nr. 138/4, dokument i cili nuk sqaron pozicionin gjeografik dhe kufizimet. Me mangësi në plotësimin e elementeve të përcaktuar ligjorë.<br>- Në relacionin sqarues të njësisë Administrative Kashar konfirmimi i AMTP e njehsuar me origjinalin, në emër të përfaqësuesit XhS të familjes bujqësore, fshati Yrshek për Pasurinë 193/16, nuk ka të sqaruar diferencën e pozicionimit duke e krahasuar me planin e rilevimit në raport me ortofoton, për rrjedhojë praktika për regjistrimin e AMTP në pronësi, është procedurë e parregullt dhe me mangësi.<br>- Në relacionin nga Njësia Administrative Kashar me nr. 14522/5, datë 03.09.2020 me qëllim regjistrimin pranë ASHK-së të pasurisë me nr. 58/2, ZK 2625. Konstatohet se AMTP-ja dhe formulari nr.6, kanë korrigjime të dukshme. Nuk ka dokumentacion ligjor sqarues dhe shoqërohet me një praktikë të pa plotë dhe pa verifikuar plotësisht.<br>Veprime në kundërshtim me Ligjin nr.7501, datë 19.07.1991 "Për Tokën", ligjin nr. 9948, datë 7.7.2008, "Për shqyrtimin e vlefshmërisë ligjore të krijimit të titujve të pronësisë mbi tokën bujqësore"; VKM nr. 994, datë 9.12.2015 "Për procedurën e regjistrimit të akteve të marrjes së tokës në pronësi". | | | disponon Njësia Administrative Kashar. |
| **10** | Nga auditimi u konstatua se në 6 raste në relacionin shpjegues nuk ka referime e përcaktime për pozicionimin e pasurisë e cila bie në status "PF", si dhe nuk ka dokumentacion shterues mbi vlefshmërinë e lëshimit të AMTP-ve, konkretisht:<br>- Nuk ka sqarime e saktësime për gjendjen faktike dhe dokumentare të pozicionimit të parcelës nr. 209 me sip. 550 m$^2$ ZK 2119, pasi figuron në gjendjen kadastrale PF(rrugë-kanale) datë 01.08.1991;<br>- Në relacionin sqarues të njësisë Administrative Kashar, në dy rastet për të njëjtën pasuri, nr. 287/. Për AMTP nr...., datë 17.05.1996 ka planë rilevimi të ndryshme dhe nuk ka dokumentacion sqarues mbi pozicionimin e saktë të pasurisë e cila figuron e regjistruar në zërin kadastral "PF"(rruge, kanale) dhe prek pjesërisht parcelën me nr. 288 e cila figuron e regjistruar në zërin kadastral "arë", gjendja 01.08.1991, duke rezultuar procedurë të parregullt dhe me mangësi;<br>- Për pasurinë nr. 79, për 1500 m$^2$ sipas AMTP pa nr. datë 20.11.1996 dhe pozicionimit sipas plan rilevimit datë 24.07.2017 konstatojmë se parcela bie PF (tokë pa frut) e cila nuk është objekt i ndarjes së tokës. AMTP-ja në emër të . MH i cili është anëtar i familjes bujqësore, pasi në 01.08.1991 është 16 vjeç e jo në moshë madhore në cilësinë për të vepruar si përfaqësues i familjes bujqësore;<br>-Për Pasurinë me nr. 156/ me emrin popullor "Radiostacioni" pasqyruar në AMTP në reshtin e 6, sip. 1500 m$^2$ sipas AMTP-së dhe plan rilevimit të përgatitur nga Top. Gj. L datë 26.06.2020 me sip. Faktike 800 m$^2$ ZK 2105, fshati Kashar. Nuk ka sqarime e saktësime për gjendjen faktike dhe dokumentare të pozicionimit të parcelës që bie mbi pronë shtetërore e jo tokë "arë".<br>- Në relacionet me nr. 4423/1, datë 21.12.2020 dhe nr. 369, datë 26.01.2021 të Njësisë Administrative (cituar edhe nga Bashkia Tiranë) nuk ka sqarime e saktësime si dhe ka qëndrime të ndryshme për gjendjen faktike të pozicionimit dhe llojit të tokës të parcelës nr. 241-242. Pasuria nr. 241, | 24-55 | i mesëm | Njësia Administrative Kashar Bashkia Tiranë në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme e Objekteve në Bashkëpronësi, Administrimit të NJA-ve dhe Emergjencave Civile (DANJ-ve/AMTP-ve), Bashkia Tiranë, të mos përcjell AMTP-të për regjistrim, në Drejtorinë Vendore të ASHK Rurale 2, pa shqyrtuar vlefshmërinë tekniko-ligjore të titullit të pronësisë të krijuar mbi tokën bujqësore (AMTP-së), pa verifikuar dhe shqyrtuar dokumentacionin kadastral që disponon Njësia Administrative Kashar. |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | sipas planit të rilevimit prek pasurinë me nr. 241/3, që sipas kartelës së pasurisë është e lloji "pemëtore-truall" dhe pasuria 242/29 sipas kartelës së pasurisë është e lloji "arë", por sipas hartës 1:5000 prek pasurinë "PF".<br>-Në përcaktimin e pozicionimit të pasurisë nr. 225/3 në lidhje me hartën 1:5000, konstatojmë se kjo pasuri është pjesë e pasurisë nr. 225 e llojit jo tokë bujqësore.<br>Veprime në kundërshtim me Ligjin nr.7501, datë 19.07.1991 "Për Tokën", Ligjin nr. 9948, datë 7.7.2008, "Për shqyrtimin e vlefshmërisë ligjore të krijimit të titujve të pronësisë mbi tokën bujqësore"; ligjin nr. 20/2020, datë 03.05.2020, datë 05.03.2020 VKM nr. 994, datë 9.12.2015 "Për procedurën e regjistrimit të akteve të marrjes së tokës në pronësi"; VKM nr.1174, datë 24.12.2020, "Për procedurat e regjistrimit të amtp-ve, saktësimin e kufijve e sipërfaqeve, si dhe normat për sipërfaqet shtetërore shtesë e pronat shërbyes". | | | |

## *I.2.B. Njësia Administrative Vaqarr.*

| Nr. | Përmbledhje e gjetjes | Referenca në Raport | Rëndësia | Rekomandimi |
|---|---|---|---|---|
| 1 | Nga auditimi u konstatua se Njësia Administrative Vaqarr:<br>**a.** për 4 vitet (2019-2022) rezulton se dokumentacioni nuk është mbajtur ne dosje te veçanta për do subjekt, me inventarizim te plote, ku te pasqyrohej gjithë procedura e korrespondencës me ASHK dhe bashkinë nga fillimi deri ne fund, me qellim qe te jepej qartësi ne zgjidhjen e problemeve te pronësisë te banoreve te Vaqarrit, dhe jo i shkëputur sipas viteve. Kështu njësia Vaqarr sipas evidencave paraqet 50 korrespondenca me Bashkinë Tirane dhe 277 korrespondenca me ASHK, te ndara sipas viteve dhe jo te grupuara ne dosje veçanta sipas subjekteve, për 4 vitet 2019-2022.<br>**b.** Ne 14 raste, dosjet e subjekteve kane mangësi dhe parregullsi ne dokumentacionin tekniko-ligjor, , konkretisht:<br>- *ne 2 raste, mungon HTR dhe formulari nr. 6,*<br>- *ne 4 raste, mungon planrilevimi ose janë te parregullta,*<br>- *ne 3 raste, mungon dokumentacioni për argumentimin e diferencës sipërfaqes midis AMTP dhe vërtetimit pagesës taksave vendore,*<br>- *ne 1 rast, nuk përputhet AMTP date 10.08.1993 me formularin nr. 6,*<br>- *ne 3 raste, deklaratat e kufitareve janë pranuar të parregullta,*<br>- *ne 1 rast, nuk përputhen kufitaret, midis deklaratës kufitareve dhe AMTP,*<br>- *ne gjitha rastet nuk disponohet vendimi ne njësinë vendore Vaqarr për normën për fryme.* | 12-42 | i mesëm | Njësia Administrative Vaqarr:<br>a. te marre masa për te krijuar dosje te veçanta për çdo subjekt me dokumentacionin përkatës te ASHK, bashkisë dhe subjektit dhe jo te veçuar sipas viteve.<br>b. te marre masa për plotësimin e dosjeve me dokumentacionin e munguar dhe te beje siguroje dokumente te rregullta duke eliminuar pasaktësitë e konstatuara sipas rasteve. |
| 2 | Nga auditimi u konstatua se Njësia Administrative Vaqarr nuk disponon listën e sipërfaqeve te tokës tepër kaluar "shtet" nga ASHK, sipas subjekteve private objekt i legalizimeve, për diferencat midis sipërfaqeve te zaptuara me ato te miratuara me legalizim *(pjesa zaptuar -pjesën legalizuar*). Kështu, tokat "shtet" kane mbetur në posedim dhe shfrytëzim në mënyrë të paligjshme nga subjektet private për një periudhë pa kufi kohor, të cilët i shfrytëzohen pa asnjë detyrim, taksë apo qira, çka tregon mos-administrim te tyre si dhe mungese bashkëpunimi me ASHK. | 12-42 | i mesëm | Njësia Administrative Vaqarr ne bashkëpunim me ASHK te marre masa për administrimin e sipërfaqeve tepër toke "shtet", diferenca midis pjesës zaptuar me atë legalizuar, te cilat kane kaluar shtet nga ASHK. |
| 3 | Nga auditimi u konstatua se ne 1 rast, pasuria 301/4, ZK 3321, vol 1, faqe 26, siperfaqja 3200 m$^2$ paraqet paqartesi, pasi sipas dokumentacionit pasqyrohet me 3 lloje si are**,** vresht, grope silazhi**,** nuk rekordon AMTP 41 me LN dhe formularine 6, mungon HTR, fakt është se edhe ASHK ka kërkuar dhe rikerkuar sqarime për pasurinë 301/4 (324) dhe nuk nuk e ka kaluar ne pronesi MIE, pasi mbi kete pasuri | 12-42 | i mesëm | Njësia Administrative Vaqarr te qartësoje me dokumente dhe te bashkëpunoje me ASHK për te sqaruar nëse pasuria 301/4, ZK 3321, vol 1, faqe 26, siperfaqja 3200 m2 ka kaluar ne pronesi MIE pasi mbi kete pasuri |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | ndodhet landfilli, *sipas references 3865 date 03.05.2019 dhe 3874 date 27.05.2019* | | | ndodhet landfilli apo është ne pronësi te privatit. |
| **4** | Nga auditimi u konstatua se Njësia Administrative Vaqarr nuk ka bashkëpunuar me njësinë Kashar dhe ASHK për sqarimin dhe zgjidhjen e përplasjes dhe mbivendosjes te disa pasurive midis 2 zonave kadastrave te tyre ZK 2119 dhe ZK 2105, pasi mungon azhurnimi hartës për pozicionin pasurive, mungojnë deklaratat noteriale e kufitareve sipas gjendjes faktike ne terren, kërkesë kjo e ASHK Rurale 2 sipas shkresës saj nr. 7186/1 date 09.11.2020. | 12-42 | i mesëm | Njësia Administrative Vaqarr ne bashkëpunim me njësinë Kashar dhe ASHK të sqarojnë përplasjen dhe mbivendosjen e disa pasurive midis 2 zonave kadastrave te tyre ZK 2119 dhe ZK 2105, duke disponuar hartën e azhurnuar për pozicionin e pasurive, deklaratat noteriale kufitareve sipas gjendjes ne terren, në përgjigje te shkresës nr. 7186/1 date 09.11.2020 te ASHK Rurale 2. |
| **5** | Nga auditimi u konstatua se Njësia Administrative Vaqarr padrejtësisht sqaron dhe kthen përgjigje për pasurinë nr. 73/, ne vend te pasurisë nr. 83/14, ZK 1867, sipërfaqe 1000 m2, vol 3, faqe 63, fshati Gropaj, kërkese kjo e ASHK 2, për sigurimin e dokumentacionit te plote tekniko-ligjor. | 12-42 | i mesëm | Njësia Administrative Vaqarr ti ktheje përgjigje DV ASHK Tirana Rurale 2, për pasurinë 83/14 me sipërfaqe 1000 m2, vol 3, faqe 63, fshati Gropaj, duke i siguruar dokumentacionin e plote tekniko-ligjor. |
| **6** | Nga auditimi u konstatua se Njësia Administrative Vaqarr- Ne 3 raste, paraqitet me moszbatim te afateve ligjore deri 1 vit, lidhur me korrespondencën për kthimin e përgjigjeve ndaj kërkesave dhe ri-kërkesave te ASHK dhe anasjelltas për Njësinë Vaqarr, nuk ka shpjegime ligjore për vonesën e përgjigjes, si dhe nuk është plotësuar dokumentacioni ligjor i kërkuar nga DV ASHK Tirana Rurale:<br>-për regjistrimin e pasurive te AMTP 45 date 19.05.1992, ZK 1017, Allgjate,<br>- aplikim me nr. 1888, datë 11.02.2020DV ASHK Tirana Rurale 2 është paraqitur G K, për tu pajisur me kopje të kartelës së pasurisë nr. 30/9 Vol.1, faqe 198, ZK 3963, "arrë" me sip. 4500 m$^2$;<br>- R M Në DV ASHK Tirana Rurale 2 ka paraqitur kërkesën me objekt lëshimin e kopjes së hartës dhe kartelës së rifreskuar kadastrale për pasurinë nr. 146/3, vol. 1, faqe 203, ZK 3064.<br>Veprime në kundërshtim me VKM nr. 994, datë 9.12.2015 "Për procedurën e regjistrimit të akteve të marrjes së tokës në pronësi" Ligjin nr. 20/2020, datë 03.05.2020 "Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë"; si dhe VKM nr. 1174, datë 24.12.2020 "Për procedurat e regjistrimit të AMTP-ve, saktësimin e kufijve e sipërfaqeve, si dhe normat për sipërfaqet shtetërore shtesë e pronat shërbyese". | 12-42 | i mesëm | Njësia Administrative Vaqarr të marrë masa për të eliminuar vonesat ne kthimin e përgjigjeve ndaj DV ASHK, DP Bashkisë apo dhe Subjektit, lidhur me sqarimin e plote te problemeve te AMTP-ve, plotësimin e dokumentacionit ligjor. |
| **7** | Nga auditimi u konstatua se **në 10 raste**, në relacionin shpjegues nuk ka referime e përcaktime për pozicionimin e pasurisë dhe dokumentacion të plotë sqarues. Relacionet shpjeguese paraqiten te pjesshëm, lidhur me saktësimin e pasurive tokës bujqësore përfituar me AMTP, sipas kërkesës se DV ASHK, Bashkisë dhe subjektit, përkatësisht:<br>- ne 1 rast, relacioni sqaron 1 pasuri te AMTP, ndërsa nuk flet për pasuritë tjera te AMTP,<br>- ne 2 raste, relacionin nuk sqaron mospërputhjen e AMTP-se me formularin nr. 6, pasi këta 2 dokumente pasqyrojnë numër dhe sipërfaqe te ndryshme te pasurive tokës bujqësore (AMTP përmban 1 pasuri, ndërsa formulari 6 përmban 3 pasuri).<br>- ne 3 raste, relacioni nuk shpjegon pajisjen me 3 AMTP të familjes pandara nga trungu 1991, ne vend te 1 AMTP, nuk sqarohet sipërfaqja totale e marre sipas normës për frymë, nëse ka efekte. | 12-42 | i mesëm | Njësia Administrative Vaqarr te marre masa për përmirësimin e relacioneve shpjeguese, duke sqaruar ne detaje te gjitha problemet e pronave te AMTP, duke i bashkëngjitur dokumentacionin shoqërues, ne zbatim te kërkesave te ASHK, bashkisë dhe subjektet. |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | - ne 1 rast, relacioni shpjegues nuk sqaron dhënien e tokës me 2 standarde, pasi 2 familje me numër te njëjtë frymësh disponojnë sipërfaqe te ndryshme për te njëjtën ZK.<br>- ne 2 raste, paraqitet mos-rakordim midis KPP dhe AMTP, madje KPP pasqyron emër tjetër.<br>- në 1 rast Pasuria me nr. 135, vol 1, faqe 150 ZK 3712 adresë Vaqarr lloji "kullotë" sipërfaqe 9140 m$^2$ pronësi "Shtet" sipas ZVRPP si dhe në lidhje me parcelën me nr. 131/135 me emër popullor "kopshti" sip. 1720 m$^2$ i zërit kadastral "Arrë" sipas AMTP-së.<br>- në 1 rast Pasuria me nr. 52/36/1, vol 2, faqe 3 ZK 1867 adresë Gropaj lloji "truall" sipërfaqe 400 m$^2$ sipas akti dhe 600 m$^2$ ndërtesë 140 m$^2$ sipas LN Maj 1995.<br>- në 1 rast Pasuria nr. 76/1, vol __, faqe __ ZK 3784 adresë Vishaj lloji "arrë" sipërfaqe 3220 m$^2$ që sipas akti rezulton e pa afishuar. Në AMTP-në nr. 18, datë 30.07.1992, në reshtin e 1,2,3 dhe 5,6,7, janë përcaktuar pasuritë që sipas relacionit në total korrespondojnë me pasurinë 76/1 është 3220 m$^2$ "arrë" pa përfshirë pasurinë 250 m$^2$ "truall", por nuk përputhen me përshkrimin dhe Plan rilevimin datë 25.07.2019, paraqitur nga Njësia Administrative. Ndërsa për pasurinë me nr. 14/12 me sip. 11400 m$^2$ sipas azhornimit, nuk ka deklarime për mos përputhje sipërfaqe.<br>Veprime në kundërshtim me VKM nr. 994, datë 9.12.2015 "Për procedurën e regjistrimit të akteve të marrjes së tokës në pronësi" dhe Ligjit nr. 9948, datë 7.7.2008, "Për shqyrtimin e vlefshmërisë ligjore të krijimit të titujve të pronësisë mbi tokën bujqësore". | | | |
| **8** | Nga auditimi u konstatua se në 2 raste *Nuk ka sqarime për ndryshimet e sipërfaqeve të pasurive dhe ndarjen e parcelave sipas regjistrimit fillestar* konkretisht:<br>- Pasuria nr. 294/6, vol. 2, faqe 53 në pronësi të X L me sip. 4500 m$^2$ e llojit "arrë" dhe Pasuria nr. 339/3, vol. 2, faqe 54 në pronësi të Xh L me sip. 2000 m$^2$ e llojit "arrë".<br>- Në kthim përgjigje nga Njësia Administrative Vaqarr me nr. 339/1, datë 08.02.2021 (relacion shpjegues) theksohet se ky person është pajisur me certifikatë pronësie për pasurinë nr. 46/12, Vol 9, faqe 121 ZK 3321 me sipërfaqe 2094 m$^2$. Drejtoria Vendore e ASHK Tirana Rurale 2 me nr. 7612, datë 16.11.2020 konfirmon se nuk ka lëshuar certifikatë sipas kartelës për pasurinë nr. 46/12, Vol 9, faqe 121 ZK 3321 me sipërfaqe 1294 m$^2$, kjo sipas regjistrimit fillestar përfunduar më 16.02.2000.<br>Veprime në kundërshtim me VKM nr. 994, datë 9.12.2015 "Për procedurën e regjistrimit të akteve të marrjes së tokës në pronësi"; me Ligjin nr. 20/2020, datë 03.05.2020 "Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë"; si dhe VKM nr. 1174, datë 24.12.2020 "Për procedurat e regjistrimit të AMTP-ve, saktësimin e kufijve e sipërfaqeve, si dhe normat për sipërfaqet shtetërore shtesë e pronat shërbyese". | 12-42 | i mesëm | Njësia Administrative Vaqarr Bashkia Tiranë në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme e Objekteve në Bashkëpronësi, Administrimit të NJA-ve dhe Emergjencave Civile (DANJ-ve/AMTP-ve), Bashkia Tiranë, të mos përcjell AMTP-të për regjistrim, në Drejtorinë Vendore të ASHK Rurale 2, pa shqyrtuar vlefshmërinë tekniko-ligjore të titullit të pronësisë të krijuar mbi tokën bujqësore (AMTP-së), pa verifikuar dhe shqyrtuar dokumentacionin kadastral që disponon Njësia Administrative Vaqarr. |
| **9** | Nga auditimi u konstatua se në 2 raste se:<br>- Nga Njësia Administrative *nuk është plotësuar dokumentacioni ligjor si certifikatat 01.08.1991 për çdo familje përfituese të tokës* sipas legjislacionit në fuqi, *nuk është argumentuar zbatimi i normës për fryme, s'ka sqarim dokumentar mbi mos përputhjen e mbiemrit në kartelën e pasurisë* ASHK, , citimi në shkresën nr. 246, datë 21.01.2021, si dhe me librin e ngastrave (fotokopje) nga "K", "K" në certifikatën e gjendjes civile.<br>-*AMTP në përdorim nuk ka korrigjimin e kërkuar me nënshkrim, mungon nënshkrimi i Kryetarit të Komisionit të ndarjes së tokës së Fshatit dhe vula e institucionit që ka lëshuar aktin.* Nuk ka arsye dokumentare për vonesën me disa vite të përgjigjes dhe dërgimin e relacionit-shpjegues nga Njësia Administrative.<br>Veprime në kundërshtim me Ligjin nr. 20/2020, datë 03.05.2020 "Për përfundimin e proceseve kalimtare të | 12-42 | i mesëm | Njësia Administrative Vaqarr Bashkia Tiranë në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme e Objekteve në Bashkëpronësi, Administrimit të NJA-ve dhe Emergjencave Civile (DANJ-ve/AMTP-ve), Bashkia Tiranë, të mos përcjell AMTP-të për regjistrim, në Drejtorinë Vendore të ASHK Rurale 2, pa shqyrtuar vlefshmërinë tekniko-ligjore të titullit të pronësisë të krijuar mbi tokën bujqësore (AMTP-së), pa verifikuar dhe shqyrtuar dokumentacionin kadastral që disponon Njësia Administrative Vaqarr. |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | pronësisë në Republikën e Shqipërisë"; si dhe VKM nr. 1174, datë 24.12.2020 "Për procedurat e regjistrimit të AMTP-ve, saktësimin e kufijve e sipërfaqeve, si dhe normat për sipërfaqet shtetërore shtesë e pronat shërbyese". | | | |

## *I.2.C. Njësia Administrative Zall-Bastar*

| Nr. | Përmbledhje e gjetjes | Referenca në Raport | Rëndësia | Rekomandimi |
|---|---|---|---|---|
| **1** | Nga auditimi konstatua se: 2 pasuritë me sipërfaqe 3531 m2 dhënë me AMTP date 22.06.1992, M L , rezultojnë me certifikate pronësie ne emër te personave tjerë, përkatësisht:<br>- *pasuria nr. 1111*, ZK 1124, Zall-Bastar Mesëm, sipërfaqe 1325 m2, AMTP 22.06.1992, ne emër M L, rezulton me certifikate pronësie për H K, pasuria 1111, ZK 1124, vol 3, faqe 43 *(AMTP 121 date 11.05.1992).*<br>- *pasuria nr. 1136*, ZK 1124, Zall-Bastar Mesëm, sipërfaqe 2206 m2, AMTP 22.06.1992, ne emër te M L, rezulton e regjistruar për H L, pasuria 1136, ZK 1124, vol 4, faqe 190.<br>Për sa më sipër dokumentohet me *Hartën kadastrave e vitit 1998* e miratuar me vendimin nr. 37 date 16.08.2004 te KK Zall-Bastar; *Shkresa e Bashkisë Tirane* nr. 4861/1 date 07.02.2020, e cila sqaron këtë problem; *Dokumentet e Kadastrës,* KPP dhe certifikata e pronësisë.<br>Veprime në kundërshtim të pikës 1 dhe 2 te nenit 68 "*Bashkëpunimi ndërinstitucional"* te ligjit nr. 111.2018 "*Për kadastrën*", përforcuar edhe me vendimin 1040 date 25.11.2020, kreu I/ 5 | 85-100 | i mesëm | Njësia Administrative Zall-Bastar te marre masa që në bashkëpunim me ASHK Rurale 1, për të përcaktuar statusin pronësor të 2 pasurive me sipërfaqe 3531 $m^2$ dhënë me AMTP date 22.06.1992 M L, pasi rezultojnë ne pronësi te personave tjerë, përkatësisht:<br>-H K, pasuria 1111, ZK 1124, vol 3, faqe 43, *AMTP 121 date 11.05.1992.*<br>- H L, pasuria 1136, ZK 1124, vol 4, faqe 190, *akti 210.* |
| **2** | Nga auditimi i ushtruar u konstatua në 1 rast se mungon korrespondenca pas vitit 2020 midis Njësisë Administrative Zall-Bastar me ASHK 1, për sqarimin dhe sistemimin e sipërfaqeve tepër 3893 $m^2$ te 5 pasurive, nëse kane kaluar "shtet", pasi 5 pasuritë regjistruar ne vitin 2001 ne emër A Ç, fshati Bastar-Murriz, ZK 1125 rezultojnë me sipërfaqe me te mëdha se AMTP 70, formulari 6 dhe plan rilevimet, sipas relacionit shpjegues 07.09.2020, përkatësisht:<br>- pasuria nr. 138/4, sipas AMTP, plan rilevimit, formularit 6 rezulton 300 m2, ndërsa sipas KPP rezulton 481 m2, vol 1, faqe 209, ZK 1125, pra diferenca tepër 181 m2.<br>- pasuria nr. 72/7, sipas AMTP, plan rilevimit, formularit 6 rezulton 200 m2, ndërsa sipas KPP rezulton 2662 m2, vol 1, faqe 208, ZK 1125, pra diferenca tepër 2462 m2.<br>- pasuria nr. 183/5, sipas AMTP, plan rilevimit, formularit 6 rezulton 950 m2, ndërsa sipas KPP rezulton 1586 m2, vol 1, faqe 213, ZK 1125, pra diferenca tepër 636 m2.<br>- pasurinë nr. 211/3, sipas AMTP, plan rilevimit, formularit 6 rezulton 1200 m2, ndërsa sipas KPP rezulton 1416 m2, vol 1, fq 217, ZK 1125, pra diferenca tepër 216 m2.<br>- pasuria nr. 219/17, sipas AMTP, plan rilevimit, formularit 6 rezulton 2350 m2, ndërsa sipas KPP rezulton 2748 m2, vol 1, faqe 219, ZK 1125, pra diferenca tepër 398 $m^2$. | 85-100 | i mesëm | Njësia Administrative Zall-Bastar te bashkëpunoje me ASHK Rurale 1, për sqarimin dhe sistemimin e sipërfaqeve tepër prej 3893 m2 te 5 pasurive, nëse kane kaluar "shtet", pasi 5 pasuritë e regjistruara ne emër A Ç, fshati Bastar-Murriz, si më sipër rezultojnë me sipërfaqe me te mëdha se AMTP 70, formulari 6 dhe plan rilevimet, referuar relacionit shpjegues date 07.09.2020 te NJA. |
| **3** | Nga auditimi në Njësinë Administrative Zall-Bastar u konstatua se:<br>a. nuk disponon listën e sipërfaqeve tokës tepër kaluar "shtet" nga ASHK, sipas subjekteve private objekt i legalizimeve, për diferencat midis pjesës te zaptuar me pjesën e legalizuar.<br>b. nuk disponon listën e sipërfaqeve tokës tepër kaluar "shtet" nga ASHK, sipas subjekteve private objekt i AMTP, për diferencat midis AMTP dhe matjeve ne terren ku sipërfaqja rezulton me e madhe se AMTP.<br>c. për rastin e okupimit nga privati te pasurisë shtet nr. 126/3 me sipërfaqe 3921 m2 are, ZK 3296, Selite Malit, vol 4, faqe 22, njësia nuk e ka administruar ketë sipërfaqe, ku i behet e qarte okupimi i saj nga ASHK, | 85-100 | i mesëm | Nga Njësia Administrative Zall-Bastar ne bashkëpunim me ASHK te marren masa për evidentimin dhe administrimin e sipërfaqeve tepër toke "shtet", rezultuar nga diferenca midis pjesës zaptuar me atë legalizuar apo edhe midis AMTP dhe sipërfaqes ne terren, kaluar shtet nga ASHK. |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | *Për rrjedhoje*, Këto *parcelëza "shtet"* kane mbetur në posedim dhe shfrytëzim në mënyrë të paligjshme nga subjektet private, pa asnjë detyrim, taksë, qira për buxhetin. | | | |
| **4** | Nga auditimi në Njësinë Administrative Zall-Bastar u konstatua se: në 1 rast, relacioni shpjegues date 15.11.2020 i Njësisë Administrative Zall-Bastar nuk sqaron diferencën 11085 m2 *(21800-10715)* midis AMTP 22/1992 dhe vërtetimit taksave vendore për S M, Besh. Njësia ka vepruar me 2 standarde, pasi ndryshe ka ndodhur me praktiken e R M dhe F M ku përputhet sipërfaqja sipas AMTP me sipërfaqen e vërtetimit të taksës vendore. | 85-100 | i mesëm | Njësia Administrative Zall-Bastar te sqaroje diferencën 11085 m2 *(21800-10715)* midis AMTP 22/1992 dhe vërtetimit taksave vendore ne emër S M, fshati Besh, për shmangien e evazionit fiskal ne pagesën e taksës tokës bujqësore. |
| **5** | Nga auditimi në Njësinë Administrative Zall-Bastar u konstatua se:<br>Në 1 rast, relacioni shpjegues date 29.12.2020 i Njësisë Administrative Zall-Bastar paraqet mangësi, pasi nuk sqaron te plota problemet e AMTP 13 date 15.06.1992 ne emër te A S, fshati Selite Malit, Zall-Bastar, konkretisht:<br>- *relacioni nuk shpjegon diferencën e sipërfaqes 3775 m2* (11537-7762), midis sipërfaqes 11537 m2 *sipas vërtetimit taksave vendore Bashkisë 6951/1 date 22.09.2020* me sipërfaqen 7762 m2 qe pasqyron AMTP 13 date 15.06.1992.<br>- *relacioni nuk sqaron nëse administron pasurinë "shtet" 126/3 me sipërfaqe 3921 m2 are,* ZK 3296, Selite Malit, vol 4, faqe 22, okupuar nga AS.<br>- *relacioni nuk sqaron mungesën e formulari nr. 6,* kërkesë kjo e bashkisë Tirane, sipas shkresës saj nr. 43109/1 date 15.12.2020. | 85-100 | i mesëm | Njësia Administrative Zall-Bastar te kompletoje dosjen me dokumente te munguara dhe te sqaroje problemet te plota për AMTP 13 date 15.06.1992 ne relacionin shpjegues te saj, ne adrese te bashkisë dhe ASHK. |
| **6** | Nga auditimi u konstatua se:<br>-Në 1 rast, ka vonesa prej 1 vit te korrespondencës *Njësisë Administrative Zall-Bastar-Bashki Tirane–ASHK Rurale 1-Subjekt,* lidhur me praktiken për AMTP pa numër dhe date, ne emër te Q P, fshati Zall-Dajt, pasi ASHK Rurale me date 27.01.2020 ka kërkuar njësisë konfirmim dokumentacioni, ndërsa kjo fundit pas 8 muajve ka përcjellë relacionin shpjegues date 16.09.2020 dhe ridërguar me 03.11.2020. Gjithashtu dokumentacioni i korrespondencës paraqet mangësi, pasi mungon ne dosje AMTP-ja dhe formulari nr. 6.<br>- Në 1 rast, përfituar 2 AMTP nga familja Dervishi, pasi pretendohet se ne 1992 ka qene e ndare ne 2 familje, por nuk disponohen 2 certifikatat familjare, përkatësisht:<br>*AMTP 16.07.1992 ne emër te babait H D fshati Zall-Dajt me sipërfaqe 1196 2 m2 are, për 2 fryme, mungon certifikata familjare 1991 e H D.<br>*AMTP 16.07.1992 ne emër te birit B H D me sipërfaqe 2208 2 m2 are, për 5 fryme, ku disponohet certifikata familjare 01.10.1992 e B D . | 85-100 | i mesëm | Njësia Administrative Zall-Bastar të marrë masa për të:<br>- shmangur vonesat duke respektuar afatet ligjore në kthimin e përgjigjeve ndaj ASHK dhe Bashkisë, lidhur me sqarimet e AMTP-ve.<br>- te kompletoje 2 dosjet e korrespondencës me dokumentet e munguara (*certifikata familjare 1991 e H D dhe AMTP, formulari 6 e Q P).* |
| **7** | Nga auditimi u konstatua se në 2 raste Njësia Administrative Zall-Bastar në relacionin shpjegues nuk ka sqaruar pajisjen me AMTP familje bujqësore me gjendje pas datës 01.08.1991, nuk ka sqaruar normën për frymë të tokës bujqësore dhe të argumentonte zbatimin e saj, konkretisht:<br>- AMTP-të me nr. 34, datë 18.08.2000; nr. 276, datë 18.08.2000; nr. 63, datë 18.08.2000<br>-AMTP nr. 64, datë 30.05.2020 në emër të BRr me sipërfaqe totale 5150 m$^2$. Janë lëshuar në kundërshtim me ligjin nr. 7501, datë 19.07.1991 "Për Tokën", me VKM nr. 994, datë 9.12.2015 "Për procedurën e regjistrimit të akteve të marrjes së tokës në pronësi". | 85-100 | i mesëm | Nga Njësia Administrative Zall-Bastar në të gjitha raste para se të përcjellje dokumentacioni për në DV ASHK Rurale 1, të verifikojë normën për frymë, bazuar në certifikatën familjare datë 01.8.1991 dhe datë 01.10.1992. |
| **8** | Nga auditimi u konstatua se në 2 raste ka mangësi dokumentare dhe nuk ka sqarime të dokumentuar:<br>-për pasuritë nr. 2/9 dhe 2/11 që i përkasin ZK 1309, fshati Bulcesh dhe jo në ZK 3884 Fshati Zall Bastar,<br>- për pasurinë 28/8, me sipërfaqe 1550 m$^2$ sipas planit të rilevimit datë 12.11.2020 dhe sipas rreshtit nr. 4 në AMTP nr. 33, datë 25.08.2000 për 1250 m$^2$ pemëtore dhe 300 m$^2$ truall. | 85-100 | i mesëm | Nga Njësia Administrative Zall-Bastar në të gjitha raste para se të përcjellje dokumentacioni për në DV ASHK Rurale 1, të verifikojë nëse kërkuesi ka qenë i legjitimuar për të përfituar tokë sipas akteve |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | Të cilat sipas ASIG nuk janë tokë bujqësore veprime në kundërshtim me Ligjin nr. 7501, datë 19.07.1991 "Për Tokën", dhe me VKM nr. 994, datë 9.12.2015 "Për procedurën e regjistrimit të akteve të marrjes së tokës në pronësi". | | | ligjore e nënligjore për ndarjen e tokës bujqësore. |
| **9** | Nga auditimi u konstatua se në 2 raste janë regjistruar pasuri të regjistruara me azhurnimin e vitit 1998 sipas kufijve të vjetër të para kolektivizimit nuk ka azhornim faktik dhe saktësimin e gjendjen të pasurisë së poseduar faktikisht në terren.<br>-Pasuritë me nr. 93, vol 1, faqe 93 ZK 3775 me sipërfaqe 6000 $m^2$ fshati Vilëz dhe nr. 711 vol. 3, faqe 211. 6600 $m^2$ "arrë" për pasuritë në emër të R K I për 4406 $m^2$, tokë arë, 75 $m^2$ pemëtore dhe 300 $m^2$ truall, sipas kufijve të vjetër. | 85-100 | i mesëm | Nga Njësia Administrative Zall-Bastar në të gjitha raste para se të përcjellje dokumentacioni për në DV ASHK Rurale 1, të verifikojë nëse kërkuesi ka qenë i legjitimuar për të përfituar tokë sipas akteve ligjore e nënligjore për ndarjen e tokës bujqësore. |

### *I.3. Opinioni i auditimit*

Ne audituam përputhshmërinë e veprimtarisë së Njësive Administrative Kashar, Vaqarr dhe Zall-Bastar Bashkia Tiranë me kriteret e vlerësimit përfshirë kuadrin ligjor, rregullat dhe rregulloret që lidhen me procedurat e regjistrimin të AMTP-ve.

Nga auditimi mbi përputhshmërinë, i mbështetur në Standardet Ndërkombëtare të Auditimit ISSAI 4000, Rregulloren e Procedurave të Auditimit dhe në Manualin e Auditimit të Përputhshmërisë së KLSH-së, i kryer në subjektet Njësia Administrative Kashar, Vaqarr dhe Zall-Bastar Bashkia Tiranë ku rezultuan mospërputhje me kuadrin ligjor dhe rregullator në fuqi (kriteret) të cilat nën gjykimin profesional të audituesit të pavarur janë materiale por jo të përhapura, efektet e të cilave justifikojnë dhënien e një *opinioni të kualifikuar*.

**Baza për opinionin e përputhshmërisë.**

Ne e kemi kryer auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit të Sektorit Publik (ISSAIs). Përgjegjësitë tona lidhur me këto standarde janë përshkruar më hollësisht në seksionin "*Përgjegjësitë e Audituesit për auditimin e përputhshmërisë*", pjesë e Projekt Raporteve të auditimit. Ne jemi të pavarur kundrejt subjektit të audituar, e theksuar kjo në ISSAI-n 10- Deklarata e Meksikës mbi Pavarësinë e SAI-t, si dhe ISSAI 30- Kodi Etik, apo edhe çështje të tjera që lidhen me auditimin e pasqyrave financiare të një institucioni ndërkombëtar, të cilat janë përmendur në ISSAI-n 4000 "*Standardi i Auditimit të Përputhshmërisë*". Ne i kemi përmbushur përgjegjësitë tona etike, në përputhje me standardet e sipërpërmendura, përfshirë këtu Manualin e Auditimit të Përputhshmërisë miratuar me Vendim nr. 66, datë 23.06.2020 edhe Kodin e Etikës së KLSH-së, miratuar me Vendimin nr. 27, datë 20.04.2018, të Kryetarit të KLSH-së. Auditimi përfshin kryerjen e procedurave me qëllim marrjen e evidencave të auditimit mbi ligjshmërinë. Procedurat janë përzgjedhur mbështetur mbi gjykimin profesional të audituesit.

Gjithashtu, ne besojmë se dëshmitë e marra gjatë punës sonë audituese janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazat për përgatitjen e opinionit të kualifikuar.

Nga auditimi i përputhshmërinë, për sa i takon shkallës së zbatueshmërisë së rregullave, ligjeve dhe rregulloreve, politikave, kodeve të vendosura apo termave dhe kushteve, mbi të cilat realizohet veprimtaria, (kriteret e auditimit të përputhshmërisë), janë konstatuar mangësi dhe parregullsi, më lidhje me verifikimin e procedurave të ndjekura për saktësinë e lëshimit të AMTP-ve dhe konfirmimi dhe pozicionimi i planvendosjeve të tyre për regjistrim të AMTP në DV ASHK Tiranë:

***Njësia Administrative Kashar:***

**- Në 21 raste,** ne listat e trojeve 0001 të ZK 2105 Kashar janë pasqyruar 2 - 3 troje për çdo kryefamiljar, ne vend te 1 trualli deri 300 m2, madje listat pasqyrojne sipërfaqe mbi normën 300 $m^2$, në kundërshtim me dekretin e Presidentit nr. 5747 datë 29.06.1978 dhe ligjin nr.

33/2012 "*Për regjistrimin e pasurive të Paluajtshme" ndryshuar* si dhe Rregulloren 184 datë 08.04.1999, ndryshuar nr. 7 datë 07.01.2000 "*Për punën e ZVRPP".* Pranimi i kësaj liste te parregullt është në kundërshtim me VKM nr. 556 datë 23.10.2000 "*Për dorëzimin dokumentacionit në ZVRPP".*

**- Ne 20 raste,** ne Kashar disponohen 2 - 3 AMTP për te njëjtin kryefamiljar, ne vend te 1 AMTP, madje AMTP paraqesin korrigjime dhe mungese te dhënash, ne kundershtim me ligjin 7501 datë 19.7.1991 "*Për tokën*", me ligjin 9948 datë 7.07.2008 "*Për Shqyrtimin vlefshmërisë ligjore krijimit titujve pronësisë mbi tokën bujqësore"* ndryshuar, me nenin 119 "*Pavlefshmëria akteve*" .

**- Ne 1 rast**, ish-komuna Kashar nuk ka dokumentacion sqarues shkresor në lidhje me kompensimin e sipërfaqes 1000 $m^2$, që rezulton ne zërin kadastral "kanal", pasuri e patjetërsueshme sipas kontratës së shitjes 05.09.2013 midis AKKP Tirane shitës dhe blerës "K.OIL" shpk, ne kundërshtim me nenin 7/1 dhe nenin 11/1/a te ligjit nr. 9235 date 29.07.2004 i ndryshuar "*Për kthimin dhe kompensimin e pronës".*

**- Ne 3 raste**, është ndryshuar zëri kadastral nga "pyll" ne "ullishte" dhe "are", pjesë e pasurisë "pyll" nr. 94 shtet, ZK 2105, vol 14, faqe 13, duke lëshuar AMTP, copëzuar, shitur dhe janë kryer ndërtime me leje dhe pa leje mbi këto pasuri, veprime në kundërshtim me nenin 2 dhe 21 te ligjit nr. 7501 date 19.07.1991 "*Per token",* me nenin 10 dhe 14 te ligjit nr. 9244 date 17.06.2004 "*Per mbrojtjen e tokes bujqesore",* me nenin 17 të ligjit 9385 datë 4.5.2005 "*Për pyjet dhe kullotat*".

**- Ne 1 rast,** sipas vendimit nr. 47 date 31.01.2017 KVVTP, ka shpallur me pavlefshmëri te plote për AMTP-në nr. 331/1996 rrjedhimisht edhe për pasurinë nr. 154 për 3200 $m^2$ "arë", e cila rezulton e shitur në të tretë. Nga Njësia Administrative Kashar nuk disponohet dokument për arkëtimin e vlerës 1,433,600 leke nga familjaret e H V, (*pasuria e regjistruar nr. 1154/38, vol 17, faqe 111, ZK 2105),* ne kundershtim me ligjin 9948 datë 7.07.2008 "*Për Shqyrtimin vlefshmërisë ligjore krijimit titujve pronësisë mbi tokën bujqësore"* ndryshuar, me ligjin 7501 datë 19.7.1991 "*Për tokën*".

**- Ne 1 rast,** *11-27*, pasi është toke pa frutë (PF), pra nuk është objekt i AMTP nr. 711/69, date 20.05.1996, shfuqizuar sipas vendimit gjykatës administrative shkalles pare Tirane nr. 2568 date 09.06.2017 dhe vendimit nr. 11 date 31.01.2017 te KVVTP Tirane**.**

**- Ne 1 rast,** nuk sqarohet diferenca 1700 m2 truall *(2000-300)* ne relacionin shpjegues nr. 1242 date 17.06.2020 te njësisë Kashar, pasi ne mënyre te paligjshme sipërfaqja 2000 m2 truall përfituar nga E S pasqyrohet ne AMTP 151 date 01.10.1992 dhe formularin 6, ne vend te 300 m2 truall qe pasqyrohet ne listën e trojeve 001.

**- Ne 3 raste,** paraqiten vonesa te pajustifikuara ne korrespondencat midis institucioneve njësi-bashki-subjekt-ASHK, pasi procedura e sqarimit te problemeve te AMTP-ve ka zgjatur nga viti 2017 deri 2022 dhe vazhdon ne proces, konkretisht:

- lidhur me AMTP .date 17.05.1996, ne emër T G; lidhur AMTP 150/1992 ne emër Xh S; lidhur me AMTP nr. 65 ne emër M L,

-**Në 3 raste,** nuk sqarojnë pasuritë e shpërndara me AMTP, te cilat ndodhen midis 2 fshatrave Kashar dhe Katund i ri, ne vend te 1 fshati ku banon përfituesi i AMTP.

**- Në 7 raste,** relacionet, nuk sqarojnë diferencat e sipërfaqeve dhe sistemimin e tyre, midis AMTP - formularit 6 - planrilevimeve

**- Ne 1 rast,** Njësia Kashar nuk sqaron llojin e pasurisë 299/ për 800 m2 te AMTP 108/1995,

**- Ne 1 rast,** Njësia Kashar nuk sqaron ne relacion menaxhimin e pasurisë "shtet" 562/8 për 1037 m2, vol 25, faqe 74, ZK 2105, pasi është e okupuar nga E E, sipas shkresës ZRPP nr. 30010 date 03.09.2018 dhe date 12.02.2020.

**- Në 14 raste** praktika e akivuar pranë Njësisë Administrative ka mangësi dhe mos plotësim të dokumentacionit të kërkuar ligjor për regjistrimin e pasurisë "Tokë bujqësore" sipas AMTP të lëshuara në zbatim të ligjit "Për tokën" si dhe relacioni shpjegues nuk ka referime e përcaktime për pozicionimin e pasurisë**.**

**- Në 6 raste** në relacionin shpjegues nuk ka referime e përcaktime për pozicionimin e pasurisë e cila bie në status "PF", si dhe nuk ka dokumentacion shterues mbi vlefshmërinë e lëshimit të AMTP-ve, konkretisht:

***Njësia Administrative Vaqarr:***

**- Në 5 raste,** rezulton se janë regjistruar në ASHK gjithsej 214 $m^2$ "truall" mbi normën mesatare prej 300 $m^2$ troje kjo e rezultuar nga rakordimi i listës të troje nr. 001 ZK 3321 administruar në ASHK me listën të troje nr. 001 ZK 3321 fshati " Sharrë" administruar në Njësinë Administrative Vaqarr.

**- Në 1 rast,** rezulton se pasuria nr. 301/4, ZK 3321, vol 1, faqe 26, me sipërfaqe 3200 $m^2$ aktualish pasuria mbi të cilën është lanfildi, rezulton e pa regjistruar megjithëse ka një korrespondencë të përsëritur midis NJA dhe ASHK dhe referuar AMTP nr. 41; LN dhe formularit nr. 6 është e llojit " arrë" ; "Vresht" dhe "Grope silazhi".

**- Në 2 raste,** rezulton se Komisioni i Ndarjes Tokës ka dhënë tokë të fshatit Vishaj dhe Damjan jashtë kufirit të fshatit Arbanë dhe ky veprim nuk është pasqyruar në relacionin shpjegues nr. 807, datë 25.03.2021, për regjistrimin e pasurive konkretisht sipas AMTP 71, pasuria 60/1 për 17000 $m^2$ dhe AMTP nr. 31 date 15.03.1993 për 11924 $m^2$, ZK 1315.

**- Në 1 rast,** rezulton se Njësia Administrative Vaqarr nuk ka zgjidhur kërkesën për saktësim nga DV ASHK Tirana Rurale 2 për azhurnimi hartës për gjendjen faktike në terren dhe pozicionin pasurive, tërheqjen e deklaratave noteriale të kufitarëve në ZK 2119 dhe ne ZK 2105.

**- Në 2 raste,** rezulton se ka vonesë mbi 10 vjet në korrespondencë Njësia administrative me ASHK për regjistrimin e pasurive sipas AMTP 45 date 19.05.1992, ZK 1017, Allgjate, Vaqarr dhe veprim të gabuar në kthimin e përgjigjes për pasurinë nr. 73/, ne vend te pasurisë nr. 83/14, ZK 1867, sipërfaqe 1000 $m^2$, vol 3, faqe 63, fshati Gropaj

**- Në 1 rast** nuk ka sqarime për plan rilevimin e datës 23.10.2020 mbi përfshirjen e kanalit si pasuri publike në pasurinë e regjistruar me nr. 76/48, vol 3, faqe 83, sipërfaqe 3900 $m^2$ (1100 $m^2$ ndërtesa), ZK 1867, fshati Gropaj megjithëse nuk është përfshirë në AMTP që është bazë e regjistrimit të kësaj pasurie.

- **Ne 7 raste,** paraqitet moszbatim te afateve ligjore deri 1 vit, lidhur me korrespondencën për kthimin e përgjigjeve ndaj kërkesave dhe ri-kërkesave te ASHK dhe anasjelltas për Njësinë Vaqarr, nuk ka shpjegime ligjore për vonesën e përgjigjes. Si dhe nuk është plotësuar dokumentacioni ligjor i kërkuar nga DV ASHK Tirana Rurale.

**- Ne 14 raste**, dosjet e subjekteve kane mangësi dhe parregullsi ne dokumentacionin tekniko-ligjor, konkretisht: Në 2 raste, mungon HTR dhe formulari nr. 6; në 4 raste, mungon plan rilevimi ose janë te parregullta; në 3 raste, mungon dokumentacioni për argumentimin e diferencës sipërfaqes midis AMTP dhe vërtetimit pagesës taksave vendore, pasi pasqyrojnë sipërfaqe te ndryshme, çka tregon mos-rakordim me ASHK (për shitjet dhe transaksionet e pronës); në 1 rast, nuk përputhet AMTP date 10.08.1993 me formularin nr. 6; në 3 raste, deklaratat e kufitareve janë pranuar të parregullta, pasi janë pa date, pa numër, me korrigjime, mungojnë firmat e kufitareve, identiteti i kufitarit nuk është i sakte; në 1 rast, nuk përputhen kufitaret, midis deklaratës kufitareve dhe AMTP, për 1 pasuri, pasi sipas deklaratës ne perëndim ajo kufizohet me "shtet", në fakt sipas AMTP kjo pasuri ne perëndim kufizohet nga kufitar privat dhe jo shtet; në të gjitha rastet nuk disponohet vendimi ne njësinë vendore Vaqarr për normën për fryme, për rrjedhoje nuk argumentohet norma për fryme.

**- Në 7 raste,** relacionet shpjeguese nuk janë analitikë duke u trajtuar ne hollësi çdo mangësi dhe problematike përkatëse, paraqiten te pjesshëm në saktësimin e pasurive tokës bujqësore përfituar me AMTP, sipas kërkesës se ASHK, Bashkisë dhe subjektit, përkatësisht: Në 1 rast, relacioni sqaron një pasuri te AMTP, ndërsa nuk flet për pasuritë tjera te AMTP; në 2 raste, relacionin nuk sqaron mospërputhjen e AMTP-se me formularin nr. 6, pasi këta 2 dokumente pasqyrojnë numër dhe sipërfaqe te ndryshme te pasurive tokës bujqësore (AMTP përmban 1 pasuri, ndërsa formulari 6 përmban 3 pasuri); në 3 raste, relacioni nuk shpjegon pajisjen me 3 AMTP të familjes pandara nga trungu 1991, ne vend te 1 AMTP, nuk sqarohet sipërfaqja totale

e marre sipas normës për frymë, nëse ka efekte; në 1 rast, relacioni shpjegues nuk sqaron dhënien e tokës me 2 standarde, pasi 2 familje me numër te njëjtë frymësh disponojnë sipërfaqe te ndryshme për te njëjtën ZK; në 2 raste, paraqitet mos-rakordim midis KPP dhe AMTP, madje KPP pasqyron emër tjetër.

**-Në 3 raste** në relacionin shpjegues nuk ka referime e përcaktime për pozicionimin e pasurisë konkretisht: - Pasuria me nr. 135, vol 1, faqe 150 ZK 3712 adresë Vaqarr lloji "kullotë" sipërfaqe 9140 m$^2$ pronësi "Shtet"; - Pasuria me nr. 52/36/1, vol 2, faqe 3 ZK 1867 adresë Gropaj lloji "truall" sipërfaqe 400 m$^2$ sipas akti dhe 600 m$^2$ ndërtesë 140 m$^2$; - Pasuria nr. 76/1, vol __, faqe __ ZK 3784 adresë Vishaj lloji "arrë" sipërfaqe 3220 m$^2$ që sipas akti rezulton e pa afishuar.

**- Në 2 raste** Nuk ka sqarime për ndryshimet e sipërfaqeve të pasurive dhe ndarjen e parcelave sipas regjistrimit fillestar konkretisht: - Pasuria nr. 294/6, vol. 2, faqe 53 në pronësi të Xh L me sip. 4500 m$^2$ e llojit "arrë" dhe Pasuria nr. 339/3, vol. 2, faqe 54 në pronësi të Xh L me sip. 2000 m$^2$ e llojit "arrë"; -për pasurinë nr. 46/12, Vol 9, faqe 121 ZK 3321 me sipërfaqe 2094 m$^2$. Veprime në kundërshtim me VKM nr. 994, datë 9.12.2015 "Për procedurën e regjistrimit të akteve të marrjes së tokës në pronësi"; me Ligjin nr. 20/2020, datë 03.05.2020 "Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë"; si dhe VKM nr. 1174, datë 24.12.2020 "Për procedurat e regjistrimit të AMTP-ve, saktësimin e kufijve e sipërfaqeve, si dhe normat për sipërfaqet shtetërore shtesë e pronat shërbyese".

***-Njësia Administrative Zall-Bastar:***

**- Ne 1 rast,** 2 pasuritë me sipërfaqe 3531 m2 *(1325+2206)* dhënë me AMTP date 22.06.1992 për familjen bujqësore M L, rezultojnë me certifikate pronësie ne emër te personave tjerë, qe ne vitin 2001.

**- Ne 1 rast,** mungon korrespondenca pas vitit 2020 midis Njësisë Zall-Bastar dhe ASHK, për sqarimin dhe sistemimin e sipërfaqeve tepër 3893 m2 nëse kane kaluar *"shtet",* pasi 5 pasuritë regjistruar ne vitin 2001 (KPP) ne emër A R Ç, fshati Bastar-Murriz, ZK 1125, janë me te mëdha se AMTP 70, formulari 6 dhe plan rilevimet, sipas relacionit shpjegues 07.09.2020.

**- Ne 1 rast,** relacioni shpjegues 15.11.2020 i njësisë Zall-Bastar nuk sqaron diferencën 11085 m2 *(21800-10715)* midis AMTP 22/1992 dhe vërtetimit taksave vendore ne emër S M, fshati Besh.

**- Ne 1 rast,** përfituar 2 AMTP nga familja Dervishi, ne 1992 pretendohet se ka qene e ndare ne 2 familje, ku disponohet 1 certifikate familjare ne vend te 2 certifikatave familjare.

**- Në 3 raste,** dosjet e kthyera për mangësi dhe mungesë të dokumentacionit të konstatuara nga Drejtoria e Përgjithshme Juridike e Aseteve dhe Liçensimit, Drejtoria e Pasurive të Paluajtshme Bashkia Tiranë nuk janë plotësuar, por janë nisur përsëri më mangësi nga Njësia Administrative Zall-Bastar.

**- Në 3 rast** janë lëshuar AMTP-të me nr. 34, datë 18.08.2000; nr. 276, datë 18.08.2000; nr. 63, datë 18.08.2000 në kundërshtim me ligjin nr. 7501, datë 19.07.1991 "Për Tokën", me VKM nr. 994, datë 9.12.2015 "Për procedurën e regjistrimit të akteve të marrjes së tokës në pronësi"

**- Në 1 rast** nga Njësia Administrative Zall-Bastar në relacionin shpjegues nuk ka sqaruar pajisjen me AMTP familje bujqësore me gjendje pas datës 01.08.1991, nuk ka sqaruar normën për frymë të tokës bujqësore dhe të argumentonte zbatimin e saj.

**- Në 2 rast** ka mangësi dokumentare dhe nuk ka sqarime të dokumentuar:

**- Në 1 rast** nuk ka azhornim faktik të pasurive të regjistruara në ASHK me nr. 93, vol 1, faqe 93 ZK 3775 me sipërfaqe 6000 m$^2$ fshati Vilëz dhe nr. 711 vol. 3, faqe 211. 6600 m$^2$ "arrë" për saktësimin e gjendjen e pasurisë së poseduar faktikisht në terren veprime në kundërshtim me nenin 38 të ligjit nr. 111/2018.

***Përgjegjësitë e Drejtuesve të Njësisë Administrative Kashar, Vaqar dhe Zall-Bastar:***

Strukturat drejtuese të Njësisë Administrative Kashar, Vaqar dhe Zall-Bastar janë përgjegjëse për konfirmimin e AMTP-ve dhe konfirmimin dhe miratimin e plan rilevimit për regjistrimin në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore të fushës, si dhe kryerjen e shërbimeve ndaj

publikut brenda afateve ligjore, me qëllim rritjen e besueshmërisë dhe transparencës ndaj qytetarëve. Stafi drejtues është përgjegjës për drejtimin e institucionit, në përputhje me politikat, ligjet dhe rregulloret e aplikuara (kriteret e vlerësimit). Stafi drejtues është përgjegjës për përdorimin e burimeve financiare në përputhje me të gjitha ligjet dhe rregulloret në fuqi.
**Përgjegjësitë e Audituesve të KLSH mbi Auditimin e Përputhshmërisë*:***
Objektivi i audituesit të jashtëm publik lidhet me garantimin e sigurisë së arsyeshme, nëse procedurat e konfirmimit të AMTP-ve dhe konfirmimin dhe miratim e plan rilevimit për regjistrimin të miratuara nga Njësitë Administrative Kashar, Vaqar dhe Zall-Bastar nuk paraqesin anomali materiale, kështu si pasaktësi apo gabime që mund të kenë ekzistuar, nëse regjistrimi i pasurive dhe transaksionet mbi pasuritë, e regjistruara janë kryer, në përputhje me kriteret e përcaktuara dhe kërkesat ligjore. Siguria e arsyeshme është një nivel i lartë sigurie, por nuk garanton që auditimi i kryer në përputhje me standardet mundëson identifikimin e çdo gabimi apo anomalie që mund të ekzistojë. Përveç standardeve ISSAI, audituesi i KLSH, gjithashtu aplikon edhe gjykimin dhe skepticizmin e tij profesional në punën audituese. Auditimi identifikon çështjet më të rëndësishme lidhur me auditimin e aktivitetit të institucionit gjatë të periudhës objekt auditimi, duke i përshkruar në raportin e auditimit, me përjashtim të rasteve kur kuadri ligjor, nuk lejon vënien në dispozicion të tyre, për publikun ose në raste të rralla kur vetë ne vendosim që këto çështje nuk duhet të përfshihen në raport për shkak të pasojave negative që publikimi i tyre mund të sjellë në publikun e gjerë.

## I - HYRJE

Mbështetur në Ligjin 154/2014, datë 27.11.2014 "Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit", në zbatim të Programit të Auditimit nr.118/1 prot., datë 31.01.2023, nga data 08.02.2023 deri në datën 28.04.2023, në subjektin Njësitë Administrative Kashar, Vaqar dhe Zall-Bastar Bashkia Tiranë u krye auditimi "Mbi verifikimin e procedurave të ndjekura për saktësisë e lëshimit të AMTP-ve dhe konfirmimin e saktësisë të AMTP-ve si dhe pozicionimit të planvendosjeve të tyre, për regjistrimin në ASHK", për periudhën nga 01.01.2019 deri me datë 31.12.2022, nga Grupi i Auditimit me përbërje:

1. A.M., Përgjegjës grupi
2. B.B., Auditues,
3. E. G., Auditues.

**1. Titulli -** Mbi Auditimin tematik të Përputhshmërisë në Njësitë Administrative Kashar, Vaqar dhe Zall-Bastar Bashkia Tiranë

**2. Marrësi –** Bashkia Tiranë

**3. Objektivat dhe qëllimi**
**Objektivat:** Mbi dhënien e një vlerësimi objektiv, profesional e të pavarur, mbi shkallën e ndjekjes nga subjekti i rregullave, ligjeve dhe rregulloreve, politikave, kodeve, procedurat e shqyrtimit dhe miratimit të kërkesave për verifikimin e procedurave të ndjekura në saktësinë e lëshimit të AMTP-ve, dhe konfirmimin e saktësisë të AMTP-ve si dhe pozicionimit sipas planvendosjeve të tokave bujqësore, për regjistrimin në ASHK.
**Qëllimi:** Raportimi dhe evidentimi i gjetjeve, nxjerrja e konkluzioneve mbi bazën e vlerësimeve të gjetjeve dhe dhënia e rekomandimeve për përmirësim, mbështetur mbi evidenca të besueshme, të mjaftueshme dhe përkatëse.

**4. Identifikimi i çështjes**
Ky Projekt Raporti Auditimit i përgatitur, synon të identifikojë përmbushjen e rolit të Njësive Administrative Kashar, Vaqar dhe Zall-Bastar Bashkia Tiranë dhe përgjegjësive të tyre, që burojnë nga kuadri ligjor dhe dispozitat në fuqi, përsa i përket procedurës së ndjekur për verifikimin e procedurave të ndjekura për saktësinë e lëshimit të AMTP-ve, konfirmimin e

saktësisë të AMTP-ve, si dhe pozicionimit sipas planvendosjeve të tokave bujqësore, për regjistrimin në ASHK. Në bazë të gjykimit dhe skepticizmit profesional, për qëllimet e auditimit, audituesit kanë bërë vlerësimin, analizimin dhe klasifikimin e gabimeve të zbuluara, si dhe janë vlerësuar evidencat e grumbulluara përsa i përket besueshmërisë, mjaftueshmërisë dhe përshtatshmërisë.
Në lidhje me verifikimin e procedurave të mësipërme, nga Grupi i Auditimit u shqyrtuan: dokumentacioni tekniko-ligjor i AMTP-ve; formulari 6; libri kadastral i fshatrave; hartat kadastrale me shk: 1:5000 dhe me shkallë 1:2500; plan rilevimet; deklarata noteriale; si dhe korrespondencat shkresore me institucionet përkatëse.
*Drejtimet kryesore të auditimit të miratuara në programin e auditimit janë si më poshtë:*
- Auditimi i procedurave të ndjekura nga Njësitë Administrative/Bashkia për saktësinë e lëshimit të AMTP-ve, në referencë të dispozitave të ligjeve nr. 9948, datë 7.7.2008, të ndryshuar, nr. 57/2012 dhe nr. 171/2014.
- Auditimi i procedurave të ndjekura nga Njëstë Administrative/Bashkia për konfirmimin e saktësisë të AMTP-ve dhe pozicionimit të planvendosjeve të tyre, në referencë të dispozitave të ligjit 33/2012 dhe 20/2020.
- Probleme të ndryshme të dala gjatë auditimit .

**5. Përgjegjësitë e strukturave drejtuese të subjektit të audituar**
Strukturat drejtuese dhe punonjësit e subjektit Njësia Administrative Kashar, Vaqar dhe Zall-Bastar Bashkia Tiranë janë autoriteti që konfirmojnë për çdo pasuri që gjendet në juridiksionin territorial. Për problematikat e trajtuara lidhur me çështjet nën auditim, mbajnë përgjegjësi për veprimet apo mosveprimet në lidhje me zbatimin e procedurës për verifikimin e lëshimit të AMTP-ve, konfirmimin, saktësimin si dhe pozicionimit sipas planvendosjeve të tokave bujqësore për regjistrimin në DV ASHK Rurale 2, në përputhje e zbatim të Ligjit nr. 9948, datë 7.7.2008, "Për shqyrtimin e vlefshmërisë ligjore të krijimit të titujve të pronësisë mbi tokën bujqësore", të ndryshuar dhe në referim të VKM nr. 994, datë 9.12.2015 "Për procedurën e regjistrimit të akteve të marrjes së tokës në pronësi".

**6. Përgjegjësitë e audituesve**
Përgjegjësia e audituesve është të shprehen në lidhje me verifikimin e procedurave të ndjekura në saktësinë e lëshimit të AMTP-ve, si dhe pozicionimit sipas planvendosjeve të tokave bujqësore, për regjistrimin në ASHK, bazuar në vlerësimin e konkluzioneve të nxjerra nga evidencat e mbledhura. Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit ISSAI sipas INOTSAI, të cilat kërkojnë që audituesi të respektojë kërkesat etike duke planifikuar e kryer auditimin me qëllim arritjen e nivelit të sigurisë të arsyeshme në dhënien e opinionit, sipas evidencës së mbledhur të auditimit.

**7. Kriteret e vlerësimit**
- Ligji nr.154/2014, datë 27.11.2014 "Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit";
- Ligji nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore";
- Ligjit nr.7501, datë 19.7.1991 "Për tokën", të ndryshuar.
- Ligji nr. 8312, datë 26.3.1998 "Për tokat bujqësore të pandara".
- Ligjin nr. 8053, datë 21.12.1995, "Për kalimin në pronësi pa shpërblim të tokës bujqësore", të ndryshuar.
- Ligjin nr. 9948, datë 7.7.2008, "Për shqyrtimin e vlefshmërisë ligjore të krijimit të titujve të pronësisë mbi tokën bujqësore", të ndryshuar.
- Ligjin nr. 171/2014, "Për përfundimin e procedurave ligjore të kalimit të tokës bujqësore të ish-ndërmarrjeve bujqësore në pronësi të përfituesve".
- Ligji nr.20/2020, datë 5.3.2020 "Për përfundimin e procesit të kalimit në pronësi të përfituesve të tokës bujqësore të ish-ndërmarrjeve bujqësore".

- VKM nr. 994, datë 9.12.2015 "Për procedurën e regjistrimit të Akteve të Marrjes së Tokës në Pronësi (AMTP)".

**8. Standardet e auditimit**

Auditimi bazohet në Ligjin nr.154/2014, datë 27.11.2014 "Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit", Manualin e Auditimit të Përputhshmërisë, Rregulloren e Procedurave të Auditimit nr.107, datë 08.08.2017, e ndryshuar me nr. 63, datë 22.06.2020 dhe Standardet Ndërkombëtare të Auditimit ISSAI.

**9. Metodat e auditimit**

Për arritjen e objektivave, audituesit janë bazuar tek kombinimi i testeve të ndryshme të auditimit dhe në procedurat analitike. Metodat e përdorura gjatë auditimit në arritjen e konkluzioneve janë:

**a.** *Metoda "Testim hap pas hapi"***:** Përfaqëson veprime specifike që ndiqen brenda sistemit nga origjina deri në veprimin e fundit. Në këtë rast një numër i caktuar praktikash janë përzgjedhur për të parë se si njësia publike i është përmbajtur procedurave të caktuara.

**b.** *Metoda e ekzaminimit*: Kjo është një procedurë e cila ka shërbyer për të shqyrtuar të dhëna që lidhen me kryerjen e auditimit. Në këtë mënyrë, ajo që është vëzhguar dhe identifikuar të mund të testohet më tej. Vlerësimi ka përfshirë procedura testimi, si dhe gjykimin profesional të audituesve në lidhje me përshtatshmërinë dhe efiçencën e veprimeve.

**c.** *Metoda e ekzaminimit kryq*: Është përdorur kur është marrë informacioni për një ngjarje nga një burim i caktuar. Ky informacion është marrë dhe është krahasuar me një informacion të marrë për të njëjtat ngjarje, por me origjinë nga një burim tjetër. Kjo metodë është përdorur për të arritur nivelin e mjaftueshëm të besueshmërisë së përfundimeve**.**

**d.** *Metoda e inspektimit fizik:* Me anë të kësaj metode audituesit kanë verifikuar gjendjen fizike të dokumenteve të ndryshme në lidhje me çështjet nën auditim.

**e.** *Metoda e intervistimit*: Është konsideruar si një nga metodat më të mira dhe më të përshtatshme të përdorura gjatë procesit të auditimit për të gjetur informacion të menjëhershëm. Duke qenë se kjo metodë kufizohet nga besueshmëria e evidencës së mbledhur gjatë përdorimit të saj, kjo metodë është përdorur për kontrollin dhe verifikimin e informacionit gjatë përdorimit të ekzaminimit kryq, ose forma të tjera si p.sh. caktimi i takimeve, intervistat me punonjësit e tjerë të institucionit, ballafaqimi midis punonjësve që kanë patur përgjegjësi në procesin e punës etj. Është intervistuar stafi menaxherial dhe operacional gjatë fazës së njohjes së aktiviteteve dhe proceseve të njësisë së audituar. Intervistat kanë ofruar një mundësi për parashtrimin e pyetjeve për sqarim të informacionit shtesë në bazë të përgjigjeve të dhëna. Audituesit kanë qenë të paanshëm dhe janë munduar të jenë sa më efektiv duke iu shmangur anshmërisë së informacioneve duke bërë pyetje të hapura (që kërkojnë përgjigje dhe shpjegime disi të gjera). Evidencat e auditimit që përftohet nga takimi janë mbajtur saktë dhe në mënyrë korrekte.

**f.** *Metoda e testimit të detajuar*: Audituesit kanë kryer ekzaminimin e dokumenteve të institucionit sipas objektivave të auditimit, dhe kanë marrë evidenca më të besueshme se sa intervistimi ose në mbështetje të informacioneve të mbledhura gjatë intervistimit.

**10. Dokumentimi i auditimit**

Dokumentimi i rezultateve të auditimit u mbështetet në kërkesat e Manualit të Auditimit të Përputhshmërisë dhe në Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit ISSAI 1230 "Dokumentimi i Auditimit". Nga audituesit u përgatit dokumentacioni i auditimit i mjaftueshëm për të mundësuar dhe kuptuar natyrën, kohën dhe shtrirjen e procedurave të auditimit të kryera në përputhje me standardet përkatëse dhe kërkesat e zbatueshme ligjore dhe rregullatorë. Konkluzionet janë arritur duke u bazuar në rezultatet e procedurave të kryera dhe evidencat e marra të auditimit, si dhe në çështjet e rëndësishme që dolën gjatë auditimit.

Auditimi është në fazën ku nga subjektet e audituar *(Njësitë administrative Kashar, Vaqar dhe Zall-Bastar Bashkia Tiranë)*, kanë paraqitur kundërshtitë në lidhje me Projektraportet e auditimit me nr. 118/5,6 dhe 7, datë 01.06.2023, për të cilën grupi i KLSH pasi analizojë me kujdes, paanshmëri dhe profesionalizëm, mori në konsiderate rastet të cilat kishin mbështetje ligjore dhe me dokumentacion. Ndërsa rastet e tjera të cilat nuk kishin argumentin e mjaftueshëm ligjorë dhe janë paraqitur jashtë afatit nuk gjejnë pasqyrim në këtë Raport Përfundimtar Auditimi i cili i përcillet subjektit për njohje dhe veprim.

## III. PËRSHKRIMI I AUDITIMIT.

### III. 1. Informacion i përgjithshëm mbi subjektin nën auditim

### III.1.A. NJËSIA ADMINISTRATIVE KASHAR

Nga të dhënat e paraqitur nga Njësia Administrative Kashar për konfirmimin e AMTP për regjistrim dhe procedurën e ndjekur për plotësimin e dokumentacionit tekniko ligjorë dhe dërgimin e dosjeve në Drejtorinë e Përgjithshme të Objekteve në Bashkëpronësi, Administrimit të NJA-ve dhe Emergjencave Civile (DANJA-ve/AMTP-ve), Bashkia Tiranë, ku kjo e fundit pas verifikimit të mëtejshëm për dërgimin e tyre në ASHK Tiranë për regjistrim, në zbatim të urdhrit të Kryetarit të Bashkisë Tiranë nr. 26474/1 datë 02.09.2016 "Për delegimin e kompetencave nga Bashkia Tiranë tek Njësitë Administrative nën administrim territorial dhe administrativ të Bashkisë Tiranë për kryerjen e procedurave që lidhen me krijimin e titujve të rinj të pronësisë mbi tokën bujqësore dhe të procedurave që lidhen me shqyrtimin e vlefshmërisë tekniko-ligjore të titujve të pronësisë të krijuara, mbi tokën bujqësore të ish ndërmarrjeve bujqësore dhe ish kooperativave bujqësore", i ndryshuar, në mbështetje në VKM-në nr. 994, datë 09.12.2015 "Për mënyrën e procedimit për pasuritë e paluajtshme, të fituara me Aktin e Marrjes të Tokës në Pronësi (AMTP), të nenit 9 të Ligjit nr. 9948, datë 7.7.2008, "Për shqyrtimin e vlefshmërisë ligjore të krijimit të titujve të pronësisë mbi tokën bujqësore", të ndryshuar, të Ligjit nr. 171/2014, "Për përfundimin e procedurave ligjore të kalimit të tokës bujqësore të ish-ndërmarrjeve bujqësore në pronësi të përfituesve", i ndryshuar, si dhe të neneve 25 dhe 45 të ligjit 33/2012 datë 21.03.2012 "Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme" dhe ligji nr. 111/2018 "Për Kadastrën".

### III.1.B. NJËSIA ADMINISTRATIVE VAQARR

Nga të dhënat e paraqitur nga Njësia Administrative Vaqarr për konfirmimin e AMTP për regjistrim dhe procedurën e ndjekur për plotësimin e dokumentacionit tekniko ligjorë dhe dërgimin e dosjeve në Drejtorinë e Përgjithshme të Objekteve në Bashkëpronësi, Administrimit të NJA-ve dhe Emergjencave Civile (DANJA-ve/AMTP-ve), Bashkia Tiranë, ku kjo e fundit pas verifikimit të mëtejshëm për dërgimin e tyre në ASHK Tiranë për regjistrim, në zbatim të urdhrit të Kryetarit të Bashkisë Tiranë nr. 26474/1 datë 02.09.2016 "Për delegimin e kompetencave nga Bashkia Tiranë tek Njësitë Administrative nën administrim territorial dhe administrativ të Bashkisë Tiranë për kryerjen e procedurave që lidhen me krijimin e titujve të rinj të pronësisë mbi tokën bujqësore dhe të procedurave që lidhen me shqyrtimin e vlefshmërisë tekniko-ligjore të titujve të pronësisë të krijuara, mbi tokën bujqësore të ish ndërmarrjeve bujqësore dhe ish kooperativave bujqësore", i ndryshuar, në mbështetje në VKM-në nr. 994, datë 09.12.2015 "Për mënyrën e procedimit për pasuritë e paluajtshme, të fituara me Aktin e Marrjes të Tokës në Pronësi (AMTP), të nenit 9 të Ligjit nr. 9948, datë 7.7.2008, "Për shqyrtimin e vlefshmërisë ligjore të krijimit të titujve të pronësisë mbi tokën bujqësore", të ndryshuar, të Ligjit nr. 171/2014, "Për përfundimin e procedurave ligjore të kalimit të tokës bujqësore të ish-ndërmarrjeve bujqësore në pronësi të përfituesve", i ndryshuar, si dhe të neneve 25 dhe 45 të ligjit 33/2012 datë 21.03.2012 "Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme" dhe ligji nr. 111/2018 "Për Kadastrën".

**III.1.C. NJËSIA ADMINISTRATIVE ZALL-BASTAR**

Nga të dhënat e paraqitur nga Njësia Administrative Zall-Bastar për konfirmimin e AMTP për regjistrim dhe procedurën e ndjekur për plotësimin e dokumentacionit tekniko ligjorë dhe dërgimin e dosjeve në Drejtorinë e Përgjithshme të Objekteve në Bashkëpronësi, Administrimit të NJA-ve dhe Emergjencave Civile (DANJA-ve/AMTP-ve), Bashkia Tiranë, ku kjo e fundit pas verifikimit të mëtejshëm për dërgimin e tyre në ASHK Tiranë për regjistrim, në zbatim të urdhrit të Kryetarit të Bashkisë Tiranë nr. 26474/1 datë 02.09.2016 "Për delegimin e kompetencave nga Bashkia Tiranë tek Njësitë Administrative nën administrim territorial dhe administrativ të Bashkisë Tiranë për kryerjen e procedurave që lidhen me krijimin e titujve të rinj të pronësisë mbi tokën bujqësore dhe të procedurave që lidhen me shqyrtimin e vlefshmërisë tekniko-ligjore të titujve të pronësisë të krijuara, mbi tokën bujqësore të ish ndërmarrjeve bujqësore dhe ish kooperativave bujqësore", i ndryshuar, në mbështetje në VKM-në nr. 994, datë 09.12.2015 "Për mënyrën e procedimit për pasuritë e paluajtshme, të fituara me Aktin e Marrjes të Tokës në Pronësi (AMTP), të nenit 9 të Ligjit nr. 9948, datë 7.7.2008, "Për shqyrtimin e vlefshmërisë ligjore të krijimit të titujve të pronësisë mbi tokën bujqësore", të ndryshuar, të Ligjit nr. 171/2014, "Për përfundimin e procedurave ligjore të kalimit të tokës bujqësore të ish-ndërmarrjeve bujqësore në pronësi të përfituesve", i ndryshuar, si dhe të neneve 25 dhe 45 të ligjit 33/2012 datë 21.03.2012 "Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme" dhe ligji nr. 111/2018 "Për Kadastrën".

**III. 2. Përshkrimi i rezultateve sipas drejtimeve të auditimit.**

**III.2.A NJËSIA ADMINISTRATIVE KASHAR**

**Mbi verifikimin e procedurave të ndjekura për verifikimin e saktësisë së lëshimit të AMTP-ve, dhe konfirmimin e saktësisë të AMTP-ve dhe pozicionimit të planvendosjeve të tyre, për regjistrimin në ASHK.**

Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion rezultoi se, Komuna Kashar sot Njësia Administrative Kashar, Bashkia Tiranë si pjesë e ish Kooperativës Bujqësore dhe ish Ndërmarrjes Bujqësore ka ndarë tokë sipas ligjit nr. 7501 "Për Tokën" për familje të cilët kanë qenë banorë të ish Kooperativës me datë 01.08.1991 dhe të Ndërmarrjes bujqësore të dhënat në pasqyrën si më poshtë:

| FSHATI | Sip. në dynym HA | Nr Familje ve | Numri i banorëve 1991 | Norma e tokës Për frymë (dynym) | Sasia e tokës disponi bël | Numri Familjeve të pajisur me tapi Referuar F.6 | Numri i familjeve pa tokë. |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| **Kashar** | 812 | 800 | 3300 | 3 | 0 | 1129 | No info |
| **Katund i ri** | 130 | 358 | 1499 | 1.2 | 0 | 529 | No info |
| **Yrshek** | 225 | 456 | 1931 | 1.2 | 0 | 429 | No info |
| **Mezez** | 400 | 375 | 1001 | 1.2 | 0 | 688 | No info |
| **Yzberish** | 407 | 770 | 3078 | 1.2 | 0 | 485 | No info |
| **Kus** | 140 | 100 | 400 | 2.2 | 0 | 110 | No info |
| **Mazrek** | 205 | 150 | 600 | 3.5 | 0 | 108 | No info |
| **Shuma** | **2319** | **3009** | **11809** | | | **3478** | |

Ndarja e tokës është bërë nga komisionet e ndarjes së tokës për çdo fshat sipas numrit te frymëve të datës 01.08.1991 dhe normës mesatare për frymë pa marrë parasysh koeficientin për bonitetin e tokës, pjerrësisë apo sipërfaqen ne ujë apo mbi ujë dhe as koeficientet për punonjësit qe punonin në sektorin shtetëror.

Në bazë të llogaritjeve të bëra nga komisjonet e ndarjes së tokës ka rezultuar norma për frymë sipas fshatrave :

| N/R | Fshati | Norma e tokës Për frymë e miratuar (dynym) |
|---|---|---|
| 1 | Kashar | 3 |
| 2 | Katund i Ri | 1.2 |
| 3 | Yrshek | 1.2 |
| 4 | Mezez | 1.2 |
| 5 | Yzberish | 1.2 |
| 6 | Kus | 2.2 |
| 7 | Mazrek | 3.5 |

Nga të dhënat e paraqitur nga Njësia Administrative Kashar për konfirmimin e AMTP për regjistrim dhe procedurën e ndjekur për plotësimin e dokumentacionit tekniko-ligjor dhe dërgimin e dosjeve në Drejtorinë e Përgjithshme të Objekteve në Bashkëpronësi, Administrimit të NJA-ve dhe Emergjencave Civile (DANJA-ve/AMTP-ve), Bashkia Tiranë, ku kjo e fundit pas verifikimit të mëtejshëm për dërgimin e tyre në ASHK Tiranë për regjistrim, kjo në zbatim të urdhrit të Kryetarit të Bashkisë Tiranë nr. 26474/1 datë 02.09.2016 "Për delegimin e kompetencave nga Bashkia Tiranë tek Njësitë Administrative nën administrimin territorial dhe administrativ të Bashkisë Tiranë për kryerjen e procedurave që lidhen me krijimin e titujve të rinj të pronësisë mbi tokën bujqësore dhe të procedurave që lidhen me shqyrtimin e vlefshmërisë tekniko-ligjore të titujve të pronësisë të krijuara, mbi tokën bujqësore të ish ndërmarrjeve bujqësore dhe ish kooperativave bujqësore" (i ndryshuar), në mbështetje në VKM-në nr. 994, datë 09.12.2015 "Për mënyrën e procedimit për pasuritë e paluajtshme, të fituara me Aktin e Marrjes të Tokës në Pronësi (AMTP), të nenit 9 të Ligjit nr. 9948, datë 7.7.2008, "Për shqyrtimin e vlefshmërisë ligjore të krijimit të titujve të pronësisë mbi tokën bujqësore", të ndryshuar të Ligjit nr. 171/2014, "Për përfundimin e procedurave ligjore të kalimit të tokës bujqësore të ish-ndërmarrjeve bujqësore në pronësi të përfituesve", i ndryshuar, si dhe të neneve 25 dhe 45 të ligjit 33/2012 datë 21.03.2012 "Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme" dhe ligji nr. 111/2018 "Për Kadastrën", *rezultoi si më poshtë*:

***Për vitin 2019,***

Nga Njësia Administrative Kashar janë plotësuar dhe ka dërguar drejt Drejtoria e Përgjithshme e Objekteve në Bashkëpronësi, Administrimit të NJA-ve dhe Emergjencave Civile (DANJ-ve/AMTP-ve), Bashkia Tiranë për **38 persona** të cilët kanë kërkuar për regjistrim të AMTP në ASHK.

Për dosjet e plotësuara me dokumentacionin e nevojshëm tekniko ligjorë dhe relacion shpjegues hartuar nga Njësia Administrative Kashar dhe të dërguara në ASHK për konfirmim e regjistrim, për **24 persona** të cilët kanë kërkuar për regjistrim të AMTP në DV ASHK të dhënat në pasqyrën si më poshtë:

| Nr. | Emri/Mbiemër | Prot. | Datë | DPB | ASHK | Shenime |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 1 | BL | 330 | 25.01.2019 | + | | Dërgim dokumentacioni |
| 2 | IN | 406 | 01/02/2019 | + | + | Dërgim dokumentacioni |
| 3 | PR | 621 | 18/02/2019 | + | | Dërgim dokumentacioni |
| 4 | RS | 753 | 27/02/2019 | + | | Dërgim dokumentacioni |
| 5 | YM | 831 | 04/03/2019 | + | + | Dërgim dokumentacioni |
| 6 | S K | 909 | 11/03/2019 | + | | Dërgim dokumentacioni |
| 7 | I P | 946 | 13/03/2019 | + | + | Dërgim dokumentacioni |
| 8 | GM | 973 | 15/03/2019 | + | + | Dërgim dokumentacioni |
| 9 | K M | 1004 | 18/03/2019 | + | + | Dërgim dokumentacioni |
| 10 | H H | 1086 | 26/03/2019 | + | + | Dërgim dokumentacioni |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 11 | M P | 1177 | 02/04/2019 | + | + | Dërgim dokumentacioni |
| 12 | GA | 1267 | 08/04/2019 | + | + | Dërgim dokumentacioni |
| 13 | Xh V | 1288 | 08/04/2019 | + | + | Dërgim dokumentacioni |
| 14 | A D | 1415 | 15/04/2019 | + | + | Dërgim dokumentacioni |
| 15 | K P | 1420 | 16/04/2019 | + | | Dërgim dokumentacioni |
| 16 | B E | 1873 | 23/05/2019 | + | + | Dërgim dokumentacioni |
| 17 | F P | 1891 | 27/05/2019 | + | + | Dërgim dokumentacioni |
| 18 | J Gj | 1908 | 28/05/2019 | + | + | Dërgim dokumentacioni |
| 19 | A M | 2625 | 05/08/2019 | + | + | Dërgim dokumentacioni |
| 20 | O Gj | 2639 | 06/08/2019 | + | + | Dërgim dokumentacioni |
| 21 | F A | 2746 | 20/08/2019 | + | + | Dërgim dokumentacioni |
| 22 | Xh S | 2772 | 23/08/2019 | + | + | Dërgim dokumentacioni |
| 23 | E S | 2773 | 23/08/2019 | + | + | Dërgim dokumentacioni |
| 24 | S D | 2839 | 29/08/2019 | + | | Dërgim dokumentacioni |
| 25 | SH H | 3792 | 18/10/2019 | + | + | Dërgim dokumentacioni |
| 26 | SM | 3830 | 23/10/2019 | + | + | Dërgim dokumentacioni |
| 27 | BN | 3941 | 31/10/2019 | + | + | Dërgim dokumentacioni |
| 28 | BB | 4204 | 19/11/2019 | + | + | Dërgim dokumentacioni |
| 29 | EE | 4944 | 16/12/2019 | + | + | Dërgim dokumentacioni |
| 30 | MK | 1573 | 26/04/2019 | + | + | Dërgim dokumentacioni |
| 31 | BM | 5973 | 15/03/2019 | + | | Dërgim dokumentacioni |
| 32 | PP | 1420 | 16/04/2019 | + | | Dërgim dokumentacioni |
| 33 | QP | 4946 | 13/08/2019 | + | | Dërgim dokumentacioni |
| 34 | TD | 14 | 04/01/2019 | + | | Dërgim dokumentacioni |
| 35 | HS | 1561 | 26/04/2019 | + | | Dërgim dokumentacioni |
| 36 | SHB | 409 | 01/02/2019 | + | | Dërgim dokumentacioni |
| 37 | HD | 405 | 01/02/2019 | + | | Dërgim dokumentacioni |
| 38 | PH | 3935 | 28/03/2019 | + | | Dërgim dokumentacioni |

***Për vitin 2020,***

Nga Njësia Administrative Kashar janë plotësuar dhe ka dërguar drejt Drejtoria e Përgjithshme e Objekteve në Bashkëpronësi, Administrimit të NJA-ve dhe Emergjencave Civile (DANJ-ve/AMTP-ve), Bashkia Tiranë për **33 persona** të cilët kanë kërkuar për regjistrim të AMTP në ASHK.

Për dosjet e plotësuara me dokumentacionin e nevojshëm tekniko ligjorë dhe relacion shpjegues hartuar nga Njësia Administrative Kashar dhe të dërguara në ASHK për konfirmim e regjistrim, për **18 persona** të cilët kanë kërkuar për regjistrim të AMTP në DV ASHK të dhënat në pasqyrën si më poshtë:

| Nr. | Emri/Mbiemër | Prot. | Datë | DPB | ASHK | Shenime |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 1 | BB | 27 | 07/01/2020 | + | + | Dërgim dokumentacioni |
| 2 | TG | 55 | 09/01/2020 | + | | Dërgim dokumentacioni |
| 3 | AB | 72 | 10/01/2020 | + | | Dërgim dokumentacioni |
| 4 | QGJ | 531 | 11/02/2020 | + | + | Dërgim dokumentacioni |
| 5 | PK | 655 | 19/02/2020 | + | + | Dërgim dokumentacioni |
| 6 | SHK | 813 | 25/02/2020 | + | | Dërgim dokumentacioni |
| 7 | BS | 1539 | 15/05/2020 | + | + | Dërgim dokumentacioni |
| 8 | SHH | 1585 | 26/05/2020 | + | + | Dërgim dokumentacioni |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 9 | BM | 1855 | 17/06/2020 | + | + | Dërgim dokumentacioni |
| 10 | PL | 1889 | 19/06/2020 | + | + | Dërgim dokumentacioni |
| 11 | AD | 1959 | 23/06/2020 | + | + | Dërgim dokumentacioni |
| 12 | IA | 2312 | 16/07/2020 | + | + | Dërgim dokumentacioni |
| 13 | SS | 2502 | 30/07/2020 | + | + | Dërgim dokumentacioni |
| 14 | KV | 2540 | 05/08/2020 | + | + | Dërgim dokumentacioni |
| 15 | ML | 2675 | 25/08/2020 | + | + | Dërgim dokumentacioni |
| 16 | HM | 2939 | 08/09/2020 | + | | Dërgim dokumentacioni |
| 17 | RXH | 3157 | 22/09/2020 | + | | Dërgim dokumentacioni |
| 18 | SHK | 3158 | 22/09/2020 | + | + | Dërgim dokumentacioni |
| 19 | PB | 3182 | 23/09/2020 | + | + | Dërgim dokumentacioni |
| 20 | ZK | 3196 | 24/09/2020 | + | | Dërgim dokumentacioni |
| 21 | GS | 3205 | 24/09/2020 | + | + | Dërgim dokumentacioni |
| 22 | GH | 3256 | 28/09/2020 | + | + | Dërgim dokumentacioni |
| 23 | RL | 3800 | 30/10/2020 | + | + | Dërgim dokumentacioni |
| 24 | BL | 3844 | 02/11/2020 | + | + | Dërgim dokumentacioni |
| 25 | XHF | 4164 | 24/11/2020 | + | | Dërgim dokumentacioni |
| 26 | MP | 4216 | 26/11/2020 | + | | Dërgim dokumentacioni |
| 27 | QL | 1069 | 02/03/2020 | + | | Dërgim dokumentacioi |
| 28 | SD | 4280/1 | 28/12/2020 | + | | Dërgim dokumentacioni |
| 29 | BM | 3135 | 18/09/2020 | + | | Dërgim dokumentacioni |
| 30 | AN | 1997 | 10/03/2020 | + | | Dërgim dokumentacioni |
| 31 | IH | 2745 | 27/08/2020 | + | | Dërgim dokumentacioni |
| 32 | BL | 295 | 28/01/2020 | + | | Dërgim dokumentacioni |
| 33 | BS | 1964 | 24/06/2020 | + | | Dërgim dokumentacioni |

***-Titulli i gjetjes:***
Problematikat e konstatuara në korrespondencën me Bashkinë Tiranë dhe dërgimin e AMTP për regjistrim në ASHK.
***Situata:***
**- Në 21 raste, ne listat e trojeve 0001 të ZK 2105 Kashar janë pasqyruar 2 - 3 troje për çdo kryefamiljar,** ne vend te 1 trualli deri 300 m2, madje listat pasqyrojne sipërfaqe mbi normën 300 $m^2$, në kundërshtim me dekretin e Presidentit nr. 5747 datë 29.06.1978 dhe ligjin nr. 33/2012 "*Për regjistrimin e pasurive të Paluajtshme" ndryshuar* si dhe Rregulloren 184 datë 08.04.1999, ndryshuar nr. 7 datë 07.01.2000 "*Për punën e ZVRPP"*. **Pranimi i kësaj liste te parregullt** është në kundërshtim me VKM nr. 556 datë 23.10.2000 "*Për dorëzimin dokumentacionit në ZVRPP"*.
**- Ne 20 raste,** ne Kashar **disponohen 2 - 3 AMTP për te njëjtin kryefamiljar,** ne vend te 1 AMTP, madje AMTP paraqesin korrigjime dhe mungese te dhënash, ne kundershtim me ligjin 7501 datë 19.7.1991 "*Për tokën*", me ligjin 9948 datë 7.07.2008 "*Për Shqyrtimin vlefshmërisë ligjore krijimit titujve pronësisë mbi tokën bujqësore"* ndryshuar, me nenin 119 "*Pavlefshmëria akteve*".
**- Ne 1 rast**, ish-komuna Kashar **nuk ka dokumentacion sqarues shkresor** në lidhje me kompensimin e sipërfaqes 1000 $m^2$, që rezulton ne zërin kadastral **"kanal",** pasuri e patjetërsueshme sipas **kontratës së shitjes 05.09.2013 midis AKKP Tirane shitës dhe blerës "K.-OIL" shpk,** ne kundërshtim me nenin 7/1 dhe nenin 11/1/a te ligjit nr. 9235 date 29.07.2004 i ndryshuar "*Për kthimin dhe kompensimin e pronës"*.
**- Ne 3 raste**, **është ndryshuar zëri kadastral nga "pyll" ne "ullishte" dhe "are",** pjesë e pasurisë "pyll" nr. 94 shtet, ZK 2105, vol 14, faqe 13, duke lëshuar AMTP, copëzuar, shitur

dhe janë kryer ndërtime me leje dhe pa leje mbi këto pasuri, veprime në kundërshtim me nenin 2 dhe 21 te ligjit nr. 7501 date 19.07.1991 "*Per token",* me nenin 10 dhe 14 te ligjit nr. 9244 date 17.06.2004 "*Per mbrojtjen e tokes bujqesore",* me nenin 17 të ligjit 9385 datë 4.5.2005 "*Për pyjet dhe kullotat*".

**- Ne 1 rast,** sipas vendimit nr. 47 date 31.01.2017 KVVTP, ka shpallur me pavlefshmëri te plote për AMTP-në nr. 331/1996 rrjedhimisht edhe për pasurinë nr. 154 për 3200 $m^2$ "arë", e cila rezulton e shitur në të tretë. Nga Njësia Administrative Kashar **nuk disponohet dokument për arkëtimin e vlerës 1,433,600 leke nga familjaret e HV,** (*pasuria e regjistruar nr. 1154/38, vol 17, faqe 111, ZK 2105),* ne kundershtim me ligjin 9948 datë 7.07.2008 "*Për Shqyrtimin vlefshmërisë ligjore krijimit titujve pronësisë mbi tokën bujqësore"* ndryshuar, me ligjin 7501 datë 19.7.1991 "*Për tokën*".

**- Ne 1 rast, mungon dokumenti qe vërteton se sipërfaqja 5150 m2 BS ka kaluar ne pronësi "shtet" nen administrimin e njësisë vendore Kashar**, pasi është toke pa frutë (PF), pra nuk është objekt i AMTP nr. 711/69, date 20.05.1996, shfuqizuar sipas vendimit gjykatës administrative shkalles pare Tirane nr. 2568 date 09.06.2017 dhe vendimit nr. 11 date 31.01.2017 te KVVTP Tirane**.**

**- Ne 1 rast, nuk sqarohet diferenca 1700 m2 truall** *(2000-300)* **ne relacionin shpjegues** nr. 1242 date 17.06.2020 te njësisë Kashar, pasi ne mënyre te paligjshme sipërfaqja 2000 m2 truall përfituar nga ES pasqyrohet ne AMTP 151 date 01.10.1992 dhe formularin 6, ne vend te 300 m2 truall qe pasqyrohet ne listën e trojeve 001.

**- Ne 3 raste, paraqiten vonesa te pajustifikuara ne korrespondencat midis institucioneve njësi-bashki-subjekt-ASHK,** pasi procedura e sqarimit te problemeve te AMTP-ve ka zgjatur nga viti 2017 deri 2022 dhe vazhdon ne proces, konkretisht:

- lidhur me AMTP .date 17.05.1996, ne emër TG; lidhur AMTP 150/1992 ne emër XHV; lidhur me AMTP nr. 65 ne emër ML,

-**Në 3 raste,** nuk sqarojnë pasuritë e shpërndara me AMTP, te cilat ndodhen midis 2 fshatrave Kashar dhe Katund i ri, ne vend te 1 fshati ku banon përfituesi i AMTP.

**- Në 7 raste,** relacionet, nuk sqarojnë diferencat e sipërfaqeve dhe sistemimin e tyre, midis AMTP - formularit 6 - planrilevimeve.

**- Ne 1 rast,** Njësia Kashar nuk sqaron llojin e pasurisë 299/ për 800 m2 te AMTP 108/1995,

**- Ne 1 rast,** Njësia Kashar nuk sqaron ne relacion menaxhimin e pasurisë "shtet" 562/8 për 1037 m2, vol 25, faqe 74, ZK 2105, pasi është e okupuar nga EE, sipas shkresës ZRPP nr. 30010 date 03.09.2018 dhe date 12.02.2020.

**- Në 14 raste** praktika e akivuar pranë Njësisë Administrative ka mangësi dhe mos plotësim të dokumentacionit të kërkuar ligjor për regjistrimin e pasurisë "Tokë bujqësore" sipas AMTP të lëshuara në zbatim të ligjit "Për tokën" si dhe relacioni shpjegues nuk ka referime e përcaktime për pozicionimin e pasurisë**.**

**- Në 6 raste** në relacionin shpjegues nuk ka referime e përcaktime për pozicionimin e pasurisë e cila bie në status "PF", si dhe nuk ka dokumentacion shterues mbi vlefshmërinë e lëshimit të AMTP-ve, konkretisht:

***Kriteri****:*

Në kundërshtim me urdhrin e Kryetarit të Bashkisë Tiranë nr. 26474/1, datë 02.07.2016 "Për delegimin e kompetencave nga Bashkia Tiranë tek Njësitë Administrative nën administrativin territorial dhe administrativ të Bashkisë Tiranë për kryerjen e procedurave që lidhen me krijimin e titujve të rinj të pronësisë mbi tokën bujqësore dhe të procedurave që lidhen me shqyrtimin e vlefshmërisë tekniko-ligjore të titujve të pronësisë të krijuara, mbi tokën bujqësore të ish ndërmarrjeve bujqësore dhe ish kooperativave bujqësore"; me VKM nr. 782, datë 7.10.2020 "Për miratimin e modeleve të akteve kadastrale dhe të dhënave në përmbajtje të hartës kadastrale"; me ligjin nr. 7501, datë 19.7.1991, "Për tokën", i ndryshuar; ligjin nr. 8053, datë 21.12.1995, "Për kalimin në pronësi, pa shpërblim, të tokës bujqësore", i ndryshuar; ligjin nr. 9948, datë 7.7.2008, "Për shqyrtimin e vlefshmërisë ligjore të krijimit të titujve të pronësisë

mbi tokën bujqësore", i ndryshuar me ligjin nr. 171/2014, "Për përfundimin e procedurave ligjore të kalimit të tokës bujqësore të ish-ndërmarrjeve bujqësore në pronësi të përfituesve", i ndryshuar, si dhe Urdhrin nr. 39203/1, datë 17.10.2019 "Për një shtesë në Urdhrin nr, 26474/1, datë 02.09.2016 të Kryetarit të Bashkisë "Për delegim kompetencave nga Bashkia Tiranë tek Njësitë Administrative të Bashkisë Tiranë".

***Ndikimi/Efekti:***

Parregullsia në dokumentacionin shoqërues të AMTP për regjistrim në kundërshtim me akte ligjore.

***Shkaku****:*

Mos zbatimi i kuadrit ligjorë nga personat përgjegjës

***Rëndësia****:* e lartë

***Rekomandim:***

Njësia Administrative Kashar Bashkia Tiranë në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme e Objekteve në Bashkëpronësi, Administrimit të NJA-ve dhe Emergjencave Civile (DANJ-ve/AMTP-ve), Bashkia Tiranë, të mos përcjell AMTP-të për regjistrim, në Drejtorinë Vendore të ASHK Rurale 2, pa shqyrtuar vlefshmërinë tekniko-ligjore të titullit të pronësisë të krijuar mbi tokën bujqësore (AMTP-së), pa verifikuar dhe shqyrtuar dokumentacionin kadastral që disponon Njësia Administrative Kashar.

**Praktikat me parregullsi në dokumentacion.**

**I.** Korrespondenca Njësia Kashar–Bashkia Tiranë–ASHK-Subjekt, lidhur me **AMTP 331/1992=8800 m2 për QV,** rezulton:

**a.** Personi QV i përbëre nga 7 anëtare ne 01.08.1991 ka përfituar 2 AMTP, ne vend te 1 AMTP, ne kundershtim me ligjin 7501 datë 19.7.1991 "*Për tokën*", me ligjin 9948 datë 7.07.2008 "*Për Shqyrtimin vlefshmërisë ligjore krijimit titujve pronësisë mbi tokën bujqësore"* ndryshuar, konkretisht:

- ***AMTP 331/1992 prej 8800 m2***, e përbëre nga 4 pasuri, te cilat nuk kane te pasqyruara kufitaret *( 48=600 m2 are, 173=500 vresht, 3500 m2 are, 154=4000 m2 are + 200 m2 truall).*
- ***AMTP dublikate 330/1998 = 4000 m2***, pasuria nr. 1154/8, ZK 2105, vol 14, faqe 183, sipas shkresës ASHK Rurale 2 date 16.05.2019.

Theksojmë se pavarësisht se është e regjistruar kjo pasuri 4000 m2 *(vjen nga referenca nr. 608 date 14.06.2004),* njësia vendore Kashar nuk e konfirmon aktin 330/1998 te nënshkruar nga k/komisionit tokës RS dhe përfaqësuesi rrethit SHA si dhe ish-kryetari komunës Kashar FF AMTP 330 date 10.01.1998 ne emër te QV është e parregullt**,** pasi nuk disponohet ne listën e AMTP-ve te ZK 2105, nuk është origjinale por dublikate, nuk pasqyron pasuritë tjera por vetëm pasurinë me sipërfaqen 4000 m2 e cila nuk i përgjigjet normës/ fryme.

Veprime në kundërshtim me ligjin nr. 7501, datë 19.7.1991 "*Për tokën*", me ligjin nr. 7843, datë 13.7.1994 "*Për Regjistrimin e Pasurive të Paluajtshme*"dhe me ligjin nr. 9948, datë 7.07.2008 "*Për Shqyrtimin e vlefshmërisë ligjore të krijimit të titujve të pronësisë mbi tokën bujqësore".*

***Njësia Kashar ka sqaruar se pasuria 154=4000 m2 are është e njëjte ne 2 AMTP***, sipas shkresës 4512 date 22.12.2020. Personi QV ka bere deklarate noteriale për heqjen dore nga AMTP 330 dhe kërkon certifikate pronësie vetëm për pasuritë e AMTP 331/1992. Sqarojmë se kjo pasuri është shitur te tretëve "CI" shpk,

**b. Mungon inventarizimi i dokumentacionit te dosjes,** në kundërshtim me kërkesat e nenit 3 e 29 të ligjit nr. 9154, datë 06.11.2003 "*Për Arkivat*".

**II.** Korrespondenca Njësia Kashar-Bashkia Tirane–ASHK-Subjekt, lidhur me **AMTP 329/1992 = 7800 m2 për H V,** me 5 anëtare sipas certifikatës përbërjes familjare 01.08.1991.

**a. Personi HV ka përfituar 2 AMTP, ne vend te 1 AMTP**, përkatësisht:

- ***AMTP 329/1992*** pa kufitare për 6 pasuri me sipërfaqe totale 7800 m2 *(48=500 m2 are, 173=800 vresht, 148/2=2500 m2 are, 154=2700 m2 are, 172=1200 m2 are, 52=100 m2 are + 250 m2 truall)* ose 7000 m2 are + 800 m2 vresht.

- ***AMTP dublikate 331/1996, pasuria 154 për 3200 m2 are,*** nënshkruar nga ***komisioni tokës RS BK*** dhe ***kryetari i komunës Kashar FF,*** AMTP e cila nuk përbën titull pronësie dhe është shpallur me pavlefshmëri te plote, sipas vendimit nr. 47 date 31.01.2017 te KVVTP, pasi toka me 01.08.1991 dhe 01.10.1992 ndodhet ne nje fshat tjeter Katundi i Ri, pra jashte fshatit Kashar ku ben pjese banori HV, ne kundershtim me ligjin 7501 datë 19.7.1991 "*Për tokën*", me vendimin 255 date 02.08.1991 "*Për kriteret e ndarjes tokës bujqësorë*", me vendimin 230 date 22.07.1991 "*Për krijimin komisionit tokave*", me udhëzimin 2 date 02.08.1991 "*Për funksionimin e komisionit tokës te rretheve e fshatrave".*

***Sa sipër***, bazuar ne ligjin 9948 datë 7.07.2008 "*Për Shqyrtimin vlefshmërisë ligjore krijimit titujve pronësisë mbi tokën bujqësore"* ndryshuar, KVVTP ka vendosur **detyrimin 1,433,600** leke ndaj familjes HV**,** pasi e ka shitur te treteve pasurinë e regjistruar nr. 1154/38, vol 17, faqe 111, ZK 2105 me sipërfaqe 3200 m2.

Përllogaritja është bere bazuar ne vendimin 89 date 03.02.2016 "*Për miratimin e vlerës se pronës për secilin qark te RSH"* përkatësisht 3200 m2 x 448 leke/m2 =1,433,600 leke.

**b. Nuk disponohet dokument për arkëtimin e vlerës 1,433,600 leke nga familjaret e H V,** ne zbatimin e këtij vendimi nr. 47 date 31.01.2017 te KVVTP**.**

**c.** Trualli paraqet mosperputhje te dhenash midis dokumenteve per H V, perkatesisht:

- tek AMTP pasuria 52 pasqyrohet 250 m2 truall,
- tek lista trojeve pasqyrohet pasuria 48/01/1 per 300 m2 truall *(100 m2 ndërtesë*) dhe pasuria 52/7/1 truall 300 m2 (*85 m2 ndërtesë*), ose 300 m2 truall tepër.

**d. Mungon inventarizimi i dokumentacionit te dosjes,** në kundërshtim me kërkesat e nenit 3 e 29 të ligjit nr. 9154, datë 06.11.2003 "*Për Arkivat*".

**III.** Korrespondenca Njësia Kashar-Bashkia Tirane–ASHK-Subjekt, lidhur me **AMTP 150/1992 = 14500 m2** me 7 pasuri **për XH S,** me 5 anëtare sipas certifikatës përbërjes familjare 01.08.1991, rezulton se.

**a. Paraqiten vonesa ne korrespondencat midis institucioneve,** pasi procedura e sqarimit lidhur me ndryshimet e sipërfaqeve te disa pasurive te AMTP 150 me plarilevimett, me matjet terren, me hartat vektoriale ka zgjatur nga viti 2017 deri 2020 dhe vazhdon ne proces, konkretisht:

- Pasuria nr. 974/2, ZK 2105, vol 9, faqe 226, regjistruar ne KPP me 20.06.2018 për 2000 m2 pajisur me certifikatë pronësie 2018, sipas planrilevimit rezulton 2000 m2, ndërsa sipas AMTP 150/1992 dhe formularit nr. 6 rezulton 4100 m2 are lagjja "Shelgje", dhe **akoma vazhdon sqarimi i diferencës midis AMTP dhe planrilevimin,** sipas shkresës bashkisë Tirane nr. 6319/3 date 30.10.2020 drejtuar njësisë Kashar, **ne një kohe qe kjo pasuri është shitur para 2 viteve,** sipas KSH 02.07.2018.
- Po kështu **paraqitet e pa sqaruar pasuria 976/3 e cila prek pjesërisht pasurinë 976/4**, sipas shkresës bashkisë Tirane nr. 6319/3 date 30.10.2020 drejtuar njësisë Kashar.
- Pasuria nr. 972 prej 1960 m2 sipas planrilevimit, ndërsa sipas AMTP 150 rezulton 2500 m2.

**b. pasuria 156 prej 1200 m2 ndodhet midis 2 fshatrave Kashar dhe Katund i ri**, ne vend te fshatit Kashar.

**c.** komisioni i tokës *SH Sdhe B K*ka vepruar pa përgjegjësi ne dhënien e tokës me diferenca nga terreni, me pjese te prekura te fshatra tjerë, duke plotësuar dhe nënshkruar AMTP 150/1992 te parregullt, pa kufitar dhe me sipërfaqe te pasakta te pasurive.

**d. Njësia Kashar paraqet tejzgjatje te afatit ligjor ne sqarimin e plote te pasurive** te AMTP 150/1992, fakt për ketë janë shkresat e ripërsëritura te bashkisë Tirane ne adrese te njësisë Kashar për sqarimin e problemeve te pasurive te kësaj AMTP, konkretisht shkresa nr. 1160/1

date 16.01.2018, shkresa nr. 1160/3 date 21.02.2018, shkresa nr. 42503/1 date 13.11.2019, shkresa nr. 6319/3 date 30.10. 2020 ejt.
**e. Mungon inventarizimi i dokumentacionit te dosjes,** në kundërshtim me kërkesat e nenit 3 e 29 të ligjit nr. 9154, datë 06.11.2003 "*Për Arkivat*".

**IV.** Korrespondenca Njësia Kashar-Bashkia Tirane–ASHK-Subjekt, lidhur me **AMTP 711/69 date 20.05.1996 = 10990 m2** me 4 pasuri **për B S,** rezulton:
**a. Personi** B S **ka përfituar 2 AMTP, ne vend te 1 AMTP**, *sipas shkresës nr. 1964/2 date 07.08.2020 te njësisë Kashar,* përkatësisht:
- AMTP dublikate nr. 711/69, date 20.05.1996, pa kufitar me 4 pasuri për 10990 m2 are *(pas.444=2960+pas.168=5000+pas. 449=2250+pas.175=780 m2)***,** nënshkruar nga komisioni tokës, B Kdhe SH Asi dhe kryetari i komunës Kashar F F,
- *AMTP 329/1992* e cila **nuk disponohet ne dosje** me sipërfaqe totale 6000 m2.

**b. Personi B S nuk i takon toke me AMTP, pasi nuk është kryefamiljar,** sipas certifikatës përbërjes familjare 01.08.1991, ku kryefamiljar rezulton babai i tij F S me 8 anëtare te familjes, ku pjese e saj janë 3 anëtaret e familjes B S ndare me vone sipas certifikatës familjare date 17.06.2020.
**c. Mungon dokumenti qe vërteton se sipërfaqja 5150 m2 ka kaluar ne pronësi "shtet" nen administrimin e njësisë vendore Kashar**, pasi është **toke pa frutë (PF) , pra nuk është objekt i AMTP,** sipas vendimit gjykatës administrative shkalles pare Tirane nr. 2568 date 09.06.2017 dhe vendimit nr. 11 date 31.01.2017 te KVVTP Tirane**.**
Kështu, sipas këtyre vendimeve është shfuqizuar pjesërisht AMTP dublikate nr. 711/69, date 20.05.1996, për sipërfaqen 5150 m2 *(10990-5150),* qe i përket pasurive me numër kadastral 168 për 5000 m2 dhe pjesërisht pasurisë 449 *(2250-150=2100)* për diferencën 150 m2.
**d. Njësia Kashar nuk disponon dokument për plotësimin me toke bujqësore te familjes F. S e përbëre nga 8 anëtare ne 1991, ku i takon te përfitojë 20000 m2, ndërsa ka përfituar 16990 m2** nga kjo shfuqizuar 5150 m2 nga gjykata**.** Gjithashtu **nuk ka dokumentacion nga ASHK lidhur me regjistrimin e pasurive sipas AMTP, përveç pasurisë nr. 175 për 750 m2,** *madje disponohen KPP te pasurive personave tjerë.*
**e. Mungon inventarizimi i dokumentacionit te dosjes,** në kundërshtim me kërkesat e nenit 3 e 29 të ligjit nr. 9154, datë 06.11.2003 "*Për Arkivat*".

**V.** Korrespondenca Njësia Kashar-Bashkia Tirane–ASHK-Subjekt, lidhur me **AMTP 151 date 01.10.1992** për **14840 m2,** 8 pasuri, 9 anëtare familjes ne 1991, ne emër **E S,** rezulton:
**a.** Personi E S **disponon 2 AMTP**, përkatësisht**:**
**-** AMTP 151 date 01.10.1992,
**- AMTP tjetër nuk disponohet** dhe **nuk flitet asgjë për këtë AMTP ne relacionin shpjegues** te njësisë Kashar nr. 1232/1 date 17.06.2020, megjithëse është kërkese e Bashkisë Tirane, sipas shkresës nr. 19799/1 date 26.06.2020.
Për rrjedhoje nuk sqarohet plotësimi me toke sipas normës/fryme.
**b. Pasuria 156 e** AMTP 151 për 1400 m2 sipas planrilevimit 21.05.2020 **ndodhet ne Katund i ri** ZK 2119, **ne vend te fshatit Kashar** ku është banor personi.
Mungon dokumenti qe sqaron sipërfaqet ne secilin fshat**.**
Njëkohësisht **nuk disponohet deklarata noteriale,** ndërsa disponohet deklarata noteriale 11.04.2019 për një pasuri tjetër nr. 1156/1, ZK 2105, vol 26, faqe 81, sipërfaqe 5425 m2, ku mosmarrëveshja është zgjidhur me mirëkuptim, pra me **2 standarde**.
**c. Nuk sqarohet ne relacionin shpjegues** nr. 1242 date 17.06.2020 te njësisë Kashar **sipërfaqja 2000 m2 truall** përfituar nga subjekti sipas AMTP dhe formularit 6, ne vend te 300 m2 truall siç e pasqyron lista e trojeve 001, pra ***diferenca 1700 m2*** *(2000-300).*
Kështu sipas AMTP 151 dhe formularit 6 ajo pasqyrohet ne mënyre jo ligjore 2000 m2, ndërsa sipas listës trojeve 001 te fshatit Kashar për E S pasqyrohet 300 m2 nga kjo 80 m2 ndërtese,

pra kemi kontradikta midis dokumenteve dhe përfitim tepër te truallit për 1700 m2, çka nuk është sqaruar nga njësia. Komisioni i tokës B Kdhe SH S .
**d. Mungon inventarizimi i dokumentacionit te dosjes,** në kundërshtim me kërkesat e nenit 3 e 29 të ligjit nr. 9154, datë 06.11.2003 "*Për Arkivat*".

**VI.** Korrespondenca Njësia Kashar-Bashkia Tirane–ASHK-Subjekt, lidhur me AMTP 127 date 01.10.1992= 8550 m2 me 8 pasuri me 6 anëtare te familjes ne 1991, ne emër **të H S,** rezulton:
**a. AMTP 127 date 01.10.1992 për 8550 m2 toke are paraqet mangësi ne forme dhe përmbajtjen e saj,** pasi:
- nuk ka te përcaktuar kufitaret për 8 pasuritë,
- sipërfaqja totale e 8 pasurive rezulton 11550 m2 pra me shumë nga ajo qe është pasqyruar ne AMTP prej 8550 m2,
- parcela nr. 7 e AMTP 127 me sipërfaqe 3000 m2 prek pasurinë 1436 e cila është "kanal",
- AMTP 127 nuk përputhet me formularin 6.

Per pasoje kjo AMTP nuk mund te shpreh titull pronesie, ne kundershtim me ligjin 7501 datë 19.7.1991 "*Për tokën*", me vendimin 230 date 22.07.1991 "*Për krijimin komisionit tokave*", me udhëzimin 2 date 02.08.1991 "*Për funksionimin e komisionit tokës te rretheve e fshatrave",* me vendimin 255 date 02.08.1991 "*Për kriteret e ndarjes tokës bujqësorë*".
AMTP 127 date 01.10.1992 nënshkruar nga ish-komisioni tokës SH Sdhe B K . Jane krijuar vështirësi ne sistemimin dhe regjistrimin e pasurive, procedure kjo e zgjatur nga viti 2017 deri 2020 nga njësia Kashar me korrespondence me bashkinë dhe ASHK, ne zbatim te kërkesave te VKM 994 date 09.12.2015 "*Për regjistrimin e AMTP*".
**b. Mungon inventarizimi i dokumentacionit te dosjes,** në kundërshtim me kërkesat e nenit 3 e 29 të ligjit nr. 9154, datë 06.11.2003 "*Për Arkivat*".

**VII.** Korrespondenca Njësia Kashar-Bashkia Tirane–ASHK-Subjekt, lidhur me AMTP 50/1992 për 34700 m2 me 5 pasuri për 12 anëtare te familjes ne 1991, ne emër **R S ,** rezulton:
**a. AMTP 50/1992 për 34700 m2 toke pasqyrohet ne emër** të R S (i biri), **ne vend te kryefamiljarit** S S (babai).
**b. AMTP 50/1992 paraqet mangësi ne forme dhe përmbajtje,** pasi:
- ***nuk ka përcaktuar kufitaret*** për 5 pasuritë,
- ***nuk rakordon sipërfaqja e AMTP*** për 34700 m2 ***me formularin nr. 6,*** i cili pasqyron 10 pasuri për 36342 m2,
- ***disponohen 2 formularë 6*** *(faqe formulari 174 dosja 459 dhe faqe 54 dosja 193),* ***pasuria 125 e AMTP për 8500 m2 ka shume pronar*** dhe ka qene ***objekt konfliktesh*** *(babe e bir).*

Veprime ne kundershtim me ligjin 7501 datë 19.7.1991 "*Për tokën*", me vendimin 230 date 22.07.1991 "*Për krijimin komisionit tokave*", me udhëzimin 2 date 02.08.1991 "*Për funksionimin e komisionit tokës te rretheve e fshatrave",* me vendimin 255 date 02.08.1991 "*Për kriteret e ndarjes tokës bujqësorë*".
AMTP 50/1992 nënshkruar nga ish-komisioni i tokës SH S dhe B K **.**
Është krijuar vështirësi ne sistemimin dhe regjistrimin e pasurive, procedure kjo e zgjatur dhe vazhdon nga njësia Kashar me korrespondence me bashkinë dhe ASHK, ne zbatim te kërkesave te VKM 994 date 09.12.2015 "*Për regjistrimin e AMTP*".
**d. Mungon inventarizimi i dokumentacionit te dosjes,** në kundërshtim me kërkesat e nenit 3 e 29 të ligjit nr. 9154, datë 06.11.2003 "*Për Arkivat*".

**VIII.** Korrespondenca Njësia Kashar-Bashkia Tirane–ASHK-Subjekt, lidhur me AMTP nr. 65 viti s,ka për 27500 m2, fshati Mazrrek, me 8 pasuri, për 9 anëtare te familjes ne 1991, ne emër të **M L ,** rezulton:
**a. Procedura e sqarimit te problemeve te pasurive te AMTP 65 paraqet zgjatje pa mbarim,** pasi korrespondenca midis Njësia Kashar – Bashkisë – ASHK – Subjektit ka zgjatur 3-4 vjet

(2018-2021). Sqarimi i tej zgjatur nga Njësia Kashar është përqendruar tek këto probleme, lidhur me pronat e subjektit te përfituara me AMTP 65, konkretisht:
- Subjekti disponon 2 AMTP, ne vend te 1 AMTP.
- AMTP-te paraqesin mangësi dhe parregullsi si ne formën dhe përmbajtjen e tyre, pasi janë lëshuar pa përgjegjësi nga komisioni i tokës duke duke u miratuar nga ish-komuna, përkatësisht:
* AMTP nuk pasqyron kufitaret,
* mungon nënshkrimi i k/komisionit tokës dhe marrësit tokës,
* 2 AMTP-ve pasqyrojnë te njëjtat pasuri, përjashtuar **pasurinë 16/18** *"Shelgje",* e cila është korrigjuar nga 3000 m2 ne 5000 m2 duke shtuar 2000 m2. **Kjo pasuri kufizohet me varrezat dhe toke PF nr. 16/12 dhe toke PF nr. 57/4,** sipas hartës 1: 5000 fshatit Mazrek.
* pasuria nr. 66 prej 900 m2 sipas AMTP rezulton se zëri kadastral përfshin truall brenda saj,
* pasuria 63/2 me 3500 m2 rezulton se prek pasurinë nr. 223 statusi juridik i saj është "*kanal",*
* pasuria 16/16 dhe 16/14 ka status juridik *" rruge".*

***Për rrjedhoje***,
pa arsye objektive këto problematika te pasurive te AMTP 65 kane marre kohe 3-4 vjet për sqarimin dhe sistemimin e tyre, ne procesin e regjistrimit ne ASHK, ne zbatim te kërkesave te VKM 994 date 09.12.2015 "*Për regjistrimin e AMTP*".

**b. Mungon inventarizimi i dokumentacionit te kësaj dosje**. Kështu dosje përmban dokumente te fotokopjuara, 2-3 kopje ne vend te origjinalit, shkrese pas shkrese te përsëritura për te njëjtën gjë te pa sqaruar sakte midis institucioneve, pa marrës dhe dorëzues, pa numerizim fletësh, në kundërshtim me kërkesat e nenit 3 dhe 29 të ligjit nr. 9154, datë 06.11.2003 "*Për Arkivat*".

**IX.** Korrespondenca Njësia Kashar-Bashkia Tirane–ASHK-Subjekt, lidhur me AMTP nr. 18 vite s,ka për 37300 m2 (nga kjo 600 m2 truall), fshati Mazrrek, me 4 pasuri, për 7 anëtare te familjes ne 1991, ne emër të **R L ,** rezulton:

**a. subjekti disponon 2 AMTP, ne vend te 1 AMTP,** përkatësisht:

- **AMTP 18 date s,ka** për 4 pasuri me 37300 m2 *(nënshkruar vetëm nga BK)* dhe AMTP 581 /1994 për 1 pasuri me 2750 m2 are. ***AMTP 18 paraqet korrigjime po kështu dhe formulari numër 6*** është me korrigjime tek sipërfaqet e pasurive. Paraqitet ***tejkalim i normës për fryme*** (nga 3500 m2/fryme ne 5328 m2/fryme). ***Njësia Kashar tek relacioni shpjegues*** nr. 3800/1 date 04.11.2020 ka pasqyruar këto parregullsi, ***por nuk ka sqaruar dhe nuk ka siguruar dokumente për arsyet***, përkatësisht:

* *për sasinë e tokës qe i takon subjektit,* sipas normës/fryme si dhe sistemimin e diferencës "shtet" nëpërmjet ASHK duke i dërguar kësaj te fundit shkrese. ASHK ka konfirmuar regjistrimin e 3 pasurive (*pasurisë 971/57=500 m2, pasurisë 971/56=440 m2 are dhe pasurisë 971/58=700 m2)* ndërsa për regjistrimin e pasurive tjera te AMTP nuk ka dokument.
* *për korrigjimet e sipërfaqes te pasurisë 22/8 (15000 m2**)** te AMTP 18 sesa ishte me pare**.***

- **AMTP 581/1994 me sipërfaqe 2750 m2 are nuk komentohet ne relacionin shpjegues** (*nënshkruar k/komisioni Sh. S).* * **Nuk ka verifikim ne terren** ose dublikate AMTP nga origjinali. Pra ne këto kushte **akti administrativ dhe nuk mund te shpreh titull pronësie**, prandaj duhej shqyrtuar vlefshmëria e saj, çka nuk është bere.

Veprime ne kundershtim me ligjin 7501 datë 19.7.1991 "*Për tokën*", me ligjin 9948 datë 7.07.2008 "*Për Shqyrtimin vlefshmërisë ligjore krijimit titujve pronësisë mbi tokën bujqësore"* ndryshuar, me nenin 119 "*Pavlefshmëria akteve*" Kodi Procedurës Civile dhe të ligjit 7850 datë 29.7.1994 "*Kodi Civil RSH*" ndryshuar, me piken 36 Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011 "*Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik* ", me VKM nr. 994, datë 09.12.2015 *"Për procedurën e regjistrimit të AMTP*", pika I/b, pika 2/2/c, ç, pika 3.4/ a.

**b. Mungon inventarizimi i dokumentacionit te dosjes,** në kundërshtim me kërkesat e nenit 3 e 29 të ligjit nr. 9154, datë 06.11.2003 "*Për Arkivat*".

**X. AMTP 261/ 1992 ne emër S H paraqet parregullsi**, pasi pasqyron truall 300 m2, paraqet korrigjime tek sipërfaqja totale, mos-kuadrim sipërfaqes totale 17300 m2 (korrigjuar) me sipërfaqet analitike 16700 m2, paraqet 341 m2 rruge (*pasuria 26/1, vol 5, faqe 220, ZK 2105, Kashar, shitur me KSH).* Për ketë te fundit fakt se pasuria 26/1 është rruge janë këto dokumente:
- shkresa 3538 date 16.11.2009 e komunës Kashar,
- planrivelimi i terrenit date 20.07.2009 dhe HTR,
- akt verifikimi ne terren i ZVRPP, *sipas referencës 2151 date 22.02.2010*.

***Për rrjedhoje***, AMTP nuk mund te shërbeje si dokument zyrtar qe shpreh titull pronësie për regjistrimin e tokës are, në papajtueshmëri me nenin 36 udhëzimit 30 datë 27.12.2011 "*Për menaxhimin aktiveve njësitë sektorit publik,*" me Kreun II, neni 119 "*Pavlefshmëria akteve*" Kodi Procedurës Civile, me nenin 193 të ligjit 7850 datë 29.7.1994 "*Kodi Civil RSH*" ndryshuar.

**XI.** Korrespondenca Njësia Kashar-Bashkia Tirane–ASHK-Subjekt, lidhur me AMTP 539 date 23.06.1992 për 16150 m2, fshati Kashar, me 5 pasuri, për 10 anëtare te familjes ne 1991, ne emër të **R H ,** rezulton:

**a. Njësia Kashar nuk sqaron 2 AMTP e përfituara nga kjo familja, ne vend te 1 AMTP,** pasi familja ka qene e pandare sipas certifikatës përbërjes familjare 01.08.1991, ku kryefamiljar rezulton babai R me 10 anëtare familjes, ku pjese e saj është dhe A, përkatësisht:
- AMTP 539 date 23.06.1992, R. H., për 16150 m2, me 5 pasuri *(nënshkruar SH. S, B. K)*, e cila përputhet me formularin nr. 6..
- AMTP 539 date 23.06.1992, R H, Dublikate *(nënshkruar F. F)* rezulton se nuk përputhet me origjinalin, pasi pasqyron me shume sipërfaqe prej 18547 m2 nga 16150 m2 qe duhej dhe 8 numër pasurish nga 5 qe ishin.
- **AMTP** për A.H. **nuk disponohet, por sipas relacionit thuhet nuk është tejkaluar norma për fryme.**

**b. Mungon vendimi i KVVTP për vlefshmërinë e këtyre 2 AMTP**, pasi ka nisur procedura e shqyrtimit, sipas shkresës Njësisë Kashar nr. 1201 date 13.04.2010, shkresës Prefekturës nr. 1731/1 date 08.07.2010 dhe nr. 1731/20 date 19.05 2014.

**c. Mungon inventarizimi i dokumentacionit te dosjes,** në kundërshtim me kërkesat e nenit 3 e 29 të ligjit nr. 9154, datë 06.11.2003 "*Për Arkivat*".

**XII.** Korrespondenca Njësia Kashar-Bashkia Tirane–ASHK-Subjekt, lidhur me AMTP 108 date 28.06.1995 për 4950 m2, fshati Yrshek Kashar, me 2 pasuri, për 4 anëtare te familjes ne 1991, ne emër të **Xh F** *(kaluar trashëgimtareve me vendim gjykate***),** rezulton:

**a. Njësia Kashar nuk sqaron llojin e pasurisë 299/ për 800 m2** te AMTP 108/1995, për rrjedhoje procedura vazhdon. Njësia Kashar ne relacionin 4146/1 date 21.12.2020 e përcakton "are" llojin e kësaj pasurie, sipas planrilevimit 30.10.2020 nuk përcaktohet lloji pasurisë, pra bie relacioni. Fakt për ketë është shkresa e mëvonshme nr. 4164/3 date 18.01.2021 ne adrese DAM KQ Tirane, ku Njësia Kashar kërkon zërin kadastral te kësaj parcele, bazuar ne regjistrin e kadastrës datës 01.08.1991, ku nuk disponohet përgjigje, pra procedura ka ngelur ne proces.

**b. Mungon Formulari nr. 6.**

**c. Mungon inventarizimi i dokumentacionit te dosjes,** në kundërshtim me kërkesat e nenit 3 e 29 të ligjit nr. 9154, datë 06.11.2003 "*Për Arkivat*".

**XIII.** Korrespondenca Njësia Kashar-Bashkia Tirane–ASHK-Subjekt, lidhur me **2 AMTP** me 2 pasuri, për 3 anëtare te familjes ne 1991, ne emër **A B,** fshati Yzberish**,** përkatësisht:
- AMTP 189 date 16.01.1996 për 2500 m2 are, pasuria 220/10, vol 2, faqe 134, ZK 3866 (*1998 certifikate pronësisë)***,**
- AMTP pa numër date 24.04.1996 për 850 m2,

Nga auditimi i kësaj praktike prone**,** rezulton:

**a. Njësia Kashar nuk sqaron 2 AMTP e përfituara nga kjo familja, ne vend te 1 AMTP,** pasi familja ka përfituar toke **brenda 3 muajve 1996** me 2 AMTP.
**b. Mungon Formulari nr. 6, kërkese kjo edhe bashkisë Tirane,** sipas shkresës nr. 15791/1 date 26.05.2020 dhe nr. nr. 15791/3 date 09.07.2020.
**d. Mungon inventarizimi i dokumentacionit te dosjes,** në kundërshtim me kërkesat e nenit 3 e 29 të ligjit nr. 9154, datë 06.11.2003 "*Për Arkivat*".

**XIV.** Korrespondenca Njësia Kashar-Bashkia Tirane–ASHK-Subjekt, lidhur me **AMTP** pa numër date 25.07.1994, për 4 pasuri me 10,030 m2 *(4533 +1500+1037+2960 m2 + truallin 300 m2)*, për 6 anëtare te familjes ne 1991, ne emër **E E,** fshati Mezes**,** rezulton:
**a. Nuk përputhet AMTP me formularin nr. 6,** pasi AMTP pasqyron 4 pasuri me 10,030 m2, ndërsa formulari nr. 6 pasqyron 3 pasuri me sipërfaqe totale 7900 m2 (*2000+1500+4400 m2*)**.**
**b. Subjekti disponon 2 AMTP, ne vend te 1 AMTP,** pasi disponohet dhe ***AMTP pa numër date 25.07.1994 për 1 pasuri me 1000 m2 are, për te cilën nuk flitet ne relacioni e njësisë*** Kashar nr. 4944/43 date 19.02.2020 dhe nr. 4944/5 date 16.04.2020.
Theksojmë se 2 AMTP për te njëjtin person janë nënshkruar nga komisioni i tokës K M, B Kdhe *I K.*
**c. Relacioni nuk sqaron pasurinë 562/8 për 1037 m2,** vol 25, faqe 74, ZK 2105**,** pasi ajo ne **KPP figuron me pronar *"shtet"*, ndërsa thuhet është e *okupuar nga E E* ,** sipas shkresës ZRPP nr. 30010 date 03.09.2018 dhe date 12.02.2020.
**d. Mungon inventarizimi i dokumentacionit te dosjes,** në kundërshtim me kërkesat e nenit 3 e 29 të ligjit nr. 9154, datë 06.11.2003 "*Për Arkivat*".

**XV.** Korrespondenca Njësia Kashar-Bashkia Tirane–ASHK-Subjekt, lidhur me **AMTP** pa numër pa date, për 1 pasuri nr. 315, për 3000 m2, për 3 anëtare te familjes ne 1991, ne emër **S D ,** fshati Yzberish**,** rezulton:
**a. Nuk përputhet AMTP me formularin nr. 6,** pasi AMTP pasqyron 1 pasuri me 3,000 m2, ndërsa formulari nr. 6 pasqyron 3 pasuri me sipërfaqe totale 6770 m2 *(Pas. 225/28= 770 m2 + pas.315=3000 m2 + pas.315=3000 m2)***.**
**b. Subjekti disponon 2 AMTP, ne vend te 1 AMTP,** përkatësisht:
**- *AMTP pa numër pa date, për 1 pasuri me 3000 m2 are* ,** nënshkruar nga komisioni i tokës BS, B Kdhe P/sek/kadastrës B C.
**- *AMTP 419/1996, për 1 pasuri me 770 m2 pemëtore dhe truall,*** nënshkruar nga komisioni i tokës F F, B K .
***Përfundimisht,*** ne relacioni shpjegues nuk flitet për:
*sipërfaqen tjetër 3000 m2 sipas formularit 6 nuk justifikohet me akt administrativ me AMTP.
* për 2 AMTP me sipërfaqet përkatëse 3000 m2 dhe 770 m2.
Kështu vërtetimi nr. 4331/1 date 05.11.2021 i njësisë Kashar flet për pajisjen me toke te S D t, por nuk përcakton 2 aktet AMTP dhe sipërfaqen qe i takon dhe sa ka marre sipas numrit frymëve, çka e bën jo te plote informacionin**.** Administratori Xh K dhe A S.
**d. Mungon inventarizimi i dokumentacionit te dosjes,** në kundërshtim me kërkesat e nenit 3 e 29 të ligjit nr. 9154, datë 06.11.2003 "*Për Arkivat*".

**XVI.** Korrespondenca Njësia Kashar-Bashkia Tirane–ASHK-Subjekt, lidhur me **AMTP 23/1992**, për 5 pasuri për 9300 m2 *(1300+3500+2000+500+2000 m2),* rakordon me formularin nr. 6, për 4 anëtare te familjes ne 1991, ne emër **S S ,** fshati Kashar**,** rezulton:
**a.** AMTP 23/1992 për 5 pasuri me 9300 m2 are, rezulton fotokopje (*sipas shkresës kadastrës 14.05.2013)* dhe pa kufitare, ne këto kushte origjinaliteti i saj është zgjidhur me akt noterial nr. 3166 date 29.07.2020, ne vend te shqyrtimit vlefshmërisë ligjore pranë KVVTP. (*Pasuria 126/6 per1300 m2 ne fakt është 900 m2 sipas plan rilevimit për te cilën ka rene dakord subjekti).*
AMTP 23/1992 është nënshkruar nga komisioni i tokës SH S dhe B K .

**b.** Me kerkesen e subjektit nr. 2602 date 12.07.2022**, Njesia Kashar ka leshuar vertetimin** nr. 2602/1 date 20.07.2022 **per efekt shitje te tokes bujqesore** me certifikate pronesie 22.04.2022, **pasuria nr. 160/6/7, siperfaqe 2000 m2 are,** ZK 2105, ne kundershtim me shitblerjen e tokes bujqesore te shperndare me AMTP 23/1992, konkretisht me nenin 2 dhe 21 te ligjit nr. 7501 date 19.07.1991 "*Per token*", dhe me nenin 10 dhe 14 te ligjit nr. 9244 date 17.06.2004 "*Per mbrojtjen e tokes bujqesore".*

**c. Mungon inventarizimi i dokumentacionit te dosjes,** në kundërshtim me kërkesat e nenit 3 e 29 të ligjit nr. 9154, datë 06.11.2003 "*Për Arkivat*".

**XVII.** Korrespondenca Njësia Kashar-Bashkia Tirane–ASHK-Subjekt, lidhur me **AMTP 184/1996**, për 3 pasuri për 3200 m2 *(1500 m2 are+500 m2 pemëtore+1200 m2 ullishte),* për 4 anëtare te familjes ne 1991, ne emër **P K ,** fshati Katund i Ri**,** rezulton:

**a. Nuk rakordon AMTP 184/1996 me formularin nr. 6** ***(*** *përveç pasurisë 225/89/25=500 m2 pemëtore, ZK 2119, vol 3, faqe 167),* pasi AMTP pasqyron 3200 m2 ndërsa formulari 6 pasqyron 4000 m2 *(1500 + 500 + 2000),* pra për pasurinë ullishte nga 1200 m2 ne AMTP ne 2000 m2 tek formulari, madje nuk ka shpjegim për regjistrimin e saj.

**d. Mungon inventarizimi i dokumentacionit te dosjes,** në kundërshtim me kërkesat e nenit 3 e 29 të ligjit nr. 9154, datë 06.11.2003 "*Për Arkivat*".

**XVIII.** Korrespondenca Njësia Kashar-Bashkia Tirane–ASHK-Subjekt, lidhur me **AMTP nr....date 17.05.1996**, për 2 pasuri për 2000 m2 *(pas. 156/4/2=1000 m2 are+1000 m2 vresht pas. 322/1),* për 4 anëtare te familjes ne 1991, ne emër **T G,** fshati Katund i Ri**,** rezulton:

**a. Paraqiten vonesa mbi 1 vit** (2019-2021) **ne korrespondencat midis institucioneve, për sqarimin e 2 pasurive te AMTP, çka ka zgjatur procedurën e regjistrimit tyre, për arsye subjektive te njësisë Kashar.** *Kështu,*

- ***4 here janë kthyer dhe rikthyer dokumentet nga bashkia*** ne adrese te njësisë Kashar, për sqarime dhe plotësim dokumentacioni te 2 pasurive te subjektit me AMTP, sipas shkresave nr. 17211/1 date 05.06.2020, nr. 17211/3 date 17.07.2020, nr. 17211/6 date 29.12.2020, nr. 1196/1 date 22.01.2021.

- ***3 here janë dërguar dhe ridërguar dokumentet nga njësia Kashar***, ne adrese te bashkisë Tirane, ne zbatim te kërkesave saj lidhur me sqarimet dhe plotësimin me dokumentacion te 2 pasurive te subjektit, sipas shkresave nr. 55/2 date 29.05.2020, nr. 55/4 date 08.07.2020, nr. 55/9 date 11.01.2021, nr. 352/1 date 26.01.2021.

- ***Po kështu është vepruar me ri-përsëritjen disa here te korrespondencave me ASHK, me Dhomën Avokatisë dhe subjektin*** T G, çka ka detyruar këta te fundit te ankimohet ne bashkinë Tirane dhe pranë kryeministrit, sipas shkresës nr. 55/10 date 21.01.2021.

**b. dokumentacioni tekniko ligjore nga njësia është me 2 standarde,** pasi ndryshon me rastet tjera, fenomen ky i konstatuar dhe nga bashkia sipas shkresave sipërcituara, konkretisht:

* ***Plarilevimet paraqiten pa nënshkrimin e njësisë vendore Kashar te Administratorit dhe pronarit*** te pasurisë 156/4/2, sipërfaqe 1000 m2, ZK 2119. Katund i Ri,

* ***Deklarata e kufitareve është pa firmën e kufitareve, madje pa numrin e identitetit tyre***, çka e bën te pavlere ketë dokument, pasi ne këto kushte nuk mund te jete deklarate kufitarësh pa gjurmët e tyre, por është mjaftuar vetëm me firmën e kryeplakut fshatit ID.

* ***Ndryshe nga rastet tjera është kryer verifikimi ne terren për pasuritë e subjektit, sipas procesverbal konstatimit ne terren date 28.12.2020,*** nënshkruar nga A S **.**

Njësia Kashar ka njoftuar dhe ri-njoftuar kryeplakun e fshatit I D, sipas shkresës nr. 55/5 date 04.11.2020 dhe nr. 55/7 date 23.11.2020.

**XIX. A M disponon 2 AMTP, ne vend te 1 AMTP qe duhej**, përkatësisht: AMTP pa numër viti 2003 me sipërfaqe te 6 pasurive 20740 m2 are, pajisur me certifikate pronësie 2003 *(400+1000+2000+5000+5000 +7340)* dhe AMTP me numër dhe date korrigjuar sipërfaqe te 5 pasurive 13400 m2 are *(5000+5000+400+800+2000 +200 m2 truall).* Ne kushtet e 2 AMTP

te përfituara nga i njëjti person, toka ndahet dhe bashkohet disa here dhe përdoret për efekte biznesi me KSH nëpërmjet disa transaksioneve.

**XX.** U konstatuan disa raste se:
**- paraqiten mangësi në relacionet shpjeguese, për saktësimin e problemeve te pasurive ne AMTP origjinale**, në kundërshtim me VKM nr. 994, datë 09.12.2015 *"Për procedurën e regjistrimit të AMTP*", pika 2/2/c dhe pika 5/b, ku thuhet:
Pika 2/2/c ku thuhet:

*c) Kur janë konstatuar një apo më shumë nga mangësitë e përmendura në nënndarjet "i", të shkronjës "b", të kësaj pike, brenda dy ditëve pune, nga data e konstatimit, me anë të një relacioni, çështja i dërgohet bashkisë, në juridiksionin e së cilës ndodhet toka bujqësore e pasqyruar në AMTP.* ***Relacioni duhet të përmbajë pjesën përshkruese të faktit, si dhe argumentimin e mangësive të konstatuara****. Relacionit, detyrimisht, i bashkëlidhet edhe një kopje e AMTP-së dhe e akteve/dokumenteve që konstatojnë këto mangësi, si dhe një kopje e kartelës së pasurisë së mbajtësit të fundit të titullit të pronësisë, së bashku me gjeneralitetet e tij dhe adresën, në rast se këto të dhëna administrohen në zyrën e regjistrimit. Pas verifikimit të mangësive, bashkia duhet të kthejë përgjigje në ZVRPP, duke plotësuar mangësitë e evidentuara. Plotësimi i mangësive nuk bëhet në AMTP konkrete, por duke i përshkruar ato shkresërisht***.**

Pika 5/ b, ku thuhet:

*Në çdo rast, nëse ZVRPP-ja konstaton se lloji i pasurisë "tokë bujqësore" (arë, vreshtë, ullishtë, pemishte), dhënë me AMTP, nuk përputhet me llojin e pasurisë që figuron e regjistruar në kartelën e pasurisë së paluajtshme, me nismën e vet apo me kërkesë të mbajtësit të titullit të pronësisë, kërkon informacion nga DAMT-i, pranë këshillit të qarkut, për zërin kadastral të ngastrës, sipas regjistrave kadastralë më datë 1.8.1991. Nëse konstatohet:*
*b) shkelje e nenit 2, të ligjit nr. 9948/2008, ZVRPP-ja i drejtohet komisionit vendor respektiv, me relacion të argumentuar, me qëllim shfuqizimin e plotë apo të pjesshëm të AMTP-së konkrete.*

**- paraqiten akte administrative te parregullta ne forme dhe përmbajtje,** ku regjistrimi i sipërfaqeve të tokës bujqësore që pasqyrojnë këto AMTP paraqet problem, pasi nuk shprehin titull pronësie, pavarësisht relacioneve sqaruese, te cilat nuk përbejnë titull pronësie. Veprime në kundërshtim me udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011 "*Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik* ", pika 36, ku thuhet:

*dokumentacioni quhet i rregullt kur përshkruan me vërtetësi veprimin ose ngjarjen, përmban të dhëna për shkakun e veprimit datën dhe vendin e kryerjes,objektin , treguesit sasiorë dhe ato të vlerës , personat që kanë urdhëruar dhe ekzekutuar veprimin dhe të tjera të dhëna të nevojshme që i japin dokumentit forcën e një prove ligjore ose administrative. Dokumentet duhet të jenë pa korrigjime, të lexueshme dhe të eliminojnë mundësinë për gabime ,.*

**Sa sipër**, konkretisht:
***XX/1.*** **AMTP e S M,** paraqet:
* AMT pa numër, pa vit, me korrigjime dhe me 2 emrat e marrësit tokës (babe e bir), ne vend te k/familjarit Q. M.
* mungese certifikate familjare te vitit 1991 per krye/familjarin.
* deklarata kufitarësh te pjesshme,
* mungese e formularit nr. 6,
* pasuria 126 ne hartë prek toke PF dhe truall,
* nuk sqarohet plotësimi me tokës sipas normës/fryme, sipas shkresës Bashkisë Tirane nr. 3656/5 date 06.11.2020 ne adrese subjektit dhe njësisë, çka bie relacioni i njësisë nr. 2296/1 date 22.01.2020.

Kështu ka vazhduar për 2 vitet 2020-2021 dërgim dhe ridërgim shkresash për sqarim ASHK-Njësi Kashar, ku relacionet janë pjesshme, paplota për gjitha pasuritë dhe përsëritura ne vend te 1 relacioni. Relacioni i njësisë 224 date 15.01.2021 flet për 2 AMTP ne vete për babe dhe bire,

***XX/2.* AMTP nr. 4 date s,ka, ne emër te SH M** , për 44200 m2 toke, me 8 veta sipas certifikatës /1991, rezulton se:

* AMTP 4 është fotokopje,

* ***AMTP ka korrigjime*** tek rreshti 2 i AMTP për pasurinë 16 korrigjuar ne 21360 m2 nga 360 m2 qe është, si dhe ***ne fund AMTP është shtuar 1 pasuri*** nr. 24/2 me 4000 m2 ullinj,

* ***AMTP i mungon firma e k/komisionit tokës,***

* ***Formulari nr. 6*** për 34100 m2 ***nuk rakordon me AMTP*** për 44200 m2 toke, për ***diferencën 10100 m2 ,*** pasi pasuria 16 pasqyrohet ne formular 6 për 11360 m2 nga 21360 m2 sipas AMTP.

* ***Paraqitet tejkalim 16200 m2*** (*AMTP 44200-28000 sipërfaqja sipas normës për 8 fryme* te sipërfaqes për normën për 8 fryme, pasi sipas normës 3,5 dylim /fryme i takon 28,000 m2 toke (*3,5 dylim x 8 fryme*) dhe jo 44200 m2 sipas AMTP.

* Dokumentacioni është fotokopje dhe me 2-3 kopje ne vend te 1 dokumenti te rregullt.

**Dokumentacioni i kësaj praktike nuk është i inventarizuar**, në kundërshtim me kërkesat e nenit 3 e 29 të ligjit nr. 9154, datë 06.11.2003 "*Për Arkivat*", fenomen ky edhe për rastet tjera**.**

* Disponohen deklaratat e kufitareve te plotësuar nga kryetaret e fshatit, ne vend te deklaratave noteriale te kufitareve**,** në kundërshtim me nenin 26/b të ligjit nr. 111/2018 "*Për kadastrën*", me nenin 62 të rregullores së urbanistikës të ligjit nr. 8405 17.9.1998 i ndryshuar me 10119, datë 23.4.2009, nr. 107/2014, me VKM 408, datë 13.05.2015 neni 33/2, 34/9, 35 si dhe me nenin 65/2/b te ligjit 20/2020 "*Për përfundimin e proceseve kalimtare pronësisë ne RSH*".

<u>*Nga verifikimi në ASHK dhe Njësinë Administrative Kashar.*</u>

**XXI. Njësia vendore Kashar nuk disponon listën e sipërfaqeve te tokës bujqësore tepër te kaluara "shtet",** sipas subjekteve private **objekt i AMTP**, si rezultat i **<u>diferencave te sipërfaqeve tepër ne terren nga ato te pasqyruara ne AMTP.</u>** Për pasojë kjo ka shkaktuar lënien në përdorim të mbajtësve të paligjshëm për një periudhë pa kufi kohor, të cilët shfrytëzojnë pronën shtetërore pa shlyer asnjë detyrim, taksë apo qira për buxhetin e shtetit**,** çka tregon se nuk ka funksionuar bashkëpunimi i pushtetit vendor me ASHK.

***Përfundimisht***, Këto diferenca tepër toka prone shtetërore kane mbetur në posedim dhe shfrytëzim nga subjektet private në mënyrë të paligjshme, duke mos u menaxhuar dhe administruar nga njësia administrative Kashar.

**XXII.** Njësia vendore Kashar **nuk disponon listën e sipërfaqeve te tokës tepër te kaluara "shtet" nga ASHK,** sipas subjekteve private **objekt i legalizimeve**, për **<u>diferencat midis sipërfaqeve te zaptuara me ato te miratuara me legalizim</u>** (pjesa zaptuar -pjesën legalizuar). Kështu, tokat "shtet" kane mbetur në posedim dhe shfrytëzim në mënyrë të paligjshme nga subjektet private për një periudhë pa kufi kohor, të cilët i shfrytëzohen pa asnjë detyrim, taksë, qira për buxhetin**,** çka tregon punë jo efektive, mos-menaxhim dhe administrim te tyre si dhe mungese bashkëpunimi te njësisë Kashar me ASHK.

**XXIII. Ndryshim zëri kadastral nga *"pyll"* ne *"ullishte"* dhe *"are",*** me tej **përfituar me AMTP copëzuar, shitur dhe ndërtime me leje dhe pa leje mbi këto pasuri**, ne kundershtim me nenin 2 te ligjit nr. 7501 date 19.07.1991 "*Per token"( i cili ndalon shitblerjen e tokes bujqesore te shperndare me AMTP)* dhe me nenin 10 dhe 14 te ligjit nr. 9244 date 17.06.2004 "*Per mbrojtjen e tokes bujqesore"* dhe me nenin 21 te ligjit nr. 7501 date 19.07.1991 "*Per token" ( i cili ndalon zenien dhe demtimin e tokes bujqesore nga ndertimet e paligjshme),* me ligjin e urbanistikes ndryshuar me ligjin nr. 10119, datë 23.4.2009 dhe nr. 107/2014 "*Për*

*Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit"*, me ligjin 9385 datë 4.5.2005 "*Për pyjet dhe kullotat*" neni 17. Nga qeverisja vendore Kashar nuk është pasur parasysh "*Karta Evropiane e vetëqeverisjes lokale*", e cila në thelb përcakton, shprehimisht: "*Menaxhimi i një qyteti duhet drejtuar që të sigurojë që ata njerëz, të drejtat dhe pronat e të cilëve preken në një shkallë të rëndësishme nga aktet e propozuara dhe vendimtare administrative, të jenë të informuar rreth tyre, tu dëgjohen mendimet dhe të bëhen kështu një pjesë aktive në procesin e vendimmarrjes. Qytetarët janë baza e demokracisë lokale. Ata janë partnerët e përfaqësuesve të zgjedhur dhe zyrtarëve qeverisës lokalë në planifikimin dhe menaxhimin e komunitetit. Me qëllim që t'i ushtrojnë këto detyra, ata duhet të informohen rreth të gjitha planeve kryesorë të perceptuara nga përfaqësuesit dhe zyrtarët e tyre të zgjedhur,* çka ben pergjegjes ish-komisionet tokave, pushtetin vendor, Keshillin Qarkut, Ministrine Bujqesise dhe zyrat e rregjistrimit**,** konkretisht:
***Pasuria 94,*** ZK 2105, Kashar, vol 14, faqe 13, sipërfaqe 26687 m2 "Pyll" shtet është ndare ne 2 pjese dhe ka kaluar tek vol 21, faqe 169-170 duke ndryshuar padrejtësisht zërin kadastral nga "pyll" ne "ullishte" dhe "are"**,** përkatësisht:
**** Pasuria 94/1***, ZK 2105, Kashar, vol 21, faqe 169, sipërfaqe 2850 m2 "*Ullinj*" shtet, me tej është dhëne me **AMTP 38 date 20.08.1992** H. Ll., por statusi i kësaj pasurie është pyll dhe nuk është objekt i AMTP. Me tej pasuria ka kaluar trashëgimtareve Ll me KDH, *sipas referencave 2567/2011, 2521/2011, 3107/2014 dhe 3227/2015.*
**** Pasuria 94/2,*** ZK 2105, Kashar, vol 21, faqe 170, sipërfaqe 25831 m2 *"Are"* shtet, e cila është ndare ne 2 pasuri duke ka kaluar tek vol 24 faqe 101-102, përkatësisht: pasuria 94/3, ZK 2105, vol 24, faqe 169, sipërfaqe 1000 m2 "Are" shtet, kaluar ne pronësi B H me **AMTP 62/1993,** por statusi juridik i saj deri ne vitin 2011 është pyll, i cili nuk është objekt i AMTP. *Pasuria regjistruar sipas referencës 3723/ 2017,* si dhe pasuria 94/4, ZK 2105, vol 24, faqe 170, sipërfaqe 24837 m2 "Are" shtet, *sipas referencës 3723/ 2017.*

**XXIV.** Sipas *referencës 4930, date 16.01 2019 (24.11.2020)* është bere regjistrimi i **AMTP 474 date 20.5.1996** ne emër **LK,** për pasuritë:
- pasuria 1179/9, ZK 2105, Kashar, sipërfaqe 4950 m2 are (1200 m2), vol 15, faqe 68,
- pasuria 1186/27, ZK 2105, Kashar, sipërfaqe 3885 m2 are (3221 m2), vol 23, faqe 42,
- pasuria 1179/96, ZK 2105, Kashar, sipërfaqe 557 m2 are , vol 26, faqe 202,
- pasuria 1179/98, ZK 2105, Kashar, sipërfaqe 2310 m2 are , vol 26, faqe 204,
- pasuria 1179/97, ZK 2105, Kashar, sipërfaqe 2300 m2 are , vol 26, faqe 203,
- pasuria 1179/97, ZK 2105, Kashar, sipërfaqe 2300 m2 are , vol 26, faqe 203,
- pasuria 1169/13, ZK 2105, Kashar, sipërfaqe 4104 m2 are , ka qene e regjistruar ne 2001,

Dokumentacioni i kësaj praktike nuk është i saktësuar dhe paraqet kontradikta midis tyre, pasi subjekti **disponon 2 AMTP**, ne vend te 1 AMTP qe duhej, përkatësisht: AMTP 474 date 20.5.1996 për sipërfaqen 24672 m2 dhe AMTP 474 viti 1993 për sipërfaqen 18020 m2, ku disa pasuri janë toke PF dhe me mbivendosje, *sipas shkresës te ZVRPP nr. 7892 date 27.02.2019.* Asnjë anëtar i familjes K nuk rezulton anëtare i kooperativës bujqësore date 01.08.1991, *sipas shkresës te Arkivit Qendror te Sigurimeve shoqërore Tirane nr. 15064/1 date 15.01.2015*.
2 AMTP janë shfuqizuar duke u shpallur me pavlefshmëri te plote nga KVVTP, bazuar ne ligjin e tokës, VKM përkatëse dhe ne Kodin Procedurës Civile nenin 119 "Pavlefshmëria akteve" si dhe me nenin 193 të ligjit 7850 datë 29.7.1994 "Kodi Civil RSH" ndryshuar, me vendimin 115 date 15.04.2016, ku kërkohet kthimi shtet i sipërfaqes 24672 m2 sipas AMTP 474 date 20.5.1996 *dhe 18020 m2 sipas AMTP 474 viti 1993 por pa pasoja.* Për rrjedhoje**,** Vendimi i gjykatës Administrative te shkalles pare Tirane nr. 4718 date 13.10.2016 ka shfuqizuar dhe ka shpallur pavlefshmëri te plote 2 AMTP si dhe ka kërkuar kthimin shtet sipërfaqes 24672 m2 sipas AMTP 474 date 20.5.1996 dhe 18020 m2 sipas AMTP 474 viti 1993 por pa pasoja (*Paditës Prefektura Tirane, i paditur L K, pale e trete ZVRPP).*
Ne këto kushte, pas 2 vjetëve është zbardhur Vendimi i gjykatës Administrative Apelit Tirane nr. 4404 date 05.12.2018, i cili ka ndryshuar vendimin nr. 4718 date 13.10.2016 shkalles pare,

dhe rrëzimin e kërkesë padisë si te pambështetur ne prova dhe ligj, por nuk shpreh këto ndryshime me shifra për sipërfaqet e tokës bujqësore dhe mungon planvendosja, për efekt te regjistrimit te pasurive sipas AMTP.

Ndryshimi nga Apeli i vendimit shkalles pare është mbështetur ne ligjin 7501 datë 19.7.1991 "*Për tokën*", por ky ligj është shkelur ne fakt, pasi nuk plotësohen 2 kritere baze për dhënien e tokës, konkretisht:

- subjekti disponon 2 AMTP, ne vend te 1 AMTP,
- asnjë anëtar i familjes K nuk rezulton anëtare i kooperativës bujqësore date 01.08.1991, sipas shkresës te Arkivit Qendror te Sigurimeve shoqërore Tirane nr. 15064/1 date 15.01.2015.

Ndryshimi nga Apeli i vendimit te shkalles pare është mbështetur edhe ne ligjin nr. 7514, date 30.09.1991 "*Për pafajësinë, amnistinë dhe rehabilitimin e përndjekurit politik*", por ky ligj nuk flet për zonën e bregut lumit Tirane ku është shpërngulur familja K, por flet për zona tjera internimi jashtë Tiranës, nuk flet për ndarjen e tokës me AMTP por flet për kthimin dhe kompensimin e pronave objekt i te cilës është AKKPP ( flet për dem shpërblimin, pensionet, te drejtat e shkollimit dhe strehimit, rikthimin e sendeve te konfiskuara etj.....).

***Perfundimisht,*** pavartesisht sa u tha me siper, duhet zbatuar vendimi gjykatës administrative Apelit Tirane nr. 4404 date 05.12.2018.

**XXV.** Korrespondenca Njësia Kashar-Bashkia Tirane–ASHK-Subjekt, lidhur me **sipërfaqen 1000 m2 kanal** përfituar me **KSH** ne emër **të B K ,** rezulton:

***Nga verifikimi ne Hipoteke.***

*Sipas referencës 4587, date 08.02 2019* është bere regjistrimi i pasurisë 1281/5, ZK 2105, vol 22, faqe 175, *përfituar me kontratë dhurimi date 19.01.2019 dhurues "K. Oil" shpk B K certifikate pronësie 10.10.2013 marres B K* , **pasuri e cila është "kanal" me sipërfaqe 530 m2, pasuri publike e patjetërsueshme, e cila nuk kalon ne pronësi private,** ne kundërshtim me ligjin 20/2020 date 05.03.2020, neni 4/ 19, me Kodin Civil... **.** Pasuria 1281/5 vjen nga (*referencë 3010 date 10.10.2013).*

Origjina e kësaj pasurie vjen nga ku pasuria shtet "kanal" ndare 2 pjese, *referenca 2977 date 11.09.2013,* përkatësisht:

- *pasuria bije privat 1281/1***,** ZK 2105, vol 22, faqe 150, sipërfaqe 1000 m2 "kanal" ne emër " K. Oil" shpk B. K., përfituar me kontrate shitje **KSH nga AKKP Tirane**, pajisur me certifikate 11.09.2013. Kjo pasuri me tej është ndare ne 3 pasuri tjera po ne emër te tij (pasuria nr. 1281/3, nr. 1281/4 dhe **nr. 1281/5,** ZK 2105, vol 22, faqe 173-175).
- *pasuria bije shtet 1281/2, ZK 2105, vol 22, faqe 151, =13000 m2 "kanal".*

***Nga verifikimi ne Njësinë Kashar****. (Disponohet AMTP 448 date 1992= 10750 m2 për 7 pasuri, ne emër B K , objekt para periudhës auditimit vitit 2019).*

-Relacioni teknik i vitit 2016 nënshkruar nga specialisti ZMMT Njësisë Kashar A S ne adrese te B K t me tekst: "*vënie ne dispozicion dokumentacioni sipas kërkesës tij 04.07.2016* për pasurinë nr. 1281, ZK 2105,vol 8, faqe 69", rezulton se: Ne relacion **nuk përcaktohet lloji i kësaj pasurie**, **por thuhet sipërfaqja 1000 m2,** ne vend qe te thuhej sipërfaqja 1000 m2 kanal, sipas certifikatës pronësisë 11.09.2013, ku citohet qarte "Kanal", **për rrjedhoje me tej gjithë procedura e ndjekur ka vazhduar me përcaktimin sipërfaqja 1000 m2 dhe jo kanal**, konkretisht:

*Kontrata shitjes 05.09.2013 midis AKKP Tirane shitës dhe blerës "K.-OIL" shpk flet për kompensim sipërfaqes 1000 m2 pa përcaktuar llojin e saj kanal.

* Po kështu është pasqyruar kjo sipërfaqe pa llojin e pasurisë edhe ne VKM 511 date 13.06.2013.

***Përfundimisht,***

AKKP Tirane ka kompensuar subjektin privat me sipërfaqe "kanal" pasuri e patjetërsueshme, Hipoteka e ka regjistruar ketë pasuri pa korrespondence me pushtetin vendor, bazuar ne këtë VKM, e cila bie ndesh me:

- neni 7/1 dhe nenin 11/1/a te ligjit nr. 9235 date 29.07.2004 i ndryshuar "*Për kthimin dhe kompensimin e pronës"*, ku thuhet:

*...kompensohet me prone te paluajtshme te te njëjtit lloj....*

- neni 1/1, 2, 3, ligji 8084 date 07.03.1996 *"Për disa shtesa për kompensimin ish-pronareve".*
- shkresa nr. 7217/3 date 15.07.2021 e ASHK Tirane, ne zbatim nenit 7, pika 1/a e c, te ligjit 20/20, date 05.03.2020 "*Për përfundimin e proceseve kalimtare pronësisë ne RSH", ku nder te tjera flitet për troje, kullota, pyll, livadhe, dhe jo per rrjet infrastrukture kanale etj.*
- ligji nr. 9948 datë 7.7.2008 "*Për Shqyrtimin vlefshmërisë ligjore të krijimit titujve pronësisë mbi tokën bujqësore*", të ndryshuar neni 2 , ku thuhet:

*Nuk kanë vlefshmëri ligjore titujt e pronësisë ne te gjitha sipërfaqet tjera, qe me date 01.8.1991 nuk kane figuruar ne regjistrat kadastral, ne zërin "toke bujqësore" si pyje, livadhe, kullot, toke pyjore dhe sipërfaqe tjera te tokës jobujqësore, pavarësisht miratimit te ndryshimeve dhe kalimeve te këtyre zërave ne toke bujqësore pas kësaj date, pasi me 01.08.1991 këto parcela nuk bënin pjesë ne fondin e tokës bujqësore, por ne fondin e tokës ne zërin kadastral 'Pa Frut".*

**XXVI.** ***Ne 20 raste, (****nga auditimi ne ASHK)* ne Kashar u konstatuan se **disponohen 2 - 3 AMTP për te njëjtin kryefamiljar, ne vend te 1 AMTP,** madje AMTP paraqesin korrigjime dhe mungese te dhënash, ne kundershtim me ligjin 7501 datë 19.7.1991 "*Për tokën*", me ligjin 9948 datë 7.07.2008 "*Për Shqyrtimin vlefshmërisë ligjore krijimit titujve pronësisë mbi tokën bujqësore"* ndryshuar, me nenin 119 "*Pavlefshmëria akteve*" Kodi Procedurës Civile me nenin 193 të ligjit 7850 datë 29.7.1994 "*Kodi Civil RSH*" ndryshuar, konkretisht:
Y Rr. M disponon 3 AMTP; PH. A disponon 2 AMTP; D H. A disponon 2 AMTP; F O. B disponon 2 AMTP; V J. Ll disponon 2 AMTP; K S. Ll disponon 2 AMTP; N B. Sh disponon 2 AMTP; D Rr. M disponon 2 AMTP; Rr Y. M disponon 2 AMTP; Sh Rr. M disponon 2 AMTP; Xh F. D disponon 2 AMTP; B V. D disponon 2 AMTP; B A. K disponon 2 AMTP; M Y. K disponon 2 AMTP; S S. H disponon 2 AMTP; D M. K disponon 2 AMTP; B S. K disponon 2 AMTP; Q H V disponon 2 AMTP (*331/1992 dhe AMTP dublikate 330/1998);* A M disponon 2 AMTP pa numër, pa date (*njëra pasqyron vitin 2003, ndërsa tjetra është e korrigjuar)* me sipërfaqe totale te 6 pasurive 20740 m2 are dhe tjetra 13400 m2 are; L K disponon 2 AMTP, përkatësisht nr. 474 date 20.05.1996 dhe nr. 474/1993, shpallur nga KVVTP dhe Gjykata me pavlefshmëri te plote 2 AMTP dhe kthim shtet te sipërfaqes 24672 m2.

**XXVII.** ***Ne 4 raste,*** **AMTP ne Kashar padrejtësisht pasqyrojnë truall, i cili nuk është objekt i AMTP por i listës trojeve 001,** duke u dhënë truall jashtë kompetencës, pasi ligji 7501 datë 19.7.1991 "*Për tokën*" flet për tokë bujqësore dhe jo truall, veprime në kundërshtim me nenin 3, pika c, nenin 10, nenin 15 të ligjit nr. 9948, datë 7.7.2008 "*Për shqyrtimin e vlefshmërisë ligjore krijimit titujve pronësisë mbi tokën bujqësore",* me pikën 5, të UKM nr. 2, datë 12.09.2012 "*Për përcaktimin e elementeve të akteve, që verifikohen nga zyra e regjistrimit pasurive të paluajtshme dhe të procedurës për nxjerrjen e urdhrit të regjistruesit*", me UKM nr. 2, datë 13.06.2013 "*Për mënyrën e procedimit të organeve të administratës publike, për pasuritë e paluajtshme, të fituara me Aktin e Marrjes së Tokës në Pronësi"* **,** përforcuar me shkresën nr. 7217/3 date 15.07. 2021 te DP ASHK, konkretisht:
* AMTP ne emër te A M ,
* AMTP 474 ne emër te L K ,
* AMTP pa numër/1992 ne emër te A S .
* AMTP 261 e vitit 1992 ne emër te S H .

**XXVIII.** ***Në 21 raste*****, ne listat e trojeve 0001 të ZK 2105 Kashar janë pasqyruar 2 - 3 troje për çdo kryefamiljar dhe me sipërfaqe mbi normën 300 m$^2$**, në kundërshtim me dekretin e

Presidentit nr. 5747 datë 29.06.1978 dhe ligjin nr. 33/2012 "*Për regjistrimin e pasurive të Paluajtshme" ndryshuar* si dhe Rregulloren nr. 184, datë 08.04.1999, ndryshuar nr. 7 datë 07.01.2000 "*Për punën e zyrës së regjistrimit të pasurive të paluajtshme",* konkretisht:
*** FB paraqet pasurinë 65/31, truall 300 m2 (82 m2 ndërtesë) dhe pasurinë 65/32, truall 300 m2 (870 m2 ndërtesë), ose 300 m2 truall tepër,*
*** RS paraqet pasurinë 81/17, truall 300 m2 (75 m2 ndërtesë) dhe pasurinë 81/18, truall 300 m2 (70 m2 ndërtesë), ose 300 m2 truall tepër,*
*** RS paraqet pasurinë 82/5, truall 300 m2 (100 m2 ndërtesë) dhe pasurinë 82/6, truall 300 m2 (42 m2 ndërtesë), ose 300 m2 truall tepër,*
*** MH paraqet pasurinë 96/9, truall 300 m2 (169 m2 ndërtesë) dhe pasurinë 96/10, truall 300 m2 (169 m2 ndërtesë), ose 300 m2 truall tepër,*
*** G A paraqet pasurinë 96/27 truall 300 m2 (120 m2 ndërtesë) dhe pasurinë 96/33, truall 300 m2 (88 m2 ndërtesë), ose 300 m2 truall tepër,*
*** I M paraqet pasurinë 193/2 truall 250 m2 (97 m2 ndërtesë) dhe pasurinë 193/4 truall 250 m2 (66 m2 ndërtesë), ose 200 m2 truall tepër,*
*** BS paraqet pasurinë 196/1 truall 250 m2 (108 m2 ndërtesë) dhe pasurinë 198/2 truall 250 m2 (106 m2 ndërtesë), ose 200 m2 truall tepër,*
*** BD paraqet pasurinë 250/4 truall 250 m2 (35 m2 ndërtesë) dhe pasurinë 250/2 truall 250 m2 (38 m2 ndërtesë), ose 200 m2 truall tepër,*
*** BB paraqet pasurinë 285/6 truall 250 m2 (90 m2 ndërtesë) dhe pasurinë 288/5 truall 250 m2 (93 m2 ndërtesë), ose 200 m2 truall tepër,*
*** BA paraqet pasurinë 291/2 truall 250 m2 (70 m2 ndërtesë) dhe pasurinë 291/3 truall 250 m2 (36 m2 ndërtesë), ose 200 m2 truall tepër,*
*** XHS paraqet pasurinë 424/1 truall 250 m2 (94 m2 ndërtesë) dhe pasurinë 424/2 truall 120 m2 (120 m2 ndërtesë), ose 60 m2 truall tepër,*
*** TS paraqet pasurinë 424/6 truall 250 m2 (63 m2 ndërtesë) dhe pasurinë 425/3 truall 250 m2 (63 m2 ndërtesë), ose 200 m2 truall tepër,*
*** XHS paraqet pasurinë 426/11 truall 250 m2 (49 m2 ndërtesë) dhe pasurinë 426/12 truall 250 m2 (100 m2 ndërtesë), ose 200 m2 truall tepër,*
*** FS paraqet pasurinë 435/2 truall 250 m2 (35 m2 ndërtesë) dhe pasurinë 435/3 truall 250 m2 (99 m2 ndërtesë), ose 200 m2 truall tepër,*
*** MS paraqet pasurinë 442/17 truall 250 m2 (30 m2 ndërtesë) dhe pasurinë 422/18 truall 250 m2 (125 m2 ndërtesë), ose 200 m2 truall tepër,*
*** RS paraqet pasurinë 439/1 truall 250 m2 (160 m2 ndërtesë) dhe pasurinë 446/1 truall 250 m2 (120 m2 ndërtesë), ose 200 m2 truall tepër,*
*** MS paraqet pasurinë 425/4 truall 250 m2 (108 m2 ndërtesë) dhe pasurinë 426/7 truall 250 m2 (80 m2 ndërtesë), ose 200 m2 truall tepër,*
**** VS paraqet pasurinë 541/2 truall 250 m2 (112 m2 ndërtesë) dhe pasurinë 542/2 truall 250 m2 (150 m2 ndërtesë) si dhe pasurine 542/6 truall 250 m2 (100 m2 ndërtesë), ose 450 m2 truall tepër,*
**** SB paraqet pasurinë 285/3 truall 250 m2 (36 m2 ndërtesë) dhe pasurinë 285/3-2 truall 250 m2 (165 m2 ndërtesë) si dhe pasurine 288/2 trual 250 m2 (136 m2 ndërtesë), ose 450 m2 truall tepër,*
**** ID paraqet pasurinë 569/8 truall 250 m2 (130 m2 ndërtesë) dhe pasurinë 569/9 truall 250 m2 (60 m2 ndërtesë) si dhe pasurine 569/28 truall 250 m2 (60 m2 ndërtesë), ose 450 m2 truall tepër,*
*** HV paraqet pasurinë 48/01/1 truall 300 m2 (100 m2 ndërtesë) dhe pasurinë 52/7/1 truall 300 m2 (85 m2 ndërtesë), ose 300 m2 truall tepër,*
**Pranimi i kësaj liste të parregullt** është në kundërshtim me VKM nr. 556, datë 23.10.2000 "*Për dorëzimin e Dokumentacionit në ZVRPP".*

Lista e trojeve te komunes Kashar eshte nenshkruar nga ish-kryeplaku B K dhe ish-kryetari komunes Kashar F F.
Në 21 rastet pasuritë truall me sipërfaqe tepër nuk duhen çelur në KPP përkatëse dhe nuk duhen lëshuar certifikatat pa titull pronësie, ne te kundërt duhen veçuar e regjistruar "shtet" këto sipërfaqe tepër. Mos kryerja e veprimeve për veçimin në KPP të sipërfaqeve tepër është në kundërshtim me ligjin nr. 7501, datë 19.7.1991 "*Për tokën*", me ligjin nr. 7843, datë 13.7.1994 "*Për Regjistrimin e Pasurive të Paluajtshme*", me nenin 25 të ligjit nr. 33, datë 21.3.2012 dhe me nenin 10 të Dekretit nr. 5747, datë 29.6.1978, datë 29.6.1978 "*Për Hartimin, Miratimin dhe Zbatimin e Planeve Rregulluese të Qyteteve dhe të Fshatrave*", ku thuhet:

*"....Për ndërtimin e banesave vetjake në fshatrat fushore e në përdorim një ngastër deri në 200 $m^2$ në fshatrat kodrinore e malore deri në 300 $m^2$ dhe në qytete, sipas rastit, 140 deri 170 $m^2$..."*

**XXIX.** *Auditimi ne origjine i disa pasurive te AMTP llojit "are" sherbeu si indicie me rrisk,* pasi:
- ***Ne disa raste*, toka bujqësore e shpërndare me AMTP ne Kashar nuk i ka shërbyer qëllimit te ligjit për token dhe mbrojtjen e tokes (** *ligjit nr. 7501 date 19.07.1991 "Per token" dhe ligjit nr. 9244 date 17.06.2004 "Për mbrojtjen tokes bujqesore"),* per ruajtjen, mbrojtjen dhe përmirësimin e pjellorisë tokës, per funksionet natyrore te saj si krijuese e bazes jetes per jetesen e njerzve, per prodhimin e drithrave dhe perimeve bujqesore, per rritjen e sigurise dhe rezervave tyre ne mireqenien e komunitetit, **pasi ka sherbyer si biznes shitje-blerje, ku mbi te jane ngritur ndertime pa leje dhe me leje,** ne dem te mbrojtjes saj dhe te planifikimit dhe zhvillimit territorit dhe infrastruktures, ne harkun kohor 30-vjeçar, çka ben pergjegjes zyrat e rregjistrimit (kadastrat), pushtetin vendor, Keshillin Qarkut dhe Ministrine Bujqesise**.**
- ***Shitblerja e tokes bujqesore e shperndare me AMTP,*** bie ndesh me nenin 2 te ligjit nr. 7501 date 19.07.1991 "*Per token*",
-***Zenia dhe demtimi i tokes bujqesore nga ndertimet e paligjshme*** *(pa leje),* bie ndesh me nenin 10 dhe 14 te ligjit nr. 9244 date 17.06.2004 "*Per mbrojtjen e tokes bujqesore"* dhe me nenin 21 te ligjit nr. 7501 date 19.07.1991 "*Per token*".
- Nga ish-komuna Kashar nuk eshte zbatuar "*Karta Evropiane e vetëqeverisjes lokale*", e cila në thelb përcakton, shprehimisht:
"*Menaxhimi i një qyteti duhet drejtuar që të sigurojë që ata njerëz, të drejtat dhe pronat e të cilëve preken në një shkallë të rëndësishme nga aktet e propozuara dhe vendimtare administrative, të jenë të informuar rreth tyre, tu dëgjohen mendimet dhe të bëhen kështu një pjesë aktive në procesin e vendimmarrjes.*
*- Qytetarët janë baza e demokracisë lokale. Ata janë partnerët e përfaqësuesve të zgjedhur dhe zyrtarëve qeverisës lokalë në planifikimin dhe menaxhimin e komunitetit. Me qëllim që t'i ushtrojnë këto detyra, ata duhet të informohen rreth të gjitha planeve kryesorë të perceptuara nga përfaqësuesit dhe zyrtarët e tyre të zgjedhur.*
***Sa siper***, konkretisht:
*** *Ne vitin 1998 shitur me KSH 16 pasuri te përfituesve me AMTP*, sipërfaqe 50478 m2 "are" për 744,000 dollarë, *"A.A.I. A.s*" shpk, pasuria e bashkuar nr. 181/17, ZK 2105, Kashar, vol 1, faqe 40, referencë 17 date 17.12.1998**,** përkatësisht:
*-pasuria 181/1, vol 1/ 18, ZK 2105, KSH/1998, 37,500, Kasem Hajdari 2500 m2 are, AMTP 338;*
*-pasuria 181/2, vol 1/19, ZK 2105, KSH/1998, 37,500, Petrit Hajdari 2500 m2 are, AMTP 60;*
*-pasuria 181/3, vol 1/20, ZK 2105, KSH/1998, 37,500, Shefqet Hajdari 2500 m2 are, AMTP 61;*
*-pasuria 181/4, vol 1/21, ZK 2105, KSH/1998, 37,500 &, Beqir Hajdari 2500 m2 are, AMTP 62;*
*-pasuria 181/5,vol 1/22, ZK 2105, KSH/1998, 73,170,Muhamet Hajdari 4878 m2, AMTP 72;*
*-pasuria 181/6, vol 1/23, ZK 2105, KSH/1998, 60,000, Halil Hajdari 4000 m2 are, AMTP 34;*
*-pasuria 181/7, vol 1/24, ZK2105, KSH/1998, 180,000, Hysen Hajdari 12000 m2, AMTP 342;*
*-pasuria 181/8, vol 1/25, ZK 2105, KSH/1998, 18,000, Shpetim Kamberi 1200 m2 are, AMTP;*
*-pasuria 181/9, vol 1/26, ZK 2105, KSH/1998, 36,000, Osman Kamberi 2400 m2, AMTP 360;*

*-pasuria 181/10, vol 1/27, ZK 2105, KSH/1998, 60,000, Sazan Kamberi 4000 m2, AMTP 360;*
*-pasuria 181/11, vol 1/28, ZK 2105, KSH/1998, 19,500 &, Halim Kamberi 1300 m2, AMTP 421;*
*-pasuria 181/12, vol 1/29, ZK 2105,KSH/1998,18,000, Xhevahir Kamberi 1200 m2, AMTP 422;*
*-pasur 181/13, vol 1/30, ZK 2105, KSH/1998, 45,000,Abdulla Kamberi 3000 m2, AMTP 420;*
*-pasuria 181/14, vol 1/31, ZK 2105, KSH/1998, 20,574, Telna Kamberi 1500 m2 , AMTP 423;*
*-pasuria 181/15, vol 1/32, ZK 2105, KSH/1998, 22,100,Jemin Kamberi 1700 m2 AMTP 425;*
*-pasuria 181/16, vol 1/33, ZK 2105, KSH/1998, 41,600,Hasan Kamberi 3200 m2, AMTP 424;*
*Pasuria bashkuar nr. 181/17, sipërfaqe 50478 m2 ne vitin 2003 nga kjo shoqëri është shitur një subjekti tjetër E. N për 1,342,000 dollarë, ky i fundit ne vitin 2005 e ka shitur B. T . Me tej pasuria është mbyllur kaluar tek vol 18, faqe 227-228, e cila ndahet 2 pjese:*
*a. Pasuria 181/18, ZK 2105, vol 18, faqe 227, sipërfaqe 12500 m2, kaluar me KDH përsëri tek E. N ne 2006 dhe pas 2 transaksioneve tjera ne 2007 ka kaluar tek shoqëria "M TCI" shpk, e cila ka kaluar tek pasuria 181/20, vol 20, faqe 98, sipërfaqe 725 m2 ne emër "M TCI" shpk dhe tek pasuria 181/21, vol 20, faqe 99, sipërfaqe 11775 m2 kaluar* ***(2011****) ne pronësi te "i.-J " shpk me KSH për 1,549,250 euro.*
*b. pasuria 181/19****,*** *ZK 2105, Kashar, vol 18, faqe 228, sipërfaqe 37978 m2 "are", kaluar nga familjaret T tek shoqëria "M T." shpk , me KSH për 3,200,000 Euro****.***

***** *Ne vitin 2004 deri 2019 jane shitur dhe kane pesuar transaksione 5 pasuri përfituar me AMTP****,*** me sipërfaqe bashkuar 16000 m2 are për 1 milion euro, pronësi "*C I "* shpk, sipas deklaratës noteriale 19.12.2019, *reference 4923 date 13.01.2020*, përkatësisht:
*- pasuria 1154/3, sipërfaqe 2800 m2, vol 14, faqe 178, ZK 2105, Kashar.*
*- pasuria 1154/32, sipërfaqe 3000 m2, vol 17, faqe 90, ZK 2105, Kashar.*
*- pasuria 1154/14, sipërfaqe 3000 m2, vol 14, faqe 190, ZK 2105, Kashar.*
*- pasuria 1154/38, sipërfaqe 3200 m2, vol 17, faqe 111, ZK 2105, Kashar.*
*- pasuria 1154/8, sipërfaqe 4000 m2, vol 14, faqe 183, ZK 2105, Kashar, kjo e fundit vjen pas 5 transaksione me KSH nga viti 2004 deri 2019. Te njëjtën procedure, transaksione kanë pasur dhe pasuritë tjera blere fisit V , pasuria 1154/3, sipërfaqe 2800 m2, vol 14, faqe 178 dhe pasuria 1154/14, sipërfaqe 3000 m2, vol 14, faqe 190.* Origjina e pasurisë 1154/8, sipërfaqe 4000 m2, vol 14, faqe 183, ZK 2105, Kashar, vjen nga referenca nr. 608 date 14.06.2004, ose nga AMTP 330 date 10.01.1996 ne emër te Q. H V,

***** *Pasuria toke are ka pësuar 6 transaksione shitblerje, bashkim dhe ndarje pasurie nga një person tek një tjetër dhe anasjelltas, për efekt biznesi dhe kredie bankare****,*** konkretisht:
*- Pasuria 1182/11, ZK 2105, vol 15, faqe 136, sipërfaqe 4470 m2 "are" ne pronësi shtet është përfituar me AMTP 371 date 01.07.1992 nga B S B , sipas referencës 95 date 23.05.2002. Kjo pasuri është shitur F F për 4,000,000 leke, sipas referencës 194 date 19.12.2002. Ky i fundit e ka shitur A P për 6,000,000 leke, sipas referencës 220 date 18.03.2003. Me tej pasuria 1182/11 me sipërfaqe 4470 m2 "are" është bere pjese* ***e*** *pasurisë bashkuar nr. 1182/13, ZK 2105, vol 16, faqe 103 me sipërfaqe 35682 m2 are ne emër te A P* , e cila përbëhet nga 11 pasuri bija. *Me pas pasuria e bashkuar 1182/13 me sipërfaqe 35682 m2 te A P është shitur F Fs ish-kryetar komunës Kashar për 30,000,000 leke me KSH 13.08.2003, reference 302 date 15.08.2003. Ky i fundit përsëri pas 2 muajve sipas KSH 06.10.2003 pasurinë 1182/13 me sipërfaqe 35682 m2 are e ka shitur 64,000,000 leke 3 personave, sipas KSH date 06.10.2003. Kjo pasuri ne 2009 ndahet 2 pjese ne pronësi 3 personave pasuria 1182/13/1 dhe 1182/13/2, ZK 2105, vol 20, faqe 137-138 kufizim për kredinë.*
***** Sipas referencës nr. 4617 date 01.03.2019 dhe 4665 date 09.04.2019, u konstatua ne origjine se toka are e përfituar me 2 AMTP te parregullta ka kaluar disa transaksione me KSH, me tej është bashkuar dhe mbi te janë ngritur objekte me leje ndërtimi, dhe pastaj është ndare përsëri ne 3 pasuri, te cilat janë shitur një kompanie private, konkretisht:
*- 2 AMTP e familjes M te pandare ne vitin 1991, pasi K dhe F janë babe e bir dhe janë pjese e pasurisë 1165/7/1, ZK 2105, sipërfaqe 7500 m2, vol 15, faqe 241. Këto 2 AMTP janë regjistruar dhe me tej pasuritë e tyre janë bashkuar ne 1 pasuri nr. 1165/16, ZK 2105, vol 18,*

*faqe 9, sipërfaqe 15000 m2 "are+truall" ne emër F M , mbi të cilën është ngritur objekti 'Depozite karburant dhe gaz" me leje ndërtimi 8 date 12.05.2005. Sipërfaqen 15000 m2 bashke me "depozite karburanti dhe gazi" është ndare dhe shitur 3 pasuri, përkatësisht:*
*a. pasuria 1165/17,vol 18, faqe 54, sipërfaqe 5010 m2, është shitur 1,079,150 leke "S –o."sha ne vitin 2017, ndërsa ky i fundit ne 2019 e ka shitur sha "E -0." 2,500,000 leke, sipas referencës 4617 date 01.03.2019.*
*b. pasuria 1165/18,vol 18, faqe 55, sipërfaqe 4980 m2 "truall" bashke me "Depozite karburant dhe gaz"është shitur 6,000,000 leke sha "F –M -OIL " ne vitin 2017, ndërsa ne vitin 2017 ka kaluar tek shpk "P C A" dhe me tej është shitur 86,900,000 leke me KSH sha "E -0IL".*
*c. pasuria 1165/19,vol 18, faqe 56, sipërfaqe 5010 m2 "are", shitur shpk "P C A " ne vitin 2017, ndërsa ne vitin 2019 kjo kompani e ka shitur sha "E -0IL" 38,400,000 leke, me kufizim deri prill/2019 për kredi bankare, sipas referencës 4665 date 09.04.2019.*

***** Ne vitin 1998 shitur me KSH shoqërisë "*D P -AL*" shpk, pasuria 974/2, ZK 2105, vol 9, faqe 226, sipërfaqe 2000 m2 "are" për 1,000,000 leke e XH S përfituar me AMTP 150/1992.

Veprime ne kundërshtim me ligjin 7501 datë 19.7.1991 "*Për tokën*" , me ligjin 9948 datë 7.7.2008 "*Për shqyrtimin e vlefshmërisë ligjore krijimit titujve pronësisë mbi tokën bujqësore",* nr. 57/2012 dhe nr. 171/2014, me UKM 2 datë 12.09.2012 "*Për përcaktimin e elementeve të akteve, që verifikohen nga zyra e regjistrimit pasurive të paluajtshme dhe të procedurës për nxjerrjen e urdhrit të regjistruesit*", me UKM 2 datë 13.06.2013 "*Për mënyrën e procedimit të organeve të administratës publike, për pasuritë e paluajtshme, të fituara me Aktin Marrjes Tokës Pronësi"***,** me shkresën 7217/3 date 15.07. 2021 te DP ASHK, me nenin 68 "*Bashkëpunimi ndërinstitucional"* te ligjit nr. 111.2018 "*Për kadastrën*", përforcuar edhe me vendimin 1040 date 25.11.2020, kreu I/ 5, me ligjin nr. 20/2020, me VKM nr. 994 date 09.12.2015 "*Për procedurën e regjistrimit te akteve te marrjes se tokës ne pronësi"*, pika 1/a,b, ç etj, me Kreun II, neni 119 "*Pavlefshmëria akteve*" Kodi Procedurës Civile, me nenin 193 të ligjit 7850 datë 29.7.1994 "*Kodi Civil RSH*" ndryshuar.

*Përgjegjësit:*

- Për mangësitë dhe parregullsitë e AMTP mbajnë përgjegjësi ish-komisioni i tokave, kryepleq fshati dhe kryetar komune Kashar: F F , B K , SH S , R , K M , I D , B S .
- *Për Njësinë Administrative Kashar,* për mangësitë ne dokumentacion, relacionet e pjesshme, shkeljet e afateve, mos-menaxhimin e parcelave shtet, mbajnë përgjegjësi ish-administratori i njësisë administrative Kashar Xh K , specialistet A S , E Ç , A I , G B , L M , A K , *sipas periudhave qe kane ushtruar detyrat funksionale.*

***XXX. 2019- A A*** Në përgjigje të kërkesës me nr. 13349, datë 17.03.2014 nga A A ZVRPP Tiranë në ju bëjmë me dije se mbas kërkimeve e bëra në listën e AMTP-ve rezultoi se në emër të përfaqësuesit të familjes bujqësore Z Xh A , janë depozituar në origjinal 2 AMTP me nr. akti 258 e cila ndodhet në origjinal dhe nr. akti 262 e cila ndodhet fotokopje.

Nga Njësia administrative Kashar me nr. 2868/1, datë 01.10.2019 drejtuar A D Drejtor i Përgjithshëm Bashkia Tiranë dhe për dijeni A A , lënda: "Relacion dhe dërgim dokumentacioni tekniko-ligjor për konfirmim". AMTP-ja të njehsuara me origjinalin nga ish-ZVRPP Tiranë (sot ASHK) më datë 19.03.2014 i ndodhur origjinal në listën e Qarkut dhe listën e Komunës, akt i cili rezulton i lëshuar nga ish-Komisioni i ndarjes së Tokës së Fshatit Kashar, bazuar në ligjin nr. 7501, datë 19.07.1991 "Për Tokën" i ndryshuar me nr. akti 258, datë .....1992 në emër të përfaqësuesit të familjes bujqësore Z A fshati Kashar, në këtë akt rezultojnë të regjistruara pasuritë si më poshtë:

- Pasuria 291/41 arë për 1650 $m^2$ korrespondon numrit rendor 4 në AMTP përputhet me AMTP;
- Pasuria 315/6 pemëtore për 200 $m^2$ korrespondon numrit rendor 2 në AMTP dhe pasuria 305 pemëtore për 1200 $m^2$ korrespondon rreshtit 2 në AMTP sipas plan rilevimit, dhe pemëtore për 250 $m^2$, + pemëtore për 1240 $m^2$ sipas AMTP-së në numrin rendor 2;

- Pasuria 319/1 arë për 2306 m$^2$ korrespondon numrit rendor 1 në AMTP sipas plan rilevimit, dhe arë për 3000 m$^2$, sipas AMTP-së në numrin rendor 1;
- Pasuria 304/37 arë për 1600 m$^2$ korrespondon numrit rendor 3 në AMTP përputhet me AMTP;
- Pasuria 536/7 arë për 950 m$^2$ korrespondon numrit rendor 9 në AMTP përputhet me AMTP;
- Pasuria 558/ arë për 2400 m$^2$ korrespondon numrit rendor 7 në AMTP sipas plan rilevimit dhe arë për 5400 m$^2$, sipas AMTP-së në numrin rendor 7;

Për mos përputhjet e mësipërme midis plan-rilevimit dhe aktit nr. 258 AMTP, ka qene gabim material i Komisionit të ndarjes së Tokës në momentin e plotësimit të AMTP.
Bashkëlidhur Relacionit me shkresë nr. 2868/1, datë 01.10.2019, janë:
- AMTP nr. 258, datë 1992 e njehsuar më origjinalin;
- plan rivelimet e konfirmuara sipas gjendjes faktike të secilës pasuri;
- Çertifikatë familjare datë 01.08.1991.

***Konkluzion***
Në praktikën e arkivuar pranë Njësisë Administrative Kashar:
- Nuk administrohet Çertifikata familjare datë 01.08.1991;
- Nuk ka plan rilevime për pasuritë e regjistruara në AMTP përkatësisht: "arë" për 3500 m$^2$ sipas AMTP-së në numrin rendor 5; "arë" për 4000 m$^2$ sipas AMTP-së në numrin rendor 6; "ullishte" për 600 m$^2$ sipas AMTP-së në numrin rendor 8, për të cilat nuk janë shprehur në relacionin shpjegues.
- Deklaratat e kufitarëve në të gjitha rastet nuk janë nënshkruar nga personat kufitarë por vetëm nga Kryetari i Fshatit D A.
- Nga personi përfitues i tokës bujqësore sipas AMTP nuk ka deklaratë noteriale për të pranuar diferencat e sipërfaqeve nga AMTP në plan rilevimet faktike.
- Vërtetimet për ekzistencën e gabimeve materiale të Komisionit të ndarjes së tokës me nënshkrimin e ish-Kryetarit të Komisionit të ndarjes së tokës SH S dhe ish përfaqësuesit të Rrethit B K janë me vulë të Kryetarit të Fshatit Kashar .

Veprime në kundërshtim me VKM nr. 994, datë 9.12.2015 "Për procedurën e regjistrimit të akteve të marrjes së tokës në pronësi", dhe ngarkojnë me përgjegjësi: A I Specialist, A S Përgjegjës Zyre, F SH Specialist dhe XH K Administrator.

***XXXI. 2019-P P***
Në përgjigje të aplikimit me nr. 63138, datë 28.06.2018 nga P P ZVRPP Tiranë në datë 10.07.2018 ju bëjmë me dije se mbas kërkimeve e bëra në listën e AMTP-ve rezultoi se në emër të përfaqësuesit të familjes bujqësore P P, janë depozituar 6 AMTP të cilat kopje të njehsuara me origjinalin janë vënë në dispozicion të z. P P.
ZVRPP në datë 16.08.2018 në përgjigje të aplikimit nr. 70207, datë 18.07.2018 nga P P kërkon planin e rilevimit për pasurinë e kërkuar për regjistrim.
- Nga Njësia administrative Kashar me nr. 4530/1, datë 18.01.2019 drejtuar A D Drejtor i Përgjithshëm Bashkia Tiranë dhe për dijeni P P, lënda: "Relacion dhe dërgim dokumentacioni tekniko-ligjor për verifikim". Nga shqyrtimi paraprak i dokumentacionit (ZVRPP Tiranë aktualisht administron 6 AMTP të cilat kopje të njehsuara me origjinalin janë vënë në dispozicion të z. P P) vërejmë se është kompetencë e *Komisionit Vendor të Verifikimit të Titujve të Pronësisë, pranë Prefektit Tiranë*, pasi referuar 6 akteve të vëna në dispozicion bashkëlidhur shkresës së ZVRPP Tiranë 10.07.2018, janë të ndryshëm nga njëri tjetri dhe tre akte janë lëshuar nga Komisioni i ndarjes së Tokës Fshati Katund i ri dhe tre akte janë lëshuar nga Komisioni i Ndarje së Tokës Fshati Yrshek.
- Për sa më lart, në relacionin e datës 18.01.2018 janë përshkruar 6 Aktet e Marrjes së Tokës në pronësi nga Familja Bujqësore e përfaqësuesit P P në mënyrë shpjeguese pa analizuar se për të njëjtën pasuri janë lëshuar 2 AMTP, në të njëjtën datë 07.07.2000 {Tokë e llojit "arrë" me sipërfaqe 1200 m$^2$, (nr. kadastral 207) }konkretisht:

- AMTP nr....., datë 07.07.2000, sipas konfirmimit nga ZVRPP Tiranë datë 05.07.2018, AKT i lëshuar përfaqësuesit të familjes bujqësore P P nga ish- Komisioni i ndarjes së Tokës Fshati Katund i ri, regjistruar në reshtin 1 të këtij Akti, Tokë e llojit "arrë" me sipërfaqe 1200 $m^2$, (nr. kadastral 207)
- AMTP nr. 326, datë 07.07.2000, e ndodhur origjinal sipas konfirmimit nga ZVRPP Tiranë datë 09.07.2018, AKT i lëshuar përfaqësuesit të familjes bujqësore P P nga ish- Komisioni i ndarjes së Tokës Fshati Katund i ri, regjistruar në reshtin nr. 1 të këtij Akti, Tokë e llojit "arrë" me sipërfaqe 1200 $m^2$ dhe në reshtin nr. 2 të këtij Akti, Tokë e llojit "arrë" me sipërfaqe 3500 $m^2$, (reshti nr. 1 për nr. kadastral 207 dhe reshti nr. 2 për nr. kadastral 211/1/)
- Për pasurinë nr. kadastral 211/1/ ka paraqitur Plan Rilevimi i pa nënshkruar nga Administratori i Njësisë Administrative si dhe Deklarata e kufitarëve të nënshkruara Kryetari i Fshatit Katund i ri I D.

***XXXII. 2019-F P***

Në relacionin nga Njësia Administrative Kashar me nr. 1891/1, datë 09.07.2019 drejtuar A D Drejtor i Përgjithshëm Bashkia Tiranë dhe për dijeni F Q P , sqaron se: në vijim të kërkesës së z. F P me nr. 1891, datë 27.05.2019 ku kërkohet konfirmimi i AMTP me nr. 397, datë 10.05.1996 në emër të përfaqësuesit të familjes bujqësore F P , fshati Yrshek: Pasuria 211, sipas planit të rilevimit me sip. 1350 $m^2$ tokë "arrë" në ZK 2119 fshati Katund i ri i referohet pasurisë së paraqitur në reshtin 1 të AMTP me nr. parcele 210-211. Sipërfaqja prej 1350 $m^2$ tokë "arrë" është sipas gjendjes në terren pavarësisht faktit që titulli i pronësisë(AMTO nr. 397, datë 10.05.1996) rezulton e regjistruar me 4000 $m^2$ në parcelat 210-211.
- Bashkia Tiranë me nr. 27475, datë 16.07.2019 në "Kthim dokumentacioni", sqaron se gjatë shqyrtimit të dosjes dhe bazuar në informacionin e DV ASHK Tirana Rurale 2 datë 16.05.2019, për pasurinë e përcjellë me nr. 211, preket pasuria me nr. 211/31 certifikuar në emër të B H si dhe pasuria 211/30 certifikuar në emër të F K .
- Në relacionin nga Njësia Administrative Kashar me nr. 1891/1, datë 09.07.2019 drejtuar A D Drejtor i Përgjithshëm Bashkia Tiranë dhe për dijeni F P , "Kthim përgjigje, plotësim dhe ridërgim dokumentacioni" sqaron se: Pasuria me nr. 211/31 certifikuar në emër të B H si dhe pasuria 211/30 certifikuar në emër të F K , janë me vendndodhje faktike në terren të ndryshme nga pasuria me nr. 211, ZK 2119 dërguar për regjistrim në pronësi të familjes bujqësore F P , fshati Yrshek.
- Bashkëlidhur me praktikën shkresore të citur më lart administrohet edhe dokumentacioni:
1.1-AMT Përdorim nr. 397, datë 16.05.1994 në emër të përfaqësuesit të familjes bujqësore Q P , fshati Katundi i ri-Yrshek ku në reshtin e 1, përcakton Parcela 211 gjithsej 2200 $m^2$ tokë "arrë" nënshkruar edhe nga Kryetari i Komisionit të Tokës në Fshat I Sh .
1.2.-AMT Pronësi nr. 397, datë 16.06.1996 në emër të përfaqësuesit të familjes bujqësore Q P , fshati Katundi i ri-Yrshek ku në reshtin e 1, përcakton Parcela 211 gjithsej 2200 $m^2$ tokë "arrë" nënshkruar edhe nga Kryetari i Komisionit të Tokës në Fshat I Sh .
1.3.- Vërtetim datë 20.09.2005 nga Kryetari i Komisionit të Tokës në Fshat I Sh , për efekt njohje të pronarit Q P për sipërfaqen sipas formularit nr. 6 plotësuar në parcelën nr. 211 për 2200 $m^2$ tokë "arrë".
2.1.- AMT Pronësi nr. 397, datë 16.05.1994 në emër të përfaqësuesit të familjes bujqësore Q P , fshati Katundi i ri-Yrshek ku në reshtin e 1, përcakton Parcela 211 gjithsej 4000 $m^2$ tokë "arrë" nënshkruar edhe nga Kryetari i Komisionit të Tokës në Fshat A P.
2.2.-AMT Pronësi nr. 397, datë ...... 1996 në emër të përfaqësuesit të familjes bujqësore F P , fshati Katundi i ri-Yrshek ku në:
Reshtin e 1, përcakton Parcela 210 gjithsej 700 $m^2$ tokë "arrë"
Reshtin e 2, përcakton Parcela 211 gjithsej 3300 $m^2$ tokë "arrë", gjithsej 4000 $m^2$, nënshkruar edhe nga Kryetari i Komisionit të Tokës në Fshat I Sh.

2.3.- formularit nr. 6 plotësuar në parcelën 210 gjithsej 700 $m^2$ tokë "arrë" dhe në parcelën nr. 211 për 3300 $m^2$ tokë "arrë", gjithsej 4000 $m^2$, nënshkruar edhe nga Kryetari i Komisionit të Tokës në Fshat I Sh si dhe nga Kryetari i Komunës A S.

***Konkluzion***

Nuk ka sqarime e saktësime për gjendjen faktike dhe dokumentare të përfitimit të tokës nga familja bujqësore me përfaqësues Q P . Veprime në kundërshtim me Ligjin nr. 9948, datë 7.7.2008, "Për shqyrtimin e vlefshmërisë ligjore të krijimit të titujve të pronësisë mbi tokën bujqësore"; VKM nr. 994, datë 9.12.2015 "Për procedurën e regjistrimit të akteve të marrjes së tokës në pronësi", dhe ngarkojnë me përgjegjësi: I SH Kryetari i Komisionit të Tokës në Fshat; A S ish-Kryetari i Komunës; A I Specialist; A S Përgjegjës Zyre; F SH Specialist dhe XH K Administrator.

***XXXIII. 2019- A F.***

- Në relacionin nga Njësia Administrative Kashar me nr. 3270/1, datë 18.09.2018 drejtuar A D Drejtor i Përgjithshëm Bashkia Tiranë dhe për dijeni A F , sqaron se: Në përgjigje të kërkesës me nr. 3270, datë 27.07.2018.- Pasuria nr. 209 sipas planit të rilevimit korrespondon e regjistruar në reshtin nr. 1 në AMTP me tokë e llojit "arë" me nr. 181/13 me emrin popullor "zalle" me sip. 2400 $m^2$ ZK 2119, fshati katund i Ri. Sipërfaqja e pasurisë sipas gjendjes faktike në terren, plani të rilevimit rezulton 550 $m^2$ "arë". *Nënshkruar nga A I Specialist; A S Përgjegjës Zyre; B L Përgjegjëse Zyre dhe E C Administrator.*
- AMTP pa nr. dhe pa datë për familjen bujqësore të A F në reshtin nr. 1 ka Ngastra 181/13 "Zallë" 2400 $m^2$ "arë" me kufi Veri-Sh.I.; Lindje-K.Kullues; Jug- R. A; Perëndim- Rrugë.

Aktualisht në praktikë administrohen 2 plan rilevime me të dhëna të njëjta por në pozicion të ndryshme:

1-Plan rilevimi i datë 21.02.2018 përgatitur nga Top. H D pasqyron në mënyrë grafike parcelë 550 $m^2$ ("arë") mbi lumin "Lana" Nënshkruar nga Kryetari i Fshati I D dhe Administratori E C .

2-Plan rilevimi i datë 21.02.2019 përgatitur nga Top. H D pasqyron në mënyrë grafike parcelë 550 $m^2$ ("arë") spostuar nga lumin "Lana" Nënshkruar nga Kryetari i Fshati I D dhe pa firmë të Administratorit.

-*Certifikata familjare me gjendje 01.08.1991 dhe 01.10.1992 ka për kryefamiljar XH F*

-Në relacionin nga Njësia Administrative Kashar me nr. 715, datë 25.02.2019 drejtuar DAMT Këshilli i Qarkut Tiranë dhe për dijeni A F, sqaron se: Në përgjigje të kërkesës me nr. 1571, datë 11.01.2019 në referencë të shkresës 1806/2, datë 24.10.2018, ku konfirmohet fakti:- Pasuria nr. 290/ mbivendose në parcelat pa nr. dhe rezultojnë të regjistruara në zërin kadastral PF(rrugë, kanale). Për sa kërkojmë saktësimin e pasurisë nr. 209/, ZK 2119 dhe jo të pasurisë 290/

Këshilli i Qarkut Tiranë me nr. 747/2, datë 03.06.2019 konfirmon se sipas hartës me shkallë 1:5000 rezulton:

-Pasuria e konturuar me ngjyrë me sip. 550 $m^2$ sipas planit të rilevimit mbivendoset mbi parcelën nr. 209 e cila figuron regjistruar në zërin kadastral "arë".

- Sipas librit të tokës Sektori Katund i ri parcela 209, figuron me sip. 3 Ha 7 Dy 600 $m^2$ "arë" dhe 200 $m^2$ troje.

*Aktualisht në praktikë administrohen dy 2 fragmente të hartës 1:5000 me indeks K-34-88-(232) (kopje) pan rilevime me të dhëna të njëjta por në pozicion të ndryshme: ku parcela në fjalë me sip. 550 $m^2$ pozicionohet në mënyrë grafike parcelë 550 $m^2$ ("arë") mbi lumin "Lana" dhe ku pozicionohet në mënyrë grafike parcelë 550 $m^2$ ("arë") spostuar nga lumin "Lana".*

-Në praktikë administrohet edhe shkresa e Këshillit të Qarkut Tiranë DAMT me nr. 307/2, datë 15.03.2019, Lënda: Kthim përgjigje tuajës me nr. 715, datë 25.02.2019 se: Pasuria me nr. 209/ me sip. 550 $m^2$ në ZK 2119 mbivendoset mbi parcelën pa numër të cilat figurojnë të regjistruara

në Zërin Kadastral –PF(rrugë-kanale) gjendja 01.08.1991, bashkëlidhur fragment të hartës 1:5000 me indeks K-34-88-(232).
-Në relacionin nga Njësia Administrative Kashar me nr. 1619/1, datë 29.05.2020 drejtuar E B Drejtor i Përgjithshëm Bashkia Tiranë dhe për dijeni A F , sqaron se: Në përgjigje të kërkesës me nr. 1571, datë 11.01.2019 për Zërin Kadastral të pasurisë në emër të familjes bujqësore A F , me nr. 209/ , ju bëjmë me dije se bashkëlidhur po Ju nisim shkresën e Qarkut Tiranë me nr. 747/1, datë 03.06.2019 ku shprehet se pasuria objekt regjistrimi është e tokë llojit "arë" . *Nënshkruar nga A S Specialist; B L Përgjegjëse Zyre dhe XH K Administrator.*
***Konkluzion***
Nuk ka sqarime e saktësime për gjendjen faktike dhe dokumentare të pozicionimit të parcelës nr. 209 me sip. 550 m$^2$ ZK 2119, pasi figuron në gjendjen kadastrale PF(rrugë-kanale) datë 01.08.1991 dhe nuk përputhen fizikisht e grafikisht me parcelën e përfituar nga AMTP pa nr. e pa datë cituar më lart. Relacionet e Njësisë Administrative Kashar bien në kundërshtim me njeri tjetri si dhe me gjendjen faktike të pasurisë gjendje 01.08.1991.
Veprime në kundërshtim me Ligjin nr. 9948, datë 7.7.2008, "Për shqyrtimin e vlefshmërisë ligjore të krijimit të titujve të pronësisë mbi tokën bujqësore"; VKM nr. 994, datë 9.12.2015 "Për procedurën e regjistrimit të akteve të marrjes së tokës në pronësi", dhe ngarkojnë me përgjegjësi:; A S Specialist dhe Përgjegjës Zyre; B L Përgjegjëse Zyre dhe E C Administrator dhe XH K Administrator.

***XXXIV. 2019 -M P***
- Në relacionin nga Njësia Administrative Kashar me nr. 1177/3, datë 10.06.2019 drejtuar A D Drejtor i Përgjithshëm Bashkia Tiranë dhe për dijeni XH K , sqaron se: Në përgjigje të DPJAL Bashkia Tiranë me nr. 14517/3, datë 17.05.2019 drejtuar NJA Kashar, në lidhje me konfirmimin e praktikës për familjen bujqësore M P konkludojmë se:
*AMTP origjinale duhet te ishte depozituar në arkivën e ZVRPP Tiranë dhe se Bashkia Tiranë ka dërguar shkresë në lidhje me llojin e tokës pranë DAMT-së dhe nga korrespondenca rezulton se pasuria nr. 587/ , është dërguar edhe më parë nga Njësia Kashar pranë DAMT-se (ku zëri kadastral është "PF")* konfirmuar si më poshtë.
- Në shkresë nr. 218/2, datë 22.02.2019 DAMT pranë Këshillit të Qarkut Tiranë konfirmon: *Pasuria me nr. 287/ me sipërfaqe 500 m$^2$ në ZK 2119 mbivendoset mbi parcelën me nr. 557, e cila figuron e regjistruar në zërin kadastral "PF"(rruge, kanale) dhe prek pjesërisht parcelën me nr. 288 e cila figuron e regjistruar në zërin kadastral "arë", gjendja 01.08.1991. (e shoqëruar me fragment të hartës 1:5000)*
- Në shkresë nr. 550/2, datë 09.05.2019 DAMT pranë Këshillit të Qarkut Tiranë konfirmon: *Pasuria me nr. 287/ me sipërfaqe 500 m$^2$ në ZK 2119 sipas planit të rilevimit të paraqitur mbivendoset mbi parcelën me nr. 288, e cila figuron e regjistruar në zërin kadastral "arë", gjendja 01.08.1991. (e shoqëruar me fragment të hartës 1:5000)*
*V.O. Pasuria me nr. 287/ me të njëjtën sipërfaqe dhe gjeometri po me pozicion të ndryshëm për të njëjtin subjekt kemi konfirmuar me anë të shkresës tonë me nr. 218/2, datë 22.02.2019 drejtuar Njësisë Administrative Kashar se mbivendoset mbi parcelën me nr. 557, e cila figuron e regjistruar në zërin kadastral "PF"(rruge, kanale) sipas planit të rilevimit të hartuar nga topografi Gj L i datë 05.02.2019, kurse plan rilevimi i paraqitur nga ju është i njëjti topograf por me datë 07.03.2019, mbi të cilin është kryer konfirmimi i mësipërm.*
Në relacionin nga Njësia Administrative Kashar me nr. 1177, datë 02.04.2019 drejtuar A D Drejtor i Përgjithshëm Bashkia Tiranë dhe për dijeni M P , sqaron se: në vijim të kërkesës së z. M P me nr. 5029, datë 13.12.2018 ku kërkohet konfirmimi i AMTP e njehësuar me origjinalin, në emër të përfaqësuesit M P të familjes bujqësore, fshati Katund i ri: Pasuria 287/. Për AMTP nr...., datë 17.05.1996 konfirmon se: *Pasuria me nr. 287/, sipas planit të rilevimit të përgatitur në datë 07.03.2019, nga Top. Gj L tokë e llojit "arë" me sipërfaqe faktike ZK 2119, fshati*

*Katund i ri, i referohet pasurisë të regjistruar në reshtin numër rendor 1 të AMTP së mësipërme (AMTP nr.., datë 17.05.1996 familjes bujqësore M P fshati Yrshek)*

***Konkluzion***

Në relacionin sqarues të njësisë Administrative Kashar, në të dy rastet për të njëjtën pasuri, ka planë rilevimi të ndryshme dhe nuk ka dokumentacion sqarues mbi pozicionimin e saktë të pasurisë duke rezultuar procedurë të parregullt dhe me mangësi, e cila bie në kundërshtim me Ligjin nr.7501, datë 19.07.1991 "Për Tokën", ligjin nr. 9948, datë 7.7.2008, "Për shqyrtimin e vlefshmërisë ligjore të krijimit të titujve të pronësisë mbi tokën bujqësore"; VKM nr. 994, datë 9.12.2015 "Për procedurën e regjistrimit të akteve të marrjes së tokës në pronësi". Për këtë praktikë ngarkohet me përgjegjësi: A I, F SH, A S Specialistë dhe Administrator Xh K.

**XXXV. 2020-I H**

- Në relacionin nga Njësia Administrative Kashar me nr. 2745, datë 27.08.2020 drejtuar E B Drejtor i Përgjithshëm Bashkia Tiranë dhe për dijeni I H , sqaron se: se nisur nga AMTP e njehsuar me origjinalin në emër të familjes H pasuria nr. 79/ sipas plan rilevimit është e llojit "arë" me sipërfaqe faktikte në terren 1500 m$^2$ fshati Mëzez.
- Drejtoria e Administrimit të NJA-ve dhe AMTP-ve me shkresën nr. 28447/3, datë 06.11.2020 Lënda: Kthim dokumentacioni, përcakton se nga shqyrtimi i dokumentacionit rezultoi se:

AMTP në emër të I H i cili është anëtar i familjes bujqësore, pasi në 01.08.1991 është 16 vjeç e jo në moshë madhore në cilësinë për të vepruar.

Përcillet për regjistrim parcela nr. 79/, kur në fakt sipas vendodhjes është parcela nr. 100.

- Në relacionin nga Njësia Administrative Kashar me nr. 2745/4, datë 23.12.2020 drejtuar A C Drejtor i Përgjithshëm Bashkia Tiranë dhe për dijeni I H , në përgjigje thekësohet se: Nisur nga konstatimi juaj informojmë se në arkivën e Njësisë Administrative nuk gjendet asnjë dokumentacion që të na informon në lidhje me mënyrën e pajisjes me AMTP Në emër të subjektit I H.

Në dosje administrohet edhe Deklarata e kufitarëve që është e pa plotë dhe pa nënshkrimet e kufitarëve.

***Konkluzioni:***

Nga krahasimi i pozicionit të parcelës me nr. pasurie 79, për 1500 m$^2$ sipas AMTP pa nr. datë 20.11.1996 dhe pozicionimit sipas plan rilevimit datë 24.07.2017 hartuar nga B T dhe nënshkruar nga K M Kryetar i Fshatit Mëzez dhe Administratori XH K , krahasuar me pozicionimin parcelës në fragmentin e hartës K-34-88-(249A) konstatojmë se parcela bie PF (tokë pa frut) e cila nuk është objekt i ndarjes së tokës me ligjin nr. 7501 "Për Tokën", përpos faktit që AMTP-ja është lëshuar në emër të I H i cili është anëtar i familjes bujqësore, pasi në 01.08.1991 është 16 vjeç e jo në moshë madhore në cilësinë për të vepruar si përfaqësues i familjes bujqësore.

Veprime në kundërshtim me VKM nr.1174, datë 24.12.2020, "Për procedurat e regjistrimit të amtp-ve, saktësimin e kufijve e sipërfaqeve, si dhe normat për sipërfaqet shtetërore shtesë e pronat shërbyes" dhe ngarkojnë me përgjegjësi: A S Specialist dhe Përgjegjës Zyre; B L Përgjegjëse Zyre dhe XH K Administrator.

**XXXVI. 2020-L S**

- Në relacionin nga Njësia Administrative Kashar me nr. 2841/3, datë 03.09.2020 drejtuar E B Drejtor i Përgjithshëm Bashkia Tiranë dhe për dijeni A S, përfaqësues me prokurë i familjes bujqësore L.S , sqaron se: Në lidhje me konfirmimin dhe regjistrimin e pasurive sipa AMTP nr. 145, datë 10.10.1992 me sipërfaqe totale 8390 m$^2$ në emër të përfaqësuesit të familjes bujqësore L S .

Pasuria me nr. 156/ me emrin popullor "Radiostacioni" pasqyruar në AMTP në reshtin e 6, sip. 1500 m$^2$ sipas AMTP-së dhe plan rilevimit të përgatitur nga Top. Gj. L datë 26.06.2020 me sip. Faktike 800 m$^2$ ZK 2105, fshati Kashar.

Bashkia Tiranë, Drejtoria e Administrimit të NJ.A.-ve dhe AMTP-ve me nr. 29129/1, datë 14.09.2020 për DV ASHK Tirana Rurale 2 dërgon bashkëlidhur dokumentacionin e verifikuar si dhe Deklaratën Noteriale me nr. rep 2591, nr. kol. 1029 në të cilën bashkëpronarët dhe trashëgimtarët e Latif Sulaj shprehen se duan të regjistrojnë gjendjen faktike prej 800 m$^2$.
- Në dosjen e administruar nga Njësia Administrative Kashar në lidhje me këtë pasuri ka:
1. Dy kopje nga fragmenti i Tabelës 6, Lista e familjeve që marrin tokë në pronësi, ku në një kopje Familja L S ka të regjistruar sipërfaqe totale prej 6450 m$^2$ tokë "arë" në 4 parcela dhe në kopjen tjetër ka të regjistruar sipërfaqe totale prej 7950 m$^2$ tokë "arë" në 6 parcela.
Kopje ku ka të regjistruar sipërfaqe totale prej 6450 m$^2$ tokë "arë" në 4 parcela është e konfirmuar me vulë të njomë dhe nënshkrim origjinal.
2. Dy kopje të AMTP nr. 145, datë 10.10.1992 të dyja me shumën totale prej 7950 m$^2$ "arë", por në një kopje ka shënimin: Nuk konfirmohet pasuria me nr. 1 dhe numër 5 dhe 6, nënshkruar nga Drejtori i DAMT Këshilli i Qarkut Tiranë.
Reshti i 6 përmban parcelën nr. 156 me emërtimin popullor "Radiostacioni" për 1500 m$^2$ tokë "arë".
- ***Konkluzioni:***
Nuk ka sqarime e saktësime për gjendjen faktike dhe dokumentare të pozicionimit të parcelës nr. 156 me emërtimin popullor "Radiostacioni" për 1500 m$^2$ tokë "arë". Veprime në kundërshtim me VKM nr.1174, datë 24.12.2020, "Për procedurat e regjistrimit të amtp-ve, saktësimin e kufijve e sipërfaqeve, si dhe normat për sipërfaqet shtetërore shtesë e pronat shërbyes" dhe ngarkojnë me përgjegjësi: A S Specialist dhe Përgjegjës Zyre; B L Përgjegjëse Zyre dhe XH K Administrator.

**XXXVII. 2020-I K**
- Në relacionin nga Njësia Administrative Kashar me nr. 4423/1, datë 21.12.2020 drejtuar A Ç Drejtor i Përgjithshëm Bashkia Tiranë dhe për dijeni D K, përfaqësues me prokurë i familjes bujqësore I K, sqaron se: Pasuria nr. 242/ , pasqyruar në AMTP në reshtin e parë sipas plan rilevimit të paraqitur datë 09.04.2020 tokë e llojit "arë" me sipërfaqe 4500 m$^2$ ZK 3866, fshati Yzberisht, sipas përgjigjes së ASHK i korrespondon kartelës "shtet". Nënshkruar nga A S Specialist dhe Përgjegjës Zyre; B L Përgjegjëse Zyre dhe XH K Administrator.
-AMTP pa nr. datë 20.04.1994 për familjen bujqësore përfaqësuar I K , fshati Yzberisht i jep në pronësi tokë 5250 m$^2$, nga të cilat në reshtin nr. 1, Parcela nr. 242 për 4500 m$^2$ "arë" dhe në reshtin nr. 2, parcela nr. 271/20 për 750 m$^2$, "pemëtore".
- Në relacionin nga Njësia Administrative Kashar me nr. 369, datë 26.01.2021 drejtuar A Ç Drejtor i Përgjithshëm Bashkia Tiranë dhe për dijeni I K , përfaqësues me prokurë i familjes bujqësore I K , sqaron se: sa i përket konstatimit tuaj se bazuar në hartën 1:5000, pasuria rezulton "PF", sqarojmë se bazuar në nenin 7 të ligjit nr. 20/2020 "Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë" toka për të cilën është lëshuar AMTP nuk ka qënë "truall, "vepër e infrastrukturës publike", "rërë bregdetare", "plazh", ose "sipërfaqe ujore". Për më tepër sipas shkresës së ASHK zëri kadastral i pasurisë është tokë "arë". Nënshkruar nga B L Përgjegjëse Zyre dhe XH K Administrator.
- Drejtoria e Administrimit të NJA-ve dhe AMTP-ve Bashkia Tiranë me nr. 643/2, datë 28.01.2021 drejtuar DV ASHK Tirana Rurale 2, për dijeni XH K Kryetar i Njësisë Administrative Kashar ka cituar shkresën e Njësisë Administrative Kashar me nr. 369, datë 26.01.2021 rezulton se: Referuar VKM nr. 556, AMTP-ja pa nr. Akti dhe pa datë lëshimi në emër të z. I K është e pa arkivuar në arkivën e ASHK Tiranë; Pasuria nr. 241, sipas planit të rilevimit prek pasurinë me nr. 241/3, sipas kartelës së pasurisë, lloji i pasurisë pemëtore-truall dhe pasuria 242/29 lloji i pasurisë "arë" sipas hartës 1:5000 prek pasurinë "PF".
-Në dosje administrohet ZK 3866 edhe Certifikata e Pasurisë me nr. 241/14 llojit "pemëtore" për 4500 m$^2$.

- ***Konkluzioni:***
Në relacionet cituar më sipër të Njësisë Administrative (cituar edhe nga Bashkia Tiranë) nuk ka sqarime e saktësime për gjendjen faktike të pozicionimit dhe llojit të tokës të parcelës nr. 241-242, ka qëndrime të ndryshme për llojin e tokës dhe nuk janë plotësuar kërkesat: e ligjit nr. 20/2020, datë 03.05.2020, datë 05.03.2020 në nenin 7 ku përcaktohet:

*1. Akti i marrjes së tokës në pronësi, i përfituar përpara hyrjes në fuqi të këtij ligji, i paregjistruar në regjistrin e pasurive të paluajtshme, nuk i nënshtrohet verifikimit të vlefshmërisë nga ASHKja. Ai regjistrohet në regjistrin e pasurive të paluajtshme nëse plotësohen njëkohësisht kriteret e mëposhtme: a) përfituesi i AMTP-së ka qenë i legjitimuar për të përfituar tokë sipas akteve ligjore e nënligjore për ndarjen e tokës bujqësore ose, edhe nëse nuk ka qenë i legjitimuar, ka përfituar tokën, për të cilën i është hequr pronësia atij apo trashëgimlënësit gjatë krijimit të ish-kooperativës apo ish-ndërmarrjes bujqësore; b) përfituesi i AMTP-së ka marrë tokë në territorin e vetëm një ish-kooperative ose ishndërmarrjeje bujqësore; c) toka për të cilën është lëshuar AMTP-ja nuk ka qenë "truall", "vepër e infrastrukturës publike", "rërë bregdetare", "plazh" ose "sipërfaqe ujore", në kohën e lëshimit të aktit. 2. Për AMTP-të që plotësojnë kriteret e pikës 1, të këtij neni, kur kanë mangësi në elementet e formës, mungesa e këtyre elementeve nuk pengon regjistrimin, me kusht që nga dokumentacioni i procesit të ndarjes së tokës bujqësore, që ASHK-ja administron, sipas pikës 6, të nenit 68, të këtij ligji, ose që paraqet subjekti si provë, vërtetohet se subjektit i është dhënë tokë në pronësi.*

Kërkesat: VKM nr.1174, datë 24.12.2020 "Për procedurat e regjistrimit të AMTP-ve, saktësimin e kufijve e sipërfaqeve, si dhe normat për sipërfaqet shtetërore shtesë e pronat shërbyes" - Kreu II "Regjistrimi i AMTP-ve të lëshuara përpara hyrjes në fuqi të ligjit nr.20/2020, "Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë" dhe ngarkojnë me përgjegjësi: B L Përgjegjëse Zyre dhe XH K Administrator.

**XXXVIII. 2020-G S**
- Në relacionin nga Njësia Administrative Kashar me nr. 3205/1, datë 30.10.2020 drejtuar A C Drejtor i Përgjithshëm Bashkia Tiranë dhe për dijeni Servete Sorra, përfaqësues me prokurë i familjes bujqësore G S , sqaron se: Pasuria nr. 125/ , me emrin popullor "lumth" pasqyruar në AMTP në reshtin e 3 me sip. 2700 m$^2$ sipas Vërtetimit të ish-Kryetarit të ndarjes së tokës , ish-Përfaqësuesi i Rrethit dhe planit të rilevimit datë 28.07.2020, tokë lloji "arrë" me sipërfaqe faktike në terren i korrespondon pasurisë nr. 126/ me sipërfaqe 1000 m$^2$ dhe pasurisë nr. 225/3 me sipërfaqe 1700 m$^2$ ZK 2105 fshati Kashar. Nënshkruar nga B L Përgjegjëse Zyre dhe XH K Administrator.

- Drejtoria e Administrimit të NJA-ve dhe AMTP-ve Bashkia Tiranë me nr. 38054/1, datë 11.11.2020 drejtuar DV ASHK Tirana Rurale 2, për dijeni XH K Kryetar i Njësisë Administrative Kashar ka cituar shkresën e Njësisë Administrative Kashar me nr. 38205/1, datë 30.10.2020 rezulton se: bazuar në dokumentacionin bashkëlidhur rezulton se:
-AMTP-ja është e pa arkivuar në ASHK në zbatim të VKM nr. 556, datë 23.10.2000,
-Gjithashtu mendojmë se është tejkaluar norma për fryme.
Për sa sipër në zbatim të ligjit nr. 111/2018 "Për kadastrën" është ASHK-ja që trajton kërkesat e verifikon dokumentacionin.
- ***Konkluzioni:***
Në përcaktimin e pozicionimit të pasurisë nr. 225/3 në lidhje me hartën 1:5000, konstatojmë se kjo pasuri është pjesë e pasurisë nr. 225 e llojit jo tokë bujqësore, dhe për mos zbatim të VKM nr. 994, datë 9.12.2015 "Për procedurën e regjistrimit të akteve të marrjes së tokës në pronësi", dhe ngarkojnë me përgjegjësi:; B L Përgjegjëse Zyre dhe XH K Administrator.

**XXXIX. 2020-Q GJ** Në relacionin nga Njësia Administrative Kashar me nr. 531/1, datë 13.02.2020 drejtuar A D Drejtor i Përgjithshëm Bashkia Tiranë dhe për dijeni Q GJ , sqaron se: në vijim të kërkesës së z. Q GJ me nr. 531, datë 11.02.2020 ku kërkohet konfirmimi i AMTP me nr. 61, pa datë, e vitit 1992 në emër të përfaqësuesit Q GJ të familjes bujqësore, fshati Kus: Pasuria 535/3, 535/4, 598/3, 598/2, 597/8,138/7,133/2-2,138/4, sipas planit të rilevimit me sip. 14121 $m^2$, nga këto 8971 $m^2$ sip. tokë "Arë", 4550 $m^2$ "Pemëtore", 600 $m^2$ "Ullishte", 200 $m^2$ "Truall" në ZK 2344. Gjithashtu, në dosje gjendet edhe një tjetër AMTP, me nr. 61, pa datë, e vitit 1992 në emër të përfaqësuesit Q GJ të familjes bujqësore, fshati Kus: Pasuria 138/4, dokument i cili nuk sqaron pozicionin gjeografik dhe kufizimet.

- Bashkëlidhur me praktikën shkresore të citur më lart administrohet edhe dokumentacioni:
1.1-AMTP në pronësi nr. 61, pa datë, e vitit 1992 në emër të përfaqësuesit Q GJ të familjes bujqësore, fshati Kus: Pasuria 535/3, 535/4, 598/3, 598/2, 597/8,138/7,133/2-2,138/4, në të gjenden nënshkrimet e Komisionit të tokës dhe nënshkrimi i kadastrës për efekt njohje të pronarit Q GJ .
1.2.-AMTP në pronësi me nr. 61, pa datë, e vitit 1992 në emër të përfaqësuesit Q GJ të familjes bujqësore, fshati Kus: Pasuria 138/4, dokument i cili nuk sqaron pozicionin gjeografik dhe kufizimet, emër mbiemër i Kryetarit të tokës në fshat, pa nënshkrim, emër mbiemër dhe nënshkrimi i përfaqësuesit të rrethit dhe në krahun e majtë të dokumentit gjendet vetëm nënshkrimi Kadastra (pa emër, mbiemër dhe vulën përkatëse).
1.3.- Deklaratë noteriale, planet e rilevimit, deklaratë kufitarësh nënshkruar vetëm nga kryetari i fshatit Kus dhe praktikat shkresore me Nr 34389/3, datë 12.12.2018, Nr 34389/1, datë 01.10.2018, Nr 700/1, datë 17.09.2018, 718/1, datë 10.03.2020.
- ***Konkluzioni:***
Proçedura për regjistrimin e AMTP në pronësi, është procedurë e parregullt dhe me mangësi, sepse në dosje konstatohet problematika e ekzistencës së dy AMTP-ve në një familje bujqësore, të ndryshme me njëra tjetrën, e cila bie në kundërshtim me Ligjin nr.7501, datë 19.07.1991 "Për Tokën", ligjin nr. 9948, datë 7.7.2008, "Për shqyrtimin e vlefshmërisë ligjore të krijimit të titujve të pronësisë mbi tokën bujqësore"; VKM nr. 994, datë 9.12.2015 "Për procedurën e regjistrimit të akteve të marrjes së tokës në pronësi", dhe për këtë praktikë ngarkohet me përgjegjësi: A I Specialist; A S Përgjegjës Zyre, B L dhe Administrator Xh K.

**XL. 2020-XH SH** Në relacionin nga Njësia Administrative Kashar me nr. 1864/1, datë 14.01.2020 drejtuar A D Drejtor i Përgjithshëm Bashkia Tiranë dhe për dijeni XH SH , sqaron se: në vijim të kërkesës së z. XH SH me nr. 1864, datë 23.05.2019 ku kërkohet konfirmimi i AMTP e njehësuar me origjinalin, në emër të përfaqësuesit XH SH të familjes bujqësore, fshati Yrshek: Pasuria 193/16, sipas planit të rilevimit me sip. 3200 $m^2$, tokë e llojit "Arë". Në këtë AMTP konstatohet se Akti i Marrjes së Tokës në Pronësi në emër të XH SH , është pa datë dhe numër akti, pa firmat përkatëse dhe vulën e Kadastrës.
- Bashkëlidhur me praktikën shkresore të citur më lart administrohet edhe dokumentacioni:
1.1-AMTP në pronësi pa nr, datë akti në emër të përfaqësuesit XH SH të familjes bujqësore, fshati Yzberish Mëzes: Pasuria 193/16, në të gjenden nënshkrimet e Komisionit të tokës dhe nënshkrimi i kadastrës për efekt njohje të pronarit.
1.2.-Procedura shkresore nr. 1864/1, datë 14.01.2020 drejtuar Bashkisë Tiranë, kërkesa e z. XH SH , çertifikatat e përbërjes familjare, formulari nr.6 dhe planet e rilevimit të dorëzuar nga vet qytetari.
1.3.- Plani i Rilevimit hartuar nga ing Gj.L. dhe nënshkruar nga Administratori XH K, Kryetari i fshatit Yrshek Z N dhe kryetari i fshatit Yzberish.
- ***Konkluzioni:***
Në relacionin sqarues të njësisë Administrative Kashar, nuk ka të sqaruar diferencën e pozicionimit duke e krahasuar me planin e rilevimit në raport me ortofoton, për rrjedhojë

praktika për regjistrimin e AMTP në pronësi, është procedurë e parregullt dhe me mangësi, e cila bie në kundërshtim me Ligjin nr.7501, datë 19.07.1991 "Për Tokën", ligjin nr. 9948, datë 7.7.2008, "Për shqyrtimin e vlefshmërisë ligjore të krijimit të titujve të pronësisë mbi tokën bujqësore"; VKM nr. 994, datë 9.12.2015 "Për procedurën e regjistrimit të akteve të marrjes së tokës në pronësi". Për këtë praktikë ngarkohet me përgjegjësi: A I Specialist; A S Përgjegjës Zyre; B L dhe Administrator Xh K.

**XLI. 2020-Q L .** Në relacionin nga Njësia Administrative Kashar me nr. 14522/5, datë 03.09.2020 drejtuar A D Drejtor i Përgjithshëm Bashkia Tiranë dhe për dijeni Q L , sqaron se: në vijim të kërkesës së z. Q L me qëllim regjistrimin pranë ASHK-së të pasurisë me nr. 58/2, ZK 2625, me sip. 4130 m², bazuar në AMTP, në emër të përfaqësuesit të familjes bujqësore Q L , banor i fshatit Mazrek, njësia Administrative Kashar: Në këtë AMTP konstatohet se Akti i Marrjes së Tokës në Pronësi në emër të Q L , me nr. Akti 8, pa datë dhe vit, në rrjeshtin e 3 dhe në sipërfaqen e përgjitshme ka korrigjime të dukshme, me sip. 12740 $m^2$, nga këto 12540 $m^2$ sip.tokë "Arë", 200 $m^2$ "Truall" në ZK 2625.
- Bashkëlidhur me praktikën shkresore të citur më lart administrohet edhe dokumentacioni:
1.1-AMTP në pronësi me nr 8 Akti, pa datë dhe vit, në emër të përfaqësuesit Q L të familjes bujqësore, fshati Mazrek: Pasuria 1/4, 58/2, 80/13, në të gjenden nënshkrimet e Komisionit të tokës dhe pa nënshkrimin e kadastrës për efekt njohje të pronarit.
1.2.-Procedura shkresore nr. 1069/7, datë 10.09.2020 drejtuar Bashkisë Tiranë, Rikthim dokumentacioni nga Bashkia Tiranë me Nr. 14522/5, datë 03.09.2020, shkresë nr. 1069/3, datë 10.06.2020, shkresë nr. 14522/1, datë 11.05.2020, shkresë nr. 14522/7, datë 14.10.2020, shkresë nr. 1069/1, datë 04.05.2020, kërkesa e z. S L (i biri), çertifikatat e përbërjes familjare, formulari nr.6 i cili ka korrigjime të dukshme, në kollonën me nr. 33, dhe planet e rilevimit të dorëzuar nga vet qytetari.
1.3.- Plani i Rilevimit hartuar nga ing E V dhe nënshkruar nga Kryetari i fshatit.
- ***Konkluzioni:***
Në relacionin sqarues të njësisë Administrative Kashar, relacioni bie në kundërshtim me planet e rilevimit. Në dy aktet konstatohet se AMTP-ja dhe formulari nr.6, kanë korrigjime të dukshme dhe për rrjedhojë, praktika nuk është verifikuar plotësisht dhe rezulton se procedura është e parregullt dhe me mangësi, e cila bie në kundërshtim me Ligjin nr.7501, datë 19.07.1991 "Për Tokën", ligjin nr. 9948, datë 7.7.2008, "Për shqyrtimin e vlefshmërisë ligjore të krijimit të titujve të pronësisë mbi tokën bujqësore"; VKM nr. 994, datë 9.12.2015 "Për procedurën e regjistrimit të akteve të marrjes së tokës në pronësi". Për këtë praktikë ngarkohet me përgjegjësi: A S Specialist; B L përgjegjës i ZMMT dhe Administrator Xh K.
Për shkeljet e konstatuara ngarkohen me përgjegjësi:
I H, XH H dhe F K Kryetarë të Komisioneve të Tokës në Fshat .
A S ish-Kryetari i Komunës F SH Specialist A I Specialist, B L ish-Përgjegjëse Zyre, A S Përgjegjës Zyre, E C ish-Administrator dhe XH K ish-Administrator.

**III.2.B NJËSIA ADMINISTRATIVE VAQARR**

**Mbi verifikimin e procedurave të ndjekura për verifikimin e saktësisë së lëshimit të AMTP-ve, dhe konfirmimin e saktësisë të AMTP-ve dhe pozicionimit të planvendosjeve të tyre, për regjistrimin në ASHK.**
Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion rezultoi se, Komuna Vaqarr sot Njësia Administrative Vaqarr, Bashkia Tiranë si pjesë e ish Kooperativës Bujqësore dhe ish Ndërmarrjes Bujqësore ka ndarë tokë sipas ligjit nr. 7501 "Për Tokën" për familje të cilët kanë qenë banorë të ish Kooperativës me datë 01.08.1991 dhe të Ndërmarrjes bujqësore të dhënat në pasqyrën si më poshtë:

| Fshati | Sip. ne HA (are, pemëtore, vreshtë, ullishte) | Nr. Familjeve | Numri i banoreve 1991 | Norma e tokës Për fryme (dynym) | Sasia e tokës disponibel (HA) | Numri i familjeve te pajisur me tapi | Numri i familjeve pa toke |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| **Allgjate** | 220.52 | 38 | | | 78.37 | 38 | Ska |
| **Arbane** | 129.34 | 76 | | | 24.57 | 76 | "" |
| **Bultice** | 95.05 | 72 | | | "" | 72 | "" |
| **Damjan-fortuzaj** | 161.03 | 136 | | | 6.44 | 136 | "" |
| **Gropaj** | 118.28 | 82 | | | 20.29 | 82 | "" |
| **Lalm** | 96.87 | 201 | | | "" | 201 | "" |
| **Prush** | 266.18 | 169 | | | 10.94 | 169 | "" |
| **Vaqarr** | 163.56 | 300 | | | 5.57 | 300 | "" |
| **Vishaj** | 241.3 | 152 | | | 8.78 | 152 | "" |
| **Sharre** | 462.03 | 573 | | | "" | 573 | "" |
| **Kurore** | 303.4 | 55 | | | "" | 55 | "" |
| **Shuma** | **2257.56** | **1854** | | | **154.96** | **1854** | |

Ndarja e tokës është bërë nga komisionet e ndarjes së tokës për çdo fshat sipas numrit te frymëve të datës 01.08.1991 dhe normës mesatare për frymë pa marrë parasysh koeficientin për bonitetin e tokës, pjerrësisë apo sipërfaqen ne ujë apo mbi ujë dhe as koeficientet për punonjësit qe punonin në sektorin shtetëror.

Sipas korrespondencës me Këshillin e Qarkut Tirane nr. 2101/1 date 13.12.2022, Njësia Administrative Vaqarr deri me date 31.12.2022 ka shpërndare me AMTP gjithsejtë 2037 ha toke, nga kjo 1604 ha are, 220 ha pemëtore, 22 ha vresht, 172 ha ullishte.
Mbetet në dispozicion te Ministrisë Bujqësisë tokë:
- 178 ha pemëtore, e cila përdoret nga fermerët pa takse qiraje,
- toke bujqësore e zëne me ndërtime informale ne proces legalizimi sipërfaqja 66 ha.
- toke e pandare dhe e refuzuar nga ish- kooperativat dhe fermat bujqësore paraqitet 334 ha.
- toke e dhëne me qira 10 ha, ranë Njësisë Administrative nuk administrohet asnjë kontratë.

Përsa i përket normave për fryme në momentin e auditimit pranë Njësisë Administrative Vaqarr **nuk disponohet dokumentacion si dhe asnjë proces - verbal i mbajtur nga komisionet e ndarjes së tokës,** nuk disponohen të dhënat e numrit të banorëve përfituese të tokës gjendje datë 01.08.1991, veprime në kundërshtim me ligjin 7501 datë 19.7.1991 "Për tokën", me vendimin nr. 255 date 02.08.1991 "Për kriteret e ndarjes tokës bujqësorë", me neni 17 pika 1/1 i ligjit 9948, datë 07.07.2008 "Për Shqyrtimin e vlefshmërisë ligjore të krijimit të titujve të pronësisë mbi tokën bujqësore", të ndryshuar ku përcaktohet: "*Ngarkohet Kryetari i Komunës dhe Bashkisë që për rastet kur komisioni i ndarjes së tokës nuk ka plotësuar aktet e marrjes së tokës në pronësi në fshatrat e ish-Kooperativave bujqësore, ti plotësojnë ato për familjet bujqësore apo individët që janë subjekte ligjore të trajtimit me tokë bujqësore sipas ligjit nr. 7501 "Për tokën"*, UKM nr. 2 datë 13.01.2010 si dhe VKM nr. 222, datë 06.03.2013 "Për përcaktimin e procedurave të kryerjes së procesit të kalimit të tokës bujqësore të ish-ndërmarrjeve bujqësore të kalimit në pronësi të përfituesve". Ngarkojnë me përgjegjësi B XH , Përgjegjësi i ZAMT, A D , Përgjegjës Sektori dhe G M Administrator.

Njësia vendore Vaqarr **nuk disponon listën e sipërfaqeve te tokës tepër te kaluara "shtet" nga ASHK, sipas subjekteve private objekt i legalizimeve**, për diferencat midis sipërfaqeve te zaptuara me ato te miratuara me legalizim ***(pjesa zaptuar -pjesën legalizuar*)**. Kështu, tokat "shtet" kane mbetur në posedim dhe shfrytëzim në mënyrë të paligjshme nga subjektet private për një periudhë pa kufi kohor, të cilët i shfrytëzohen pa asnjë detyrim, taksë, qira për buxhetin**,**

çka tregon mos-menaxhim dhe mos-administrim te tyre si dhe mungese bashkëpunimi me ASHK.

Nga të dhënat e paraqitur nga Njësia Administrative Vaqarr për konfirmimin e AMTP për regjistrim dhe procedurën e ndjekur për plotësimin e dokumentacionit tekniko ligjorë dhe dërgimin e dosjeve në Drejtorinë e Përgjithshme të Objekteve në Bashkëpronësi, Administrimit të NJA-ve dhe Emergjencave Civile (DANJA-ve/AMTP-ve), Bashkia Tiranë, ku kjo e fundit pas verifikimit të mëtejshëm për dërgimin e tyre në ASHK Tiranë për regjistrim, kjo në zbatim të urdhrit të Kryetarit të Bashkisë Tiranë nr. 26474/1 datë 02.09.2016 "Për delegimin e kompetencave nga Bashkia Tiranë tek Njësitë Administrative nën administratimin territorial dhe administrativ të Bashkisë Tiranë për kryerjen e procedurave që lidhen me krijimin e titujve të rinj të pronësisë mbi tokën bujqësore dhe të procedurave që lidhen me shqyrtimin e vlefshmërisë tekniko-ligjore të titujve të pronësisë të krijuara, mbi tokën bujqësore të ish ndërmarrjeve bujqësore dhe ish kooperativave bujqësore" (i ndryshuar), në mbështetje në VKM-në nr. 994, datë 09.12.2015 "Për mënyrën e procedimit për pasuritë e paluajtshme, të fituara me Aktin e Marrjes të Tokës në Pronësi (AMTP), të nenit 9 të Ligjit nr. 9948, datë 7.7.2008, "Për shqyrtimin e vlefshmërisë ligjore të krijimit të titujve të pronësisë mbi tokën bujqësore", të ndryshuar të Ligjit nr. 171/2014, "Për përfundimin e procedurave ligjore të kalimit të tokës bujqësore të ish-ndërmarrjeve bujqësore në pronësi të përfituesve", i ndryshuar, si dhe të neneve 25 dhe 45 të ligjit 33/2012 datë 21.03.2012 "Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme" dhe ligji nr. 111/2018 "Për Kadastrën", *rezultoi si më poshtë*:

Njësia administrative Vaqarr për 4 vitet (2019-2022) ka korrespondence për çdo subjekt me Bashkinë dhe ASHK, ku disponohet dokumentacioni tekniko-ligjor dhe shkresat përkatëse.
Dokumentacioni është mbajtur sipas muajve dhe viteve ne dosje veçanta**,** ne vend qe te mbahej sipas subjekteve ne një dosje te veçante, ku te pasqyrohej gjithë procedura nga fillimi deri ne fund, me qellim qe te jepej qartësi ne zgjidhjen e problemeve pronësisë te subjekteve përfitues së tokës bujqësore në përputhje e zbatim të lifjit nr 7501 "Për tokën".
**a.** Njësia administrative Vaqarr sipas evidencave, paraqet **93 korrespondenca me Bashkinë** Tirane, për 4 vitet 2019-2021, sipas viteve, sa vijon:
- për vitin 2019 paraqet 39 praktika, për vitin 2020 paraqet 42 praktika, për vitin 2021 paraqet 12 praktika, për vitin 2022 paraqet praktika,
**b.** Njësia administrative Vaqarr sipas evidencave, paraqet **277 korrespondenca me ASHK** Tirane, për 4 vitet 2019-2022, sipas viteve, sa vijon: për vitin 2019 paraqet 117 praktika, për vitin 2020 paraqet 68 praktika, për vitin 2021 paraqet 66 praktika, për vitin 2022 paraqet 26 praktika.
***Për vitin 2019,*** nga Njësia Administrative Vaqarr janë plotësuar dhe ka dërguar drejt Drejtoria e Përgjithshme e Objekteve në Bashkëpronësi, Administrimit të NJA-ve dhe Emergjencave Civile (DANJ-ve/AMTP-ve), Bashkia Tiranë për **39 persona** të cilët kanë kërkuar për regjistrim të AMTP në ASHK.
***Për vitin 2020,*** nga Njësia Administrative Vaqarr janë plotësuar dhe ka dërguar drejt Drejtoria e Përgjithshme e Objekteve në Bashkëpronësi, Administrimit të NJA-ve dhe Emergjencave Civile (DANJ-ve/AMTP-ve), Bashkia Tiranë për **42 persona** të cilët kanë kërkuar për regjistrim të AMTP në ASHK.

***Për vitin 2021,*** nga Njësia Administrative Vaqarr janë plotësuar dhe ka dërguar drejt Drejtoria e Përgjithshme e Objekteve në Bashkëpronësi, Administrimit të NJA-ve dhe Emergjencave Civile (DANJ-ve/AMTP-ve), Bashkia Tiranë për **12 persona** të cilët kanë kërkuar për regjistrim të AMTP në ASHK.

***Për vitin 2019*** Për dosjet e plotësuara me dokumentacionin e nevojshëm tekniko ligjorë dhe relacion shpjegues hartuar nga Njësia Administrative Vaqarr dhe të dërguara në ASHK për

konfirmim e regjistrim, për **117 persona** të cilët kanë kërkuar për regjistrim të AMTP në ASHK.

***Për vitin 2020***Për dosjet e plotësuara me dokumentacionin e nevojshëm tekniko ligjorë dhe relacion shpjegues hartuar nga Njësia Administrative Vaqarr dhe të dërguara në ASHK për konfirmim e regjistrim, për **68 persona e subjekte** të cilët kanë kërkuar për regjistrim të AMTP në ASHK.

***Për vitin 2021*** Për dosjet e plotësuara me dokumentacionin e nevojshëm tekniko ligjorë dhe relacion shpjegues hartuar nga Njësia Administrative Vaqarr dhe të dërguara në ASHK për konfirmim e regjistrim, për **66 persona** të cilët kanë kërkuar për regjistrim të AMTP në ASHK.

***-Titulli i gjetjes:***
Problematikat e konstatuara në korrespondencën me Bashkinë Tiranë dhe dërgimin e AMTP për regjistrim në ASHK.
***Situata:***
**- Në 5 raste,** rezulton se janë regjistruar në ASHK gjithsej 214 m$^2$ "truall" mbi normën mesatare prej 300 m$^2$ troje kjo e rezultuar nga rakordimi i listës të troje nr. 001 ZK 3321 administruar në ASHK me listën të troje nr. 001 ZK 3321 fshati " Sharrë" administruar në Njësinë Administrative Vaqarr.
**- Në 1 rast,** rezulton se pasuria nr. 301/4, ZK 3321, vol 1, faqe 26, me sipërfaqe 3200 m$^2$ aktualish pasuria mbi të cilën është lanfildi, rezulton e pa regjistruar megjithëse ka një korrespondencë të përsëritur midis NJA dhe ASHK dhe referuar AMTP nr. 41; LN dhe formularit nr. 6 është e llojit " arrë" ; "Vresht" dhe "Grope silazhi".
**- Në 2 raste,** rezulton se Komisioni i Ndarjes Tokës ka dhënë tokë të fshatit Vishaj dhe Damjan jashtë kufirit të fshatit Arbanë dhe ky veprim nuk është pasqyruar në relacionin shpjegues nr. 807, datë 25.03.2021, për regjistrimin e pasurive konkretisht sipas AMTP 71, pasuria 60/1 për 17000 m$^2$ dhe AMTP nr. 31 date 15.03.1993 për 11924 m$^2$, ZK 1315.
**- Në 1 rast,** rezulton se Njësia Administrative Vaqarr nuk ka zgjidhur kërkesën për saktësim nga DV ASHK Tirana Rurale 2 për azhurnimi hartës për gjendjen faktike në terren dhe pozicionin pasurive, tërheqjen e deklaratave noteriale të kufitarëve në ZK 2119 dhe ne ZK 2105.
**- Në 2 raste,** rezulton se ka vonesë mbi 10 vjet në korrespondencë Njësia administrative me ASHK për regjistrimin e pasurive sipas AMTP 45 date 19.05.1992, ZK 1017, Allgjate, Vaqarr dhe veprim të gabuar në kthimin e përgjigjes për pasurinë nr. 73/, ne vend te pasurisë nr. 83/14, ZK 1867, sipërfaqe 1000 m$^2$, vol 3, faqe 63, fshati Gropaj
**- Në 1 rast** nuk ka sqarime për plan rilevimin e datës 23.10.2020 mbi përfshirjen e kanalit si pasuri publike në pasurinë e regjistruar me nr. 76/48, vol 3, faqe 83, sipërfaqe 3900 m$^2$ (1100 m$^2$ ndërtesa), ZK 1867, fshati Gropaj megjithëse nuk është përfshirë në AMTP që është bazë e regjistrimit të kësaj pasurie.
- **Ne 7 raste,** paraqitet moszbatim te afateve ligjore deri 1 vit, lidhur me korrespondencën për kthimin e përgjigjeve ndaj kërkesave dhe ri-kërkesave te ASHK dhe anasjelltas për Njësinë Vaqarr, nuk ka shpjegime ligjore për vonesën e përgjigjes. Si dhe nuk është plotësuar dokumentacioni ligjor i kërkuar nga DV ASHK Tirana Rurale.
**- Ne 14 raste**, dosjet e subjekteve kane mangësi dhe parregullsi ne dokumentacionin tekniko-ligjor, konkretisht: Në 2 raste, mungon HTR dhe formulari nr. 6; në 4 raste, mungon plan rilevimi ose janë te parregullta; në 3 raste, mungon dokumentacioni për argumentimin e diferencës sipërfaqes midis AMTP dhe vërtetimit pagesës taksave vendore, pasi pasqyrojnë sipërfaqe te ndryshme, çka tregon mos-rakordim me ASHK (për shitjet dhe transaksionet e pronës); në 1 rast, nuk përputhet AMTP date 10.08.1993 me formularin nr. 6; në 3 raste, deklaratat e kufitareve janë pranuar të parregullta, pasi janë pa date, pa numër, me korrigjime, mungojnë firmat e kufitareve, identiteti i kufitarit nuk është i sakte; në 1 rast, nuk përputhen kufitaret, midis deklaratës kufitareve dhe AMTP, për 1 pasuri, pasi sipas deklaratës ne perëndim

ajo kufizohet me "shtet", në fakt sipas AMTP kjo pasuri ne perëndim kufizohet nga kufitar privat dhe jo shtet; në të gjitha rastet nuk disponohet vendimi ne njësinë vendore Vaqarr për normën për fryme, për rrjedhoje nuk argumentohet norma për fryme.

**- Në 7 raste,** relacionet shpjeguese nuk janë analitikë duke u trajtuar ne hollësi çdo mangësi dhe problematike përkatëse, paraqiten te pjesshëm në saktësimin e pasurive tokës bujqësore përfituar me AMTP, sipas kërkesës se ASHK, Bashkisë dhe subjektit, përkatësisht: Në 1 rast, relacioni sqaron një pasuri te AMTP, ndërsa nuk flet për pasuritë tjera te AMTP; në 2 raste, relacionin nuk sqaron mospërputhjen e AMTP-se me formularin nr. 6, pasi këta 2 dokumente pasqyrojnë numër dhe sipërfaqe te ndryshme te pasurive tokës bujqësore (AMTP përmban 1 pasuri, ndërsa formulari 6 përmban 3 pasuri); në 3 raste, relacioni nuk shpjegon pajisjen me 3 AMTP të familjes pandara nga trungu 1991, ne vend te 1 AMTP, nuk sqarohet sipërfaqja totale e marre sipas normës për frymë, nëse ka efekte; në 1 rast, relacioni shpjegues nuk sqaron dhënien e tokës me 2 standarde, pasi 2 familje me numër te njëjtë frymësh disponojnë sipërfaqe te ndryshme për te njëjtën ZK; në 2 raste, paraqitet mos-rakordim midis KPP dhe AMTP, madje KPP pasqyron emër tjetër.

**-Në 3 raste** në relacionin shpjegues nuk ka referime e përcaktime për pozicionimin e pasurisë konkretisht: - Pasuria me nr. 135, vol 1, faqe 150 ZK 3712 adresë Vaqarr lloji "kullotë" sipërfaqe 9140 m$^2$ pronësi "Shtet"; - Pasuria me nr. 52/36/1, vol 2, faqe 3 ZK 1867 adresë Gropaj lloji "truall" sipërfaqe 400 m$^2$ sipas akti dhe 600 m$^2$ ndërtesë 140 m$^2$; - Pasuria nr. 76/1, vol __, faqe __ ZK 3784 adresë Vishaj lloji "arrë" sipërfaqe 3220 m$^2$ që sipas akti rezulton e pa afishuar.

**- Në 2 raste** Nuk ka sqarime për ndryshimet e sipërfaqeve të pasurive dhe ndarjen e parcelave sipas regjistrimit fillestar konkretisht: - Pasuria nr. 294/6, vol. 2, faqe 53 në pronësi të XH L me sip. 4500 m$^2$ e llojit "arrë" dhe Pasuria nr. 339/3, vol. 2, faqe 54 në pronësi të XH L me sip. 2000 m$^2$ e llojit "arrë"; -për pasurinë nr. 46/12, Vol 9, faqe 121 ZK 3321 me sipërfaqe 2094 m$^2$. Veprime në kundërshtim me VKM nr. 994, datë 9.12.2015 "Për procedurën e regjistrimit të akteve të marrjes së tokës në pronësi"; me Ligjin nr. 20/2020, datë 03.05.2020 "Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë"; si dhe VKM nr. 1174, datë 24.12.2020 "Për procedurat e regjistrimit të AMTP-ve, saktësimin e kufijve e sipërfaqeve, si dhe normat për sipërfaqet shtetërore shtesë e pronat shërbyese".

***Kriteri:***

Në kundërshtim me urdhrin e Kryetarit të Bashkisë Tiranë nr. 26474/1, datë 02.07.2016 "Për delegimin e kompetencave nga Bashkia Tiranë tek Njësitë Administrative nën administrativin territorial dhe administrativ të Bashkisë Tiranë për kryerjen e procedurave që lidhen me krijimin e titujve të rinj të pronësisë mbi tokën bujqësore dhe të procedurave që lidhen me shqyrtimin e vlefshmërisë tekniko-ligjore të titujve të pronësisë të krijuara, mbi tokën bujqësore të ish ndërmarrjeve bujqësore dhe ish kooperativave bujqësore"; me VKM nr. 782, datë 7.10.2020 "Për miratimin e modeleve të akteve kadastrale dhe të dhënave në përmbajtje të hartës kadastrale"; me ligjin nr. 7501, datë 19.7.1991, "Për tokën", i ndryshuar; ligjin nr. 8053, datë 21.12.1995, "Për kalimin në pronësi, pa shpërblim, të tokës bujqësore", i ndryshuar; ligjin nr. 9948, datë 7.7.2008, "Për shqyrtimin e vlefshmërisë ligjore të krijimit të titujve të pronësisë mbi tokën bujqësore", i ndryshuar me ligjin nr. 171/2014, "Për përfundimin e procedurave ligjore të kalimit të tokës bujqësore të ish-ndërmarrjeve bujqësore në pronësi të përfituesve", i ndryshuar, si dhe Urdhrin nr. 39203/1, datë 17.10.2019 "Për një shtesë në Urdhrin nr, 26474/1, datë 02.09.2016 të Kryetarit të Bashkisë "Për delegim kompetencave nga Bashkia Tiranë tek Njësitë Administrative të Bashkisë Tiranë".

***Ndikimi/Efekti:***

Parregullsia në dokumentacionin shoqërues të AMTP për regjistrim në kundërshtim me akte ligjore.

***Shkaku:***

Mos zbatimi i kuadrit ligjorë nga personat përgjegjës

***Rëndësia:*** e lartë
***Rekomandim:***
Njësia Administrative Vaqarr Bashkia Tiranë në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme e Objekteve në Bashkëpronësi, Administrimit të NJA-ve dhe Emergjencave Civile (DANJ-ve/AMTP-ve), Bashkia Tiranë, të mos përcjell AMTP-të për regjistrim, në Drejtorinë Vendore të ASHK Rurale 2, pa shqyrtuar vlefshmërinë tekniko-ligjore të titullit të pronësisë të krijuar mbi tokën bujqësore (AMTP-së), pa verifikuar dhe shqyrtuar dokumentacionin kadastral që disponon Njësia Administrative Vaqarr.

**<u>Praktikat me parregullsi në dokumentacion</u>.**
**I. Korrespondenca Njësia Vaqarr - Bashki Tirane – ASHK - Subjekt,** lidhur me praktiken për AMTP nr. 7 date 30.07.1992, **XH A** , Vaqarr, fshati Vishaj, paraqet këto dokumente:
- Shkresa nr. 188 date 15.01.2021 e njësisë administrative Vaqarr dërguar ne adrese te Bashkisë Tirane për konfirmim.
- Relacion shpjegues date 15.01.2021 i njësisë administrative Vaqarr dërguar ne adrese te Bashkisë Tirane (Drejtorisë juridike dhe aseteve) për saktësimin e numrit te 8 pasurive tokës bujqësore përfituar me AMTP 7 date 30.07.1992, sipas kërkesës se subjektit.
- **S**hkresa e ASHK Rurale 2 e vitit 2020 për kopjen e AMTP 7 date 30.07.1992 dhe formularin nr. 6, për 8 pasuritë, sipërfaqet e te cilave përputhen midis AMTP dhe Formularit**.**
- Plan rilevime date 04.10.2020 gjithsejtë 8 cope, hartuar nga topograf i licencuar i nënshkruar dhe nga njësia vendore Vaqarr dhe kryeplaku fshatit Vishaj, për saktësimin e sipërfaqeve dhe kufitareve te 8 pasurive përkatëse, sipas AMTP 7, ku nuk rezultojnë diferenca, përkatësisht pasuritë nr. 106/6=600 m2 are, nr. 106/4=550 m2 are, nr. 174 =4295 m2 are, nr. 53 =2860 m2 are, nr. 175=1000 m2 are, nr. 175/1=7128 m2 are, nr. 54/12=3000 m2 are dhe nr. 108/2=405 m2 are, gjithsejtë 20,148 m2. Planrilevimet përcaktohen me vijëzim me ngjyre të kuqe pozicionin gjeografik të pasurive, në papajtueshmëri me pikën 10.6, Kreu i II, të Rregullores nr. 184, datë 08.04.1999 "*Për punën e zyrës së regjistrimit të pasurive të paluajtshme*", të ndryshuar.
- Certifikate e përbërjes familjare te përfituesit te AMTP prej 7 veta me 01.08.1991.
- Vërtetim i taksave vendore te bashkisë Tirane 8734/1 date 30.10.2020 për shlyerjen e taksave vendore nga subjekti.
- **S**hkresa e ASHK Rurale 2 e vitit 2020 për sqarimin e subjektit, i cili kishte kërkuar informacion hipotekës për pasuritë e tij, sipas kërkesës tij nr. 23209 date 14.10.2020. Shkresa ka bashkëngjitur kopjet e KPP dhe plan rilevimet e pasurive ne fjale.
*Përfundimisht,* praktika për AMTP nr. 7 date 30.07.1992 ne emër te XH A , Vaqarr, fshati Vishaj, nuk paraqet probleme, pasi është e plote për ASHK.

**II. Korrespondenca Njësia Vaqarr - Bashkia Tirane – ASHK - Subjekt,** lidhur me praktiken për AMTP nr. 32 date 25.01.2000, **Z L** , Njësia Vaqarr, paraqet këto dokumente:
- Shkresa nr. 242 date 21.01.2021 e njësisë administrative Vaqarr dërguar ne adrese te Bashkisë Tirane (zyrës juridike dhe aseteve) për konfirmim.
- **Mungon plan vendosja e 3 pasurive**, kërkese kjo e VKM nr. 994 date 09.12.2015 "*Për procedurën e regjistrimit te akteve te marrjes se tokës ne pronësi*", pika 3/1, b.
- Relacion shpjegues date 21.01.2021 i njësisë administrative Vaqarr dërguar ne adrese te Bashkisë Tirane (*Drejtorisë juridike dhe aseteve*) për saktësimin e pasurisë 323 ne vend te pasurisë me numër 340/2 tokës bujqësore 1600 m2 are, përfituar me AMTP nr. 32 date 25.01.2000, sipas kërkesës se subjektit. Pra pasuria 323 është e njëjte me pasurinë 340/2.
**Relacion shpjegues date 21.01.2021 i njësisë administrative Vaqarr, paraqet këto mangësi:**
*** *nuk ka shpjeguar normën për fryme,*** sipas AMTP 32, ne zbatim te ligjit 7501 date 19.07.1991 *"Për token"* ndryshuar nr. 8053 date 21.12.1995 "*Për kalimin ne pronësi pa*

*shpërblim tokës bujqësore"* dhe VKM 452 date 17.10.1992 "*Për ristrukturimin e Ndërmarrjeve shtetërore*".
* ***Nuk flet për 2 pasuritë tjera te pasqyruara ne AMTP 32, përkatësisht pasuria nr. 320 për 4600 m2 dhe nr. 313 për 900 m2***, përjashtuar 1 pasuri (323 saktësuar 340/2 për 1600 m2).
Relacion shpjegues date 21.01.2021 i njësisë administrative Vaqarr është nënshkruar nga Kryetari, P/zyrës kadastrës, P/ sektori, topografi, specialisti ZAMT.
* **AMTP 32 date 25.01.2000 nuk ka asnjë vule,** ne kundërshtim me VKM nr. 994 date 09.12.2015 "*Për procedurën e regjistrimit te akteve te marrjes se tokës ne pronësi"*, pika 1/ ç. Kjo AMTP është mjaftuar vetëm me firma e marrësit tokës dhe 1 anëtar komisionit tokës ( përfaqësuesi i rrethit).
- Certifikata familjare e përfituesit me date 01.08.1991 përbëhet nga 11 anëtare, ku kane përfituar 3 pasuri ( *4600 m2 +1600 m2+ 900 m2*) gjithsej 7100 m2 are, sipas AMTP 32 date 25.01.2000**,** çka nuk justifikon normën për fryme, madje mungon vendimi për miratimin e normës për fryme, fenomen edhe për rastet tjera.
***AMTP 32 date 25.01.2000 nuk ka nënshkrimin e kryetari i komisionit të ndarjes së tokës dhe as te kryetarit njësisë vendore**, kërkesë kjo e VKM nr. 994 date 09.12.2015 "*Për procedurën e regjistrimit te akteve te marrjes se tokës ne pronësi"*, pika 1/ b, me ligjin nr. 9948 date 07.07.2008, nr. 57/2012, nr. 171/2014, me shkronjën "a" neni 25, të ligjit 33, datë 21.03.2012 "*Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme",* me ligjin 9948, datë 07.07.2008 "*Për Shqyrtimin e vlefshmërisë ligjore të krijimit të titujve të pronësisë mbi tokën bujqësore"*, të ndryshuar, me shkronjën "b" pika 1, të UKM 2, datë 13.06.2013 "*Për mënyrën e procedimit të organeve të administratës publike, për pasuritë e paluajtshme, të fituara me AMTP"*, me shkronjën "a" pika 1, të UKM. 2, datë 13.01.2010.
- Formulari nr. 6 pasqyron 3 pasuri, përkatësisht: pasuria 320 për 4600 m2, pasuria 323 për 1600 m2 dhe pasuria 313 për 900 m2 ose gjithsej 7100 m2 are, e cila përputhet me AMTP 32 date 25.01.2000.
**-** Plan rilevimi date 23.11.2020 për pasurinë 340/2 për 1600 m2 are, hartuar nga topograf i licencuar i nënshkruar dhe nga njësia vendore Vaqarr dhe kryeplaku fshatit Sharre, për saktësimin e sipërfaqes sipas AMTP, ku nuk rezultojnë diferenca, *Plan rilevimet përcaktohen me vijëzim me ngjyre të kuqe pozicionin gjeografik të pasurisë, në papajtueshmëri me pikën 10.6, Kreu i II, të Rregullores nr. 184, datë 08.04.1999 "Për punën e zyrës së regjistrimit të pasurive të paluajtshme", të ndryshuar*.
- Deklarata kufitarësh 2020, nënshkruar nga kryeplaku fshatit Sharre.
- Vërtetim i taksave vendore te bashkisë Tirane 4096/1 date 19.06.2020 për shlyerjen e taksave vendore për sipërfaqen 7100 m2 për vitin 2020 nga subjekti.
**- S**hkresa e ASHK Rurale 2 e vitit 2020 për sqarimin e subjektit, lidhur me dëshminë e trashëgimisë për 3 pasuritë e tij, sipas kërkesës trashëgimtareve tjerë.
- Prokure e trashëgimisë noteriale date 19.02.2020.
- Kopja e KPP për regjistrimin e pasurisë 340/2, sipërfaqe 1600 m2 are, ne emër Z L, ZK Sharre, vol 2, faqe 48.

**III. Korrespondenca Njësia Vaqarr - Bashkia Tirane – ASHK - Subjekt,** lidhur me praktiken për AMTP nr. 173 date 20.06.1992, Lalm, Vaqarr, **K K** , Vaqarr, paraqet këto dokumente:
**- AMTP 173 date 20.06.1992 nuk ka asnjë vule, madje nuk ka firmën e përfituesit** K K t, ndryshe nga AMTP 143 date 17.05 2001 e te birit *( 4 pasuri me 4740 m2 are + 200 m2 truall për 4 fryme),* ne kundërshtim me VKM nr. 994 date 09.12.2015 "*Për procedurën e regjistrimit te akteve te marrjes se tokës ne pronësi"*, pika 1/ ç.
*- Plan rilevimi date 14.01.2021 për pasurinë 30/8/2 për 500 m2 are, hartuar nga topograf i licencuar i nënshkruar dhe nga njësia vendore Vaqarr dhe kryeplaku fshatit Lalm, për saktësimin e sipërfaqes sipas AMTP.*

*- Deklarata kufitarësh 2021, nënshkruar nga kryeplaku fshatit Lalm, Vaqarr.*
*- Certifikata familjare 26.01.2021 e subjektit me date 01.08.1991 përbëhet nga 4 anëtare, ku kane përfituar 3 pasuri ( 1760 m2 +500 m2+ 3250 + 200 m2 truall) gjithsej 5710 m2 are, sipas AMTP 173 date 20.06.1992*,.
*- Formulari nr. 6 pasqyron 4 pasuri bashke me truallin, e cila përputhet me AMTP 173.*
*- Vërtetim i taksave vendore te bashkisë Tirane 844/1 date 01.02.2021 për shlyerjen e taksave vendore për vitin 2020 nga subjekti.*
*- Shkresa nr. 641 date 04.03.2021 e njësisë administrative Vaqarr dërguar ne adrese te Bashkisë Tirane (zyrës juridike dhe aseteve) për konfirmim.*
**-- Shkresa e ASHK Rurale 2 date 06.01.2020 për sqarimin e subjektit për 3 pasuritë tjera bashke me truallin, sipas AMTP 173 dhe listës trojeve, ku citohet drejtohuni njësisë vendore, e cila kjo e fundit nuk disponon dokument sqarues.**
*- Relacion shpjegues date 04.03.2021 i njësisë administrative Vaqarr dërguar ne adrese te Bashkisë Tirane (Drejtorisë juridike dhe aseteve) për saktësimin e pasurisë 31 dhe 32, e cila është e njëjte me pasurinë me numër 30/8/2 tokës bujqësore 500 m2 are, përfituar me AMTP nr. 173 date 20.06.1992, sipas kërkesës se subjektit nr. 556 date 22.02.2021.*
Relacion shpjegues date 04.03.2021 i njësisë administrative Vaqarr, **paraqet këto mangësi:**
* **Relacioni nuk flet për 2 pasuritë tjera te pasqyruara ne AMTP 173** dhe ne formularin 6, **kërkese kjo edhe e subjektit** (kërkesa 33056 AV-O).
**Mungojnë 2 planrilevimet e pasurive nr. 135 për 3250 m2 dhe nr. 159 për 1760 m2.**
**Pasuria nr. 159 për 1760 m2** are pasqyrohet edhe tek AMTP 143 date 17.05 2001 *(i biri V K),* pra **e njëjta pasuri pasqyrohet ne 2 AMTP, ne vend te një AMTP.** Pra mungon **akt verifikimi ne terren** *(siç është bere tek H M),* kërkese kjo e VKM nr. 994 date 09.12.2015 "*Për procedurën e regjistrimit te akteve te marrjes se tokës ne pronësi"*, pika 3/1.b.
** Ne relacion nuk sqarohet plotësimi i normës për fryme, sipas 2 AMTP me sipërfaqe kryefamiljari disponon 5710 m2 dhe i biri disponon 4740 m2 toke.*

**IV. Korrespondenca Njësia Vaqarr -Bashkia Tirane –ASHK- Subjekt,** lidhur me praktiken për AMTP 64 date 15.09.1993, Arbane, Vaqarr, **F K** , paraqet këto dokumente:
*- Shkresa nr. 246 date 21.01.2021 e njësisë administrative Vaqarr dërguar ne adrese te Bashkisë Tirane (zyrës juridike dhe aseteve) për konfirmim.*
- Relacion shpjegues date 21.01.2021 i njësisë administrative Vaqarr ne adrese te Bashkisë Tirane (zyrës juridike dhe aseteve), ku citohet:
* pasuria 22 është e njëjtë me pasurinë 22/4 me sipërfaqe 2224 m2 are sipas AMTP 64, planrilevimit 2019, deklaratës kufitare 2019, shkresës kthim përgjigje date 28.05.2018 te ASHK Rurale 2.
Pasuria 22/4, vol 1, faqe 174, ZK 1032, Arbane, rezulton 2470 m2 are sipas LN 1995.
Për rrjedhoje **diferenca tepër 246 m2** (2470-2224), **sistemimi shtet i se cilës nuk dihet.**
Ndryshe ka ndodhur me praktiken SH A, e cila sqaron madje disponon dhe certifikatën pronësisë për kompensimin e diferencës mangët 3380 m2 are midis AMTP 34/2005 dhe azhornimit, pra paraqiten **2 standarde.**
* Certifikata e trungut familjar te subjektit me date 01.08.1991 përbëhet nga **11 anëtare**, por thuhet **ne fakt kane qene te ndare ne 3 familje, ku për 2 familjet e ndara nuk ka certifikata familjare me 01.08.1991, çka nuk justifikon dhënia e tokës 2 familjeve bija.**
Për pasoje **kane përfituar 3 AMTP për sipërfaqen totale rreth 21,400 m2 toke bashke me truallin, pasqyruar ne formulari nr. 6 dhe listën e trojeve për secilin**, konkretisht:
*a. AMTP nr. 64 date 15.09.1993 për 2 pasuri me sipërfaqe totale 10,200 m2 toke are pasuria bashke me 200 m2 truall, F K, e cila disponohet , sipas shkresës 24.11.2020 te ASHK Rurale 2.*
*b. AMTP nr. s,ka date s,ka për 2 pasuri me sipërfaqe totale 6,000 m2 toke are pasuria bashke me 250 m2 truall, R K. e cila AMTP nuk disponohet (por vetëm formulari 6 disponohet).*

*c. AMTP nr. s,ka date s,ka për 2 pasuri me sipërfaqe totale 5,200 m2 toke are pasuria bashke me 250 m2 truall, H K, e cila AMTP nuk disponohet(por vetëm formulari 6 disponohet).*

* Theksojmë se:

***relacionet shpjeguese janë ne përgjithësi te një maketi te njëjtë për çdo rast, ne vend qe te zbërtheheshin analitikisht duke u trajtuar ne hollësi çdo mangësi dhe problematike përkatëse...***

**Nuk disponohet vendimi ne njësinë vendore Vaqarr për normën për fryme**, për rrjedhoje nuk argumentohet norma për fryme.

Relacion shpjegues date 21.01.2021 i njësisë administrative Vaqarr është nënshkruar nga Administratori, P/ sektorit**,** topografi**,** specialisti ZAMT dhe P/zyrës kadastrës.

**V. Korrespondenca Njësia Vaqarr - Bashkia Tirane – ASHK - Subjekt,** lidhur me praktiken për AMTP nr. s,ka date 10.08.1993, Sharre, Vaqarr, **B V** , paraqet këto dokumente:

*- Shkresa nr. 640 date 04.03.2021 e njësisë administrative Vaqarr dërguar ne adrese te Bashkisë Tirane (zyrës juridike dhe aseteve) për konfirmim.*

*- Relacion shpjegues date 04.03.2021 i njësisë administrative Vaqarr ne adrese te Bashkisë Tirane (zyrës juridike dhe aseteve).*

*- Shkresa e ASHK Rurale 2 e vitit 2020 për sqarimin e subjektit, lidhur me pasurinë nr. 257/9, vol 1, faqe 235, ZK 3321, sipërfaqe 2500 m2 are sipas AMTP dhe 2400 m2 sipas LN dhe planrilevimit date 25.08.2020.*

*- AMTP nr. s,ka date 10.08.1993, fshati Sharre, Vaqarr***,** *ne emër B V , për 1 pasuri 216 me 2500 m2 ose sipas KPP nr. 257/9, vol 1, faqe 235, ZK 3321, sipërfaqe 2400 m2 are sipas LN.*

*-KPP për pasurinë nr. 257/9, ZK 3321, Sharre, vol 1, faqe 235, ZK 3321.*

*- HTR pasurisë 2400 m2 are me nr. 257/9, ZK 3321, Sharre, vol 1, faqe 235, ZK 3321.*

*- Plan rilevimi date 25.08.2020, për pasurinë nr. 257/9, ZK 3321, Sharre për 2400 m2,*

*- Deklarata kufitarësh 2020, nënshkruar nga kryeplaku fshatit Sharre.*

*- Vërtetim i taksave vendore te bashkisë Tirane 6547/1 date 26.08.2020 për shlyerjen e taksave vendore për sipërfaqen 2500 m2 për vitin 2020 nga subjekti.*

*- Certifikata familjare 27.08.2020 e subjektit me date 01.08.1991 përbëhet nga 11 anëtare,*

*- Formulari nr. 6 për subjektin me 3 pasuri me sipërfaqe totale 7500 m2 are dhe 7 rrënje ullinj, përkatësisht: pasuria 286 me 5000 m2 are, pasuria 215 me 2500 m2 are dhe 7 rrënje ullinj.*

***Konkluzion:***

**a. Nuk përputhet AMTP date 10.08.1993 me formularin nr. 6** ne emër B V , pasi AMTP përmban 1 pasuri nr. 215 me 2500 m2 are, ndërsa formulari nr. 6 përmban 3 pasuri si: nr. 286 me 5000 m2, nr. 215 me 2500 m2 are dhe 7 rrënje ullinj.

**b. Nuk argumentohet norma për fryme dhe dhënia e tokës familjeve paraqet 2 standarde,** pasi familja Kasemi me 11 anëtare ka marre 21000 m2 are, ndërsa familja Vrapi me 11 anëtare ka marre sipërfaqe totale 7500 m2 are dhe 7 rrënje ullinj, pra me një diference 13500 m2 midis tyre**.**

**Relacioni shpjegues date 21.01.2021 i njësisë nuk ka sqaruar 2 mangësitë e sipërcituara,**

**VI.** Korrespondenca Njësia Vaqarr-Bashkia Tirane–ASHK-Subjekt, lidhur me AMTP 51 date 15.09.1993 për **R C ,** rezulton:

**a.** Personit **nuk i takonte AMTP 51 date 15.09.993, pasi nuk ka qene i ndare ne vitin 1991** nga trungu familjar **(***8 anëtare trungu***)** me babain e tij k/familjar Q C, ku ky i fundit ka përfituar AMTP ne vete**.** Po kështu SH C (*vëllai i R C )* nuk i takonte AMTP ne vete, pasi nuk ka qene i ndare nga babai tij Q C. Për rrjedhoje**,**

**Familja C ka përfituar 3 AMTP ne vend te 1 AMTP,** për sipërfaqen totale 23,852 m2 toke sipas formularit nr. 6 *(9804m2 Rr + 4048 m2 Q + 10000 m2 Sh )* plus 300 m2 truall *(208 m2 ndërtesa,)* sipas listës trojeve në emër te Q C.

Ish-komisioni i ndarjes tokës bujqësorë ka vepruar me **2 standarde,** lidhur me dhënien e tokës me AMTP sipas normës për fryme, **për 2 familjet bujqësore te pandara 1991, pasi njëra ka përfituar toke me shume, ndërsa tjetra më pak, madje kjo e fundit paraqet më shume fryme, çka duhej te ndodhe e kundërta,** konkretisht:
- familja "C " me 8 anëtare është pajisur me 23852 m2 toke nëpërmjet 3 AMTP.
- familja "K " me 11 anëtare është pajisur me 21,400 m2 toke nëpërmjet 3 AMTP.

**b. Dokumentacioni paraqet mangësi dhe te meta,** konkretisht:
*** mungojnë 2 AMTP** e S dhe Q C.
*** njësia ne relacion nuk shpjegon diferencën e sipërfaqes prej 3798 m2, midis vërtetimit taksave vendore** date 22.05.2020 për **13852 m2 dhe AMTP 51 për 10054 m2.**
* **Mungon relacioni shpjegues pas datës 24.07.2020**, kërkesë kjo e bashkisë shkresaj nr. 23723/1 date 24.07.2020, por është mjaftuar me relacionin shpjegues 23.01.2020 (*dhe tjetri pa date ngjitur shkresës 1224 date 14.07.2020).*
***Sa sipër,*** Njësia administrative Vaqarr **nuk ka siguruar këto dokumente dhe nuk ka trajtuar këto probleme, çka e bën te pjesshëm relacionin shpjegues 23.01.2020 dhe relacionin tjetër pa date, ndërsa te munguar atë pas datës 24.07.2020.**
Veprime ne kundërshtim me kërkesat e ligjit nr. 7501 date 19.07.1991 *"Për token"* ndryshuar nr. 8053 date 21.12.1995 "*Për kalimin ne pronësi pa shpërblim tokës bujqësore",* me VKM 452 date 17.10.1992 "*Për ristrukturimin e Ndërmarrjeve shtetërore*", me VKM nr. 994 date 09.12.2015 "*Për procedurën e regjistrimit te akteve te marrjes se tokës ne pronësi"*.
**c.** Disponohen ne dosjen e subjektit, këto dokumente:
- *Relacion shpjegues 263 date 23.01.2020 i njësisë administrative Vaqar ne adrese te Bashkisë Tirane ZAMT bashke me (Certifikata e trungut familjar te subjektit date 01.08.1991, Formulari 6 ).*
- *Shkresa nr. 840 date 28.05.2020 e njësisë administrative Vaqar dërguar ne adrese te ASHK Rurale 2 Tirane, dërgim dokumentacioni (AMTP 51/1993, certifikate pronësie për 4800 m2 are, 2 planrilevime 17.02.2020, kërkesa e subjektit nr. 421 date 11.02.2020, njoftim 2018 për subjektin nga ZRPP. 2 KPP dhe 1 HTR).*
- *Shkresa 23723/1 date 24.07.2020 e Bashkisë Tirane zyrës administrimit NJA dhe AMTP, kthim dokumentacioni, ne adrese te njësisë administrative Vaqarr (protokolluar ne njësi me nr. 1224 date 27.07.2020), e cila paraqet këto kërkesa:*
** AMTP ne pronësi dhe jo ne përdorim e R C ,*
** AMTP e SH C dhe Q C si k/familjar ne 1991 me familje te pandare.*
** relacioni shpjegues pas datës 24.07.2020 dhe te ketë numër protokolli dhe date lëshimi.*
- *Kthim përgjigje e dokumentacioni e njësisë administrative Vaqarr* nr. 705 date 10.03.2020 dhe nr. 1224 date 14.07.2020 ne adrese te Bashkisë Tirane zyrës juridike, Aseteve dhe administrimit NJA dhe AMTP, rezulton:
** relacioni s,ka numër dhe s,ka date, i cili ka sqaruar 2 pasuritë, përkatësisht pasuria 52 me 9804 m2 është e njëjte me pasurinë 15/6 me 5004 m2 are ZK 1032 Arbane, ku për diferencën 4800 m2 personi është pajisur me certifikate pronësie.*
**relacioni, sqaron se AMTP "Përdorim" është lëshuar nga komisioni për mungese formati ne "pronësi",por ne rastet tjera komisioni ka fshire nga përdorim me nëntekstin "pronësi", konkretisht AMTP 50 date 15.09.1993 MA, AMTP 47 date 15.09.1993 Y A, etj.*
**Arsyeja e ndryshimit te numrave pasurive vjen nga azhurnimi nder vite.*
** Gjithashtu relacioni thotë dokumentet tjera te kërkuara janë bashkëngjitur, por ato janë te njëjta me ata te shkresës nr. 840 date 28.05.2020 ridërguar me pare, përjashtuar:deklaratën e kufitareve pa date pa numër, deklarata noteriale 07.05.2020 heqje dore nga prona e 3 anëtareve familjes (vdekur 1999 Q ).*
***Theksojmë:*** I njëjti fenomen ka ndodhur me K B M i cili ka përfituar toke bujqësore me AMTP, ne kushtet kur nuk ka qene i ndare ne vitin 1991 nga trungu familjar me kryefamiljarin (babai) B M, kështu kane përfituar AMTP secili ne vete.

**VII.** Korrespondenca Njësia Vaqarr-–ASHK, lidhur me AMTP 48 date 13.08.2002 për **SH A ,** për pasurinë nr. 18/13, vol 2, faqe 183, ZK 3963**,** rezulton:
Me shkresën 1423 date 07.02.2019 ASHK Rurale 2 ne adrese Njësisë Administrative Vaqarr kërkon: *plan rilevimi ku te saktësohet pozicononi i pasurisë nr. 18/13, vol 2, faqe 183, ZK 3963* Njësia Administrative Vaqarr me shkresën nr. 653 date 02.04.2020 ka kthyer përgjigje ASHK 2 duke i bashkëngjitur plan rilevimin 17.01.2020, ku ka saktësuar pozicononin e pasurisë nr. 18/13, vol 2, faqe 183, ZK 3963 për sipërfaqen 2080 m2, nga e cila: *1780 m2 are dhe truall 300 m2 brenda te cilës ndodhet pasuria ndërtese 18/13-D me sipërfaqe 93,4 m2.*
**Njësia Administrative Vaqarr paraqet problem te pajustifikuar vonesën mbi 1 vit te kthimit përgjigjes ndaj ASHK Rurale 2,** ne vend qe te bënte sqarimin brenda afatit 1 mujor, për pozicionin e pasurisë 18/13, çka e ka zvarritur procedurat e pasurisë duke e lëne ne pritje subjektin. Plan rilevimi 17.01.2020 i hartuar nga "*Studio M."*është nënshkruar nga Përgjegjësi i ZMMT B XH , Kryetari i fshatit I T dhe Administratori G M .

**VIII.** Korrespondenca Njësia Vaqarr—ASHK, lidhur me AMTP 470 date 12.06.2004 për **P V ,** për pasurinë nr. 139/23 me 835 m2 dhe nr. 139/27 me 2500 m2, ZK 3321**,** Sharre**,** për te cilat disponohet formulari nr. 6, rezulton:
**Dokumentacioni i kësaj praktike paraqet parregullsi dhe mangësi**, sipas shkresës 172 date 16.01.2020 te Njësisë Administrative Vaqarr, konkretisht:
- ***Planrilevimi date 16.12.2019 për pasurinë 139/23 dhe pasurinë 139/27 paraqet korrigjime*** (*mungon HTR për 2 pasuritë***),** *hartuar A K nënshkruar nga A M k/fshatit Sharre, B XH, F SH dhe Administratori.*
- ***Deklaratat e kufitareve*** *(2019)* ***rezultojnë pa date, pa numër, madje ka dhe korrigjime.***
- Në relacionin shpjegues me n. 836, datë 31.03.2021 Njësia Administrative Vaqarr për DV ASHK Tirana Rurale 2 sqaron se: B. Xh. banor i Fshatit Bultice ZK 1315, ka përfituar tokë në përputhje me ligjin nr. 7501, datë 19.07.1991 "Për tokën", sipas AMTP nr. 43, datë 15.03.1993, bashkëlidhur Fotokopje e AMTP, pasi origjinali është dorëzuar në ASHK. Përsa i përket AMTP në përdorim , ka qenë mungesë e AMTP në pronësi për gjithë fshatin Bultice.
***Kokluzion.***
***- AMTP në përdorim nuk ka korrigjimin e kërkuar me nënshkrim, mungon nënshkrimi i Kryetarit të Komisionit të ndarjes së tokës së Fshatit dhe vula e institucionit që ka lëshuar aktin.*** Nuk ka arsye dokumentare për vonesën me disa vite të përgjigjes dhe dërgimin e relacionit-shpjegues nga Njësia Administrative.
Veprime në kundërshtim me Ligjin nr. 20/2020, datë 03.05.2020 "Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë"; si dhe VKM nr. 1174, datë 24.12.2020 "Për procedurat e regjistrimit të AMTP-ve, saktësimin e kufijve e sipërfaqeve, si dhe normat për sipërfaqet shtetërore shtesë e pronat shërbyese" dhe ngarkojnë me përgjegjësi: F SH, B G , Specialist, Përgjegjësi Zyrës ZAMT B XH , A D dhe Administratorin G M .
Për sa më lart sipas rasteve specifike ngarkohen me Përgjegjësi:
F SH, B G , Specialist, B XH Përgjegjësi Zyrës ZAMT, A D Përgjegjës Sektori si dhe G M Administrator.

## III.2.C NJËSIA ADMINISTRATIVE ZALL-BASTAR

**Mbi verifikimin e procedurave të ndjekura për verifikimin e saktësisë së lëshimit të AMTP-ve, dhe konfirmimin e saktësisë të AMTP-ve dhe pozicionimit të planvendosjeve të tyre, për regjistrimin në ASHK.**

Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion rezultoi se, Komuna Zall-Bastar sot Njësia Administrative Zall-Bastar, Bashkia Tiranë si pjesë e ish Kooperativës Bujqësore ka ndarë tokë sipas ligjit nr. 7501 "Për Tokën" për familje të cilët kanë qenë banorë të ish Kooperativës me datë 01.08.1991 të dhënat në pasqyrën si më poshtë:

| Fshati | Sip. në dynym | Nr Familjeve | Numri i banorëve 1991 | Norma e tokës Për frymë (dynym) | Sasia e tokës Disponi bël (Ha) | Numri Familjeve të pajisur me tapi | Numri i familjeve pa tokë. |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| **Zall-Bastar** | 1270 | 216 | 1056 | 1.2 | 48 | 216 | - |
| **Vilëz** | 1100 | 193 | 1050 | 1.2 | 40 | 193 | - |
| **Mëner i Sipërm** | 1220 | 177 | 883 | 1.55 | 42 | 177 | - |
| **Bastar i Mesëm** | 850 | 156 | 667 | 1.1 | 48 | 156 | - |
| **Bastar Murrize** | 380 | 96 | 487 | 1.0 | 52 | 96 | - |
| **Zall-Dajt** | 1060 | 124 | 638 | 1.8 | 54 | 124 | - |
| **Besh** | 370 | 42 | 224 | 1.7 | 34 | 42 | - |
| **Dajt** | 160 | 43 | 147 | 0.83 | 6 | 43 | - |
| **Shëngjin i Vogël** | 400 | 68 | 364 | 1.6 | 51 | 68 | - |
| **Selitë e Malit** | 540 | 104 | 541 | 1.44 | 55 | 104 | - |
| **GJITHSEJ** | **7350** | **1219** | **6057** | **-** | **430** | **1219** | **-** |

Ndarja e tokës është bërë nga komisionet e ndarjes së tokës për çdo fshat sipas numrit te frymëve të datës 01.08.1991 dhe normës mesatare për frymë pa marrë parasysh koeficientin për bonitetin e tokës, pjerrësisë apo sipërfaqen ne ujë apo mbi ujë dhe as koeficientet për punonjësit qe punonin në sektorin shtetëror.

Në bazë të llogaritjeve të bëra nga komisjonet e ndarjes së tokës ka rezultuar norma për frymë sipas fshatrave :

| N/R | Fshati | Norma e tokës Për frymë e miratuar (dynym) |
|---|---|---|
| 1 | Zall-Bastar | 1.2 |
| 2 | Vilëz | 1.2 |
| 3 | Mëner i Sipërm | 1.55 |
| 4 | Bastar i Mesëm | 1.1 |
| 5 | Bastar Murrize | 1.0 |
| 6 | Zall-Dajt | 1.8 |
| 7 | Besh | 1.7 |
| 8 | Dajt | 0.830 |
| 9 | Shëngjin i Vogël | 1.6 |
| 10 | Selitë e Malit | 1.44 |

Nga të dhënat e paraqitur nga Njësia Administrative Zall-Bastar për konfirmimin e AMTP për regjistrim dhe procedurën e ndjekur për plotësimin e dokumentacionit tekniko-ligjor dhe dërgimin e dosjeve në Drejtorinë e Përgjithshme të Objekteve në Bashkëpronësi, Administrimit të NJA-ve dhe Emergjencave Civile (DANJA-ve/AMTP-ve), Bashkia Tiranë, ku kjo e fundit pas verifikimit të mëtejshëm për dërgimin e tyre në ASHK Tiranë për regjistrim, kjo në zbatim të urdhrit të Kryetarit të Bashkisë Tiranë nr. 26474/1 datë 02.09.2016 "Për delegimin e kompetencave nga Bashkia Tiranë tek Njësitë Administrative nën administrimin territorial dhe administrativ të Bashkisë Tiranë për kryerjen e procedurave që lidhen me krijimin e titujve të

rinj të pronësisë mbi tokën bujqësore dhe të procedurave që lidhen me shqyrtimin e vlefshmërisë tekniko-ligjore të titujve të pronësisë të krijuara, mbi tokën bujqësore të ish ndërmarrjeve bujqësore dhe ish kooperativave bujqësore" (i ndryshuar), në mbështetje në VKM-në nr. 994, datë 09.12.2015 "Për mënyrën e procedimit për pasuritë e paluajtshme, të fituara me Aktin e Marrjes të Tokës në Pronësi (AMTP), të nenit 9 të Ligjit nr. 9948, datë 7.7.2008, "Për shqyrtimin e vlefshmërisë ligjore të krijimit të titujve të pronësisë mbi tokën bujqësore", të ndryshuar të Ligjit nr. 171/2014, "Për përfundimin e procedurave ligjore të kalimit të tokës bujqësore të ish-ndërmarrjeve bujqësore në pronësi të përfituesve", i ndryshuar, si dhe të neneve 25 dhe 45 të ligjit 33/2012 datë 21.03.2012 "Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme" dhe ligji nr. 111/2018 "Për Kadastrën", *rezultoi si më poshtë*:

***Për vitin 2019,*** nga Njësia Administrative Zall-Bastar janë plotësuar dhe ka dërguar drejt Drejtoria e Përgjithshme e Objekteve në Bashkëpronësi, Administrimit të NJA-ve dhe Emergjencave Civile (DANJ-ve/AMTP-ve), Bashkia Tiranë për **17 persona** të cilët kanë kërkuar për regjistrim të AMTP në ASHK.

***Për vitin 2020,*** nga Njësia Administrative Zall-Bastar janë plotësuar dhe ka dërguar drejt Drejtoria e Përgjithshme e Objekteve në Bashkëpronësi, Administrimit të NJA-ve dhe Emergjencave Civile (DANJ-ve/AMTP-ve), Bashkia Tiranë për **20 persona** të cilët kanë kërkuar për regjistrim të AMTP në ASHK.

***Për vitin 2021,*** nga Njësia Administrative Zall-Bastar janë plotësuar dhe ka dërguar drejt Drejtoria e Përgjithshme e Objekteve në Bashkëpronësi, Administrimit të NJA-ve dhe Emergjencave Civile (DANJ-ve/AMTP-ve), Bashkia Tiranë për **9 persona** të cilët kanë kërkuar për regjistrim të AMTP në ASHK.

***-Titulli i gjetjes:***
Problematikat e konstatuara në korrespondencën me Bashkinë Tiranë dhe dërgimin e AMTP për regjistrim në ASHK.
***Situata:***
**- Ne 1 rast,** 2 pasuritë me sipërfaqe 3531 m$^2$ *(1325+2206)* **dhënë me AMTP date 22.06.1992** për familjen bujqësore **M L, rezultojnë me certifikate pronësie ne emër te personave tjerë,** konkretisht:
- Pasuria nr. 1111, ZK 1124, me sipërfaqe 1325 m$^2$, referuar AMTP 22.06.1992, ne emër te M L. Rezulton e regjistruar (sipas KPP) me nr. pasurie 1111, ZK 1124, vol 3, faqe 43, akti 121, me pronar H K e reflektuar (Harta kadastrave e vitit 1998 miratuar me vendimin 37 date 16.08.2004 te Këshillit Komunës).
- Pasuria nr. 1136, ZK 1124, me sipërfaqe 2206 m$^2$, referuar AMTP 22.06.1992, ne emër te M L. Rezulton e regjistruar (sipas KPP) me nr. pasurie 1136, ZK 1124, vol 4, faqe 190, akti 210, me pronar H L e reflektuar (Harta kadastrave e vitit 1998 miratuar me vendimin 37 date 16.08.2004 te Këshillit Komunës).
**Plan rilevimet date 11.12.2019 kane mospërputhje me hartën** 1:2500 vitit 1998 për 2 pasuritë nr. 1136 dhe nr. 1111, ZK 1124, pasi plan rilevimet i pasqyrojnë këto 2 pasuri ne emër te M L dhe jo te 2 personave tjerë pajisur me certifikate pronësie.
**Ky fakt nuk është konstatuar dhe nuk është trajtuar ne relacionin shpjegues**, pasi 2 pasuritë e M L ne këto kushte nuk janë objekt regjistrimi ne ASHK, sepse i përkasin personave tjerë regjistruar ne KPP qe ne vitin 2001 *dhe nuk mundet te njëjtat parcela te kenë 2 pronare te ndryshëm*. Pra ka munguar bashkëpunimi edhe me ASHK, kërkese kjo e pikës 1 dhe 2 te nenit 68 "*Bashkëpunimi ndërinstitucional"* te ligjit nr. 111.2018 "*Për kadastrën*", përforcuar edhe me vendimin 1040 date 25.11.2020, kreu I/ 5.
**- Ne 1 rast,** në korrespondencën **Njësisë Administrative Zall-Bastar- Bashki Tiranë–ASHK Rurale 1- Subjekt,** ka vonesa rreth 1 vit të pa argumentuara lidhur kjo me praktiken për AMTP pa numër dhe date, ne emër te **Q P,** fshati Zall-Dajt. Nga ASHK Rurale me date 27.01.2020 për

Njësinë Administrative është kërkuar konfirmim dokumentacioni, përgjigjur me relacionin shpjegues datë 16.09.2020 dhe ridërguar me 03.11.2020. Gjithashtu **dokumentacioni i korrespondencës paraqet mangësi**, pasi **mungon ne dosje AMTP-ja dhe formulari nr. 6** .

**- Ne 1 rast,** mungon korrespondenca pas vitit 2020 midis Njësisë Administrative Zall-Bastar me ASHK 1, **për sqarimin dhe sistemimin e sipërfaqeve tepër 3893 m$^2$ te 5 pasurive, nëse kane kaluar "shtet",** pasi 5 pasuritë regjistruar ne vitin 2001 ne emër **A C**, fshati Bastar-Murriz, ZK 1125 rezultojnë me sipërfaqe me te mëdha se AMTP 70, formulari 6 dhe plan rilevimet, sipas relacionit shpjegues 07.09.2020**.**

**- Ne 1 rast, relacioni shpjegues** 15.11.2020 i njësisë Zall-Bastar **nuk sqaron diferencën 11085 m2** *(21800-10715)* **midis AMTP 22/1992 dhe vërtetimit taksave vendore** ne emër **S M,** fshati Besh.

**- Ne 1 rast, janë përfituar 2 AMTP** nga familja D të pa argumentuara e të pa mbështetur ligjërisht sipas gjendjes familjare më 01.08.1991, konkretisht: për AMTP datë 16.07.1992 ne emër te H D fshati Zall-Dajt me sipërfaqe 1196 m$^2$ are, **mungon certifikata familjare 01.08.1991 e H D** dhe AMTP datë 16.07.1992 ne emër te B D me sipërfaqe 2208 m$^2$ are, sipas certifikatës familjare 01.10.1992 e B D.

**- Ne 1 rast, relacioni shpjegues date 29.12.2020 të njësisë Zall-Bastar, nuk sqaron diferencën e sipërfaqes 3775 m2** (11537-7762), midis sipërfaqes 11537 m$^2$ sipas vërtetimit Drejtorisë përgjithshme të Taksave Vendore Bashkisë Tiranë nr. 6951/1 date 22.09.2020 dhe sipërfaqen 7762 m2 qe pasqyron AMTP 13 date 15.06.1992, ne emër te A S**,** fshati Selite Malit, Zall-Bastar. Relacioni edhe pse në mungesë reference të formularit 6 nuk sqaron nëse administrohet pasuria "shtet" nr. 126/3 me sipërfaqe 3921 m2 are, ZK 3296, Selite Malit, vol 4, faqe 22, okupuar nga A S.

**- Në 3 raste,** dosjet e kthyera për mangësi dhe mungesë të dokumentacionit të konstatuara nga Drejtoria e Përgjithshme Juridike e Aseteve dhe Liçensimit, Drejtoria e Pasurive të Paluajtshme Bashkia Tiranë **nuk janë plotësuar, por janë nisur përsëri më mangësi nga Njësia Administrative Zall-Bastar.**

**- Në 3 rast** janë lëshuar AMTP-të me nr. 34, datë 18.08.2000; nr. 276, datë 18.08.2000; nr. 63, datë 18.08.2000 në kundërshtim me ligjin nr. 7501, datë 19.07.1991 "Për Tokën", me VKM nr. 994, datë 9.12.2015 "Për procedurën e regjistrimit të akteve të marrjes së tokës në pronësi"

**- Në 2 raste** ka mangësi dokumentare dhe nuk ka sqarime të dokumentuar për pasuritë regjistruara si tokë bujqësore të cilat edhe sipas portalit qeveritar ASIG nuk janë tokë bujqësore konkretisht:

-për pasuritë nr. 2/9 dhe 2/11 që i përkasin ZK 1309, fshati Bulcesh dhe jo në ZK 3884 Fshati Zall Bastar.

- për pasurinë 28/8, me sipërfaqe 1550 m$^2$ sipas planit të rilevimit datë 12.11.2020 dhe sipas rreshtit nr. 4 në AMTP nr. 33, datë 25.08.2000 për 1250 m$^2$ pemëtore dhe 300 m$^2$ truall.

**- Në 1 rast** nuk ka azhornim faktik të pasurive në kufijt e vjetër dhe të regjistruara në ASHK me nr. 93, vol 1, faqe 93 ZK 3775 me sipërfaqe 6000 m$^2$ fshati Vilëz dhe nr. 711 vol. 3, faqe 211. 6600 m$^2$ "arrë" për saktësimin e gjendjen e pasurisë së poseduar faktikisht në terren veprime në kundërshtim me nenin 38 të ligjit nr. 111/2018.

***Kriteri***:

Në kundërshtim me urdhrin e Kryetarit të Bashkisë Tiranë nr. 26474/1, datë 02.07.2016 "Për delegimin e kompetencave nga Bashkia Tiranë tek Njësitë Administrative nën administrativin territorial dhe administrativ të Bashkisë Tiranë për kryerjen e procedurave që lidhen me krijimin e titujve të rinj të pronësisë mbi tokën bujqësore dhe të procedurave që lidhen me shqyrtimin e vlefshmërisë tekniko-ligjore të titujve të pronësisë të krijuara, mbi tokën bujqësore të ish ndërmarrjeve bujqësore dhe ish kooperativave bujqësore"; me VKM nr. 782, datë 7.10.2020 "Për miratimin e modeleve të akteve kadastrale dhe të dhënave në përmbajtje të hartës kadastrale"; me ligjin nr. 7501, datë 19.7.1991, "Për tokën", i ndryshuar; ligjin nr. 8053, datë 21.12.1995, "Për kalimin në pronësi, pa shpërblim, të tokës bujqësore", i ndryshuar; ligjin nr.

9948, datë 7.7.2008, "Për shqyrtimin e vlefshmërisë ligjore të krijimit të titujve të pronësisë mbi tokën bujqësore", i ndryshuar me ligjin nr. 171/2014, "Për përfundimin e procedurave ligjore të kalimit të tokës bujqësore të ish-ndërmarrjeve bujqësore në pronësi të përfituesve", i ndryshuar, si dhe Urdhrin nr. 39203/1, datë 17.10.2019 "Për një shtesë në Urdhrin nr, 26474/1, datë 02.09.2016 të Kryetarit të Bashkisë "Për delegim kompetencave nga Bashkia Tiranë tek Njësitë Administrative të Bashkisë Tiranë".

***Ndikimi/Efekti:***

Parregullsia në dokumentacionin shoqërues të AMTP për regjistrim në kundërshtim me akte ligjore.

***Shkaku:***

Mos zbatimi i kuadrit ligjorë nga personat përgjegjës.

***Rëndësia:*** e mesme

***Rekomandim:***

Njësia Administrative Zall-Bastar Bashkia Tiranë në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme e Objekteve në Bashkëpronësi, Administrimit të NJA-ve dhe Emergjencave Civile (DANJ-ve/AMTP-ve), Bashkia Tiranë, të mos përcjell AMTP-të për regjistrim, në Drejtorinë Vendore të ASHK Rurale 1, pa shqyrtuar vlefshmërinë tekniko-ligjore të titullit të pronësisë të krijuar mbi tokën bujqësore (AMTP-së), pa verifikuar dhe shqyrtuar dokumentacionin kadastral që disponon Njësia Administrative Zall-Bastar.

**<u>Praktikat me parregullsi në dokumentacion</u>.**

**I.** Korrespondenca Njësia Zall-Bastar-Bashki–ASHK Rurale 1-Subjekt, lidhur me praktiken për **AMTP date 22.06.1992, ne emër M L**, fshati Zall-Bastar i Mesëm, rezulton se:

**a.** Praktika e kësaj dosje përbëhet nga këto dokumente:

- Shkresa nr. 53/1 date 27.01.2020 e njësisë administrative Zall-Bastar ne adrese te Bashkisë Tirane për regjistrimin e pasurive nr. 1136, 1152 dhe nr. 1112, ZK 1124, për AMTP nr. s,ka date 22.06.1992, ne emër te K L e cila përmban bashkëngjitur këto shkresa.
- Kërkesa e subjektit date 10.01.2020,
- Deklarate noteriale 21.12.2019 e 3 familjareve Lila për regjistrim pasurive ne emër M L .
- Vërtetim i taksave vendore te bashkisë Tirane 14997/1 date 12.12.2019 për shlyerjen e taksave vendore nga subjekti ( 9326 m2 are).
- Shkresa ASHK Rurale 1 date 05.12.2019 për kopjen AMTP nr. s,ka date 22.06.1992, për 3 pasuritë,
- Certifikate e përbërjes familjare M L prej 3 veta me 01.08.1991, përfitues i AMTP.
- Plan rilevime date 11.12.2019 gjithsejtë 3 cope, hartuar nga topograf i licencuar: G –S "shpk i nënshkruar dhe nga njësia vendore Zall- Bastar dhe Administratori G S dhe specialist i ZAMT E P , për 3 pasuritë ZK 1124 sipas AMTP 2.06.1992, përkatësisht: pasuria 1136 me sipërfaqe 2206 m2, pasuria 1111 me sipërfaqe 1325 m2 dhe pasuria 1152 me sipërfaqe 600 m2.
- Relacion shpjegues date s,ka *(2020),* nënshkruar nga specialist i ZAMT E P dhe kryetari i fshatit XH H, për saktësimin e 3 pasurive tokës bujqësore përfituar me AMTP date 22.06.1992, ne emër te M L, ku thuhet:

* Ngastra 2206 m2 ne AMTP rakordon me pasurinë nr. 1136, ZK 1124, me sipërfaqe 2206 m2, ne plan rilevim 11.12.2019.

* Ngastra 1325 m2 ne AMTP rakordon me pasurinë nr. 1111, ZK 1124, me sipërfaqe 1325 m2, ne plan rilevim 11.12.2019.

* Ngastra 600 m2 ne AMTP rakordon me pasurinë 1152 me sipërfaqe 600 m2 ne plan rilevim 11.12.2019.

**b.** Shkresa nr. 4861/1 date 07.02.2020 e Bashkisë Tirane (*Drejtorisë juridike dhe aseteve)* dërguar njësisë administrative Zall-Bastar, për kthim dokumentacioni dhe për sqarimin e pasurive 1111 dhe 1136, ZK 1124, ku thuhet se nga verifikimi ne sistemin e ASHK, u konstatua:

* Pasuria nr. 1111, ZK 1124, me sipërfaqe 1325 m2, rezulton me certifikate pronësie ne emër te një personi tjetër te H K, sipas KPP, pasuria 1111, ZK 1124, vol 3, faqe 43, akti 121 *(AMTP date 11.05.1992 me 7 pasuri).*
***** Pasuria nr. 1136, ZK 1124, me sipërfaqe 2206 m2, rezulton e regjistruar ne kartelën e pasurive paluajtshme ne emër te një personi tjetër H L, pasuria 1136, ZK 1124, vol 4, faqe 190, akti 210. Prandaj, kërkohet Harte, Kartele dhe Statusi juridik për pasuritë objekt regjistrimi 1111 dhe 1136, te cilat nuk disponohen (*pas datës 07.02.2020).*

**c. <u>Konkluzion</u>:**

***1. Pasuria nr. 1111*, ZK 1124, me sipërfaqe 1325 m2, sipas AMTP 22.06.1992, ne emër te M L , rezulton me certifikate pronësie ne emër te një personi tjetër H K,** sipas KPP, pasuria 1111, ZK 1124, vol 3, faqe 43, akti 121, AMTP 11.05.1992, sqaruar edhe me shkresën 4861/1 date 07.02.2020 te Bashkisë Tirane.

**Harta kadastrave e vitit 1998 miratuar me vendimin 37 date 16.08.2004 te Këshillit Komunës Zall-Bastar e pasqyron këtë pasuri ne emër te H K** dhe jo te M L .

***2. Pasuria nr. 1136*, ZK 1124, me sipërfaqe 2206 m2, sipas AMTP 22.06.1992, ne emër te M L, rezulton e regjistruar ne KPP qe ne vitin 2001 ne emër te një personi tjetër H L,** pasuria 1136, ZK 1124, vol 4, faqe 190, akti 210, sqaruar edhe me shkresën 4861/1 date 07.02.2020 te Bashkisë Tirane.

**Harta kadastrave e vitit 1998** miratuar me vendimin 37 date 16.08.2004 te Këshillit Komunës Zall-Bastar **e pasqyron këtë pasuri ne emër te H L** dhe jo te M L .

***Vendimi 37 date 16.08.2004 i KK, nder te tjera thotë***:

- te miratoje azhurnimin e tokës bujqësore te bere ne vitin 1998 *(azhurnimi i tokës bujqësore sipas gjendjes reale dhe kufijve vjetër është pasqyruar ne hartën 1:2500 te vitit 1998 dhe nuk ka harta tjera te kësaj shkalle).*
- te miratoje legalizimin e tapive te tokës bujqësore për çdo familje bujqësore, sipas azhurnimit te bere ne vitin 1998.
- Ngarkohen për zbatimin e këtij vendimi zyra bujqësisë dhe kryetari i komunës.

***3.* Plan rilevimet** date 11.12.2019 **kane mospërputhje me hartën** 1:2500 vitit 1998 **për 2 pasuritë nr. 1136 dhe nr. 1111**, ZK 1124, pasi plan rilevimet pasqyrojnë këto 2 pasuri ne emër te M L , ne fakt sipas hartës janë te personave tjerë.

***4.* Relacion shpjegues date s'ka**, nënshkruar nga specialist i ZAMT, kryetari i fshatit dhe administratori, për saktësimin e pasurive tokës bujqësore përfituar me AMTP date 22.06.1992, ne emër te M L , thotë:
* Ngastrat e subjektit nuk kane mbivendosje, konflikte dhe mospërputhje.
* Ngastra 2206 m2 e AMTP rakordon me pasurinë 1136, ZK 1124, sipërfaqe 2206 m2, ne plan rilevimin 11.12.2019, por nuk thotë se nuk rakordon me hartën 1998 dhe me dokumentin e pronësisë të një personi tjetër.
* Ngastra 1325 m2 ne AMTP rakordon me pasurinë nr. 1111, ZK 1124, me sipërfaqe 1325 m2, ne plan rilevim 11.12.2019, por nuk thotë se nuk rakordon me hartën 1998 dhe me dokumentin e pronësisë të një personi tjetër.

**Ky fakt nuk është trajtuar ne relacionin shpjegues**, pasi 2 pasuritë e M L ne këto kushte nuk janë objekt regjistrimi ne ASHK, prandaj bashkia ka rikthyer dokumentacionin dhe relacionin njësisë, ku i ka bere e qarte se 2 pasuritë janë prone e tjerëve, sipas shkresës 4861/1 date 07.02.2020.

Gjithashtu ka munguar rakordimi me ASHK, kërkese e nenit 68 "*Bashkëpunimi ndërinstitucional"* te ligjit nr. 111.2018 "*Për kadastrën*", përforcuar edhe me vendimin 1040 date 25.11.2020, kreu I/ 5.

Administratori G S , specialisti i ZAMT E P , kryetari i fshatit XH H.

**II.** Korrespondenca Njësia Zallbastar - Bashki Tirane – ASHK Rurale nr 1 - Subjekt, lidhur me praktiken për AMTP nr. s,ka date s,ka *(mungon AMTP ne dosje),* ne emër te **Q P,** fshati Zall-Dajt, paraqet këto dokumente:

**a.** Shkresa nr. 517 date 27.01.2020 e ASHK Rurale 1, ne adrese te Bashkisë Tirane njësia administrative Zall-Bastar, për konfirmim dokumentacioni, mbështetur ne aplikimin e subjektit date 03.09.2020, lidhur me Q P, ku nuk përputhen plan rilevimet me HTR për pasuritë:

- pasurinë nr. 276/7 me 280 m2, vol 6, faqe 232 ZK 3876, Zall-Dajt,
- pasurinë nr. 276/8 me 930 m2, vol 6, faqe 233 ZK 3876, Zall-Dajt,
- pasurinë nr. 252/8 me 1080 m2, vol 6, faqe 57 ZK 3876, Zall-Dajt,
- pasurinë nr. 687 me 1628 m2, vol 10, faqe 40 ZK 3876, Zall-Dajt,

Kështu, kërkohet relacion shpjegues *(bashkëngjitur shkresës plan rilevimet, HTR dhe KPP).*

**b.** Relacion shpjegues date 16.09.2020, nënshkruar nga E P dhe kryetari fshatit Zall-Dajt R D, për rakordimin e sipërfaqeve te ngastrave te Q P, ku thuhet:

Ngastrat e subjektit nuk kane mbivendosje, nuk kane konflikt, dhe për mospërputhjen plan rilevime-HTR, për pasuritë e ZK 3876:

** Ngastra 1080 m2 ne AMTP rakordon me pasurinë 252/6 me plan rilevimin 19.05.2016.*
** Ngastra 1628 m2 ne AMTP rakordon me pasurinë nr. 276/3/2 me plan rilevimin 19.05.2016.*
** Ngastra 280 m2 ne AMTP rakordon me pasurinë 283/2 me plan rilevimin 19.05.2016,*
** Ngastra 930 m2 ne AMTP rakordon me pasurinë 273/11/1 me plan rilevimin 19.05.2016,*

**c.** Shkresa nr. 5172/2 date 03.11.2020 e Bashkisë Tirane, njësia administrative Zall-Bastar, ne adrese ASHK Rurale 1, për **rikonfirmim** dokumentacioni.

Relacioni shpjegues, ku thuhet: ngastrat e subjektit nuk kane mbivendosje si dhe plan rilevimet date 17.06.2021, për pasuritë:

** Ngastra 1080 m2 me AMTP rakordon me pasurinë nr. 252/6, ZK 3876, me plan rilevim 17.06.2021.*
** Ngastra 1628 m2 ne AMTP rakordon me pasurinë nr. 276/4,5,6,7,8/2, ZK 3876, me plan rilevim.*
** Ngastra 280 m2 ne AMTP rakordon me pasurinë 283/4 me plan rilevim 17.06.2021,*
** Ngastra 930 m2 ne AMTP rakordon me pasurinë 273/17 me plan rilevim 17.06.2021.*

<u>**Konkluzion:**</u> **Praktika e kësaj korrespondence paraqet vonesa** mbi 1 vit ne kthimin e përgjigjeve**.**

**Mungon ne praktiken dokumentare AMTP-ja dhe formulari nr. 6** për Q P.

**III.** Korrespondenca Njësia Zall-Bastar-Bashki–ASHK Rurale 1-Subjekt, lidhur me praktiken për AMTP nr. 70 date s,ka, ne emër te **A C,** fshati Bastar-Murriz, paraqet këto probleme:

**a. AMTP 70 date s,ka për 5 pasuri rakordon me plan rilevimet** 23.10.2017 **dhe formularin nr. 6**, te cilën e sqaron dhe relacioni 07.09.2020, **por nuk rakordon me KPP** *(2001),* pasi kartelat pasqyrojnë sipërfaqe me te mëdha krahasuar me AMTP dhe plan rilevimet dhe formularin 6, për 5 pasuritë, përkatësisht:

- pasuria nr. 138/4 sipas AMTP, plan rilevimit, formularit 6 rezulton me 300 m2, ndërsa sipas KPP (2001) rezulton 481 m2, vol 1, faqe 209, ZK 1125, Bastar Murriz, pra ***diferenca tepër 181 m2.***
- pasuria nr. 72/7 sipas AMTP, plan rilevimit, formularit 6 rezulton me 200 m2, ndërsa sipas KPP (2001) rezulton 2662 m2, vol 1, faqe 208, ZK 1125, Bastar-Murriz, pra ***diferenca tepër 2462 m2.***
- pasuria nr. 183/5 sipas AMTP, plan rilevimit, formularit 6 rezulton me 950 m2, ndërsa sipas KPP (2001) rezulton me 1586 m2, vol 1, faqe 213, ZK 1125, Bastar-Murriz, pra ***diferenca tepër 636 m2.***
- pasurinë nr. 211/3 sipas AMTP, plan rilevimit, formularit 6 rezulton me 1200 m2, ndërsa sipas KPP (2001) rezulton 1416 m2, vol 1, faqe 217, ZK 1125, Bastar-Murriz, pra ***diferenca tepër 216 m2.***

- pasuria nr. 219/17 sipas AMTP, plan rilevimit, formularit 6 rezulton me 2350 m2, ndërsa sipas KPP (2001) rezulton me 2748 m2, vol 1, faqe 219, ZK 1125, Bastar-Murriz, pra ***diferenca tepër 398 m2.***

***<u>Përfundimisht,</u>***

*** Mungon korrespondenca pas vitit 2020** midis Njësi Zall-Bastar - ASHK 1, **për sqarimin dhe sistemimin e sipërfaqes totale tepër prej 3893 m2, nëse kane kaluar "shtet",** pasi 5 pasuritë e regjistruara ne 2001 ne kartelat pasurive paluajtshme janë me te mëdha se AMTP 70, formulari 6 dhe plan rilevimet, sipas relacionit shpjegues 07.09.2020**.**

*** Kjo për efekt te administrimit dhe menaxhimit te kësaj sipërfaqe nga ana e njësisë,** nëse sipërfaqet e tepërta 3893 m2 te 5 pasurive kane kaluar "shtet".

**b. Disponohen këto dokumente:**

**-** Shkresa nr. 3118/1 date 14.10.2020 e Bashkisë Tirane, ne adrese ASHK Rurale 1 dhe njësisë administrative Zall-Bastar, për përcjellje dhe verifikim dokumentacioni, ku me tej personi i interesuar ka proceduar ne rruge elektronike *(e-albania)*, fenomen edhe për rastet tjera nga viti 2021 e ne vazhdim.

**-** Shkresa nr. 1539/1 date 15.09.2020 e njësisë administrative Zall-Bastar, ne adrese Bashkisë Tirane.

- Relacion shpjegues date 07.09.2020, nënshkruar nga specialist i ZAMT E P dhe kryetari i fshatit Bastar-Murriz.

- Planimetritë dhe KPP përkatëse te pasurive ne emër te A C, fshati Bastar-Murriz.

**IV.** Korrespondenca Njësia Zall-Bastar-Bashki Tirane–ASHK Rurale 1-Subjekt, lidhur me praktiken e AMTP 22 date 23.06.1992, ne emër **S M ,** fshati Besh, paraqet këto probleme:

**Nuk sqarohet ne relacionin shpjegues te njësisë Zall-Bastar diferenca 11085 m2** *(21800-10715)* **midis AMTP 22/1992 dhe vërtetimit taksave vendore** te bashkisë Tirane, pasi AMTP 22 date 23.06.1992 përmban 6 pasuri me sipërfaqe totale 10715 m2 are, ndërsa vërtetimi i bashkisë Tirane te drejtorisë taksave vendore nr. 11341/1 date 03.09.2019 flet për likuidimin e taksave vendore për sipërfaqen 21800 m2. Ndryshe ka ndodhur ne praktiken e R M ku përputhet sipërfaqja 18720 m2 e AMTP me sipërfaqen e vërtetimit për pagesën e taksës. Po kështu ne praktiken e F M përputhet sipërfaqja 5231 m2 e AMTP 27.06.1992 me sipërfaqen e vërtetimit për pagesën e taksës nr. 8759/1 date 02.11.2020.

*Relacioni 15.11.2020 i njësisë Zall-Bastar për 6 pasuritë me sipërfaqe totale 10715 m2 are sipas AMTP 22, sqaron se sipërfaqet e tyre rakordojnë me 6 plan rilevimet date 13.02.2018 dhe me KPP e regjistruara ne Hipoteke Rurale 1 ne vitin 2015, përkatësisht:.*

*- pasuria nr. 334/8 me 1700 m2, vol 3, faqe 246, ZK 1171, Besh.*

*- pasuria nr. 335/3 me 3240 m2, vol 3, faqe 250, ZK 1171, Besh.*

*- pasuria nr. 336/3 me 2400 m2, vol 4, faqe 5, ZK 1171, Besh.*

*- pasurinë nr. 339/1 me 1517 m me LN 1855 m2 (pjesa tjetër e sipërfaqes është trajtuar tek pasuria 335/1), vol 4, faqe 8, ZK 1171, Besh, diferenca tepër 338 m2.*

*- pasuria nr. 340/4 me 1405 m2, vol 4, faqe 14, ZK 1171, Besh.*

**V.** Korrespondenca Njësia Zall-Bastar - Bashki Tirane – ASHK Rurale nr 1 - Subjekt, lidhur me praktiken për AMTP nr. s,ka date s,ka, ne emër te **B P,** fshati Zall-Dajt, rezulton:

AMTP nr. s,ka date s,ka përmban 4 pasuri me sipërfaqe totale 5310 m2 are, për 3 fryme.

Disponohen plan rilevimet përkatëse, ku përputhen sipërfaqet e tyre me pasuritë e AMTP.

Pagesa taksave vendore për sipërfaqen 5270 m2 përputhet me sipërfaqen e AMTP, sipas vërtetimit drejtorisë bashkisë Tirane nr. 8585/1 date 27.10.2020.

Relacioni 03.12.2020 i njësisë Zall-Bastar për 4 pasuritë sqaron se: rakordon sipërfaqja total dhe ne mënyre analitike midis AMTP, plan rilevimeve dhe ngastrave date 21.10.2020, përkatësisht:.

- pasuria nr. 232/2 me 2420 m2, are, vol 6, faqe 62, ZK 3876, Zall-Dajt.

- pasuria nr. 264/1 me 1030 m2, vol 6, faqe 144, ZK 3876, Zall-Dajt.
- pasuria nr. 322/9 me 1480 m2, vol 8, faqe 101, ZK 3876, Zall-Dajt.
- pasuria nr. 254/23 me 380 m2, vol 6, faqe 85, ZK 3876, Zall-Dajt.

AMTP pa numër dhe date nuk është dhëne ne emër te kryefamiljares (*N P*) por ne emër te birit *(B P*), edhe nen mungesën e deklaratës noteriale te kryefamiljares dhe te birit, sipas certifikatës date 01.08.1991, kërkesë e ligjit nr. 7501 "*Për token"* dhe VKM 994 date 09.12.2015 "*Për regjistrimin e AMTP*".

**VI.** Korrespondenca Njësia Zall-Bastar-Bashki–ASHK Rurale 1-Subjekt, lidhur me praktiken për AMTP date 16.07.1992, ne emër **B D,** fshati Zall-Bastar, rezulton:
Familja D ne 1992 pretendohet se ka qene e ndare ne 2 familje, ku disponohet 1 certifikate familjare ne vend te 2 certifikatave familjare, ndërsa kane përfituar 2 AMTP, përkatësisht:
-AMTP 16.07.1992 ne emër te babait H D me *1 pasuri* me sipërfaqe 1196 2 m2 are, për 2 fryme, por mungon certifikata familjare 1991 e H D. Pasuria 104 me sipërfaqe 1196 m2 ka kaluar ne emër birit B D me akt trashëgimie, pasi kane vdekur 2 prindërit ne vitin 1999 dhe 2017.
-AMTP 16.07.1992 ne emër te birit B D me *2 pasuri* nr. 102/3 me sipërfaqe 1208 2 m2 are dhe nr. 105/1 me sipërfaqe 1000 m2 are, për 5 fryme, ku disponohet certifikata familjare 01.10.1992 e B D.
Disponohen plan rilevimet përkatëse, ku përputhen sipërfaqet e tyre me pasuritë e 2 AMTP.
Disponohen pagesat e taksave vendore për sipërfaqet e AMTP-ve, sipas 2 vërtetimeve drejtorisë bashkisë Tirane nr. 8623/1/2020 dhe nr. 8916/1 date 06.11.2020.
Relacioni 28.12.2020 i njësisë Zall-Bastar për 3 pasuritë sqaron se: rakordon sipërfaqja ne total dhe ne mënyre analitike midis AMTP, plan rilevimeve dhe ngastrave date 05.05.2019, përkatësisht:.
- pasuria nr. 102/3 me 1208 m2, are, ZK 3884, Zall-Bastar.
- pasuria nr. 105/1 me 1000 m2, ZK 3884, Zall-Bastar.
- pasuria nr. 104 me 1196 m2, ZK 3884, Zall-Bastar.

**Konkluzion:**

**a.** AMTP 16.07.1992 ne emër te babait HD me sipërfaqe 1196 2 m2 are, **rezulton jo origjinale** *(fotokopje)* **dhe mungon certifikata e përbërjes familjare 1991**.
**b. Ne 2 rastet AMTP padrejtësisht pasqyrojnë 125 m2/secila truall, i cili nuk është objekt i AMTP por i listës trojeve 001,** duke u dhënë truall jashtë kompetencës, pasi ligji 7501 datë 19.7.1991 "*Për tokën*" flet për tokë bujqësore dhe jo truall, veprime në kundërshtim me nenin 3, pika c, nenin 10, nenin 15 të ligjit nr. 9948, datë 7.7.2008 "*Për shqyrtimin e vlefshmërisë ligjore krijimit titujve pronësisë mbi tokën bujqësore",* me pikën 5, të UKM nr. 2, datë 12.09.2012 "*Për përcaktimin e elementeve të akteve, që verifikohen nga zyra e regjistrimit pasurive të paluajtshme dhe të procedurës për nxjerrjen e urdhrit të regjistruesit*", me UKM nr. 2, datë 13.06.2013 "*Për mënyrën e procedimit të organeve të administratës publike, për pasuritë e paluajtshme, të fituara me Aktin Marrjes Tokës Pronësi"***,** përforcuar me shkresën 7217/3 date 15.07. 2021 te DP ASHK.
Njëkohësisht **i biri B D nuk rezulton ne listën e trojeve 001,** ndërsa H D rezulton ne listën e trojeve ne emër te gruas tij XH D për 300 m2 truall brenda te cilës 80 m2 ndërtese.
Ngarkohen me pergjegjesi **ish-komisionet e ndarjes tokes A V e M L , ish-kryeplaku J F dhe ish-kryetari komunes Zall-Bastar.**

**VII.** Korrespondenca Njësia Zall-Bastar lidhur me praktiken për AMTP nr. s,ka date 22.02.2007, për 5500 m2 are për 6 fryme ne emër te **B H ,** fshati Shëngjin i vogël, rezulton:
- Procedura e regjistrimit te pasurive ka vazhduar me rruge elektronike e-albania, kështu njësia Zall-Bastar ka kthyer subjektit dokumentacionin përkatës, sipas shkresës nr. 2574/2 date 10.03.2021.

- AMTP nr. s,ka date 22.02.2007 ka te shtuar ne fund te saj numri 11, pasuria 1500 m2 are, por pa efekte për normën për fryme *( 916 m2/fryme norma 1000 m2/fryme).*

**VIII.** Korrespondenca Njësia Zall-Bastar - Bashki Tirane – ASHK Rurale nr 1 - Subjekt, lidhur me praktiken për AMTP nr. 14 date 15.06.1992, ne emër B SH**,** fshati Selite e Malit (Poshtme), Zall-Bastar, rezulton:

AMTP nr. 14 date 15.06.1992 për 3 pasuri me sipërfaqe totale 11565 2 m2 are (*për 7 fryme sipas certifikatës familjare 1991)* **paraqet ne rreshtin e pare te saj pasurinë me sipërfaqe te përbashkët 8718 m2,** *te grupuara ne emër te përbashkët "Blloku Shkallajve*", **ne vend te 8 pasurive analitike me pozicione larg njëra tjetrës, çka bie saktësia e kufitareve,** ne papajtueshmëri me ligjin 7501 datë 19.7.1991 "*Për tokën*", **çka bën përgjegjës ish-komisionin tokës E H, SH S**.

Me kalimin ne tokat me kufij te vjetër ne vitin 1998, gjithsejtë 8 nen pasuritë e sipërfaqes 8718 m2 janë sqaruar ne relacionin shpjegues date 27.11.2020 te njësisë Zall-Bastar dhe me 8 plan rilevimet datë 05.10.2020 te specialistit liçensuar, përkatësisht:

- pasuria nr. 270/2 me sipërfaqe 371,37 m2, are, ZK 3296, Selite Malit, Zall-Bastar.
- pasuria nr. 268/1 me sipërfaqe 896,65 m2, are, ZK 3296, Selite Malit, Zall-Bastar.
- pasuria nr. 234/4 me sipërfaqe 1246,6 m2, are, ZK 3296, Selite Malit, Zall-Bastar.
- pasuria nr. 274/4 me sipërfaqe 484 m2, are, ZK 3296, Selite Malit, Zall-Bastar.
- pasuria nr. 274/3 me sipërfaqe 345,3 m2, are, ZK 3296, Selite Malit, Zall-Bastar.
- pasuria nr. 263/5 me sipërfaqe 278,2 m2, are, ZK 3296, Selite Malit, Zall-Bastar.
- pasuria nr. 747 me sipërfaqe 961,55 m2, are, ZK 3296, Selite Malit, Zall-Bastar.
- pasuria nr. 727 me sipërfaqe 4056,33 m2, are, ZK 3296, Selite Malit, Zall-Bastar.

**IX.** Korrespondenca Njësia Zall-Bastar - Bashki Tirane – ASHK Rurale nr 1 - Subjekt, lidhur me praktiken për AMTP nr. 13 date 15.06.1992, ne emër te **A S,** fshati Selite Malit, Zall-Bastar. AMTP nr. 13 date 15.06.1992**,** për 5 pasuri me sipërfaqe totale 7762 m2 are (*për 5 fryme sipas certifikatës familjare 1991)* paraqet te njëjtat sipërfaqe pa diferenca me plan rilevimet date 19.10.020 dhe me relacionin shpjegues date 29.12.2020 të njësisë Zall-Bastar, për 5 pasuritë përkatëse, ku nuk konstatohen probleme mbivendosje ose konflikte tjera.

**a. Relacioni** date 29.12.2020 **nuk shpjegon diferencën e sipërfaqes 3775 m2** (11537-7762), midis sipërfaqes se paguar prej 11537 m2 (*sipas vërtetimit drejtorisë taksave vendore te Bashkie Tirane nr. 6951/1 date 22.09.2020)* me sipërfaqen 7762 m2 qe pasqyron AMTP nr. 13 date 15.06.1992.

**b. Relacioni shpjegues date 29.12.2020 të njësisë Zall-Bastar nuk sqaron nëse menaxhohet dhe administrohet pasuria "shtet" e okupuar nga AS**, pasuria nr. 126/3 me sipërfaqe 3921 m2 are, ZK 3296, Selite Malit, vol 4, faqe 22.

**c. Relacioni shpjegues date 29.12.2020 nuk flet për mos sigurimin e formulari nr. 6, kërkesë kjo** e bashkisë Tiranë, sipas shkresës saj nr. 43109/1 date 15.12.2020.

**X.** Njësia Administrative Zall-Bastar:

**a. nuk disponon listën e sipërfaqeve tokës tepër kaluar "shtet" nga ASHK,** sipas subjekteve private **objekt i legalizimeve**, për **diferencat midis pjesa zaptuar me pjesën legalizuar**.

**b. nuk disponon listën e sipërfaqeve tokës tepër kaluar "shtet" nga ASHK,** sipas subjekteve private **objekt i AMTP**, për **diferencat midis AMTP dhe matjeve ne terren** ku sipërfaqja rezulton me e madhe se AMTP.

**c. Madje edhe për rastin e okupimit nga privati te pasurisë shtet nr. 126/3 me sipërfaqe 3921 m2** are, ZK 3296, Selite Malit, vol 4, faqe 22, **njësia nuk e ka administruar ketë sipërfaqe, ku i behet e qarte okupimi i saj nga ASHK**.

Kështu, këto parceleza "shtet" kane mbetur në posedim dhe shfrytëzim në mënyrë të paligjshme nga subjektet private për një periudhë pa kufi kohor, pa asnjë detyrim, taksë, qira për buxhetin,

çka tregon punë jo efektive, mos-menaxhim dhe mos-administrim te tyre si dhe mungese bashkëpunimi te Njësisë Administrative Zall-Bastar me ASHK.

**XI.** Ne Njësinë Administrative Zall-Bastar, bazuar ne shkresën nr. 266/1date 09.05.2019 te saj, ne adrese KQ dhe Drejtorisë Përgjithshme Projekteve dhe Zhvillimit Ekonomik Rural Tirane, rezulton:
Menjëherë pas ndarjes tokës me AMTP, te gjithë familjet kane kaluar ne tokat e tyre sipas kufijve vjetër, mbi bazën e se cilës është hartuar harta kadastrave 1:2500 e vitit 1998 e miratuar ne Këshillin e Komunës sipas vendimit 37 date 16.08.2004, por i pakonfirmuar nga Prefektura sipas shkresës 2096/1 date 08.09.2004.
Toke pa frutë ( PF ) paraqitet për 14,6 ha ne njësinë vendore Zall-Bastar ndërsa pyjet dhe kullotat rezultojnë shtetërore dhe jo private.

Veprime ne kundërshtim me ligjin 7501 datë 19.7.1991 "*Për tokën*" , me ligjin 9948 datë 7.7.2008 "*Për shqyrtimin e vlefshmërisë ligjore krijimit titujve pronësisë mbi tokën bujqësore",* nr. 57/2012 dhe nr. 171/2014, me UKM 2 datë 12.09.2012 "*Për përcaktimin e elementeve të akteve, që verifikohen nga zyra e regjistrimit pasurive të paluajtshme dhe të procedurës për nxjerrjen e urdhrit të regjistruesit*", me UKM 2 datë 13.06.2013 "*Për mënyrën e procedimit të organeve të administratës publike, për pasuritë e paluajtshme, të fituara me Aktin Marrjes Tokës Pronësi"***,** me shkresën 7217/3 date 15.07. 2021 te DP ASHK, me nenin 68 "*Bashkëpunimi ndërinstitucional"* te ligjit nr. 111.2018 "*Për kadastrën*", përforcuar edhe me vendimin 1040 date 25.11.2020, kreu I/ 5, me ligjin nr. 20/2020, me VKM nr. 994 date 09.12.2015 "*Për procedurën e regjistrimit te akteve te marrjes se tokës ne pronësi"*, pika 1/a,b, ç etj, me Kreun II, neni 119 "*Pavlefshmëria akteve*" Kodi Procedurës Civile, me nenin 193 të ligjit 7850 datë 29.7.1994 "*Kodi Civil RSH*" ndryshuar.
- Për mangësitë dhe parregullsitë e AMTP mbajnë përgjegjësi **komisioni i tokave, kryepleq fshati dhe kryetar komune:** E H, Sh .S, A.V, M.L, J.F, Xh.H, R.D.
-Për **njësinë administrative Zall-Bastar,** për mangësitë ne dokumentacion, relacionet e pjesshme, shkeljet e afateve, mos-menaxhimin e parcelave shtet, shmangien e pjesshme te taksës tokës bujqësore, mos-sqarimin e sipërfaqeve problematike, mbajnë përgjegjësi ish-administratori G.S , specialist i ZAMT E P **,** V.H, O.S, juriste A.R, R.K, N.D, *sipas periudhave qe kane ushtruar detyrat funksionale.*

*Për sa më sipër më hollësisht është mbajtur Projektraport Auditimi nisur në subjekt me nr. 118/5, datë 01.06.2023, për të cilin në fazën e hartimit të Raportit përfundimtar të Auditimit, janë paraqitur observacione me nr. 118/8, datë 15.06.2023 nga Njësia Administrative Zall-Bastar.*
***- Në lidhje me pretendimin se:** për rastin M L nuk ka pengesë ligjore për përcjellje të dokumentacionit në ASHK.*
***Në qëndrimet e Grupit të auditimit** të KLSH argumentojmë se:* ***observacioni nuk qëndron*** *pasi lidhur me relacionin shpjegues date s,ka (2020), për saktësimin e 2* pasurive nr. 1136 dhe nr. 1111, ZK 1124*, 3 pasurive tokës bujqësore përfituar me AMTP date 22.06.1992, ne emër M.L , ku ne fakt ato i përkasin personave tjerë, sipas shkresës 4861/1 date 07.02.2020 Bashkisë dhe Hartës.*
***- Në lidhje me pretendimin se:** Për rastet e observuara te pa justifikuara që kundërshtojnë trajtimeve tona ne Projektraport Auditimi.*
***Në qëndrimet e Grupit të auditimit** të KLSH argumentojmë se:* ***observacionet nuk qëndrojnë*** *pasi:*
*- relacionet shpjeguese te njësisë, te cilat janë te pjesshme dhe me mangësi ne dokumentacion, për pasoje janë bere objekt rikthimi nga ASHK dhe Bashkia nuk konsiderohet komunikim shkresor;*

*-në projektraport nuk ka cilësime për ç fuqizim aktesh nga Njësia Administrative po janë cilësuar shkeljet ligjore në plotësimin edhe hartimin e dokumentacionit të kërkuar ligjor;*
*- për relacionin shpjegues 15.11.2020 te njësisë Zall-Bastar si dhe raste të tjera nuk sqarohen diferencat e sipërfaqeve midis AMTP dhe Vërtetimit taksave vendore, ndryshe nga rastet tjera, pra konstatojmë sjellje shkresore me 2 standarde.*
*-me rastin A. Ç. kartelat pasqyrojnë sipërfaqe me te mëdha krahasuar me AMTP dhe plan rilevimet dhe formularin 6, për 5 pasuri;*
*- konstatojmë se ka mos-menaxhimin dhe mos-administrimin të parcelave shtet, si rezultat i diferencave tepër midis AMTP-Terrenit dhe diferencave midis legalizimit- zaptimit te sipërfaqeve.*

**XII. *2019 - B V,*** ZVRPP Tiranë me nr. 3227, datë 20.01.2019, për kërkesën e B V sipas aplikimit nr. 340, datë 04.01.2019 për regjistrimin e AMTP për këtë subjekt dërguar nga pushteti lokal me nr. 19573, datë 13.06.2018.
Njësia Adminastrative Zall-Bastar me nr. 4, datë 03.01.2019 drejtuar ZVRPP Tiranë ka dërguar saktësimin e hartës për regjistrim të parcelës së B V; me nr. 4/4, datë 09.08.2019 për DV ASHK Rurale 1 ka dërguar relacionin datë 09.08.2019.
- Në relacionin shpjegues datë 09.08.2019 *"Për tokën bujqësore të regjistruar në emër të B V"*, hartuar nga E P specialit e ZAMT dhe J F Kryetar i Fshatit Zall-Bastar, është cilësuar:
Toka Bujqësore në emër të familjes bujqësore B V është përfituar me AMTP datë 10.06.1992 në bazë të ligjit nr. 7501, datë 19.07.1991 "Për Tokën", e regjistruar në nr. 6 të fshatit Zall-Bastar me faqe 13 me nr. rendor 151, për sipërfaqe 7250 $m^2$ kategoria VI. Familja bujqësore e përfaqësuar nga B V në datë 01.08.1991 figuron me 6 anëtarë. Norma për frymë e fshatit Zall-Bastar është 1200 $m^2$.
H B V, Bashkim B V, P H, B V janë fëmijët e B V dhe janë përfshirë në familjen bujqësore B V që ka përfituar tokë bujqësore sipas AMTP pa nr. datë 10.06.1992.
- Në praktikën dokumentare janë:
1. AMTP me nr. ..., datë 10.06.1992 për familjen bujqësore *B V*, fshati Zall-Bastar për tokë gjithsej 7250 $m^2$, në 6 parcela dhe 1 parcelë truall për 250 $m^2$. Nënshkruar nga Kryetari i Komisionit të Tokës në Fshat A D dhe Përfaqësuesi i Rrethit D B.
2. AMTP me nr. 34, datë 18.08.2000 për familjen bujqësore *H B V*, fshati Zall-Bastar për tokë gjithsej 5635 $m^2$, në 6 parcela nga të cilat 1 parcelë pemëtore për 275 $m^2$. Nënshkruar nga Kryetari i Komisionit të Tokës në Fshat M F dhe Përfaqësuesi i Rrethit E P .
3. AMTP me nr. 276, datë 18.08.2000 për familjen bujqësore *P B V*, fshati Zall-Bastar për tokë gjithsej 5980 $m^2$, në 6 parcela nga të cilat 1 parcelë pemëtore për 490 $m^2$. Nënshkruar nga Kryetari i Komisionit të Tokës në Fshat M F dhe Përfaqësuesi i Rrethit E P .
4. AMTP me nr. 63, datë 18.08.2000 për familjen bujqësore *B B V*, fshati Zall-Bastar për tokë gjithsej 5462 $m^2$, në 5parcela. Nënshkruar nga Kryetari i Komisionit të Tokës në Fshat M F dhe Përfaqësuesi i Rrethit E P .

***Konkluzion***
Sipas Certifikatës familjare gjendje në datë 01.08.1991, Familja bujqësore e përfaqësuar nga B V, figuron me 6 anëtarë. Norma për frymë e fshatit Zall-Bastar është 1200 $m^2$. Për sa më lart AMTP nr. 34, datë 18.08.2000; nr. 276, datë 18.08.2000; nr. 63, datë 18.08.2000 janë lëshuar në kundërshtim me ligjin nr. 7501, datë 19.07.1991 "Për Tokën", me VKM nr. 994, datë 9.12.2015 "Për procedurën e regjistrimit të akteve të marrjes së tokës në pronësi" dhe ngarkojnë me përgjegjësi Kryetarin e Komisionit të Tokës në Fshat M F dhe Përfaqësuesi i Rrethit E P .

**XIII. 2019-B R**, ka aplikuar pranë DV ASHK Tirana Rurale 1, me nr. 67536, datë 01.08.2019, për kalimin e pronësisë sipas dokumentacionit të përcjellë për regjistrim nga Njësia Administrative Zall-Bastar me shkresë nr. 712, datë 28.12.2015.

- DV ASHK Tirana Rurale 1, me nr. 6303, datë 07.10.2019, ka kërkuar nga Njësia Administrative Zall Bastar: – Depozitimin e një relacioni shpjegues ku të sqarohet se përse AMTP është plotësuar në emër të B R, ku në certifikatën e datës 01.08.1991 kryefamiljar është B R. Në dokumentacionin e paraqitur keni bashkëlidhur fotokopjet e 2 AMTP, konkretisht AMTP me nr. 63, datë 30.05.2002 në emër të H R me sipërfaqe totale prej 5050 m$^2$ dhe nr. 64, datë 30.05.2020 në emër të B R me sipërfaqe totale 5150 m$^2$. Në arshivën e DV ASHK Tirana Rurale 1 nuk rezultojnë të depozituara këto AMTP.

- Njësia Administrative Zall-Bastar me nr. 1431/1, datë 17.10.2019 ka dërguar në DV ASHK Tirana Rurale 1, Relacionin Shpjegues "Mbi tokën bujqësore të regjistruar me AMTP në emër të H R" – *prona tokë bujqësore në emër të familjes bujqësore H R ndodhet në fshatin Shëngjin i Vogël, Njësia Administrative Zall-Bastar ZK 3398, Familja e B R me datë 01.08.1991 ka qënë pjesë e prindërve të tij me kryefamiljar H R dhe në datë 24.07.1996 është ndarë familje më vete. Për këtë arsye është trajtuar me tokë në vitin 2002 si familje e veçantë me AMTP nr. 64, datë 30.05.2002, me sipërfaqe 5150 m$^2$ nga e cila 4950 m$^2$ tokë " arë" dhe 200 m$^2$ tokë " truall".*

Familja H R është trajtuar me tokë me AMTP nr. 63, datë 30.05.2002, me sipërfaqe 5050 m$^2$, nga e cila 4800 m$^2$ tokë " arë" dhe 200 m$^2$ tokë " truall".

***Konkluzion***

Për sa më lart nga Njësia Administrative Zall-Bastar në relacionin shpjegues nuk ka sqaruar pajisjen me AMTP familje bujqësore me gjendje pas datës 01.08.1991, nuk ka sqaruar normën për frymë të tokës bujqësore dhe të argumentonte zbatimin e saj.

AMTP nr. 64, datë 30.05.2020 në emër të B R me sipërfaqe totale 5150 m$^2$ është lëshuar në kundërshtim me ligjin nr. 7501, datë 19.07.1991 "Për Tokën", me VKM nr. 994, datë 9.12.2015 "Për procedurën e regjistrimit të akteve të marrjes së tokës në pronësi" dhe ngarkojnë me përgjegjësi Kryetarin e Komisionit të Tokës në Fshat I H dhe Përfaqësuesi i Rrethit E P .

**XIV. *2020-G M*** Njësia Administrative Zall Bastar datë 23.11.2020 ka hartuar në Relacion Shpjegues mbi rakordimin e sipërfaqeve të ngastrave me pronar z. G M. Nënshkruar nga E P specialist në ZAMT dhe J F Kryetar i Fshatit Zall Bastar. Konkludon: Nga verifikimet e pronave në emër të familjes bujqësore G M ndodhur në fshatin Zall Bastar ZK 3884, të regjistruara sipas azhornimit të vitit 1998 me AMTP nr. 33, datë 25.08.2000 dhe jo sipas emrave tradicionale e jo sipas ndarjes së tokës me ligjin nr. 7501, datë 19.07.1991 "Për Tokën".

- Njësia Administrative Zall Bastar datë 05.01.2021 në Relacionin Shpjegues nënshkruar nga E P Specialist në ZAMT dhe J F Kryetar i Fshatit Zall Bastar ka përcaktuar:

Pronat (tokë bujqësore) në emër të familjes bujqësore G M ndodhet në fshatin Zall Bastar ZK 3884 Njësia Administrative Zall Bastar, janë regjistruar sipas AMTP nr. 33, datë 25.08.2000 e plotësuar nga Komuna Zall Bastar sipas azhurnimit të tokës në vitin 1998 në kufijtë e vjetër para kolektivizimit dhe jo sipas ligjit nr. 7501, datë 19.07.1991 "Për Tokën".

Sipërfaqja e ngastrave sipas AMTP është 12075 m$^2$, ndërsa sipas formularit nr. 6 të fshatit Zall Bastar ka 6000 m$^2$. Nga ku rezulton një diferencë prej 6075 m$^2$ është mbivendosje e ardhur nga sipërfaqja që ju është dhënë banorëve sipas ligjit nr. 7501, datë 19.07.1991 "Për Tokën".

- Njësia Administrative Zall Bastar me nr. 67/1, datë 15.01.2021 lënda: "Përcjellje për regjistrim, referuar ligjit nr. 7501, datë 19.07.1991 "Për tokën" i është drejtuar Drejtorisë së Administrimit të Njësive Administrative dhe AMTP-ve Bashkia Tiranë, përcjelljen e praktikës së plotësuar në emër të G M.

- Drejtoria e Administrimit të NJA-ve dhe AMTP-ve Bashkia Tiranë me nr. 2405/1, datë 27.01.2021 "Kthim Dokumentacioni" bazuar në AMTP nr. 33, datë 25.08.2000në emër të G M gjatë shqyrtimit të dokumentacionit rezulton se:

- AMTP është në emër të G M i cili është anëtar i familjes bujqësor nga ku sipas certifikatës datë 01.08.1991 është kryefamiljar Z M, *të konfirmohet nëse ka tapi të tjera për këtë familje.*

- Planet e rilevimit të pasurive nr. 2/9 dhe 2/11 i përkasin ZK 1309, fshati Bulcesh dhe jo në ZK 3884, *mbasi të rregullohen të firmosen nga kryetari i Fshatit Bulcesh.*

- Plani i rilevimit për pasurinë 28/8 që i përket rreshtit nr. 4 në AMTP nr. 33, datë 25.08.2000, ka sipërfaqe 1550 $m^2$ nga të cilat 1250 $m^2$ janë pemëtore dhe 300 $m^2$ truall.

*Sa sipër sillni dokumentacionin e plotësuar me mangësitë e shënuara.*

***Konkluzion***

Për sa më sipër ka mangësi dokumentare dhe nuk ka sqarime të dokumentuar:

-për pasuritë nr. 2/9 dhe 2/11 që i përkasin ZK 1309, fshati Bulcesh dhe jo në ZK 3884 Fshati Zall Bastar, të cilat sipas ASIG nuk janë tokë bujqësore që të mund aplikohej ligji nr. 7501, datë 19.07.1991 "Për Tokën".

- për pasurinë 28/8, me sipërfaqe 1550 $m^2$ sipas planit të rilevimit datë 12.11.2020 dhe sipas rreshtit nr. 4 në AMTP nr. 33, datë 25.08.2000 për 1250 $m^2$ pemëtore dhe 300 $m^2$ truall.

Veprime në kundërshtim me VKM nr. 994, datë 9.12.2015 "Për procedurën e regjistrimit të akteve të marrjes së tokës në pronësi" dhe ngarkojnë me përgjegjësi Kryetarin e fshatit Bastar i Mesëm XH H, Specialist i ZAMT E P .

**XV.** ***2021-Trashëgimtarët "Sh"*** Me kërkesë nr. 10, datë 06.01.2021 nga i janë drejtuar Zyrës së Administrimit dhe Mbrojtjes së Tokës (ZAMT) Njësia Administrative Zall Bastar, për saktësimin e vendodhjes së pasurisë nr. 93, vol 1, faqe 93 ZK 3775 me sipërfaqe 6000 $m^2$ fshati Vilëz Njësia Administrative Zall Bastar.

- Njësia Administrative Zall Bastar me nr. 130/1, datë 22.02.2021 Lënda: Mbi saktësimin e vendodhjes së pasurisë në emër të bashkëpronarëve "Shtufi", i është drejtuar Drejtorisë Vendore të ASHK Rurale 1 si dhe për dijeni "Bashkëpronarëve Shtufi", ku përcaktohet:

Duke u bazuar në dokumentacionin e paraqitur nga "Bashkëpronarët Sh", si dhe verifikimi në terren rezulton se pretendimi i tyre është i drejtë pasi pasuria "Tokë bujqësore" me sipërfaqe 6000 $m^2$ ndodhet në fshatin Vilëz ZK 3775 me nr. Pasurie 711 me kufizime V. Nr. 713; L. Nr. 714; J. Nr. 712; P. Nr. 713, e përcaktuar edhe në Plan Rilevimi përgatitur nga Gjeodeti A P dhe nënshkruar nga Kryetari i Fshatit Vilëz, Specialist në ZAMT dhe Administratori i Njësisë Administrative Zall-Bastar.

- Drejtoria Vendore e ASHK Tirana Rurale 1 me shkresën nr. 5139, datë 29.06.2021 Lenda: Njoftim Bashkisë Tiranë Njësia Administrative Zall-Bastar, për dijeni XH SH ku përcaktohet: referuar plan rilevimit që paraqitet tani për saktësim sipërfaqja prej 6000 $m^2$ "arrë" e regjistruar me nr. 93, pozicionohet në pasurinë me nr. 711 e regjistruar nga regjistrimi fillestar në vol. 3, faqe 211 me gjendje referuar aktit l.n. 6600 $m^2$ "arrë" në pronësi të A H fakt që nga Njësia Juaj nuk është marrë parasysh. Në këto kushte bazuar në ligjin nr. 111/2018 "Për kadastrën" *nga ana Juaj si njësi Administrative kërkojmë sqarimin e problematikës së dalë, deklaratë noteriale të pronarëve që preken nga ky saktësim si dhe plan rilevimet ku azhornohen pasuritë e secilit pronar sipas gjendjes faktike në terren.*

***Konkluzion***

Nga Njësia Administrative Zall Bastar nuk ka praktikë në përgjigje të kërkesës së DV ASHK, nuk ka azhornim faktik të pasurive të regjistruara në ASHK me nr. 93, vol 1, faqe 93 ZK 3775 me sipërfaqe 6000 $m^2$ fshati Vilëz dhe nr. 711 vol. 3, faqe 211. 6600 $m^2$ "arrë" për saktësimin e gjendjen e pasurisë së poseduar faktikisht në terren veprime në kundërshtim me nenin 38 të ligjit nr. 111/2018, çka ngarkon me përgjegjësi Specialisti ZAMT E P dhe Kryetari Fshatit Vilëz F K.

**XVI.** ***2021- R I,*** Njësia Administrative Zall Bastar me nr. 774, datë 22.04.2021 lënda: "Dërgim dokumentacioni" i është drejtuar DV ASHK Tirana Rurale 1 për dërgim dokumentacioni në emër të R I , Vërtetim pronësia me nr. 5598; Plan rilevimet; Relacion shpjegues datë 15.04.2021.

- *Në vërtetimin* e lëshuar nga DVASHK Tirana Rurale 1 nr. 5598, datë 21.05.2018 nga verifikimi i sistemit digjital në emër të R I t figurojnë të regjistruara pronat për 4406 $m^2$, tokë arë, 75 $m^2$ pemëtore dhe 300 $m^2$ truall si më poshtë:
Pasuria nr. 1001, vol 4, faqe 37, ZK 1124 "arrë" për 948 $m^2$,
Pasuria nr. 1002, vol 4, faqe 38, ZK 1124 "arrë" për 75 $m^2$,
Pasuria nr. 1002/1, vol 4, faqe 39, ZK 1124 "truall" për 300 $m^2$, me 50 $m^2$ "ndërtesë"
Pasuria nr. 1074, vol 4, faqe 40, ZK 1124 "arrë" për 2437 $m^2$,
Pasuria nr. 1078, vol 4, faqe 41, ZK 1124 "arrë" për 526 $m^2$,
Pasuria nr. 1075, vol 4, faqe 37, ZK 1124 "arrë" për 120 $m^2$,
- *Në relacionin shpjegues datë 15.04.2021* nënshkruar nga Kryetari i fshatit Bastar i Mesëm XH H dhe Specialist i ZAMT E P përcaktohet se Familja R I ndodhet në Fshatin Bastar i mesëm dhe nuk ka përfituar tokë sipas ligjit 7501 në Fshatin Bastar i mesëm, me paraqitjen e vërtetimit nr. 5598, datë 21.05.2018 nga DVASHK Tirana 1, rezulton të ketë regjistruar në ZK 1124 pasuri prej 4406 $m^2$ tokë arrë; 75 $m^2$ pemëtore dhe 300$m^2$ truall, pasuri të regjistruara me azhurnimin e vitit 1998 sipas kufijve të vjetër të para kolektivizimit dhe vijnë në kundërshtim me ndarjen e tokës në përputhje e zbatim të ligjit 7501, datë 19.07.1991 "Për Tokën".
Dokumentacioni nga Njësia Administrative Zall Bastar me nr. 774, datë 22.04.2021 lenda: "Dërgim dokumentacioni" i është drejtuar DV ASHK Tirana Rurale 1.

***Konkluzion***

Në momentin e auditimit nuk ka dokumentacion për ecurinë dhe reflektimin e situatës faktike në lidhje me këto pasuri. Nuk ka shpjegime të dokumentuara në relacion mbi ecurinë e ndarjes së tokës për këto parcela në zbatim të ligjit 7501, datë 19.07.1991 "Për Tokën".
Për sa më lart kemi mos zbatim të: ligjit nr. 7501, datë 19.07.1991 "Për Tokën"; Ligjit nr. 20/2020 "Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë".
Kanë nënshkruar relacionin: Kryetari i fshatit Bastar i Mesëm XH H dhe Specialist i ZAMT E P .
Për shkeljet e konstatuara ngarkohen me përgjegjësi:
E P , si Përfaqësuesi i Rrethit, aktualisht si Specialist ZAMT; I H, XH H dhe F K Kryetarë të Komisioneve të Tokës në Fshat.
*Për sa më sipër më hollësisht është mbajtur Projektraport Auditimi nisur në subjekt me nr. 118/5, datë 01.06.2023, për të cilin në fazën e hartimit të Raportit përfundimtar të Auditimit, janë paraqitur observacione me nr. 118/9, datë 23.06.2023 nga ish-Administratori G S dhe me nr. 118/8, datë 15.06.2023 nga Njësia Administrative Zall-Bastar dhe me nr. 118/10, datë 27.06.2023 nga E P .*
**- Në lidhje me pretendimin se:** *për rastin e referencave ligjore të pa cituara,* ***Në qëndrimet e Grupit të auditimit*** *të KLSH argumentojmë se:* ***observacioni nuk qëndron*** *pasi në çdo rast për shkeljet e konstatuara në projektraport janë cituar specifikisht shkeljet në referenca ligjore konkrete.*
**- Në lidhje me pretendimin se:** *për rastin e ngarkimit me përgjegjësi të ish-Administratorit observacioni merret në konsideratë.*
**- Në lidhje me pretendimin se:** *në rastin e mos plotësimit të dokumentacionit për regjistrim ASHK njofton të interesuarin e jo NJA; vonesat në paraqitjen e dokumentacionit nuk janë përgjegjësi e Njësisë Administrative; në çdo rast kemi paraqitur dokumentacionin e plotë; me hyrjen në fuqi të ligjit 20/2020 përcjellja e AMTP-ve nuk bëhet nga Njësia Administrative; rakordimi i diferencave të shpërfaqjes të disponuara me sipërfaqet që taksohen nuk është kërkesë ligjore për Njësinë Administrative;*
***Në qëndrimet e Grupit të auditimit*** *të KLSH argumentojmë se:* ***observacioni nuk qëndron*** *pasi në çdo rast për shkeljet e konstatuara në projektraport janë cituar specifikisht shkeljet në referenca ligjore konkrete.*

## IV. GJETJE DHE REKOMANDIME

## A- NJËSIA ADMINISTRATIVE KASHAR

## MASA ORGANIZATIVE

**1. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi u konstatua se Njësia Administrative Kashar:
**a. nuk disponon listën e sipërfaqeve tokës tepër kaluar "shtet" nga ASHK,** sipas subjekteve private **objekt i legalizimeve**, për diferencat midis pjesës te zaptuar me pjesën e legalizuar.
**b. nuk disponon listën e sipërfaqeve tokës tepër kaluar "shtet" nga ASHK,** sipas subjekteve private **objekt i AMTP**, për diferencat midis AMTP dhe matjeve ne terren ku sipërfaqja rezulton me e madhe se AMTP. Kështu parcelëzat "shtet" kane mbetur në posedim dhe shfrytëzim në mënyrë të paligjshme nga subjektet private, pa asnjë detyrim, taksë apo qira për buxhetin *(Me hollësisht trajtuar në faqet 24-55. të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*
**<u>1.1. Rekomandimi:</u>** Njësia Administrative Kashar **ne bashkëpunim me ASHK te marre masa për administrimin e sipërfaqeve tepër toke "shtet", diferenca midis pjesës zaptuar me atë legalizuar** dhe **midis AMTP dhe sipërfaqes ne terren**, te cilat kane kaluar shtet nga ASHK.

***Në vijimësi***

**2. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi u konstatua se ***Ne 4 raste (****para periudhes auditimit***),** **toka bujqesore e shperndare me AMTP ne Kashar nuk i ka sherbyer qellimit te ligjit** nr. 7501 date 19.07.1991 *"Per token"* dhe ligjit nr. 9244 date 17.06.2004 *"Per mbrojtjen tokes bujqesore",*per ruajtjen, mbrojtjen, permiresimin pjellorise tokes, per funksionet natyrore te saj si krijuese bazes jetes per jetesen e njerzve, per prodhimin e drithrave dhe perimeve bujqesore, per rritjen e sigurise dhe rezervave tyre ne mireqenien e komunitetit, **pasi ka sherbyer si biznes shitje-blerje, ku mbi te jane ngritur ndertime pa leje dhe me leje,** ne dem mbrojtjes tokes dhe planifikimit, zhvillimit territorit e infrastruktures, per periudhen 30-vjeçare (1992-2022), konkretisht:
- *sipërfaqe bashkuar 50478 m2 "are", pasuria 181/17, ZK 2105, vol 1, faqe 40, referencë 17 date 17.12.1998***,**
- *sipërfaqe bashkuar 16000 m2 are, reference 4923 date 13.01.2020,*
- *sipërfaqe 2000 m2 "are", pasuria 974/2, ZK 2105, vol 9, faqe 226, AMTP 150/1992,*
- *sipërfaqe 4470 m2 "are", pasuria 1182/11, ZK 2105, vol 15, faqe 136, AMTP 371 date 01.07.1992***,** *referencë 95 date 23.05.2002.*
**-** Shitblerja e tokes bujqesore e shperndare me AMTP, bie ndesh me nenin 2 te ligjit nr. 7501 date 19.07.1991 "*Per token*",
-Zenia dhe demtimi i tokes bujqesore nga ndertimet e paligjshme, bie ndesh me nenin 10 dhe 14 te ligjit 9244 date 17.06.2004 "*Per mbrojtjen tokes bujqesore"* dhe me nenin 21 ligjit nr. 7501 date 19.07.1991 "*Per token*" *(Me hollësisht trajtuar në faqet 24-55. të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*
**<u>2.1. Rekomandimi:</u>** Njësia Administrative Kashar në bashkëpunim me Bashkinë Tiranë të marrë masa për mbrojtjen e tokës bujqësore nga ndërtimet e pa ligjshme.

***Në vijimësi***

**3. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi u konstatua se në **1 rast, nuk disponohet dokument për arkëtimin e vlerës 1,433,600 leke nga familjaret H V, ne zbatim te vendimit nr. 47** date 31.01.2017 te KVVTP, pasi pasuria nr. 154 për 3200 m$^2$ "are" e AMTP 331/1996 është shpallur me pavlefshmëri plote, ndërsa ajo është shitur treteve, pasuria nr. 1154/38, vol 17, faqe 111,

ZK 2105, ne kundershtim me ligjin 9948 datë 7.07.2008 "*Për Shqyrtimin vlefshmërisë ligjore krijimit titujve pronësisë mbi tokën bujqësore"* ndryshuar, me ligjin 7501 datë 19.7.1991 "*Për tokën*" *(Me hollësisht trajtuar në faqet 24-55. të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*
**3.1. Rekomandimi:** Njësia Administrative Kashar në bashkëpunim me Bashkinë Tiranë te marre masa për sigurimin e dokumentit të arkëtimit vlerës **1,433,600 leke** nga familjaret e H V**,** ne zbatim te vendimit nr. 47 date 31.01.2017 te KVVTP, pasi pasuria nr. 154 për 3200 m2 "are" e AMTP 331/1996 është shpallur me pavlefshmëri te plote.

***Menjëherë***

**4. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi u konstatua se në **1 rast se mungon dokumenti qe vërteton se sipërfaqja 5150 m2 e B S ka kaluar pronësi "shtet"**, pasi është toke pa frutë (PF) sipas AMTP nr. 711/69, date 20.05.1996, shfuqizuar me vendimin e gjykatës administrative shkalles pare Tirane nr. 2568 date 09.06.2017 dhe vendimit nr. 11 date 31.01.2017 te KVVTP Tirane *(Me hollësisht trajtuar në faqet 24-55. të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*
**4.1. Rekomandimi:** Njësia Administrative Kashar në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme e Objekteve në Bashkëpronësi, Administrimit të NJA-ve dhe Emergjencave Civile (DANJ-ve/AMTP-ve), Bashkia Tiranë, **dhe me ASHK te siguroje dokumentin (KPP),** për sipërfaqen 5150 m2 nëse ka kaluar pronësi "shtet", ne zbatim vendimit gjykatës administrative shkalles pare Tirane nr. 2568 date 09.06.2017 dhe vendimit nr. 11 date 31.01.2017 KVVTP Tirane, lidhur me AMTP 711/69 date 20.05.1996. Të marrë masa **për menaxhimin dhe administrimin e sipërfaqes 5150 m$^2$ "shtet".**

***Menjëherë***

**5. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi u konstatua se ne relacionin shpjegues nr. 1242 date 17.06.2020 te njësisë Kashar **nuk sqarohet diferenca 1700 m2 truall** *(2000-300),* pasi subjekti E S ne mënyre te paligjshme ka përfituar 2000 m2 truall sipas AMTP 151 date 01.10.1992 dhe formularit 6, ne vend te 300 m2 truall e pasqyruar ne listën e trojeve 001 *(Me hollësisht trajtuar në faqet 24-55. të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*
**5.1. Rekomandimi:** Njësia Administrative Kashar në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme e Objekteve në Bashkëpronësi, Administrimit të NJA-ve dhe Emergjencave Civile (DANJ-ve/AMTP-ve), Bashkia Tiranë **te marre masa për verifikimin dhe sistemimin e diferencës 1700 m2 truall**, pasi ne listën e trojeve pasqyrohet 300 m2 truall dhe jo 2000 m2 sipas AMTP dhe formularit 6, ku trualli nuk është objekt i tyre.

***Menjëherë***

**6. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi u konstatua se n***e 3 raste* paraqiten vonesa te pajustifikuara ne korrespondencat midis institucioneve njësi-bashki-subjekt-ASHK,** pasi procedura e sqarimit te problemeve te AMTP-ve ka zgjatur nga viti 2017 deri 2022 dhe vazhdon ne proces, konkretisht:
** lidhur me AMTP date 17.05.1996, ne emër T G, fshati Katund Ri***,** *për sqarimin e 2 pasurive te AMTP, rezulton se 3-4 here janë kthyer dhe rikthyer dokumentet nga bashkia dhe ASHK ne adrese te njësisë Kashar. Po kështu është ripërsëritur korrespondencave me ASHK, me Dhomën Avokatisë dhe subjektin, çka ka detyruar këta te fundit te ankimohet ne bashkinë Tirane dhe Kryeministri, sipas shkresës nr. 55/10 date 21.01.2021.*
** lidhur me AMTP 150/1992 ne emër XH S sqarimi ka zgjatur nga viti 2017 deri 2020 dhe vazhdon, sipas shkresave bashkisë ne adrese njësisë Kashar nr. 1160/1 date 16.01.2018, nr. 1160/3 date 21.02.2018, nr. 42503/1 date 13.11.2019 dhe nr. 6319/3 date 30.10. 2020 ejt.*
** lidhur me AMTP nr. 65 ne emër M L* **,** *procedura e sqarimit problemeve pasurive paraqet zgjatje pa mbarim, pasi subjekti disponon 2 AMTP te parregullta ne formë, përmbajtje dhe*

*mangësi e korrigjime, nuk pasqyrojnë kufitaret, mungon nënshkrimi i k/komisionit tokës dhe marrësit tokës ((Me hollësisht trajtuar në faqet 24-55. të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**6.1. Rekomandimi:** Njësia Administrative Kashar **të marrë masa** , të përcjell AMTP-të për regjistrim, në Drejtorinë Vendore të ASHK Rurale 2, në afat dhe pasi të ketë shqyrtuar vlefshmërinë tekniko-ligjore të titullit të pronësisë të krijuar mbi tokën bujqësore (AMTP-së), pa verifikuar dhe shqyrtuar dokumentacionin kadastral që disponon Njësia Administrative Kashar.

***Në vijimësi***

**7. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi u konstatua se në **19 raste** Njësia Administrative Kashar **paraqet relacione shpjeguese te pjesshme, pa sqaruar gjitha problematikat, pa dokumentacion te plote** tekniko-ligjor shoqërues**,** çka janë bere objekt kthimi dhe rikthimi nga Bashkia Tiranë dhe ASHK, duke ndikuar ne dem zgjidhjes kërkesave subjekteve ne regjistrimin e pronave përfituara me AMTP, konkretisht:

- ***ne 3 raste, relacionet nuk sqarojnë pasuritë e shpërndara me AMTP, te cilat ndodhen midis 2 fshatrave*** Kashar dhe Katund Ri, ***ne vend te 1 fshati ku banon përfituesi AMTP***, përkatësisht:

** AMTP 151 date 01.10.1992, E S, ku pasuria nr. 156 për 1400 m2 sipas planrilevimit 21.05.2020 ndodhet ne Katund i ri, ne vend te fshatit Kashar ku është banor personi. Mungon dokumenti qe sqaron sipërfaqet ne secilin fshat. Subjekti disponon edhe AMTP tjetër për te cilën nuk flitet asgjë ne relacionin shpjegues 1242 date 17.06.2020, kërkese kjo e Bashkisë Tirane sipas shkresës saj nr. 19799/1 date 26.06.2020.*

******* *AMTP 150/1992 për XH S, pasuria 156 prej 1200 m2 ndodhet midis 2 fshatrave Kashar dhe Katund i ri, ne vend te fshatit Kashar.*

** AMTP dublikate 331/1996, pasuria 154 për 3200 m2 are, shpallur me pavlefshmëri te plote, sipas vendimit nr. 47 date 31.01.2017 te KVVTP, pasi toka me 01.08.1991 dhe 01.10.1992 ndodhet ne fshat tjeter Katundi Ri, pra jashte fshatit Kashar ku ben pjese banori H V.*

- ***ne 7 raste, relacionet nuk sqarojnë diferencat e sipërfaqeve dhe sistemimin e tyre, midis AMTP - formularit 6 - planrilevimeve,*** përkatësisht:

** AMTP 127 date 01.10.1992 për 8550 m2 për H S, rezulton me e madhe 11550 m2 dhe nuk përputhet me formularin 6. Parcela 7 e AMTP 127 prej 3000 m2 prek pasurinë 1436 "kanal" dhe nuk sqarohet.*

******* *AMTP nr. 50/1992 për 34700 m2, R S rezulton se nuk rakordon sipërfaqja AMTP me formularin 6, madje pasuria 125 AMTP për 8500 m2 ka shume pronar dhe ka qene objekt konfliktesh.*

** AMTP 18 për 37300 m2 dhe AMTP 581 /1994 për 2750 m2 e R L, paraqet korrigjime, formulari 6 ka korrigjime tek sipërfaqet e pasurive. Paraqitet tejkalim i normës për fryme nga 3500 m2/fryme ne 5328 m2/fryme, dhe njësia në relacionin shpjegues 3800/1 date 04.11.2020 i ka pasqyruar këto parregullsi, por nuk ka sqaruar sistemimin "shtet" te diferencës se sipërfaqes mbi normën për fryme dhe nuk komenton AMTP 581/1994 me sipërfaqe 2750 m2.*

** AMTP 539 date 23.06.1992, R H, Dublikate rezulton se nuk përputhet me origjinalin, pasi pasqyron me shume sipërfaqe prej 18547 m2 nga 16150 m2 qe duhej si dhe 8 numër pasurish nga 5 qe ishin.*

******* *nuk flitet ne relacionin nr. 4944/43 date 19.02.2020 dhe nr. 4944/5 date 16.04.2020 për pasurinë me 1000 m2 are E E , te AMTP date 25.07.1994, pasi disponon 2 AMTP.*

** ne relacioni shpjegues nuk flitet për sipërfaqen 3000 m2. Keshtu vërtetimi nr. 4331/1 date 05.11.2021 i njësisë Kashar flet për pajisjen me toke te S D t, por nuk përcakton 2 aktet AMTP dhe sipërfaqen qe i takon dhe sa ka marre sipas numrit frymëve.*

******* *Nuk rakordon AMTP 184/1996 me 3200 m2 ne emër P K , fshati Katund i Ri me formularin nr. 6 qe pasqyron 4000 m2 (diferenca "ullishte" nga 1200 m2 ne AMTP ne 2000 m2 tek formulari), madje nuk ka shpjegim për regjistrimin e saj.*

***- Ne 4 raste, dokumentacionin tekniko-ligjor shoqërues i relacioneve shpjeguese paraqitet me mangësi dhe parregullsi,*** përkatësisht:
**  nuk disponohet AMTP e 2-te ne emër E S  dhe nuk flitet asgjë për këtë AMTP ne relacionin shpjegues te njësisë Kashar nr. 1232/1 date 17.06.2020, megjithëse është kërkese e Bashkisë Tirane, sipas shkresës nr. 19799/1 date 26.06.2020. Për rrjedhoje nuk sqarohet plotësimi me toke  sipas normës/fryme. Nuk disponohet deklarata noteriale e subjektit,*
** nuk disponohet AMTP për  A H. Mungon vendimi i KVVTP për vlefshmërinë e 2 AMTP, pasi ka nisur procedura e shqyrtimit, sipas shkresës Njësisë  1201 date 13.04.2010, shkresës Prefekturës 1731/1 date 08.07.2010 dhe 1731/20 date 19.05 2014.*
** mungon Formulari nr. 6 lidhur me AMTP 108/1995.*
** mungon Formulari nr. 6, kërkese kjo edhe bashkisë Tirane, sipas shkresës nr. 15791/1 date 26.05.2020 dhe nr. nr. 15791/3 date 09.07.2020 lidhur me 2 AMTP, A.B., Yzberish,*
***- Ne 1 rast, Njësia Kashar nuk sqaron llojin e pasurisë 299/ për 800 m2 te AMTP 108/1995,*** *emër të XH F, pasi ne relacionin 4146/1 date 21.12.2020 përcaktohet "are", ndërsa planrilevimi 30.10.2020 nuk përcakton llojin e pasurisë, pra bie relacioni. Fakt për ketë është shkresa e mëvonshme 4164/3 date 18.01.2021 ne adrese KQ Tirane, ku njësia kërkon zërin kadastral te kësaj parcele, bazuar ne regjistrin e kadastrës datës 01.08.1991 (ne proces).*
***- Ne 1 rast, Njësia Kashar nuk sqaron  ne relacion menaxhimin e pasurisë "shtet"  562/8 për 1037 m2, vol 25, faqe 74, ZK 2105,  pasi  është e okupuar*** *nga E E  , sipas shkresës ZRPP nr. 30010 date 03.09.2018 dhe date 12.02.2020.*
***- Ne 3 raste, dokumentacioni tekniko ligjore paraqitet i parregullt dhe me 2 standarde,*** përkatësisht:
** Plarilevimet pranohen pa nënshkrimin e njësisë vendore Kashar te Administratorit dhe pronarit te pasurisë 156/4/2, sipërfaqe 1000 m2, ZK 2119. Katund i Ri, ndryshe nga rastet tjera.*
** Deklarata e kufitareve janë lejuar pa firmën e kufitareve, madje pa numrin e identitetit tyre, por është mjaftuar vetëm me firmën e kryeplakut fshatit.*
** Ne 1 rast është kryer verifikimi ne terren për pasuritë e subjektit, sipas procesverbal konstatimit ne terren date 28.12.2020, nënshkruar nga 1 person i ZMT, ne vend te komisionit njësisë, ndërsa nuk është aplikuar matjet ne terren për rastet tjera (Me hollësisht trajtuar në faqet 24-55. të  Raportit Përfundimtar të Auditimit).*
**7.1. Rekomandimi:**  Njësia Administrative Kashar **te marre masa për plotësimin e dosjeve me dokumentacionin e munguar dhe te beje sqarime te plota për gjitha problemet e AMTP ne relacionet e saj,** sipas rasteve te cituara me larte.

***Menjëherë dhe në vijimësi***

**8.  Gjetje nga auditimi**:  Ne Njësinë Administrative Kashar te gjitha dosjet e AMTP nuk janë inventarizuar, në kundërshtim me kërkesat  e nenit 3 e 29 të ligjit nr. 9154, datë 06.11.2003 "*Për Arkivat*"  *(Me hollësisht trajtuar në faqet 24-55. të  Raportit Përfundimtar të Auditimit).*
**8.1. Rekomandimi:** Njësia Administrative Kashar **te marre masa për inventarizimin e dosjeve te AMTP**, ne zbatim te kërkesave ligjore.

***Menjëherë dhe në vijimësi***

**9. Gjetje nga auditimi,** Nga auditimi u konstatua **se në 7 raste** praktika e akivuar pranë Njësisë Administrative ka mangësi dhe mos plotësim të dokumentacionit të kërkuar ligjor për regjistrimin e pasurisë "Tokë bujqësore" sipas AMTP të lëshuara në zbatim të ligjit "Për tokën" si dhe relacioni shpjegues nuk ka referime e përcaktime për pozicionimin e pasurisë konkretisht:
- Praktika për pasuritë e regjistruar të familjes bujqësore Z A, sipas 2 AMTP me nr. akti 258 e cila ndodhet në origjinal dhe nr. akti 262 e cila ndodhet fotokopje.
- **Praktika për** pasuritë e regjistruar të familjes me përfaqësuesit P P me nr. kadastral 211/1/ Plan Rilevimi i pa nënshkruar nga Administratori i Njësisë Administrative si dhe Deklarata e kufitarëve pa nënshkrime.

- Në arkivën e Njësisë Administrative nuk gjendet asnjë dokumentacion që të na informon në lidhje me mënyrën e pajisjes me AMTP Në emër të subjektit I H, cili është anëtar i familjes bujqësore, pasi në 01.08.1991 është 16 vjeç e jo në moshë madhore në cilësinë për të vepruar si përfaqësues i familjes bujqësore.
- Në dosje konstatohet problematika e ekzistencës së dy AMTP-ve në një familje bujqësore, të ndryshme me njëra tjetrën, AMTP me nr. 61, pa datë, e vitit 1992 në emër të përfaqësuesit Q GJ të familjes bujqësore, fshati Kus: për Pasuritë 535/3, 535/4, 598/3, 598/2, 597/8,138/7,133/2-2,138/4. Gjithashtu, në dosje gjendet edhe një tjetër AMTP, me nr. 61, pa datë, e vitit 1992 në emër të përfaqësuesit Q GJ të familjes bujqësore, fshati Kus: për pasurinë nr. 138/4, dokument i cili nuk sqaron pozicionin gjeografik dhe kufizimet. Me mangësi në plotësimin e elementeve të përcaktuar ligjorë.
- Në relacionin sqarues të njësisë Administrative Kashar konfirmimi i AMTP e njehsuar me origjinalin, në emër të përfaqësuesit XH SH të familjes bujqësore, fshati Yrshek për Pasurinë 193/16, nuk ka të sqaruar diferencën e pozicionimit duke e krahasuar me planin e rilevimit në raport me ortofoton, për rrjedhojë praktika për regjistrimin e AMTP në pronësi, është procedurë e parregullt dhe me mangësi.
- Në relacionin nga Njësia Administrative Kashar me nr. 14522/5, datë 03.09.2020 me qëllim regjistrimin pranë ASHK-së të pasurisë me nr. 58/2, ZK 2625. Konstatohet se AMTP-ja dhe formulari nr.6, kanë korrigjime të dukshme. Nuk ka dokumentacion ligjor sqarues dhe shoqërohet me një praktikë të pa plotë dhe pa verifikuar plotësisht.
Veprime në kundërshtim me Ligjin nr.7501, datë 19.07.1991 "Për Tokën", ligjin nr. 9948, datë 7.7.2008, "Për shqyrtimin e vlefshmërisë ligjore të krijimit të titujve të pronësisë mbi tokën bujqësore"; VKM nr. 994, datë 9.12.2015 "Për procedurën e regjistrimit të akteve të marrjes së tokës në pronësi" *(Me hollësisht trajtuar në faqet 24-55. të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*
**9.1.Rekomandim** Njësia Administrative Kashar Bashkia Tiranë në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme e Objekteve në Bashkëpronësi, Administrimit të NJA-ve dhe Emergjencave Civile (DANJ-ve/AMTP-ve), Bashkia Tiranë, të mos përcjell AMTP-të për regjistrim, në Drejtorinë Vendore të ASHK Rurale 2, pa shqyrtuar vlefshmërinë tekniko-ligjore të titullit të pronësisë të krijuar mbi tokën bujqësore (AMTP-së), pa verifikuar dhe shqyrtuar dokumentacionin kadastral që disponon Njësia Administrative Kashar.

***Menjëherë dhe në vijimësi***

**10. Gjetje nga auditimi,** Nga auditimi u konstatua **se në 6 raste** në relacionin shpjegues nuk ka referime e përcaktime për pozicionimin e pasurisë e cila bie në status "PF", si dhe nuk ka dokumentacion shterues mbi vlefshmërinë e lëshimit të AMTP-ve, konkretisht:
- Nuk ka sqarime e saktësime për gjendjen faktike dhe dokumentare të pozicionimit të parcelës nr. 209 me sip. 550 m$^2$ ZK 2119, pasi figuron në gjendjen kadastrale PF(rrugë-kanale) datë 01.08.1991;
- Në relacionin sqarues të njësisë Administrative Kashar, në dy rastet për të njëjtën pasuri, nr. 287/. Për AMTP nr...., datë 17.05.1996 ka planë rilevimi të ndryshme dhe nuk ka dokumentacion sqarues mbi pozicionimin e saktë të pasurisë e cila figuron e regjistruar në zërin kadastral "PF"(rruge, kanale) dhe prek pjesërisht parcelën me nr. 288 e cila figuron e regjistruar në zërin kadastral "arë", gjendja 01.08.1991, duke rezultuar procedurë të parregullt dhe me mangësi;
- Për pasurinë nr. 79, për 1500 m$^2$ sipas AMTP pa nr. datë 20.11.1996 dhe pozicionimit sipas plan rilevimit datë 24.07.2017 konstatojmë se parcela bie PF (tokë pa frut) e cila nuk është objekt i ndarjes së tokës. AMTP-ja në emër të I H i cili është anëtar i familjes bujqësore, pasi në 01.08.1991 është 16 vjeç e jo në moshë madhore në cilësinë për të vepruar si përfaqësues i familjes bujqësore;
-Për Pasurinë me nr. 156/ me emrin popullor "Radiostacioni" pasqyruar në AMTP në reshtin e 6, sip. 1500 m$^2$ sipas AMTP-së dhe plan rilevimit të përgatitur nga Top. Gj. L., datë 26.06.2020

me sip. Faktike 800 $m^2$ ZK 2105, fshati Kashar. Nuk ka sqarime e saktësime për gjendjen faktike dhe dokumentare të pozicionimit të parcelës që bie mbi pronë shtetërore e jo tokë "arë".
- Në relacionet me nr. 4423/1, datë 21.12.2020 dhe nr. 369, datë 26.01.2021 të Njësisë Administrative (cituar edhe nga Bashkia Tiranë) nuk ka sqarime e saktësime si dhe ka qëndrime të ndryshme për gjendjen faktike të pozicionimit dhe llojit të tokës të parcelës nr. 241-242. Pasuria nr. 241, sipas planit të rilevimit prek pasurinë me nr. 241/3, që sipas kartelës së pasurisë është e lloji "pemëtore-truall" dhe pasuria 242/29 sipas kartelës së pasurisë është e lloji "arë", por sipas hartës 1:5000 prek pasurinë "PF".
-Në përcaktimin e pozicionimit të pasurisë nr. 225/3 në lidhje me hartën 1:5000, konstatojmë se kjo pasuri është pjesë e pasurisë nr. 225 e llojit jo tokë bujqësore
Veprime në kundërshtim me Ligjin nr.7501, datë 19.07.1991 "Për Tokën", Ligjin nr. 9948, datë 7.7.2008, "Për shqyrtimin e vlefshmërisë ligjore të krijimit të titujve të pronësisë mbi tokën bujqësore"; ligjin nr. 20/2020, datë 03.05.2020, datë 05.03.2020 VKM nr. 994, datë 9.12.2015 "Për procedurën e regjistrimit të akteve të marrjes së tokës në pronësi"; VKM nr.1174, datë 24.12.2020, "Për procedurat e regjistrimit të amtp-ve, saktësimin e kufijve e sipërfaqeve, si dhe normat për sipërfaqet shtetërore shtesë e pronat shërbyes" *(Me hollësisht trajtuar në faqet 24-55. të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*
**10.1.Rekomandim** Njësia Administrative Kashar Bashkia Tiranë në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme e Objekteve në Bashkëpronësi, Administrimit të NJA-ve dhe Emergjencave Civile (DANJ-ve/AMTP-ve), Bashkia Tiranë, të mos përcjell AMTP-të për regjistrim, në Drejtorinë Vendore të ASHK Rurale 2, pa shqyrtuar vlefshmërinë tekniko-ligjore të titullit të pronësisë të krijuar mbi tokën bujqësore (AMTP-së), pa verifikuar dhe shqyrtuar dokumentacionin kadastral që disponon Njësia Administrative Kashar.

***Menjëherë dhe në vijimësi***

## B- NJËSIA ADMINISTRATIVE VAQARR

## MASA ORGANIZATIVE

1. **Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi u konstatua se Njësia Administrative Vaqarr:
**a.** për 4 vitet (2019-2022) rezulton se dokumentacioni nuk është mbajtur ne dosje te veçanta për do subjekt, me inventarizim te plote, ku te pasqyrohej gjithë procedura e korrespondencës me ASHK dhe bashkinë nga fillimi deri ne fund, me qellim qe te jepej qartësi ne zgjidhjen e problemeve te pronësisë te banoreve te Vaqarrit, dhe jo i shkëputur sipas viteve. Kështu njësia Vaqarr sipas evidencave paraqet 50 korrespondenca me Bashkinë Tirane dhe 277 korrespondenca me ASHK, te ndara sipas viteve dhe jo te grupuara ne dosje veçanta sipas subjekteve, për 4 vitet 2019-2022.
**b.** Ne 14 raste, dosjet e subjekteve kane mangësi dhe parregullsi ne dokumentacionin tekniko-ligjor, , konkretisht:
- *ne 2 raste, mungon HTR dhe formulari nr. 6,*
- *ne 4 raste, mungon planrilevimi ose janë te parregullta,*
- *ne 3 raste, mungon dokumentacioni për argumentimin e diferencës sipërfaqes midis AMTP dhe vërtetimit pagesës taksave vendore,*
- *ne 1 rast, nuk përputhet AMTP date 10.08.1993 me formularin nr. 6,*
- *ne 3 raste, deklaratat e kufitareve janë pranuar të parregullta,*
- *ne 1 rast, nuk përputhen kufitaret, midis deklaratës kufitareve dhe AMTP,*
- *ne gjitha rastet nuk disponohet vendimi ne njësinë vendore Vaqarr për normën për fryme. (Me hollësisht trajtuar ne faqe 55-85të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**1.1. Rekomandimi:** Njësia Administrative Vaqarr:
**a. te marre masa për te krijuar dosje te veçanta për çdo subjekt** me dokumentacionin përkatës te ASHK, bashkisë dhe subjektit dhe jo te veçuar sipas viteve.

**b. te marre masa për plotësimin e dosjeve me dokumentacionin e munguar dhe te beje siguroje dokumente te rregullta** duke eliminuar pasaktësitë e konstatuara sipas rasteve.

***Në vijimësi***

**2. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi u konstatua se Njësia Administrative Vaqarr nuk disponon listën e sipërfaqeve te tokës tepër kaluar "shtet" nga ASHK, sipas subjekteve private objekt i legalizimeve, për diferencat midis sipërfaqeve te zaptuara me ato te miratuara me legalizim *(pjesa zaptuar -pjesën legalizuar*). Kështu, tokat "shtet" kane mbetur në posedim dhe shfrytëzim në mënyrë të paligjshme nga subjektet private për një periudhë pa kufi kohor, të cilët i shfrytëzohen pa asnjë detyrim, taksë apo qira, çka tregon mos-administrim te tyre si dhe mungese bashkëpunimi me ASHK (*Me hollësisht trajtuar ne faqe 55-85 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

<u>**2.1. Rekomandimi:**</u> Njësia Administrative Vaqarr **ne bashkëpunim me ASHK te marre masa për administrimin e sipërfaqeve tepër toke "shtet", diferenca midis pjesës zaptuar me atë legalizuar**, te cilat kane kaluar shtet nga ASHK.

***Menjëherë e në Vijimësi***

**3. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi u konstatua se ne 1 rast, pasuria 301/4, ZK 3321, vol 1, faqe 26, siperfaqja 3200 $m^2$ paraqet paqartesi, pasi sipas dokumentacionit pasqyrohet me 3 lloje si are**,** vresht, grope silazhi**,** nuk rekordon AMTP 41 me LN dhe formularine 6, mungon HTR, fakt është se edhe ASHK ka kërkuar dhe rikerkuar sqarime për pasurinë 301/4 (324) dhe nuk nuk e ka kaluar ne pronesi MIE, pasi mbi kete pasuri ndodhet landfilli, *sipas references 3865 date 03.05.2019 dhe 3874 date 27.05.2019 (Me hollësisht trajtuar ne faqe 55-85 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

<u>**3.1. Rekomandimi:**</u> Njësia Administrative Vaqarr **te qartësoje me dokumente dhe te bashkëpunoje me ASHK për te sqaruar nëse pasuria 301/4,** ZK 3321, vol 1, faqe 26, siperfaqja **3200 m2 ka kaluar ne pronesi MIE** pasi mbi kete pasuri ndodhet landfilli apo është ne pronësi te privatit.

***Menjëherë e në Vijimësi***

**4. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi u konstatua se Njësia Administrative Vaqarr nuk ka bashkëpunuar me njësinë Kashar dhe ASHK për sqarimin dhe zgjidhjen e përplasjes dhe mbivendosjes te disa pasurive midis 2 zonave kadastrave te tyre ZK 2119 dhe ZK 2105, pasi mungon azhurnimi hartës për pozicionin pasurive, mungojnë deklaratat noteriale e kufitareve sipas gjendjes faktike ne terren, kërkesë kjo e ASHK Rurale 2 sipas shkresës saj nr. 7186/1 date 09.11.2020 (*Me hollësisht trajtuar ne faqe 55-85 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

<u>**4.1. Rekomandimi:**</u> Njësia Administrative Vaqarr ne bashkëpunim me njësinë Kashar dhe ASHK **të sqarojnë përplasjen dhe mbivendosjen e disa pasurive midis 2 zonave kadastrave te tyre ZK 2119 dhe ZK 2105,** duke disponuar hartën e azhurnuar për pozicionin e pasurive, deklaratat noteriale kufitareve sipas gjendjes ne terren, në përgjigje te shkresës nr. 7186/1 date 09.11.2020 te ASHK Rurale 2.

***Menjëherë***

**5. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi u konstatua se Njësia Administrative Vaqarr padrejtësisht sqaron dhe kthen përgjigje për pasurinë nr. 73/, ne vend te pasurisë nr. 83/14, ZK 1867, sipërfaqe 1000 m2, vol 3, faqe 63, fshati Gropaj, kërkese kjo e ASHK 2, për sigurimin e dokumentacionit te plote tekniko-ligjor *(Me hollësisht trajtuar ne faqe 55-85 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

<u>**5.1. Rekomandimi:**</u> Njësia Administrative Vaqarr **ti ktheje përgjigje DV ASHK Tirana Rurale 2, për pasurinë 83/14** me sipërfaqe 1000 m2, vol 3, faqe 63, fshati Gropaj, duke i siguruar dokumentacionin e plote tekniko-ligjor.

***Menjëherë***

**6. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi u konstatua se Njësia Administrative Vaqarr- **Ne 3 raste,** paraqitet me moszbatim te afateve ligjore deri 1 vit, lidhur me korrespondencën për kthimin e përgjigjeve ndaj kërkesave dhe ri-kërkesave te ASHK dhe anasjelltas për Njësinë Vaqarr, nuk ka shpjegime ligjore për vonesën e përgjigjes, si dhe nuk është plotësuar dokumentacioni ligjor i kërkuar nga DV ASHK Tirana Rurale:
-për regjistrimin e pasurive te AMTP 45 date 19.05.1992, ZK 1017, Allgjate,
- aplikim me nr. 1888, datë 11.02.2020DV ASHK Tirana Rurale 2 është paraqitur G K, për tu pajisur me kopje të kartelës së pasurisë nr. 30/9 Vol.1, faqe 198, ZK 3963, "arrë" me sip. 4500 $m^2$;
- R M Në DV ASHK Tirana Rurale 2 ka paraqitur kërkesën me objekt lëshimin e kopjes së hartës dhe kartelës së rifreskuar kadastrale për pasurinë nr. 146/3, vol. 1, faqe 203, ZK 3064.
Veprime në kundërshtim me VKM nr. 994, datë 9.12.2015 "Për procedurën e regjistrimit të akteve të marrjes së tokës në pronësi" Ligjin nr. 20/2020, datë 03.05.2020 "Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë"; si dhe VKM nr. 1174, datë 24.12.2020 "Për procedurat e regjistrimit të AMTP-ve, saktësimin e kufijve e sipërfaqeve, si dhe normat për sipërfaqet shtetërore shtesë e pronat shërbyese" *(Me hollësisht trajtuar ne faqe 55-85 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*
__**6.1. Rekomandimi:**__ Njësia Administrative Vaqarr **të marrë masa për të eliminuar vonesat ne kthimin e përgjigjeve ndaj DV ASHK, DP Bashkisë apo dhe Subjektit,** lidhur me sqarimin e plote te problemeve te AMTP-ve, plotësimin e dokumentacionit ligjor.

***Në Vijimësi***

**7. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi u konstatua se **në 10 raste**, në relacionin shpjegues nuk ka referime e përcaktime për pozicionimin e pasurisë dhe dokumentacion të plotë sqarues. Relacionet shpjeguese paraqiten te pjesshëm, lidhur me saktësimin e pasurive tokës bujqësore përfituar me AMTP, sipas kërkesës se DV ASHK, Bashkisë dhe subjektit, përkatësisht:
- ne 1 rast, relacioni sqaron 1 pasuri te AMTP, ndërsa nuk flet për pasuritë tjera te AMTP,
- ne 2 raste, relacionin nuk sqaron mospërputhjen e AMTP-se me formularin nr. 6, pasi këta 2 dokumente pasqyrojnë numër dhe sipërfaqe te ndryshme te pasurive tokës bujqësore (AMTP përmban 1 pasuri, ndërsa formulari 6 përmban 3 pasuri).
- ne 3 raste, relacioni nuk shpjegon pajisjen me 3 AMTP të familjes pandara nga trungu 1991, ne vend te 1 AMTP, nuk sqarohet sipërfaqja totale e marre sipas normës për frymë, nëse ka efekte.
- ne 1 rast, relacioni shpjegues nuk sqaron dhënien e tokës me 2 standarde, pasi 2 familje me numër te njëjtë frymësh disponojnë sipërfaqe te ndryshme për te njëjtën ZK.
- ne 2 raste, paraqitet mos-rakordim midis KPP dhe AMTP, madje KPP pasqyron emër tjetër.
- në 1 rast Pasuria me nr. 135, vol 1, faqe 150 ZK 3712 adresë Vaqarr lloji "kullotë" sipërfaqe 9140 $m^2$ pronësi "Shtet" sipas ZVRPP si dhe në lidhje me parcelën me nr. 131/135 me emër popullor "kopshti" sip. 1720 $m^2$ i zërit kadastral "Arrë" sipas AMTP-së.
- në 1 rast Pasuria me nr. 52/36/1, vol 2, faqe 3 ZK 1867 adresë Gropaj lloji "truall" sipërfaqe 400 $m^2$ sipas akti dhe 600 $m^2$ ndërtesë 140 $m^2$ sipas LN Maj 1995.
- në 1 rast Pasuria nr. 76/1, vol __, faqe __ ZK 3784 adresë Vishaj lloji "arrë" sipërfaqe 3220 $m^2$ që sipas akti rezulton e pa afishuar. Në AMTP-në nr. 18, datë 30.07.1992, në reshtin e 1,2,3 dhe 5,6,7, janë përcaktuar pasuritë që sipas relacionit në total korrespondojnë me pasurinë 76/1 është 3220 $m^2$ "arrë" pa përfshirë pasurinë 250 $m^2$ "truall", por nuk përputhen me përshkrimin dhe Plan rilevimin datë 25.07.2019, paraqitur nga Njësia Administrative. Ndërsa për pasurinë me nr. 14/12 me sip. 11400 $m^2$ sipas azhornimit, nuk ka deklarime për mos përputhje sipërfaqe Veprime në kundërshtim me VKM nr. 994, datë 9.12.2015 "Për procedurën e regjistrimit të akteve të marrjes së tokës në pronësi" dhe Ligjit nr. 9948, datë 7.7.2008, "Për shqyrtimin e

vlefshmërisë ligjore të krijimit të titujve të pronësisë mbi tokën bujqësore" *(Me hollësisht trajtuar ne faqe 55-85 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**7.1. Rekomandimi:** Njësia Administrative Vaqarr **te marre masa për përmirësimin e relacioneve shpjeguese**, duke sqaruar ne detaje te gjitha problemet e pronave te AMTP, duke i bashkëngjitur dokumentacionin shoqërues, ne zbatim te kërkesave te ASHK, bashkisë dhe subjektet.

***Në vijimësi***

**8. Gjetje nga auditimi** Nga auditimi u konstatua **se në 2 raste *Nuk ka sqarime për ndryshimet e sipërfaqeve të pasurive dhe ndarjen e parcelave sipas regjistrimit fillestar*** konkretisht:

- Pasuria nr. 294/6, vol. 2, faqe 53 në pronësi të XH. L me sip. 4500 $m^2$ e llojit "arrë" dhe Pasuria nr. 339/3, vol. 2, faqe 54 në pronësi të XH.L me sip. 2000 $m^2$ e llojit "arrë".
- Në kthim përgjigje nga Njësia Administrative Vaqarr me nr. 339/1, datë 08.02.2021 (relacion shpjegues) theksohet se ky person është pajisur me certifikatë pronësie për pasurinë nr. 46/12, Vol 9, faqe 121 ZK 3321 me sipërfaqe 2094 $m^2$. Drejtoria Vendore e ASHK Tirana Rurale 2 me nr. 7612, datë 16.11.2020 konfirmon se nuk ka lëshuar certifikatë sipas kartelës për pasurinë nr. 46/12, Vol 9, faqe 121 ZK 3321 me sipërfaqe 1294 $m^2$, kjo sipas regjistrimit fillestar përfunduar më 16.02.2000.

Veprime në kundërshtim me VKM nr. 994, datë 9.12.2015 "Për procedurën e regjistrimit të akteve të marrjes së tokës në pronësi"; me Ligjin nr. 20/2020, datë 03.05.2020 "Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë"; si dhe VKM nr. 1174, datë 24.12.2020 "Për procedurat e regjistrimit të AMTP-ve, saktësimin e kufijve e sipërfaqeve, si dhe normat për sipërfaqet shtetërore shtesë e pronat shërbyese" *(Me hollësisht trajtuar ne faqe 55-85 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**8.1. Rekomandim** Njësia Administrative Vaqarr Bashkia Tiranë në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme e Objekteve në Bashkëpronësi, Administrimit të NJA-ve dhe Emergjencave Civile (DANJ-ve/AMTP-ve), Bashkia Tiranë, të mos përcjell AMTP-të për regjistrim, në Drejtorinë Vendore të ASHK Rurale 2, pa shqyrtuar vlefshmërinë tekniko-ligjore të titullit të pronësisë të krijuar mbi tokën bujqësore (AMTP-së), pa verifikuar dhe shqyrtuar dokumentacionin kadastral që disponon Njësia Administrative Vaqarr.

***Në Vijimësi***

**9. Gjetje nga auditimi,** Nga auditimi u konstatua **se në 2 raste** se:

- Nga Njësia Administrative ***nuk është plotësuar dokumentacioni ligjor si certifikatat 01.08.1991 për çdo familje përfituese të tokës*** sipas legjislacionit në fuqi, ***nuk është argumentuar zbatimi i normës për fryme, s'ka sqarim dokumentar mbi mos përputhjen e mbiemrit në kartelën e pasurisë*** ASHK, , citimi në shkresën nr. 246, datë 21.01.2021, si dhe me librin e ngastrave (fotokopje) nga "K", "K" në certifikatën e gjendjes civile.

***-AMTP në përdorim nuk ka korrigjimin e kërkuar me nënshkrim, mungon nënshkrimi i Kryetarit të Komisionit të ndarjes së tokës së Fshatit dhe vula e institucionit që ka lëshuar aktin.*** Nuk ka arsye dokumentare për vonesën me disa vite të përgjigjes dhe dërgimin e relacionit-shpjegues nga Njësia Administrative.

Veprime në kundërshtim me Ligjin nr. 20/2020, datë 03.05.2020 "Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë"; si dhe VKM nr. 1174, datë 24.12.2020 "Për procedurat e regjistrimit të AMTP-ve, saktësimin e kufijve e sipërfaqeve, si dhe normat për sipërfaqet shtetërore shtesë e pronat shërbyese" *(Me hollësisht trajtuar ne faqe 55-85 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**9.1. Rekomandim** Njësia Administrative Vaqarr Bashkia Tiranë në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme e Objekteve në Bashkëpronësi, Administrimit të NJA-ve dhe Emergjencave Civile (DANJ-ve/AMTP-ve), Bashkia Tiranë, të mos përcjell AMTP-të për regjistrim, në Drejtorinë Vendore të ASHK Rurale 2, pa shqyrtuar vlefshmërinë tekniko-ligjore

të titullit të pronësisë të krijuar mbi tokën bujqësore (AMTP-së), pa verifikuar dhe shqyrtuar dokumentacionin kadastral që disponon Njësia Administrative Vaqarr.

***Në Vijimësi***

**C- NJËSIA ADMINISTRATIVE ZALL-BASTAR**

**MASA ORGANIZATIVE**

**1. Gjetje nga auditimi.** Nga auditimi konstatua se: **2 pasuritë me sipërfaqe 3531 m2 dhënë me AMTP date 22.06.1992, M L , rezultojnë me certifikate pronësie ne emër te personave tjerë,** përkatësisht:
**- *pasuria nr. 1111,*** ZK 1124, Zall-Bastar Mesëm, sipërfaqe 1325 m2, AMTP 22.06.1992**,** ne emër M L **,** rezulton me certifikate pronësie për H K**,** pasuria 1111, ZK 1124, vol 3, faqe 43 *(AMTP 121 date 11.05.1992).*
**- *pasuria nr. 1136*,** ZK 1124, Zall-Bastar Mesëm, sipërfaqe 2206 m2, AMTP 22.06.1992, ne emër te M L , rezulton e regjistruar për H L, pasuria 1136, ZK 1124, vol 4, faqe 190.
Për sa më sipër dokumentohet me ***Hartën kadastrave e vitit 1998*** e miratuar me vendimin nr. 37 date 16.08.2004 te KK Zall-Bastar; ***Shkresa e Bashkisë Tirane*** nr. 4861/1 date 07.02.2020, e cila sqaron këtë problem; ***Dokumentet e Kadastrës,*** KPP dhe certifikata e pronësisë.
Veprime në kundërshtim të pikës 1 dhe 2 te nenit 68 "*Bashkëpunimi ndërinstitucional"* te ligjit nr. 111.2018 "*Për kadastrën*", përforcuar edhe me vendimin 1040 date 25.11.2020, kreu I/ 5 (*Me hollësisht trajtuar ne faqe 85-100 të Raportin Përfundimtar të Auditimit*).
**1.1.Rekomandimi:** Njësia Administrative Zall-Bastar **te marre masa që në bashkëpunim me ASHK Rurale 1**, për të përcaktuar statusin pronësor të **2 pasurive me sipërfaqe 3531 m$^2$ dhënë me AMTP date 22.06.1992 M L ,** pasi rezultojnë ne pronësi te personave tjerë, përkatësisht:
-H K, pasuria 1111, ZK 1124, vol 3, faqe 43, *AMTP 121 date 11.05.1992.*
- H L, pasuria 1136, ZK 1124, vol 4, faqe 190, *akti 210.*

***Menjëherë***

**2. Gjetje nga auditimi.** Nga auditimi i ushtruar u konstatua në 1 rast se mungon korrespondenca pas vitit 2020 midis Njësisë Administrative Zall-Bastar me ASHK 1, **për sqarimin dhe sistemimin e sipërfaqeve tepër 3893 m$^2$ te 5 pasurive, nëse kane kaluar "shtet",** pasi 5 pasuritë regjistruar ne vitin 2001 ne emër **A C**, fshati Bastar-Murriz, ZK 1125 rezultojnë me sipërfaqe me te mëdha se AMTP 70, formulari 6 dhe plan rilevimet, sipas relacionit shpjegues 07.09.2020**,** përkatësisht:
- pasuria nr. 138/4, sipas AMTP, plan rilevimit, formularit 6 rezulton 300 m2, ndërsa sipas KPP rezulton 481 m2, vol 1, faqe 209, ZK 1125, pra diferenca tepër 181 m2.
- pasuria nr. 72/7, sipas AMTP, plan rilevimit, formularit 6 rezulton 200 m2, ndërsa sipas KPP rezulton 2662 m2, vol 1, faqe 208, ZK 1125, pra diferenca tepër 2462 m2.
- pasuria nr. 183/5, sipas AMTP, plan rilevimit, formularit 6 rezulton 950 m2, ndërsa sipas KPP rezulton 1586 m2, vol 1, faqe 213, ZK 1125, pra diferenca tepër 636 m2.
- pasurinë nr. 211/3, sipas AMTP, plan rilevimit, formularit 6 rezulton 1200 m2, ndërsa sipas KPP rezulton 1416 m2, vol 1, fq 217, ZK 1125, pra diferenca tepër 216 m2.
- pasuria nr. 219/17, sipas AMTP, plan rilevimit, formularit 6 rezulton 2350 m2, ndërsa sipas KPP rezulton 2748 m2, vol 1, faqe 219, ZK 1125, pra diferenca tepër 398 m$^2$ (*Me hollësisht trajtuar ne faqe 85-100 të Raportin Përfundimtar të Auditimit*).
**2.1. Rekomandimi:** Njësia Administrative Zall-Bastar **te bashkëpunoje me ASHK Rurale 1, për sqarimin dhe sistemimin e sipërfaqeve tepër prej 3893 m2 te 5 pasurive, nëse kane kaluar "shtet",** pasi 5 pasuritë e regjistruara ne emër A C, fshati Bastar-Murriz, si më sipër

**rezultojnë me sipërfaqe me te mëdha se AMTP 70, formulari 6 dhe plan rilevimet,** referuar relacionit shpjegues date 07.09.2020 te NJA**.**

***Menjëherë***

**3. Gjetje nga auditimi.** Nga auditimi në Njësinë Administrative Zall-Bastar u konstatua se:
**a. nuk disponon listën e sipërfaqeve tokës tepër kaluar "shtet" nga ASHK,** sipas subjekteve private **objekt i legalizimeve**, për diferencat midis pjesës te zaptuar me pjesën e legalizuar.
**b. nuk disponon listën e sipërfaqeve tokës tepër kaluar "shtet" nga ASHK,** sipas subjekteve private **objekt i AMTP**, për diferencat midis AMTP dhe matjeve ne terren ku sipërfaqja rezulton me e madhe se AMTP.
**c. për rastin e okupimit nga privati te pasurisë shtet nr. 126/3 me sipërfaqe 3921** m2 are, ZK 3296, Selite Malit, vol 4, faqe 22, **njësia nuk e ka administruar ketë sipërfaqe, ku i behet e qarte okupimi i saj nga ASHK**.
***Për rrjedhoje***, Këto ***parcelëza "shtet"*** kane mbetur në posedim dhe shfrytëzim në mënyrë të paligjshme nga subjektet private, pa asnjë detyrim, taksë, qira për buxhetin (*Me hollësisht trajtuar ne faqe 85-100 të Raportin Përfundimtar të Auditimit*).
**<u>3.1. Rekomandimi:</u>** Nga Njësia Administrative Zall-Bastar **ne bashkëpunim me ASHK te marren masa për evidentimin dhe administrimin e sipërfaqeve tepër toke "shtet", rezultuar nga diferenca midis pjesës zaptuar me atë legalizuar** apo edhe **midis AMTP dhe sipërfaqes ne terren**, kaluar shtet nga ASHK.

***Në vijimësi***

**4. Gjetje nga auditimi.** Nga auditimi në Njësinë Administrative Zall-Bastar u konstatua se: në 1 rast**, relacioni shpjegues date 15.11.2020 i Njësisë Administrative Zall-Bastar nuk sqaron diferencën 11085 m2** *(21800-10715)* **midis AMTP 22/1992 dhe vërtetimit taksave vendore** për **S M ,** Besh. Njësia ka vepruar me **2 standarde,** pasi ndryshe ka ndodhur me praktiken e R M dhe F M, ku përputhet sipërfaqja sipas AMTP me sipërfaqen e vërtetimit të taksës vendore (*Me hollësisht trajtuar ne faqe 85-100 të Raportin Përfundimtar të Auditimit*).
**<u>4.1. Rekomandimi:</u>** Njësia Administrative Zall-Bastar **te sqaroje diferencën 11085 m2** *(21800-10715)* **midis AMTP** 22/1992 **dhe vërtetimit taksave vendore** ne emër **S M ,** fshati Besh, **për shmangien e evazionit fiskal ne pagesën e taksës tokës bujqësore.**

***Menjëherë***

**5. Gjetje nga auditimi.** Nga auditimi në Njësinë Administrative Zall-Bastar u konstatua se:
Në 1 rast, **relacioni shpjegues date 29.12.2020** i Njësisë Administrative Zall-Bastar **paraqet mangësi, pasi nuk sqaron te plota problemet e AMTP 13 date 15.06.1992** ne emër te **A S,** fshati Selite Malit, Zall-Bastar, konkretisht:
**- *relacioni nuk shpjegon diferencën e sipërfaqes 3775 m2*** (11537-7762), midis sipërfaqes 11537 m2 *sipas vërtetimit taksave vendore Bashkisë 6951/1 date 22.09.2020* me sipërfaqen 7762 m2 qe pasqyron AMTP 13 date 15.06.1992.
- ***relacioni nuk sqaron nëse administron pasurinë "shtet"" 126/3 me sipërfaqe 3921 m2 are***, ZK 3296, Selite Malit, vol 4, faqe 22, **okupuar** nga A S.
- ***relacioni nuk sqaron mungesën e formulari nr. 6,*** kërkesë kjo e bashkisë Tirane, sipas shkresës saj nr. 43109/1 date 15.12.2020 (*Me hollësisht trajtuar ne faqe 85-100 të Raportin Përfundimtar të Auditimit*).
**<u>5.1. Rekomandimi</u>:** Njësia Administrative Zall-Bastar **te kompletoje dosjen me dokumente te munguara dhe te sqaroje problemet te plota për AMTP 13 date 15.06.1992 ne relacionin shpjegues te saj,** ne adrese te bashkisë dhe ASHK**.**

***Menjëherë***

**6. Gjetje nga auditimi.** Nga auditimi u konstatua se:

**-Në 1 rast,** ka **vonesa prej 1 vit te korrespondencës** ***Njësisë Administrative Zall-Bastar-Bashki Tirane–ASHK Rurale 1- Subjekt,*** lidhur me praktiken për AMTP pa numër dhe date, ne emër te **Q P,** fshati Zall-Dajt, pasi ASHK Rurale me date 27.01.2020 ka kërkuar njësisë konfirmim dokumentacioni, ndërsa kjo fundit pas 8 muajve ka përcjellë relacionin shpjegues date 16.09.2020 dhe ridërguar me 03.11.2020. Gjithashtu **dokumentacioni i korrespondencës paraqet mangësi**, pasi mungon ne dosje AMTP-ja dhe formulari nr. 6.

**- Në 1 rast, përfituar 2 AMTP** nga familja D , pasi pretendohet se ne 1992 ka qene e ndare ne 2 familje, por nuk disponohen 2 certifikatat familjare, përkatësisht:

*AMTP 16.07.1992 ne emër te babait H D fshati Zall-Dajt me sipërfaqe 1196 2 m2 are, për 2 fryme, **mungon certifikata familjare 1991 e H D**.

*AMTP 16.07.1992 ne emër te birit B H D me sipërfaqe 2208 2 m2 are, për 5 fryme, ku disponohet certifikata familjare 01.10.1992 e B D (*Me hollësisht trajtuar ne faqe 85-100 të Raportin Përfundimtar të Auditimit*).

**6.1. Rekomandimi:** Njësia Administrative Zall-Bastar të marrë masa për të:

**- shmangur vonesat duke respektuar afatet ligjore në kthimin e përgjigjeve ndaj ASHK** dhe Bashkisë, lidhur me sqarimet e AMTP-ve.

**- te kompletoje 2 dosjet e korrespondencës me dokumentet e munguara (***certifikata familjare 1991 e H D dhe AMTP, formulari 6 e Q P).*

***Menjëherë e në vijimësi***

**7. Gjetje nga auditimi.** Nga auditimi u konstatua se në 2 raste Njësia Administrative Zall-Bastar në relacionin shpjegues nuk ka sqaruar pajisjen me AMTP familje bujqësore me gjendje pas datës 01.08.1991, nuk ka sqaruar normën për frymë të tokës bujqësore dhe të argumentonte zbatimin e saj, konkretisht:

- AMTP-të me nr. 34, datë 18.08.2000; nr. 276, datë 18.08.2000; nr. 63, datë 18.08.2000.

-AMTP nr. 64, datë 30.05.2020 në emër të B R me sipërfaqe totale 5150 $m^2$. Janë lëshuar në kundërshtim me ligjin nr. 7501, datë 19.07.1991 "Për Tokën", me VKM nr. 994, datë 9.12.2015 "Për procedurën e regjistrimit të akteve të marrjes së tokës në pronësi" (*Me hollësisht trajtuar ne faqe 85-100 të Raportin Përfundimtar të Auditimit*).

**7.1. Rekomandimi:** Nga Njësia Administrative Zall-Bastar në të gjitha raste para se të përcjellje dokumentacioni për në DV ASHK Rurale 1, të verifikojë normën për frymë, bazuar në certifikatën familjare datë 01.8.1991 dhe datë 01.10.1992.

***Në vijimësi***

**8. Gjetje nga auditimi.** Nga auditimi u konstatua se në 2 raste ka mangësi dokumentare dhe nuk ka sqarime të dokumentuar:

-për pasuritë nr. 2/9 dhe 2/11 që i përkasin ZK 1309, fshati Bulcesh dhe jo në ZK 3884 Fshati Zall Bastar,

- për pasurinë 28/8, me sipërfaqe 1550 $m^2$ sipas planit të rilevimit datë 12.11.2020 dhe sipas rreshtit nr. 4 në AMTP nr. 33, datë 25.08.2000 për 1250 $m^2$ pemëtore dhe 300 $m^2$ truall.

Të cilat sipas ASIG nuk janë tokë bujqësore veprime në kundërshtim me Ligjin nr. 7501, datë 19.07.1991 "Për Tokën", dhe me VKM nr. 994, datë 9.12.2015 "Për procedurën e regjistrimit të akteve të marrjes së tokës në pronësi" (*Me hollësisht trajtuar ne faqe 85-100 të Raportin Përfundimtar të Auditimit*).

**8.1. Rekomandimi:** Nga Njësia Administrative Zall-Bastar në të gjitha raste para se të përcjellje dokumentacioni për në DV ASHK Rurale 1, të verifikojë nëse kërkuesi ka qenë i legjitimuar për të përfituar tokë sipas akteve ligjore e nënligjore për ndarjen e tokës bujqësore.

***Në vijimësi***

**9. Gjetje nga auditimi.** Nga auditimi u konstatua se në 2 raste janë regjistruar pasuri të regjistruara me azhurnimin e vitit 1998 sipas kufijve të vjetër të para kolektivizimit nuk ka azhornim faktik dhe saktësimin e gjendjen të pasurisë së poseduar faktikisht në terren.
-Pasuritë me nr. 93, vol 1, faqe 93 ZK 3775 me sipërfaqe 6000 $m^2$ fshati Vilëz dhe nr. 711 vol. 3, faqe 211. 6600 $m^2$ "arrë" për
Pasuritë në emër të R I t për 4406 $m^2$, tokë arë, 75 $m^2$ pemëtore dhe 300 $m^2$ truall, sipas kufijve të vjetër (*Me hollësisht trajtuar ne faqe 85-100 të Raportin Përfundimtar të Auditimit*).
**<u>9.1. Rekomandimi:</u>** Nga Njësia Administrative Zall-Bastar në të gjitha raste para se të përcjellje dokumentacioni për në DV ASHK Rurale 1, të verifikojë nëse kërkuesi ka qenë i legjitimuar për të përfituar tokë sipas akteve ligjore e nënligjore për ndarjen e tokës bujqësore.

***Në vijimësi***

Për sa më sipër paraqitet ky Raport Përfundimtar Auditimi.

**KONTROLLI I LARTË I SHTETIT**